



BULETINI ZYRTAR

Nr. 10 , 2014

Tiranë , 2014

Buletini Zyrtar Nr. 10 , 2014

Përgatitur nga :
Autoriteti i Konkurrencës

Përpunimi grafik dhe printimi:



Botuar nga :

Autoriteti i Konkurrencës,
Rruga "Sami Frashëri", Nr.4, Kati 4

tel: 035542234504

fax: 035542234497

website: www.caa.gov.al

e-mail: competition@caa.gov.al

©Autoriteti i Konkurrencës , 2014

Përmbajtja

Vendimi Nr. 302, datë 14.01.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit.....**Fq. 8**

Vendimi Nr. 303, datë 16.01.2014 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA dhe rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare”
.....**Fq. 13**

Vendimi Nr.304 , datë 27.01.2014 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 292, datë 16.09.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës.....**Fq. 39**

Vendimi Nr. 305, datë 14.02.2014 “Për ndryshime në vendimin e KK nr. 300, datë 06.12.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”
.....**Fq. 41**

Vendim Nr.306, datë, 19.02.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës”.....**Fq. 44**

Vendim Nr.308, datë 21.02.2014 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës ne tregun e shërbimit të transportit ajror”**Fq. 47**

Vendim Nr. 309,datë 06.03. 2014 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët në mënyrë të tërthortë në shoqërinë Beralb SH.A nëpërmjet transferimit të 50% të aksioneve të shoqërisë Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS, nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS tek shoqëritë Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co.LTD dhe CRM International (Beijing) Co.LTD”
.....**Fq. 53**

Vendim Nr. 310, datë 31.03.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.”**Fq. 59**

Vendim Nr. 311 , datë 17.04.2014 “Kërkesë për sigurimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enerprises S.A”**Fq. 66**

Vendim Nr. 312, datë 18.04.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me funksionimin etregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve”**Fq. 68**

Vendim Nr.313 , datë 30.04.2014 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të biznesit të markës ACE nga shoqëria Fater S.p.a me anë të blerjes së aseteve nga shoqëria The Procter & Gamble.”

.....**Fq. 72**

Vendim Nr.314, datë 08.05.2014 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit, shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit”**Fq.78**

Vendim Nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”**Fq.85**

Vendim Nr. 316, datë 23.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”**Fq.95**

Vendim Nr.317 , datë 23/05/2014 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës”**Fq.100**

Vendim Nr. 318,datë 02.06. 2014 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë ndaj ndërmarrjes Heaney Assets Corporation për mosdhënie të dhënash brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit**Fq.106**

Vendim Nr.319, datë 13.06.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”**Fq. 109**

Vendim Nr.320, datë 24/06/2014 “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”**Fq.115**

Vendim Nr. 321, datë 01/07/2014 “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “ Rapiscan Sustems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”**Fq.118**

Vendim Nr. 322 , datë 03.07.2014 Për miratimin e Rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave”**Fq.121**

Vendim Nr.323 , datë 08/07/2014 “Për vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes “Pelikan Security” Shpk në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike”**Fq.128**

Vendim Nr.324, datë 30.07.2014 “Për vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”**Fq.133**

Vendim Nr.325 , Datë, 30/07/2014 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”**Fq.143**

Vendim Nr. 326, datë 08.09.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregëtimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”**Fq.154**

Vendim Nr.327, datë 08/09/2014 “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për revokimin e Vendimit nr. 325, datë 30.07.2014 të Komisionit të Konkurrencës”**Fq.157**

Vendim Nr. 328, datë 11.09.2014 Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit nga Alpha Bank S.A, të aseteve të zotëruara nga CitiBank Internacional PLC që i përkasin aktivitetit të shërbimeve bankare për individë në Greqi dhe të ndërmarrjes Diners Club of Greece Finance Company S.A”**Fq.163**

Vendim Nr.329 , Datë 29.09.2014 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 316, datë 23.05.2014 ”Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”**Fq.169**

Vendim Nr. 330, datë 03.10.2014 Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të plotë nga shoqëria Ferrero International S.A të shoqërive të Oltan Group”**Fq.172**

Vendim Nr. 331, datë 07.10.2014 Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë CEZ SH.A nga shoqëria CEZ A.S. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.....**Fq.177**

Vendim Nr.332 , datë 09.10.2014 Për miratimin e udhëzimit “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominues”**Fq.184**

Vendim Nr.333 , datë 21.10.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”**Fq.206**

Vendim Nr. 334, datë 31.10.2014 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes”**Fq.209**

Vendim Nr. 335, datë 31.10.2014 Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të plotë nga shoqëria TransAtlantic Petroleum Ltd të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd”**Fq.215**

Vendim Nr.336, datë 11.11.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj shoqërisë Vodafone SH.A”**Fq.219**

Vendim Nr.337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”**Fq.221**

Vendim Nr. 338, datë 11.11.2014 “Mbi përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes-Tip mes shoqërisë “Digitalb” SH.A dhe operatorëve televizivë”**Fq.225**

Vendim Nr. 339, datë 24.11.2014 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 324, datë 30.07.2014, të Komisionit të Konkurrencës mbi kushtet dhe detyrimet ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik”**Fq. 232**

Vendim Nr. 340 , datë 27.11.2014 Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur CMA CGM Albania Sh.p.k nga ndërmarrjet CMA CGM Agencies Worldwide dhe Pelikan Sh.p.k ”**Fq.238**

Vendim Nr. 341 , datë 27.11.2014 “Për vendosjen e një gjobe të lehtë ndaj shoqërisë “Pelikan” Sh.p.k për njoftimin jashtë afatit të përqendrimit të realizuar me CMA CGMA Agencies Worldwide për krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k.”**Fq.243**

Vendim Nr. 342, datë 27.11.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikua”**Fq.246**

Vendim Nr. 343, datë 04.12.2014 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të 100% të kapitalit aksionar të Landeslease Sh.a nga Union Bank Sh.a ”.**Fq.249**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
Nr. 302, datë 14.01.2014**

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit
dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv.kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun përkatës të importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit (cigareve të fabrikuara dhe duhanit “Rrotulloje vetë” .

Baza ligjore:Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 42, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të Grupit të Punës mbi monitorimin e tregut përkatës të importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit (cigareve të fabrikuara dhe duhanit “Rrotulloje vetë”);
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës

VËREN SE :

I. BAZA LIGJORE DHE PROCEDURA E NDJEKUR

1. Në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji), Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka monitoruar dhe analizuar kushtet e tregut përkatës të duhanit (cigareve të fabrikuara dhe duhanit “Rrotulloje vetë”) për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.
2. Monitorimi i tregut përkatës është bërë në zbatim të urdhërit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës nr 2 .datë 08.01.2014, “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e tregut të duhanit dhe nënprodukteve të tij” dhe në zbatim të nenit 28, germa a të ligjit nr. 9121, datë 28.04.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar mbi bazën e shqetësimeve publike mbi rritjen e çmimeve të produkteve të duhanit dhe cigareve më shpejt dhe në një masë më të madhe sesa rritja e akcizës sipas paketës fiskale që hyri në fuqi më 1 janar 2014.
3. Funksionimi i tregut të duhanit rregullohet me anë të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 17, datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (të ndryshuar). Sipas këtij udhëzimi, specifikisht pika 9.5.3. “Rregulla të përgjithshme”:
 - a) Çmimi maksimal i shitjes me pakicë të cigareve, për çdo lloj cigareje dhe çdo lloj pakete, përcaktohet nga furnizuesit kryesorë.
 - b) Furnizuesit kryesorë janë të detyruar të deklarojnë çmimin maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj pakete dhe çdo lloj cigareje. Deklarata e ndryshimit të çmimit të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete, duhet të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar furnizuesi kryesor, jo më vonë se 10 ditë para datës së aplikimit të çmimit të ri maksimal të shitjes me pakicë.
 - c) Furnizuesit kryesorë janë të detyruar të publikojnë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore nacionale dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketingu çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.
 - ç) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e detyruar të publikojë në faqen e saj të internetit çmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë të cigareve jo më vonë se dy ditë para datës së zbatimit të çmimeve të reja. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të publikojë çmimet maksimale të shitjes me pakicë të cigareve në çdo formë tjetër publikimi.
 - d) Ndalohet shitja e cigareve me çmim më të lartë se çmimi maksimal i shitjes me pakicë, i deklaruar sipas pikave a-d më lart. Drejtoritë Rajonale Tatimore kontrollojnë zbatimin e çmimeve maksimale të shitjes me pakicë të cigareve. Shitja e një pakete cigare me çmim më të lartë se çmimi i deklaruar, konsiderohet shkelje.
 - dh) Tatimpaguesit që kanë gjendje malli në magazinë deri në hyrjen në fuqi të skemës, e faturonjë atë për furnizuesin e tyre, me çmimin e blerjes. Furnizuesi kryesor e rifaturon këtë sasi ndaj furnizuesve të tjerë, në

përputhje me procedurat e parashikuara në këtë udhëzim. Njësitë e shitjes me pakicë, jo subjekte të TVSH-së, nuk kanë detyrim të faturojnë për furnizuesit e tyre. Gjithë ky proces vazhdon deri sa faturimi përfundon tek furnizuesi kryesor.”

4. Referuar Ligjit Nr. 180/2013 'Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, akciza për një paketë cigaresh e cila përmban 20 cigare, duke filluar nga viti 2014, do të shkojë në 90 lek për një paketë, pra 20 lek më shumë(pa tvsh) se një vit më parë. Ky ndryshim në akcizë do të analizohet nëse do të reflektohet në të njëjtën masë edhe në çmimin përfundimtar të produktit, pra çmimin e shitjes me pakicë të paketës.

II. TREGU PËRKATËS

5. Përcaktimi i tregut përkatës është realizuar në bazë të Udhëzimit nr.76 dt 07/06/2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës".
6. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a) Tregu përkatës i produktit
 - b) Tregu përkatës gjeografik

II.1 Tregu përkatës i produktit

7. Referuar rasteve të ngjashme trajtuara nga Autoriteti i Konkurrencës si dhe Komisioni European, industria e duhanit ndahet në nivelet e mëposhtme: rritja dhe kujdesi, përpunimi, prodhimi, dhe shpërndarja. Shpërndarja e produkteve të duhanit tek konsumatori final duke përdorur kanalet e tregtimit që mbizotërojnë në çdo shtet (psh shitësit me shumicë, distributorët, shitësit me pakicë, kioska, makina shitëse).
8. Në tregun e brendshëm treg përkatës do të konsiderohet vetëm segmenti i shpërndarjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit me produktet kryesore, cigaret e paketuara dhe duhani "rrotulloje vetë".

III. MONITORIMI I TREGUT

9. Gjatë ditëve të fundit ka patur një shqetësim publik në rritje mbi rritjen e çmimit të duhanit dhe cigareve të paketuara në një masë më të madhe sesa akcizat e rritura(24 lekë bashkë me TVSH) me miratimin e Paketës Fiskale që hyri në fuqi me datë 1 janar 2014. Madje në media dhe në opinionin publik ka një shqetësim se rritja e çmimit të cigareve ka filluar përpara se të hynte në fuqi paketa fiskale.
10. Statistikat zyrtare tregojnë se gjatë muajit Dhjetor 2013, në Shqipëri u importuan rreth 246 ton cigare më shumë e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky produkt fillimisht depozitohet nëpër magazina dhe pas një fare periudhe ai del në treg, dhe ky është moment kur për këtë mall paguhet akciza. Akciza e duhanit është rritur me 20 lekë në

fillim të këtij muaji, pasi aktualisht po tregtohen produktet e importit që në vend kanë hyrë gjatë vitit 2013.

11. Ndërsa sipas procesverbalit të mbajtur në Komisionin për veprimtarinë prodhuese, tregtinë dhe mjedisin në datë 13.11.2013 rezulton se tregu i cigareve ka një xhiro rreth 300 milion euro në vit ndër të cilat 70% e tyre janë tatime, si: akcizë, TVSH, taksë doganore dhe të gjitha llojet e tatimeve të tjera. Deri në fund të vitit 2013 akciza ka qënë 70 lekë për paketë.
12. Nga monitorimi i tregut të duhanit dhe cigareve të paketuara në nivelet e shitjes me shumicë dhe pakicë rezulton se ka patur rritje të çmimeve thuajse nga të gjithë shoqëritë aktive në tregun përkatës përpara hyrjes në fuqi të paketës fiskale që ndryshoi akcizën e këtij produkti.
13. Produkti duhan dhe cigare të paketuara është një mall që i nënshtrohet regjimit të akcizës dhe për këtë arsye konsumatori ka një kërkesë të fortë për këtë produkt që nënkupton një kërkesë inelastike ndaj çmimit.
14. Trasmetimi i akcizës dhe TVSH te konsumatori final është i pritshëm për karakteristikat e këtij produkti dhe ndryshimit të barrës fiskale, por Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë nivelin e konkurrencës në treg nëse ka kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës si pasojë e sjelljes së një ose disa konkurrentëve në treg në formën e abuzimit të mundshëm me pozitën dominuese (të përbashkët të disa ndërmarrjeve) dhe/ose marrëveshjeve të ndaluara për fiksimit të çmimeve.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4 dhe 9, nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës

V E N D O S I:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun përkatës të duhanit dhe cigareve të paketuara.
2. Hetimi paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2013 - 14 Janar 2014;
3. Procedura hetimit paraprak dhe dorezimi i raportit të hetimit do të behet jo më vonë se data 28 Shkurt 2014.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
Nr. 303, datë 16.01.2014**

**“Për
mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj
ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA dhe rekomandime për Autoritetin e
Komunikimeve Elektronike dhe Postare”**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- | | |
|-----------------------|------------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| • Rezana KONOMI | Zv/Kryetar |
| • Servete GRUDA | Anëtar |
| • Koço BROKA | Anëtar |
| • Iva ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 16.01.2014, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Rezana Konomi, Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi hetimin e thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë dhe i pretendimeve të shoqërisë “Vodafone Albania” SHA

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, neni 24, shkronja d) dhe f); neni 26 dhe neni 70 pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar;
Ligji nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Ndërmarrjet nën hetim: Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 275, datë 25.03.2013 ka përcaktuar se ndërmarrja objekt hetimi është ndërmarrja “Vodafone Albania” SHA, me adresë: Autostrada Tirane - , Rr “Pavaresia”, nr 61, Kashar, Tirane, Albania

Periudha e hetimit: Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 275, datë 25.03.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes ‘Vodafone Albania’ SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”, përcakton se periudha e hetimit është periudha 01.01.2011 deri në 31.12.2012.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Pretendimeve të ndërmarrjes nën hetim “Vodafone Albania” SHA me shkresën nr. 472 prot, datë 09. 12. 2013 dhe në seancën dëgjimore të datës 10.12.2013 pranë Autoritetit të Konkurrencës.

VËREN SE:

I. ÇËSHTJA NË SHQYRTIM

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, në fund të muajit nëntor 2012 janë depozituar 2 (dy) ankesa, në tregun e telefonisë celulare me pakicë, përkatësisht nga ndërmarrjet “Albanian Mobile Communication” SHA (këtu e në vijim AMC) dhe ndërmarrja “PLUS COMMUNICATION” SHA (këtu e në vijim Plus). Ankimuesit pretendojnë se ndërmarrja “VODAFONE Albania” SHA ka abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg nëpërmjet planeve tarifore (Vodafone Club dhe Vodafone Card). Gjithashtu, operatori Plus Communication ankohet për fushatën publicitare të Vodafon lidhur me bonusin për shpërndarësit e pavarur, i cili do të përfitohej nëse i jepnin përparësi reklamimit të gjithë produkteve Vodafone.
2. Tregu i telefonisë celulare është një treg i rregulluar, prandaj për vlerësimin e funksionimit të këtij tregu janë konsultuar vendimet dhe raportet e analizave të tregut të telefonisë së lëvizëshme të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Në vendimin e Bordit drejtues nr.2118, datë 4.07.2012 “Për miratimin e dokumentit “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit dokumenti përfundimtar”¹, në faqen 81 konstatohet se: “...në treg shohim një fenomen antikonkurrues që lidhet me diferencimin e theksuar të tarifave të thirrjeve brenda rrjetit dhe atyre jashtë rrjetit nga operatorët celularë të konsoliduar në treg pavarësisht se kostoja për thirrjet brenda rrjetit është e përafërt me koston për thirrjet jashtë rrjetit. Ky fenomen kushtëzon sjelljen e konsumatorit shqiptar, shkakton impakt negativ për konkurrencën e lirë në treg dhe kufizimin e saj për shkaqe që rrjedhin nga diskriminimi në aplikimin e thirrjeve brenda rrjetit dhe atyre jashtë rrjetit.....”.

II. PROÇEDURA

3. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e si vijon Ligji), me propozim të Sekretariatit, me Vendimin nr.258, datë 21.12.2012, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”. Me Vendimin nr.260, date 11.01. 2013, vendosi “Mbi

1 <http://akep.al/images/stories/AKEP/publikime/2012/Vendim-nr2118date4072012.pdf>

revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 258, datë 21.12.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë” dhe me anë të Vendimit nr. 261, datë 11.01.2013 të Komisionit të Konkurrencës, u vendos “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë” për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

4. Bazuar në gjetjet e raportit të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit, si dhe të nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit vendosi me anë të Vendimit nr.275, datë 25.03.2013, i ndryshuar me Vendimin nr. 280, datë 22.04.2013, për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.
5. Ky vendim iu njoftua ndërmarrjes nën hetim dhe ndërmarrjeve ankimuese me anë të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës nr. 150 prot., datë 26.03.2013.
6. Në vijim të procedurës, Sekretariati i paraqiti Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë. Ky raport iu bë me dije dhe ndërmarrjes nën hetim.
7. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës më datë 10 dhjetor 2013 organizoi seancën dëgjimore, në të cilën ndërmarrja nën hetim paraqiti në mënyrë verbale si edhe me shkrim pretendimet e saj mbi raportin e hetimit të thelluar. Pretendimet e palës me shkrim u depozituan me shkresën nr. 472 prot, datë 09. 12.2013 në Autoritetin e Konkurrencë dhe janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

III. TREGU PERKATËS

8. Në bazë të nenit 3, pika 7 të Ligjit, tregu përkatës përbëhet nga *“produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”*.
9. Në zbatim të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 76, datë 07.04.2008 ka miratuar udhëzimin “Për tregun përkatës”, sipas të cilit tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik. Përcaktimi i tregut si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, bëhet me qëllim që të identifikohen konkurrentët aktualë dhe potencialë të ndërmarrjeve që janë të përfshirë në atë treg, sjelljen e këtyre ndërmarrjeve, llogaritjen e pjesëve të tregut, përcaktimin e fuqisë së ndërmarrjes, strukturën e tregut me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg.

III.1 Tregu përkatës i produktit

10. **Tregu përkatës i produktit** përcaktohet si: “Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të

karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.

11. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, nënkupton që një rritje e çmimeve e bën një produkt më pak të pëlqyer nga konsumatorët, të cilët vendosin të blejnë më pak nga ai produkt dhe më shumë nga produktet zëvendësuese. Konsumatorët kanë interes që të informohen për operatorët që ofrojnë një gamë më të gjerë shërbimesh, ku përfshihen: pagesa fillestare e aktivizimit, pagesa mujore e abonimi, tarifat e pikut dhe jashtë pikut, telefonata dhe mesazhe me tekst të përfshira në paketë, tarifat e SMS, tarifat për thirrjet brenda rrjetit të njëjtë (on-net thirrjet), tarifat për thirrjet drejt rrjeteve tjera celulare (off-net), thirrjet drejt rrjeteve, ndër-subvencionet për celularin etj.
12. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës nënkupton që kompanitë të jenë të afta të këmbëjnë produktet e tyre me produktet e tregut përkatës dhe t'i tregtojnë ato në periudha afatshkurtra pa sjellë kosto shtesë, në përgjigje të ndryshimeve të vogla ose përhershme të çmimeve. Në fakt të gjitha ndërmarrjet ofrojnë shumë shërbime dhe mundësi, nëpërmjet planeve tarifore (paketa), të cilat përfshijnë: thirrjet dalëse, MMS, SMS.
13. Tregu objekt hetimi është tregu me pakicë i telefonisë së lëvizëshme ku si treg përkatës i produktit janë shërbimet publike të telefonisë së lëvizëshme të ofruara nga kompanitë, që përfshijnë aksesin e përdoruesve në rrjet dhe thirrjet dalëse të ofruara nëpërmjet paketave si me parapagim dhe me kontratë. Pra, përdoruesi ka mundësi ta ketë këtë shërbim gjithmonë me vete (nëpërmjet një aparati telefonik celular) dhe disponibël për ta përdorur në çdo vend, të paktën brenda territorit të shërbimit që mbulon operatori, ku përdoruesi është abonuar. Në këtë treg shërbimi me parapagim zë mbi 90% të tregut dhe për “Vodafone Albania” SHA kjo pjesë është 94,94%. Të gjithë pajtimtarët me parapagim janë përdorues privatë, ndërsa përdoruesit me kontratë janë përdorues privatë dhe biznese.
14. Telefonia fikse, nuk përfshihet në tregun përkatës për arsye të veçorive të ndryshme që ajo ka, në raport me telefoninë e lëvizëshme. Nga pikëpamja e konsumatorëve, shërbimet e telefonisë fikse nuk janë të zëvendësueshme me shërbimet e telefonisë së lëvizëshme.
15. Në tregun objekt hetimi operojnë 4 kompani celulare, të cilat veprojnë njëkohësisht në të dy nivelet e tregut, si në rrjedhën e sipërme (tregu me shumicë), ashtu dhe në rrjedhën e poshtme të tij (tregu me pakicë). Pra, këto ndërmarrje janë të integruara vertikalisht dhe ofrojnë shërbime për konkurrentët e tyre në tregun e shitjes me pakicë. Në treg nuk ka operatorë të tjerë të pavarur (MVNO), që t'u ofrojnë këtë shërbim përdoruesve fundorë.
16. Shërbimi SMS nuk është pjesë e tregut përkatës, për arsye të karakteristikave të ndryshme të këtij shërbimi me atë zanor. Shërbimi telefonik (edhe ai celular) ka si karakteristikë dalluese transmetimin e menjëhershëm të valëve zanore (zërit) nga pala thirrëse te ajo marrëse dhe anasjelltas, si dhe potencialisht është i pakufizuar në kohë. Shërbimi SMS nuk e ka këtë veçori.

17. Pavarishtë sa më sipër, për vetë zhvillimet që ka pësuar tregu (progresi teknologjik zëvendësueshmëria e SMS-ve me elementë të tjerë, shitjen në forme pakete etj), tregu i telefonisë celulare me pakicë është një treg i vetëm dhe përfshin të gjitha shërbimet e telefonisë celulare të ofruara nga operatorë të ndryshëm në nivel pakice
18. Për përcaktimin e tregut përkatës janë marrë në konsideratë dhe kriteret e tjera si: konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes, të cilat trajtohen në mënyrë të zgjeruar.

Bazuar në sa më sipër, **tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha shërbimet publike të telefonisë celulare të ofruar nga kompanitë celulare në tregun e shitjes me pakicë.**

III.2 Tregu përkatës gjeografik

19. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Zona gjeografike e shërbimit të telefonisë së lëvizshme të kompanive celulare me pakicë është territori i Republikës së Shqipërisë. Në bazë të licencave individuale, me të cilat këto kompani operojnë, ato ofrojnë shërbimet e tyre, vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE

20. Pozita dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të Ligjit përkatësisht: "Pozitë dominuese" është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët."
21. Sipas Ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.
22. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të Ligjit janë: pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë; barrierat e hyrjes në tregun përkatës; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve; fuqia kundërvepruese e blerësve konsumatorëve; zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve dhe mundësitë e shfrytëzimit të burimeve të produkteve; lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera; karakteristika të tjera të tregut përkatës.


IV.1 Pjesët e Tregut përkatës të konkurrentëve dhe shkalla e përqendrimit

IV.1.1 Pjesët e Tregut

23. Një nga kriteret bazë, nga e cila fillon analiza e pozitës dominuese është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Praktikisht më të mira të vendeve të Bashkimit Europian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit².
24. Në rastin e çështjes 85/76 Hoffmann-La Roche GJED³ specifikohet se: “megjithëse madhësia e pjesëve të tregut ndryshon nga tregu në treg, me të vërtete mund të thuhet që pjesë të mëdha të tregut përbejnë në vetvete, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, prove të ekzistencës se një pozite dominuese.”
25. Pjesët e tregut përkatës janë llogaritur bazuar në disa tregues: të ardhurat e gjeneruara në tregun me pakicë; të ardhura nga thirrjet dalese; të ardhurat nga SMS; të ardhura në total neto; numri i pajtimtarëve sipas pajtimtare aktiv dhe Karta SIM.

IV.1.1.1 Pjesët e tregut të pakicës sipas të ardhurave

26. Sipas Udhëzimit të Tregut Përkatës, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 76, datë 07.04.2008, parashikohet se niveli i të ardhurave është kriteri bazë për përlogaritjen e pjesëve të tregut. Llogaritja e pjesëve të tregut për nga të ardhurat e realizuara është tregues më i saktë për një reflektim më të mirë të pozicionit dhe të fuqisë së çdo ndërmarrje në treg. Këto të ardhura në tregun përkatës, realizohen nga thirrjet dalëse, SMS, MMS etj dhe pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku 1- Grafiku mbi të ardhurat e realizuara në retail nga ndërmarrjet për vitet 2011-2012⁴

² Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 - Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant

³ Vendimi i GjD, dt. 13 shkurt 1979 në çështjen 85/76, Hoffmann-La Roche, § 41 :. *...although the importance of the market shares may vary from one market to another the view may legitimately be taken that very large shares are in themselves, and save in exceptional circumstances, evidence of the existence of a dominant position*

⁴Burimi AKEP: Formulari E “Te dhena Financiare 2011-2012”

27. Sipas grafikut të mësipërm rezulton se ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu për nga të ardhurat e realizuara në tregun përkatës është Vodafone me 50% të tregut në vitin 2012 dhe 48.74% në vitin 2011. Konkurrenti i përafërt me Vodafone, AMC rezulton me 33% pjesë tregu në vitin 2012 duke ulur pjesën e tregut në krahasim me vitin 2011 me 2,94%. Në vitin 2012 dhe 2 operatorët e vegjël kanë patur ndryshime të pjesëve të tregut në menyre të papërfillshme.

IV.1.1.2 Pjesët e tregut sipas të ardhurave nga thirrje dalëse

28. Duke vlerësuar kriterin sipas të ardhurave nga thirrjet dalëse në tregun përkatës rezulton se: volumi total i të ardhurave të thirrjeve dalëse ka rënë 15% në krahasim me vitin 2011. Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për vitin 2012 është Vodafone Albania me 49,95% me një rritje të pjesës së tregut krahasuar me vitin 2011 me 1,31%. Ndërmarrja e dytë në treg është AMC me pjesë tregu 37,6% në vitin 2012, të ardhurat e të cilës janë ulur me 2.2% në krahasim me vitin 2011. Ndërmarrja Eagle Mobile zë 9,67% të tregut në vitin 2012, të ardhurat e së cilës janë ulur me 27% krahasuar me vitin 2011. Ndërmarrja Plus Communication zë 2,78% të pjesës së tregut sipas të ardhurave nga thirrjet dalëse. Dinamika e pjesëve të tregut sipas të ardhurave dalëse paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:




Grafiku 2. Pjesët e tregut nga të ardhurat dalëse

IV.1.1.3 Pjesët e tregut sipas të ardhurave nga SMS

29. Duke vlerësuar kriterin sipas të ardhurave nga SMS⁵ rezulton se: për periudhën 2011-2012, ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut është Vodafone Albania (viti 2011 58,69%, viti 2012 58,91%) pasuar nga shoqëria AMC me 27,54%, Eagle Mobile me 10,01% dhe Plus Communication me 3,54%. Dinamika e pjesëve të tregut sipas këtij treguesi është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:


⁵ Te ardhurat e realizuara nga SMS zene rreth 10-11% të ardhurave në total në tregun me pakicë



Grafiku 3: Pjeset e tregut nga SMS në tregun përkatës 2011-2012

IV.1.1.4 Pjesët e tregut sipas të ardhurave totale neto të telefonisë celulare

30. Sipas treguesit të të ardhurave totale neto, ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu për vitin 2012 është Vodafone Albania me 56,31%⁶ krahasuar me 51,71% në vitin 2011. Ndërmarrja më e afërt është AMC, pjesët e tregut sipas këtij treguesi kanë rrënë nga 34,19 në vitin 2011 në 29,49% në vitin 2012. Ndërmarrja Eagle Mobile është ndërmarrja e tretë e cila ka ulur pjesën e tregut krahasuar me vitin 2011, ndërsa ndërmarrja Plus Communication ka rritur të ardhurat por përsëri ngelet në nivelin 4,5%. Kjo dinamikë paraqitet si më poshtë:



Grafiku 4: Pjesët e tregut për nga të ardhurat totale për periudhën 2011-2012 për ndërmarrjet e telefonisë celulare⁷

31. Duke vlerësuar treguesit e të ardhurave të kompanive për periudhën 2011-2012 rezulton se të ardhurat totale të telefonisë celulare në vitin 2012 janë rritur në krahasim me vitin 2011, por janë pothuajse në nivelin e vitit 2010. Rritja totale e të ardhurave është 7%. Rritjen më të madhe në vlerë relative e ka ndërmarrja Plus Communication. Ndërmarrja Vodafone ka rritur të ardhurat me 16,9% në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011. Ndërmarrja AMC, si konkurrenti më i afërt ka ulur të ardhurat krahasuar me vitin 2011 me 7% , ndërsa ndërmarrja Eagle mobile ka ulur të ardhurat me 14%.

⁶ In Case C-62/86, AZKO Chemie BV vs. Commission (1991), the European Court of Justice considered that a market share of 50% could be considered to be very large such that, absent exceptional circumstances, an undertaking with such a market share would be presumed dominant.

⁷ Burimi: Të dhenat nga pasqyrat financiare të kompanive celulare

32. Dinamika e këtij treguesi, si tregues përgjithësues, për dy konkurrentët me të afërt, Vodafon dhe AMC tregon se pjesa e tregut të Vodafon Albania nga 48% në vitin 2010 bëhet 56.31% në vitin 2012, ndërsa AMC nga 40% në vitin 2010 bëhet 29.49% në vitin 2012.

IV.1.2. Pjesët e tregut sipas volumit

33. Llogaritja e pjesëve të tregut dhe e madhësisë totale të tregut është bërë edhe mbi bazën e volumit të shprehur sipas treguesve: numri i përdoruesve të kartave SIM dhe numri i përdoruesve aktivë.

34. Nga tabela e mëposhtme në bazë të vlerësimit të pjesëve të tregut (e pasqyruar në kolonat “MSH 2011 dhe MSh 2012” sipas kriterit të numrit të pajtimtareve të kartave SIM dhe pajtimtareve aktivë rezultojnë se:

Tabela 1: Pjesët e tregut të operatorëve sipas kartave SIM⁸, dhe pajtimtarëve aktivë⁹ për vitet 2011-2012¹⁰

N/r	Ndermarrjet	M SH 2011		M SH 2012	
		Karta SIM	Aktive	Karta SIM	Aktive
1	VODAFONE	38.66%	44.22%	42.54%	43.07%
2	AMC	41.02%	37.47%	39.48%	40.66%
3	Eagle mobile	11.84%	12.38%	11.61%	10.42%
4	Plus Communication	8.48%	5.94%	6.37%	5.85%
	Totali	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

- Numri i përdoruesve për kartat SIM aktive në total është rritur nga XXX në vitin 2011 në XXX në vitin 2012 me një rritje 1,43%. Ku Vodafon Albania pësoi një rritje të numrit të përdoruesve të kartave SIM me 11.63% në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011. Bazuar në numrin e pajtimtarëve për kartat SIM aktive për vitin 2012, ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu është Vodafone Albania me 42.54%, ndërmarrje e cila ka rritur pjesën e tregut në krahasim me vitin 2011 me 3,89%. Ndermarrja e dytë për vitin 2012 është AMC me 39.48% e cila ka ulur pjesën e tregut në krahasim me vitin 2011 me 1,54%. Rënie të numrit pajtimtarëve (SIM) por dhe në pjesë tregu (krahasuar me vitin 2011) ka ndërmarrja Plus Communication.
- Numri i përdoruesve aktivë në total është rritur me 12.66%. Rritjen më të madhe në këtë tregues e ka patur AMC me 22.26%, Plus Communication me 10,98% dhe Vodafone Albania me 9,73%. Bazuar në numrin e pajtimtarëve aktivë për vitin 2012, ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu

8 Sipas Raportit të AKEP të vitit 2012: numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfundon para afatit 1 vjeçar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj.

9 Burimi për vitin 2010 është marrë nga AKEP. Sipas Raportit vjetor të AKEP numri i përdoruesve aktivë janë përdoruesit që kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit.

10 Numri i pajtimtareve për kartat SIM dhe aktive ka ndryshim në krahasim me AKEP vetëm për Eagle, pasi AK ju është referuar të dhenave të operatorëve dhe Eagle Mobile me shkresën nr 3698/1 date 26.07.2013 prot me tonen 186/4 date 26.07.2013 ben sqarime lidhur me numrin e pajtimtareve, ku me shkresën nr 3698 prot date 28.06.2013 “Ne lidhje me pjesët e tregut të Albtelekom të percaktuara në bazë të numrit të pajtimtarëve “ i drejtohet edhe AKEP

është Vodafone Albania me 43.07%. Ndermarrja e dyte për vitin 2012 është AMC me 40.66% e cila ka rritur pjesën e tregut për vitin 2012 me 3,19% krahasuar me vitin 2011.

35. Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur pjesët e tregut për secilin nga ndërmarrjet bazuar në treguesit e të ardhurave dhe të volumit.

Tabela 2: Pjesa e tregut në bazë të ardhurave, përdoruesve dhe diferenca midis tyre për periudhën 2011- 2012

Kompanite	Pjesa tregut ne baze te ardhurave		Pjesa tregut ne baze te ardhurave totale neto		Pjesa tregut ne baze te perd aktive		Dif midis pjeses se tregut perd dhe te ardh		Dif midis pjeses se tregut perd dhe te ardh tot neto	
	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012
VODAFONE	48.74%	50.00%	51.49%	56.31%	44.22%	43.07%	-4.52%	-6.93%	-7.27%	-13.24%
AMC	35.74%	32.80%	34.04%	29.49%	37.47%	40.66%	1.73%	7.86%	3.43%	11.17%
Eagle mobile	13.72%	12.34%	12.52%	9.74%	12.38%	10.42%	-1.34%	-1.92%	-0.14%	0.68%
Plus comm	1.80%	4.85%	1.95%	4.46%	5.94%	5.85%	4.13%	1.00%	3.98%	1.39%

Burimi: Ndermarrjet dhe AKEP përpunuar nga AK

36. Tabela e mësipërme tregon një diferencë ndërmjet pjesës së tregut të të ardhurave në raport me pjesën e tregut të përcaktuar në bazë të përdoruesve aktivë, por të gjithë treguesit shprehin se Vodafon Albania ka pjesë tregu të konsiderueshme.

IV.2. Vlerësimi i fuqisë së tregut

37. Fuqia e tregut është fuqia për të patur ndikim mbi parametrat e konkurrencës në treg. Matës specifik i përqendrimit të tregut, domethënë i shkallës në të cilën një numër i vogël i firmave zënë një përqindje të madhe të tregut të produktit është Indeksi Herfindahl-Hirschman, (HHI-ja) i cili përdoret si një tregues i mundshëm i fuqisë së tregut ose i konkurrencës midis firmave¹¹.

38. Vlerat e indeksit HHI për periudhën 2011-2012 i bazuar në pjeset e tregut per numrin e përdoruesve dhe te ardhurat në tregun përkatës dhe të ardhurat në tregun e telefonisë celulare, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

11 Indeksi Herfindahl-Hirschmann (IHH) Ky indeks mat përqendrimin e tregut duke mbledhur përqindjet e tregut në katror të të gjitha firmave të industries. Sa më i lartë të jetë IHH-ja për një treg të caktuar, aq më shumë është i përqendruar produkti i atij tregu në një numër të vogël firmash. Me fjalë më të përgjithshme, kur një IHH është më i vogël se 1 000, atëherë përqendrimi i tregut mund të konsiderohet si i ulët, kur është midis 1 000 dhe 1 800 mund të konsiderohet mesatarisht i përqendruar, ndërsa nëse është më i madh se 1 800 mund të konsiderohet si i lartë.

Table 3-Tabela mbi indeksi perqendrimit(HHI) per periudhën 2011-2012 ¹²

Kompanite	HHI 2011					HHI 2012				
	AMC	Vodafone	Eagle	Plus	totali	AMC	Vodafone	Eagle	Plus	totali
ardhura tregu pakice	1,278	2,375	188	3	3,844	1,076	2,500	152	24	3,752
perdorues SIM	1,683	1,494	140	72	3,389	1,559	1,810	135	41	3,544
perdorues aktive	1,404	1,955	153	35	3,548	1,653	1,855	109	34	3,651
ardhura totale	1,159	2,651	157	4	3,970	870	3,170	95	20	4,155

39. Nga të dhënat e tabelës vihet re një vlerë shumë e lartë e indeksit HHI, ku sipas të ardhurave të gjeneruara në tregun me pakicë është 3752, duke rënë lehtësisht krahasuar me vitin 2011 (3844) dhe për numrin përdoruesve kartave aktive është 3651, duke u rritur lehtësisht krahasuar me vitin 2011. Shkalla e përqendrimit sipas treguesit të të ardhurave në tregun përkatës është rritur nga 2375 në 2500 për ndërmarrjen Vodafone Albania dhe sipas të ardhurave totale neto në telefoninë celulare nga 2651 në 3170, ku vetëm ky operator e tejkalon shkallën e lartë të përqendrimit¹³. Në këtë shkallë përqëndrimi fuqia e dy operatorëve me te rinj Eagle dhe Plus Communication është e pakonsiderueshme.

40. Vlerat e HHI për tregun me shumicë janë të njëjta me vlerat e HHI për tregun me pakicë të shërbimeve celulare si rezultat i mospjesëmarrjes së ofruesve të pavarur të shërbimeve nga MVNO, pasi rezulton të mos ketë të tilla, ndonëse me ligj mund të operohet në këtë treg. Në vendet e tjera përfshirja e MVNO, ka çuar në zbutjen e këtij indeksi.

41. Përgjithsisht, në tregun e telefonisë celulare HHI është më e lartë se në tregjet e tjera, pasi në këtë lloj tregu operojnë një numër i kufizuar operatorësh. Në kushtet e madhësisë së tregut shqiptar, ku operojnë 4 ndërmarrje, ky tregues duhej të ishte shumë më i ulët. Fakti që treguesi i shkallës së përqendrimit është i lartë dhe ka pësuar një rritje të lehtë të gjatë periudhës objekt hetimi, tregon që tregu nuk ka përmirësim në treguesit e konkurrencës.

IV.3. Pengesat në hyrjen në tregun përkatës

42. Tregu i telefonisë së lëvizshme në Shqipëri është i rregulluar. Institucioni i ngarkuar për rregullimin e tregut të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë është AKEP.

43. Me gjithë ndryshimet në legjislacion, aktualisht në tregun celular me pakicë nuk ka ende ofrues të pavarur shërbimesh apo MVNO. Ky fakt përben një tregues se tregu celular me pakicë vazhdon të ketë pengesa për hyrjen në treg te ofruesve te shërbimeve.

44. Pengesat në hyrje mund të jenë administrative, teknike dhe ekonomike.

¹²Burimi: të dhena të sjella nga kompanite, perpunuar nga AK sipas pjesëve të tregut, si dhe AKEP

¹³ 1800

IV.3.1 Pengesat administrative dhe teknike

45. Në Republikën e Shqipërisë numri i licencave për të ushtruar veprimtari në tregun e telefonisë celulare është i kufizuar, për shkak të burimeve të kufizuara natyrore siç janë frekuencat. Aktualisht në treg janë dhënë të 4 (katër) licencat e mundshme dhe nisur nga hapësira e burimeve natyrore, nuk ka mundësi teknike dhe administrative për licenca të tjera në dispozicion. Kjo shpreh mjaft qartë faktin se kemi të bëjmë me një treg ku ekzistojnë barriera hyrëse administrative.
46. Spektri i radiofrekuencave është një burim natyror i kufizuar, ndërkohë që Plani Kombëtar i Radiofrekuencave, ose ndryshimi i tij miratohet nga Këshilli i Ministrave. Për këtë arsye, edhe me hapjen e plotë për konkurrencë të tregut të telekomunikacioneve që ndodhi më herët, disa shërbime do vazhdojnë të ekzistojnë në këtë kategori ku numri i licencave është i kufizuar. Kjo shpreh mjaft qartë faktin se kemi të bëjmë me një treg ku ekzistojnë barriera hyrëse teknike.
47. Fakti që Shqipërisë i është lënë një kuotë e caktuar bandash në kategori të ndryshme frekuencash nga ITU (International Telecommunication Union), të cilat e lejojnë në maksimumin e tyre licensimin e vetëm 4 ndërmarrjeve të telefonisë mobile, tregon, përsëri, se kemi të bëjmë me barriera teknike.

IV. 3.2 Pengesat ekonomike

48. Së pari, kostot për hyrjen dhe daljen e një operatori në tregun e telefonisë së lëvizshme janë të konsiderueshme, sidomos ajo që konsiderohet kosto e pakthyeshme;
49. Së dyti, investimet fillestare për ndërtimin e rrjeteve të telefonisë celulare të operatorve që hyjnë në këtë treg, janë mjaft të mëdha. Për hyrësit e rinj siç janë Eagle Mobile dhe Plus Communication, këto investime për të hyrë fuqishëm në këtë treg janë më shumë të kushtueshme, pasi ato nuk mund të arrijnë në mënyrë të shpejtë shitjet dhe numrin e mjaftueshëm të pajtimtarëve;
50. Së treti, këto kosto janë të pakthyeshme, pasi pajisjet e përdorura për ndërtimin e rrjetjeve nuk mund të përdoren për qëllime të tjera. Kostot e pakthyeshme përbëjnë një kufizim për konkurruesit, dhe janë një barrierë e konsiderueshme ekonomike nëse ndërmarrja del nga tregu.
51. Ekonomitë e shkallës¹⁴ mund t'i japin ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun përkatës avantazh mbi konkurrentët e vegjël. Kur një kompani celulare bën investime të mëdha për ndërtimin e rrjetit, si: stacionet; antenat; pas përfundimit të ndërtimit të të gjithë rrjetit, shtimi i çdo klienti të ri, çon në reduktimin e kostove mesatare të kësaj kompanie. Operatorët e rinj në këto tregje nuk mund të kenë një trafik të madh në krahasim me operatorët ekzistues në treg, si rrjedhojë ato nuk përftojnë nga ekonomitë e shkallës.

14Burimi: Faqja zyrtare e internetit e legjislacionit të BE-së: <http://eur-lex.europa.eu> ... Operatori i telefonisë së lëvizshme arrin ekonomie e shkallës kur arrin të ketë 20% të tregut. 15-20% arrihet minimum i efikasitetit.

IV.4 Konkurrenca potenciale

52. Në tregjet që janë mjaftueshmërisht fitimprurëse ka prirje për të pasur hyrës të rinj në treg. Në këtë mënyrë, për vlerësimin e konkurrencës ponteciale duhet të merret në konsideratë faktorë të tillë si barrierat e hyrjes, reagimet e mundshme të ndërmarrjes më të madhe në treg dhe konkurrentëve të tjerë, si dhe riskun dhe koston e falimentimit.
53. Autoriteti i Konkurrencës dhe AKEP kanë ndërhyrë për rritjen e konkurrencës në treg nëpërmjet zbatimit të ligjit të konkurrencës dhe nxjerrjes së akteve rregulluese të këtij tregu, megjithatë tregu përsëri ka një shkallë shumë të lartë përqëndrimi, sikurse është evidentuar më lart. Për arritjen e një niveli të pranueshëm konkurrence, operatorët e mëdhenj, por edhe operatorët e vegjël ekzistues, duhet të kërkojnë klientët e tyre, midis atyre që tashme janë klientë të operatorëve të tjerë. Duke marrë në konsideratë indeksin e penetrimit që është 198,45%¹⁵, sipas përdoruesve të kartave SIM, shifër kjo më e lartë se shume vende të tjera, ky fenomen sjell vështirësi për operatorët e vegjël për të tërhequr klientë në rjetet e tyre.
54. Operatorët e vegjël për të qënë konkurrues duhet të përdorin çmime më të favorshme në krahasim me operatorët e mëdhenj të pranishëm në treg. Por, tërheqja e pajtimtareve kryesisht ndër klientët ekzistues të operatorëve të tjerë paraqet një pengesë për rritjen e aktorëve të pranishëm në treg.

IV.5. Fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve

55. Kompanitë celulare rezultojnë kompani me xhiron vjetore më të lartë në Shqipëri. Te ardhurat e gjeneruara në telefoninë celulare për vitin 2012 janë 41.1 miliardë lekë, nga 38,4 miliarde leke në vitin 2011.
56. Rezultati financiar për kompanitë celulare për vitin 2011, krahasuar me vitin 2010 është ulur me 49,93%. Kompania Vodafone Albania rezulton te ketë ulur rezultatin financiar në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 me 28,55%, kompania AMC ka ulur rezultatin me 34.9%, ndërsa dy konkurrentet me te vegjël kane thelluar rezultatet negative. Rezultati financiar i vitit 2012 krahasuar me vitin 2011 është ulur me 3,45%. Kompania Vodafone Albania rezulton te ketë rritur rezultatin financiar në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011 me 19,52%. Konkurrenti më i afërt i ndërmarrjes Vodafone, AMC ka ulur rezultatin financiar në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011 me 25,11%. Dy konkurrentet Eagle Mobile dhe Plus Communication rezultojnë me rezultat financiar negativ gjate periudhës 2010-2012.
57. Bazuar në të dhënat mbi të ardhurat e çdo kompanie evidentohet se konkurrenti më i afërt i ndërmarrjes Vodafone, ndërmarrja AMC¹⁶, ka ulur të

15 Raporti vjetor 2012 AKEP, ne raportin Report 2 final 20120706 Cullen international; Enlargement countries monitoring report 2 – July 2012; Cullen International – SEE Electronic Communications market – December 2011..... In Albania and Serbia mobile penetration is also higher than the EU average, ka ndryshuar ne raportin nr 3 Cullen International..... Kjo shifer ka ndryshuar per vitin 2012 është 114,3% pasi është korigjuar me numrin e pajtimtareve aktive tek Cullen International. Penetrimi i tregut 198,45% do të thote perdorimin e me shume se një karte nga një abonent,

16 Burimi: AKEP, ANALIZE E TREGUT të TELEFONISE SE LEVIZSHME fq 61 tabela IV 1

ardhurat në krahasim me vitin 2011 me 7% dhe të ardhurat e Vodafone rezultojnë 1.9 here me te larta se te AMC. Kompania AMC ka ulur të ardhurat në vite nga 39,63% në vitin 2010 në 29,49% në vitin 2012.

IV.6 Fuqia kundërvepruese e konsumatorëve dhe blerësve (konkurrentëve)

58. Vetë struktura e tregut të telefonisë celulare me pakicë është e tillë, që përdoruesit që blejnë sasira të konsiderueshme shërbimi celular janë mjaft të pakët në numër. Sikurse, e kemi përmendur në përcaktimin e tregut përkatës, numri i përdoruesve me parapagesë zë rreth 90-95% të numrit të përgjithshëm të përdoruesve. Pjesa tjetër prej 5-10%, abonentët me kontratë përdorin sasi më të mëdha të shërbimit të telefonisë celulare (me kontratë). Tek ndërmarrja Vodafone shërbimi me parapagesë zë 95% të të gjithë shërbimit që kjo ndërmarrje ofron në tregun përkatës. Abonentët e shërbimit me parapagim gjithsesi janë përdorues të vegjël dhe nuk kanë fuqi kundërvepruese, ndërsa pjesa tjetër e abonentëve përbëjnë një numër të vogël (megjithatë pjesa më e madhe e këtyre të fundit janë persona fizikë). Në këto kushte është e qartë, që përdoruesit në tregun e telefonisë celulare me pakicë, nuk zotërojnë ndonjë fuqi kundërvepruese për t'u marrë në konsideratë.
59. Ndërmarrja "Vodafone Albania" SHA ka krijuar avantazhe në tregun e telefonisë celulare, nëpërmjet krijimit të rrjeteve të veta, klientëve përkatës (abonentët), eksperiencës në menaxhimin e tregut, emër nëpërmjet marketingut, si dhe fuqi të konsiderueshme ekonomike dhe financiare. Në këto kushte, operatorëve të rinj do tu duhet kohë dhe mjete monetare të konsiderueshme, për tu bërë pjesë efektive e këtij tregu. Numri i abonentëve potencialë të mbetur në treg është relativisht i kufizuar.
60. Një tjetër përparësi për ndërmarrjet ekzistuese përbën edhe fakti që operatorët "Eagle" dhe "Plus" janë më të rinj dhe nuk kanë fuqi të madhe kundërvepruese. Gjithashtu, karakteristikë e rrjeteve të telekomunikacionit është se operatorët janë të integruar vertikalisht në tregjet e shumicës dhe të pakicës. Ky integrim përbën avantazh për operatorët ekzistues në krahasim me hyrësit e rinj.
61. Sa më sipër evidentohet që fuqia e tyre kundërvepruese e konkurrentëve të vegjël si Eagle Mobile dhe Plus Communication është e pandjeshme.
62. Ndërmarrja Vodafone Albania ka aktualisht një rrjet prej 136 pika shitje¹⁷ në të gjithë vendin, të cilat ofrojnë shërbim çdo ditë të javës. Dyqanet Vodafone ofrojnë produkte dhe shërbime të kompanisë Vodafone, telefona celulare dhe aksesore, si dhe asistencë teknike. Shërbimi i Kujdesit për Klientin i Vodafone Albania i përgjigjet nevojave të klientëve në 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

17 Burimi: faqja internetit http://www.vodafone.al/vodafone/Vodafone_Albania_202_1.php

IV.7 Karakteristika të tjera të tregut përkatës

63. Vodafone Albania¹⁸ SHA është pjesë e Vodafone Group Plc - kompani lider në botë në fushën e komunikimeve elektronike. Marka Vodafone renditet si marka e shtatë më e vlerësuar në botë. Vodafone është i pranishëm në më shumë se 30 vende të botës dhe është partner me rrjete të tjera në mbi 40 vende.
64. Kjo ndërmarrje ka akses në tregjet e kapitalit dhe burimet financiare, për arsye se është pjesë e grupit ndërkombëtar lider në fushën e telekomunikacioneve
65. Vodafone Albania është operatori i parë që prezantoi shërbimet e teknologjisë 3G në Shqipëri në Janar 2011. Tashmë Vodafone mbulon 99 % të popullsisë me sinjalin e rrjetit 3G.
66. Vodafone ju ofron mbi 2 milion klientëve të saj në Shqipëri një gamë të gjerë shërbimesh komunikimi të një cilësie të lartë, duke përfshirë komunikimin zanor dhe të të dhënave duke siguruar që klientët të përdorin rrjetin më të mirë të komunikimeve elektronike dhe të përfitojnë nga shërbime novatore dhe cilësore.
67. Gjatë periudhës objekt hetimi Vodafone Albania është operatori më i madh në tregun përkatës në krahasim me tre konkurrentët e tjerë.

Nisur nga pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit, por dhe nga praktikat me të mira të së drejtës europiane të konkurrencës ndërmarrja Vodafone Albania ka pozitë dominuese në tregun e telefonisë celulare me pakicë për vitet 2011-2012.

V. ANALIZA E SJELLJES SË NDËRMARRJES VODAFONE ALBANIA

68. Siç kemi argumentuar, ndërmarrja Vodafone ka pozitë dominuese në tregun përkatës, e cila, sipas Ligjit nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje në treg që kufizojnë konkurrencën, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të Ligjit.
69. Kjo bazohet edhe në përvojën e praktikave gjyqësore të njehsuara (unifikuese) dhe të konsoliduara të gjykatave në nivel BE. Konkretisht në

18 Burimi: faqja e internetit http://www.vodafone.al/vodafone/Vodafone_Albania_202_1.php

rastin e çështjes British Gypsum Ltd 65/89 GJED19 shprehet se: “Megjithëse qenia e një ndërmarrjeje në pozitë dominuese nuk mund ta ndalojë që të mbrojë interesat e saj tregtare kur cenohen dhe megjithëse kësaj ndërmarrjeje duhet t’i jepet e drejta, kur e sheh të nevojshme, të ndërmarrë hapa të arsyeshme për mbrojtjen e këtyre interesave, këto lloj sjelljesh gjithsesi nuk mund të lejohen në se kanë si objekt forcimin e pozitës dominuese dhe abuzimin me të”.

70. Sjellja e ndërmarrjes Vodafone me pozitë dominuese në një periudhë të mjaftueshme kohore mbështetur kryesisht në sjelljen e saj ndaj çmimit dhe ndaj konkurrentëve në tregun përkatës, analizohet në lidhje me planet tarifore që kjo ndërmarrje ofron, ofertat e tjera të planeve tarifore, bonuset e ofruara ndaj distributorëve dhe ofertat (PNOP) që lidhen me tërheqjen e abonentëve të rinj nëpërmjet portabilitetit të numrit.

V.1 Planet tarifore të ndërmarrjes Vodafone

71. Për periudhën e marrë në shqyrtim 2011-2012 Vodafone ka operuar me dy plane tarifore: Vodafone Card dhe Vodafone Club.

V.1.1 Çmimi i Vodafone për thirrjet brenda rrjetit (on-net)

72. Për periudhën e marrë në shqyrtim 2011-2012 Vodafone ka operuar me dy plane tarifore: 1- Vodafone Card dhe 2- Vodafone Club. Nga materiali i administruar, në lidhje me tarifimin on-net nga ana e Vodafone, domethënë ndërmjet klientëve Vodafone Club dhe Vodafone Card ka diferenca në tarifim.

73. Për një thirrje on-net, siç është rasti i të dy planeve tarifore me parapagesë të sipërpërmendura, origjinimi dhe terminimi i thirrjes bëhen në linjën e vetë operatorit (Vodafone), kështu që ky operator përballet veçse me dy operacione të brendshme. Duke vënë në dukje natyrën e njëjtë të operacioneve që kryhen deri tek klienti fundor, po paraqesim më poshtë në formë tabelare, diferencat në tarifim brenda rrjetit, për planet tarifore Vodafone Club dhe Vodafone Card.

Table 5: Tarifat²⁰ Vodafone Club brënda rrjetit 2011-2012²¹

Vodafone Club 2011		Vodafone Club 2012	
	Tarifa		Tarifa
Brenda Club	24.00 l/min	Brenda Club	24.00 l/min
Drejt nr Vodafone	54.00 l/min	Drejt nr Vodafone	54.00 l/min
Vodafone Card 2011		Vodafone Card 2012	
Drejt nr te tjere Vodafone	30.00 l/min	Drejt nr te tjere Vodafone	30.00 l/min

19 Vendimi i Gjykatës Shkalës së Parë i dt.1 prill 1993 në çështjen T-65/89, BPB Industries Plc et BritishGypsum Ltd c. Commission, § 69 : «Whilst the fact that an undertaking is in a dominant position cannot disentitle it from protecting its own commercial interests if they are attacked and whilst such an undertaking must be conceded the right to take such reasonable steps as it deems appropriate to protect its said interests, such behaviour cannot be countenanced if its actual purpose is to strengthen this dominant position and abuse it”

20 tarifat jane me tvsh

21 Burimi të dhenat e sjella nga Vodafone shkresa 733/2 dt 14.01.2013 CEO/004/MF

74. Në tabelën e mësipërme vihet re se përgjatë periudhës objekt hetimi për vitet 2011-2012, tarifat kanë ngelur të ngurtësuara dhe nuk ka pasur ndryshime në tarifat e aplikuara nga ndërmarrja Vodafone. Ndërmarrja Vodafone ka tarifuar pajtimtarët e tij brenda Vodafone Club-i me 24 lekë/min, kurse pajtimtarët e tij jashtë Vodafone Club, por brenda rrjetit Vodafone janë tarifuar me 54 lekë/min. Ndersa Vodafone ka tarifuar pajtimtarët e saj, të cilët i përkasin planit tarifor Vodafone Card me 30 lekë/min për çdo thirrje brenda rrjetit Vodafone, qoftë ndaj klientëve V.Club apo V.Card.
75. Tarifa nga Club drejt Vodafone është (2.25) herë më e lartë se ajo e aplikuar në telefonatat brenda Club. Në anën tjetër tarifimi për kategorinë e pajtimtarëve Vodafone Card është uniform. Vodafone Card ruan parimin e mosdiferencimit brenda rrjetit. Thirrjet e origjinuara nga një pajtimtar Vodafone Card drejt një pajtimtari Vodafone Club kushtojnë 30 lekë/min, në raport me 54 lekë/min që do t'i kushtonte thirrja pajtimtarit Vodafone Club drejt Vodafone Card (gati 2-fish). Kjo strategji e ndjekur nga ana e Vodafone, kërkon që pajtimtarët e Vodafone Club, të cilët janë më të shumtët në numër, ti mbajë të mbyllur brenda këtij Plani Tarifor. Kjo strategji e ndjekur nga Vodafone krijon të ashtuquajturin “Efekt Club”, sipas të cilit vetëm një grup i caktuar pajtimtarësh përfitojnë nga çmimet e ulëta, dhe kjo bëhet më e dukshme edhe në diferencimin midis vetë pajtimtarëve të Vodafone, që përdorin plane të ndryshme tarifore.
76. Ky diferencim në tarifim që kryen ndërmarrja Vodafone, nuk justifikohet me kostot që përballon operatori për kryerjen e këtyre thirrjeve, pasi shërbimet e origjinimit dhe terminimit janë operacione të brendshme, që janë të njëjta si për kategorinë e klientëve Vodafon Club ashtu edhe Vodafon Card. Në planin me parapagesë Vodafone Club vihet re diferencim on-net në tarifim, duke aplikuar tarifa të ndryshme për klientët e tij për thirrjet brenda Clubit dhe jashtë tij, megjithëse janë pajtimtar të Vodafone. Diferencimi në tarifim bëhet më i theksuar jo vetëm në terma absolutë, 54l/min me numrat e tjerë Vodafone, por edhe në terma relativë për shkak të tarifave shumë të ulëta brenda Clubit dhe tarifave 2.25 herë më të larta me klientët e tjerë Vodafone, pa lidhje të arsyeshme me koston.
77. Kjo i bën telefonatat e klientëve Club drejtuar klientëve brenda rrjetit më të shtrenjta dhe “mbyt” nismën e tyre për të dalë jashtë tij, dhe duke nxitur tërheqjen nga ana e klientëve aktualë Club të tjerëve jashtë Clubit për të shmangur daljen jashtë tij, e cila do t'i përballte me kosto të larta. Pra, ndërmarrja Vodafone, në planin e saj tarifor Vodafonë Club, i mbyll pajtimtarët e saj për të komunikuar vetëm brenda këtij Plani Tarifor.

V.1.2 Çmimi i Vodafone për thirrjet “Jashtë rrjetit” (Off-Net)

78. Lidhur me këto tarifa, janë marrë në shqyrtim tarifat që ndërmarrja Vodafone aplikon ndaj pajtimtarëve të vet, për secilin plan tarifor, për periudhën 2011-2012, për thirrjet drejt operatorëve të tjerë celulare, jashtë rrjetit (off-net).

Tabela 6:Tarifat Vodafone Për Thirrjet “Jashtë Rrjetit” për periudhën 2011-2012²²

Vodafone Club 2011		Vodafone Club 2012	
	Tarifa		Tarifa
Brenda Club	24.00 l/min	Brenda Club	24.00 l/min
Drejt nr Vodafone	54.00 l/min	Drejt nr Vodafone	54.00 l/min
Drejt nr Fiks	54.00 l/min	Drejt nr Fiks	54.00 l/min
Drejt AMC	54.00 l/min	Drejt AMC&Eagle	54.00 l/min
Drejt Eagle Mobile	56.40 l/min	Drejt Plus Communication	56.40 l/min
Drejt Plus Communication	63.60 l/min		
Vodafone Card 2011		Vodafone Card 2012	
Drejt nr te tjere Vodafone	30.00 l/min	Drejt nr te tjere Vodafone	30.00 l/min
Drejt nr Fiks	24.96 l/min	Drejt nr Fiks	24.96 l/min
Drejt AMC	35.88 l/min	Drejt AMC&Eagle	35.88 l/min
Drejt Eagle Mobile	38.40 l/min	Drejt Plus Communication	38.40 l/min
Drejt Plus Communication	45.60 l/min		

79. Në tabelën e mësipërme vihet re se për periudhën 2011-2012, tarifat edhe në kete plan tarifor kanë qënë relativisht të ngurtësuar. Për vitin 2012 kemi ndryshime në tarifim, si dhe rënie të tarifave të thirrjeve të origjinuara, si nga pajtimtarët Vodafone Card per Eagle Mobile dhe Plus Comunication, ashtu edhe nga pajtimtarët Vodafone Club, ndaj pajtimtarëve Eagle Mobile dhe Plus Comunication. Ndërmarrja Vodafone e njofton në tetor të vitit 2012 këtë reduktim të tarifave pranë AKEP.²³

V.1.3 Diferencimi ndërmjet çmimit të thirrjeve brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit të Vodafone

80. Në ndryshim nga thirrjet on-net për thirrjet off-net ndërmarrja nga e cila origjinohet thirrja duhet të përballet me kostot e terminimit në rrjetin e operatorit tjetër. Për një thirrje off-net operatori “thirrës” origjinojnë thirrjen dhe ia dërgon operatorit të thirrur, i cili nga ana e tij siguron terminimin e thirrjes. Operatori thirrës i paguan operatorit të thirrur këtë shërbim terminimi.

81. Kështu për një thirrje off-net, operatori thirrës origjinojnë thirrjen dhe blen terminimin e saj. Nëse tarifat ndaj klientëve finalë do të ishin të orientuar drejt kostove, këto kosto terminimi do të reflektoheshin në çmimin fundor.

82. Për të analizuar dinamikën e tarifave të aplikuara për një periudhë më të gjatë kohore, në tabelën e mëposhtme evidentohen tarifat e rregulluara nga AKEP në tregun e shitjes me pakicë për ndërmarrjen Vodafon Albania Sha, i cili ishte i përcaktuar si OFNT.

²² Burimi të dhenat e sjella nga Vodafone shkresa 733/2 dt 14.01.2013 CEO/004/MF

²³ Burimi AKEP, shkresa 2352/1 date 22.01.2013 Shkresa e Vodafone dt. 09.10.2012 drejtuar AKEP, nr. protokolli 1968, dt. 10.10.2012

Tabela 7: Reduktimi i tarifave me parapagim Vodafone Card sipas metodologjisë²⁴

TABELA IV.4. REDUKTIMI I TARIFAVE TE PROGRAMIT ME PARAPAGIM VADAFONE CARD, TE VODAFONE ALBANIA SIPAS METODOLOGJISE. (LEK/MINUTE +TVSH)

	Shtator 2008	Metodologjia: Shtator 2008-	Metodologjia: Shtator 2009	Ndryshimi Metodologjia
Brenda rrjetit Vodafone				
<i>Brezi orar PEAK</i>	45,60	34,80	30,00	-34%
<i>Brezi orar OFF-PEAK</i>	36,00	34,80	30,00	-17%
Drejt operatorëve të tjerë celularë	60,00	45,60	35,88	-40%
Drejt rrjeteve fiks	45,60	33,60	25,20	-45%

83. Duke ju referuar tabelës së mësipërme, tarifa e aplikuar nga Vodafon drejt operatorëve të tjerë celular, gjatë periudhës objekt hetimi, janë ndjeshëm më të larta se tarifat e përcaktuara sipas metodologjisë së aplikuar nga AKEP për të dy vitet: shtator 2008 dhe shtator 2009, e cila ka qënë periudhë gjatë të cilës tarifat e shitjes me pakicë kanë qënë objekt rregullimi.

84. Pra, pas liberalizimit të tarifave të telefonisë celulare me pakicë nga ana e AKEP, vihet re se ndërmarrja Vodafone ka rritur ndjeshëm tarifat e telefonisë celulare me pakicë, kryesisht ato drejt operatorëve të tjerë celular. Megjithatë, tarifat e terminimit janë ulur gjatë periudhës objekt hetimi, konkretisht 41% në vitin 2012 kundrejt 2010 (nga 10.5 në 6.10 lekë), tarifat e aplikuar nga ndërmarrja objekt hetimi nuk e kanë reflektuar uljen e vazhdueshme të tarifës së terminimit.

85. Gjithashtu diferenca midis thirrjeve brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit është shume e ngushte per periudhen që ka qënë në rregullim për 5.88 lekë me tvsh. Kjo diferencë është rritur ndjeshëm në 30 lekë, brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit gjatë periudhës nën hetim.

86. Çmimi i shumicës për Vodafone dhe AMC është i njëjtë (tarifa e terminimit 6.1 si për AMC dhe për Vodafone), por çmimet me pakicë për thirrjet jashtë rrjetit të Vodafone drejt AMC janë në mënyrë të konsiderueshme më të larta se çmimi mesatar për thirrjet brenda rrjetit të Vodafone (nga 20 leke pa tvsh brenda V Club në 45 leke pa tvsh drejt AMC ose 2.25 here më të larta). Diferencimi²⁵ i çmimeve të pakicës on-net të Vodafone drejt operatorëve të tjerë nuk kanë lidhje me çmimet e shumicës që Vodafone duhet t'u paguajë operatorëve për terminimin e thirrjeve, bazuar në rregulloren e AKEP-it. Në këto kushte mund të konsiderohet se këto diferenca në çmim janë të

24 Burimi AKEP: vendimi nr 1211, datë 31.03.2010 për "Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafon Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese" fq.101

25 Autoriteti i Konkurrencës në analizën e kryer është referuar rasteve të ngjashme dhe metodologjive të përdorura nga autoritetet e konkurrencës në shqyrtimin e analizës së abuzimit me pozicionin dominues si pasojë e diferencimit të tarifave brenda/jashtë rrjetit. Diferencimi i tarifave brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit nga kompanitë celulare në shumë shtete të Europës dhe më gjerë, kanë sjellë shqetësime vitet e fundit, duke nxitur reagimet e rregullatorëve dhe autoriteteve të konkurrencës përkatëse. Në rastin e Sllovenisë, Western Wireless International, i cili ishte operatori i trete në tregun e telefonisë celulare me pakicë u detyrua të dilte nga tregu pas pesë vjetëve nga hyrja në treg për shkak të vonësës së Rregullatorit për ndërhyrjen në treg për të adresuar problemet e konkurrencës shkaktuar

pajustificueshme dhe të orientuara për të nxitur klientët që të zgjedhin ose të qëndrojnë në rrjetin e Vodafone Club²⁶.

V.2 Karakteristikat e ofertave të zbatuara nga Vodafone Albania


87. Vodafone ofron paketa të lidhura të cilat ofrohen në formë ofertash për të dy planet tariforë me parapagesë, Vodafone Card dhe Vodafone Club.
88. Për Vodafone Card kemi vetëm një kategori oferte, e cila për të njëjtën vlerë dhe trafik minutash SMS apo MMS është më e volitshme për abonentin që të kalojë në planin tarifor Vodafone Club. Kjo për shkak të kufizimeve në lidhje me numrin e abonentëve, të cilët mund të thirren në mënyrë të palimituar, kufizime në lidhje me minutat dhe SMS-të kombëtare.
89. Nga ana tjetër ofertat e planit tarifor Vodafone Club janë më të shumta dhe me bazë ditore, javore, mujore. Ndryshueshmëria më e theksuar në këto paketa të ofruar është ai i ofertës javore. Pra, nëpërmjet ofertave të ndërmarrjes Vodafone në planin tarifor Vodafone Club i shtyn abonentët e vet që të kalojnë apo të zgjedhin planin tarifor Vodafone Club, pasi ofron një sasi shumë të madhe minutash, SMS, MMS dhe Internet brenda Vodafone Club, për të njëjtën sasi të hollash. Kalimi i abonentëve në planin tarifor Vodafone Club ka përfitime për komunikimin brenda këtij plani tarifor, por në rast se abonentin do të duhet të dalë jashtë këtij plani do të përballet me tarifa shumë të larta për thirrje drejt operatorëve të tjerë. Kjo do të bëjë që këta abonentë të mos kryejnë thirrje drejt operatorëve të tjerë celularë, duke pasur parasysh që këto thirrje janë të ardhura për operatorin tjetër celular, për shkak të tarifës së terminimit që Vodafone duhet të paguajë për këto thirrje.
90. Ofertat e Vodafone kufizojnë aftësinë për të bërë thirrje në mënyrë të pakufizuar në të vetmet thirrje on-net që rezultojnë me një diferencë tarifore në mes të çmimit të thirrjeve on-net dhe atij të thirrjeve off-net, duke qenë çmimi i të parave mjaft më i ulët se i thirrjeve të dyta.
91. Në raportin e hetimit të thelluar është analizuar oferta javore të Vodafone, (250 lekë pa tvsh) nga e cila rezulton se nëse kjo ofertë do të ofrohej nga 3 operatorët e tjerë, sa duhet të konsumonte një klient në mënyrë që këto të ishin konkurrues dhe në cilin nivel trafiku ndërmarrjet do të fillonin të kishin humbje duke marrë si kriter vetëm koston e shitjes me shumicë (pra të terminimit) të tyre drejt Vodafone.
92. Nga përlllogaritjet rezulton se nëse një klient i njëjës nga tre ndërmarrjeve të tjera konsumon 5.85 minuta në ditë me një klient të Vodafone, operatorëve u duhet të paguajnë 250 lekë në javë Vodafone si kosto e terminimit me shumicë tek Vodafone. Për 1200 minuta të terminuara tek Vodafone, secili nga tre operatorët e tjerë do të kishte një kosto terminimi prej 7320 lekë e cila është 29,28 herë më e lartë se sa paketa javore e Vodafone. Apo për

26 Diferenca e çmimit ndërmjet thirrjeve *on-net/off-net* është një praktikë e zakonshme në tregun e telekomunikacioneve të telefonisë celulare me pakicë. Si e tillë kjo i është nënshtruar hetimeve të ndryshme dhe sanksionohet/ndalohehet në disa shtete shihni vendimin e Autoritetit Francez *Kjo praktikë e diferencimit të çmimeve, e cila nuk ka asnjë justifikim objektiv ekonomik, ka për pasojë të shtrembërojë dhe të kufizojë konkurrencën në tregun me pakicë për telefoninë mobile*

600 SMS të terminura tek Vodafone, do të kishte një kosto terminimi e cila është 4,8 herë më e lartë sesa paketa javore e Vodafone.

93. Analiza e mësipërme është aplikuar edhe për ofertën mujore të Vodafone, (833.33 lekë pa tvsh). Përlllogaritjet tregojnë se nëse një klient i operatorëve të tjerë konsumon 4,55 minuta në ditë me një klient të Vodafone, dhe këtyre operatorëve u duhet të paguajnë 833,33 lekë në muaj operatorit Vodafon si kosto e terminimit me shumicë tek ky operator. Në këtë mënyrë operatorëve të tjerë nuk do tu mbetej asnjë e ardhur për të mbuluar kostot e tyre. Për 3000 minuta të terminuara tek Vodafone këto operatorë do të kishin një kosto terminimi prej 18300 lekë e cila është shumë më e lartë se sa paketa javore e Vodafone.

94. Në këto kushte për të qene konkurrues ndërmarrjet e vogla duhet të ulin më shumë çmimet e tyre fakt i cili u rrit kostot. Asimetria në numrin e pajtimtarve shkakton trafik të ulët drejt operatorëve të vegjël dhe sjell të ardhura negative nga terminimi. Ky fakt evidentohet tek bilanci i terminimit te Vodafone Albania, (të ardhura që ka gjeneruar shoqëria Vodafone të detajuar sipas çdo kompanie për periudhën 2011-2012 mbi bazë vjetore, si dhe pagesat e shoqërisë Vodafone për shoqëritë e tjera celulare), paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku 5: Bilanci i terminimit (te ardhurat-shpenzimet në leke)²⁷ per vitet 2011-2012 per ndermarrjen Vodafone.

95. Gjithashtu, për thirrjet jashtë rrjetit, ndërmarrja Vodafone aplikon çmime shumë të larta për thirrjet drejt operatorëve të tjerë celularë, të cilat nuk kanë lidhje me vlerën e tarifës së terminimit që ndërmarrja Vodafone do të duhet t'u paguajë këtyre operatorëve, e cila është një e ardhur për këta operatorë. Pra ndërmarrja Vodafone nëpërmjet aplikimit të çmimeve të larta për thirrjet jashtë rrjetit ngre një barrierë për pajtimtarët e vet për të kryer thirrje jashtë rrjetit, e cila do të gjeneronte të ardhura për konkurrentët e Vodafone ose shpenzime për terminimin për Vodafone. Kjo ulje e të ardhurave nga terminimi duket mjaft qartë edhe tek grafiku i mësipërm, ku duket mjaft qartë

27 Burimi: Vodafone reference CEO/060/MF date 03/05/2013 prot.AK 185/1 date 03.05.2013

që operatorët konkurrentë të tij, gjatë periudhës së hetimit, kanë dalë përgjithësisht me rezultat negativ nga terminimi.

V.3 Ngushtimi i marzhit të fitimit (margin squeeze)

96. Ndërmarrja AMC SHA në ankesën e saj me nr. 6525 prot., datë 23.11.2012, drejtuar Autoritetit të Konkurrencës dhe për dijeni AKEP, është ankuar ndaj ndërmarrjes "VODAFONE", lidhur me ofertën javore me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. (Sipas ofertës për 450 lekë përfitohet paketa javore me: 100 minuta kombëtare + 1200 minuta & 600 SMS (brenda Vodafone Club) + 50 MB).
97. Sipas analizës së kryer nga ndërmarrja AMC, kosto mesatare e interkoneksionit e bazuar në ndarjet e tregut llogaritet në 6.74 lek/minuti dhe në rast se abonenti përdor të gjitha minutat kombëtare të ofruara në paketë për telefonata jashtë rrjetit Vodafone, kosto totale e paketës është mesatarisht 674 lekë (çmimi i paketës është 375 lekë).
98. Sipas pretendimeve të ankuesit ky vëllim minutash kombëtare të përfshira dhe të ofruara në këtë paketë, në gjykimin e ndërmarrjes AMC, rezulton i ofruar nën koston e interkoneksionit dhe për këtë arsye përbën shitje nën kosto.
99. Analiza e diferencimit mes koston dhe të ardhurave është bërë mbi bazën e krahasimit të tarifës së terminimit (niveli i rrjedhjes së sipërme) dhe tarifave të pakicës (retail, niveli i rrjedhjes së poshtme). Ndërmarrja Vodafone ka pozitë dominuese në tregun rrjedhës së sipërme, pasi zotëron 100 % të tregut të shumicës (terminimi në rrjetin e vet) pa të cilin ndërmarrjet e tjera nuk mund të kryejnë thirrje në rrjetin Vodafone. Pra terminimi është një input i domosdoshëm për konkurrentët e Vodafone për të kryer thirrje drejt këtij rrjeti. Gjithashtu Vodafone është i integruar vertikalisht edhe në tregun e rrjedhës së poshtme (tregu i shitjes me pakicë), duke e transmentuar fuqinë në tregun e rrjedhës së sipërme edhe në tregun e rrjedhës së poshtme.
100. Ndërmarrjet e vogla që të jenë eficiente, për tu zgjeruar dhe rritur në treg, duhet të aplikojnë çmime jashtë rrjetit sa është çmimi brenda rrjetit i Vodafone, pasi nëse do të aplikonte një çmim më të lartë jashtë rrjetit, kjo nuk do të influenconte në zgjedhjen dhe ofrimin e pajtimtarëve drejt këtij operatori. Nga ana tjetër, operatorët e vegjël nuk mund të aplikojnë çmime kaq të ulëta për shkak të tarifës së terminimit që duhet ti paguajnë për çdo thirrje operatorit Vodafone dhe për pasojë konkurrentët e vegjël vendosen në pozita të pafavorshme kundrejt operatorit dominues në treg. Kjo sjellje reflektohet në bilancin e terminimit mes operatorëve (të ardhura të hyra vs të ardhura të dala) nga ku rezulton se Vodafone vazhdon të rrisë të ardhurat neto ndërkohë që të tre konkurrentët e tjerë reflektojnë të ardhura neto negative (humbje) nga ky bilanc. Parë në një periudhë më të gjatë kohe ky bilanc në mënyrë progresive rrit përfitimet neto të kompanisë dominante dhe rrit humbjet neto të konkurrentëve të tjerë.
101. AKEP ka miratuar tabelën me asimetrinë dhe procesin e reduktimit të tarifave të terminimit të dhënë mbi një bazë statike dhe të pandryshueshme në varësi të ndarjes së pjesëve të tregut mes operatorëve dhe të impaktit që

ka patur kjo metodologji në tregun e rrjedhjes së poshtme. Bazuar në tabelën mbi reduktimin e tarifave të terminimit miratuar nga AKEP rezulton se: nga tarifat e terminimit të trafikut me shumicë që origjinohet nga rrjeti i operatorëve dhe përcillet tek rrjeti fundor dhe planet tarifore Vodafone Club, kostoja bazë e thirrjes me shumicë off-net drejt operatorit Plus kushton të paktën 19.02 lek/min (12.92 kostoja e terminimit dhe 6.1 kosto origjinimi). Sipas tabelës së mësipërme për planet tarifore Vodafone Club për tarifat (pa tvsh) drejt operatoreve të tjerë, tarifa është 47 lek/minute. Diferenca prej 27.98 lek përfaqëson një normë fitimi të lartë prej 59%, (ose mbi 2 here tarifën e terminimit), duke dekurajuar klientët të kryejnë thirrje jashtë rrjetit. Vodafone shkon edhe më tej përmes ofertave të tij speciale (si p.sh. Vodafone Day Pass dhe/ose PNP dhe ofertave javore, mujore) dhe është në gjendje të ulë çmimin për thirrjet on-net.

102. Përmes paketës së ofertës speciale Vodafone²⁸ Day Pass²⁹ tarifon vetëm 60 lekë (me tvsh) ose 50 lekë pa tvsh për 600 minuta thirrje brenda rrjetit, 600 SMS/MMS, 60 MB internet 3G, ndërsa operatorët e vegjël për të njëjtën vlerë mund të blejnë vetëm 8.2 minuta (50leke/6.1lek/minute=8.2) trafik terminimi tek Vodafone. E gjithë pagesa prej 50 lekë është përdorur për të mbuluar pagesën me shumicë të operatoreve të vegjël që i detyrohen Vodafone, për 8.2 minuta terminimi ndërsa në të vërtetë këto do të duhet të mbulojnë gjithashtu të gjitha kostot e origjinimit në rrjetin e tyre dhe një fitim të arsyeshëm, ndaj paketa e Vodafone nuk mund të prodhohet nga operatorët e vegjël për shkak të çmimit të terminimit krahasuar me çmimin e pakicës on-net që aplikon Vodafone. Operatorët që zotërojnë pjesë më të vogla të tregut, për të qenë konkurrues, duhet të konkurrojnë Vodafone me oferta cross net, që të përfshijnë minutazhe të larta të thirrjeve off-net drejt rrjeteve të tjera, veçanërisht drejt rrjetit Vodafone. Rrjedhimisht këta operatorë do duhet të përballojnë kostot shtesë të thirrjeve off net, pra tarifat respektive të terminimit në çdo rrjet tjetër.
103. Ndërmarrja Vodafone nëpërmjet materialit mbështetës të “Frontier economis” pretendon se testi i propozuar për margin squeeze nuk përputhet me testin EEO duke pretenduar se “testi i paraqitur në raport nuk merr në konsideratë faktin se operatorët më të vegjël përfitojnë në mënyrë joproporcionale nga të ardhurat më të larta të terminimit (duke kompensuar kështu kostot më të larta të terminimit për thirrjet dalëse” dhe se “zbatimi i duhur i testit EEO tregon se nuk ka abuzim”. Duhet sqaruar se ndryshe nga pretendimet me shkrim të shoqërisë, në materialin mbështetës të Frontier Economis për llogari të Vodafone Albania për herë të parë pala nën hetim i referohet të ardhurave duke konfirmuar rritjen e të ardhurave respektive nga 17 786 688 956 lekë për vitin 2011 në 22 304 500 322 lekë në 2012(rritje 28.7 %) dhe rritjen e fitimit mbi kostot e alokuara plotësisht nga 2 835 903 494 lekë në vitin 2011 në 3 628 288 719 lekë(rritje 27.9 %).
104. Vlerësimi i dominancës dhe abuzimit me pozitën dominuese është një proces që shikohet në dinamikë dhe në periudha relativisht më të gjata kohe sesa ajo për të cilin është ankuar AMC. Oferta për festën e pavarësisë ka qenë për një periudhë të kufizuar kohore vetëm një javore dhe vetëm për

28 http://www.vodafone.al/vodafone/Vodafone_DayPass_1618_1.php

29 Permendur më lart

rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë së Republikës dhe nuk është përsërritur nga Vodafone. Gjithashtu ankimuesi AMC nuk e ka shoqëruar ankesën e tij me evidenca të tjera lidhur me zgjatjen në kohë të sjelljes së Vodafone Albania në tregun përkatës.

V.4. Trajtimi i ankesës për fushatën e bonusit për shpërndarësit

105. Nga ankesa e shoqërisë Plus 27.11.2012 dhe nga inspektimi i datës 06.02.2013 në shoqërinë Plus dhe datë 11.02.2013 në shoqërinë AMC, u konstatua se qarkullon një mesazh dërguar më 08.12.2012 me subjekt “*Komunikim i rëndësishëm*” lidhur me rritjen e bonusit nga 3 % në 15 % për shpërndarësit e pavarur me kusht që t’i jepnin përparësi reklamimit të gjithë produkteve Vodafone.
106. Nga procedurat hetimore rezultoi se mesazhi është dërguar nga adresa *etopupig@interas.al* dhe në seancën dëgjimore u pohua se ky nuk ishte mesazh zyrtar i kompanisë Vodafone Albania, e kundërta e së cilës nuk u provua. Gjithashtu, gjatë periudhës objekt hetimi rezultoi se ka ndryshuar mënyra e rimbushjes së numrave me parapagesë nga karta të parapaguara në porosi direkte në dyqanet e secilës prej kompanive celulare.
107. Për këto arsye, vlerësohet që pjesa e ankesës për bonusin për shpërndarësit e pavarur nuk rezultoi si sjellje abuzuese e ndërmarrjes objekt hetimi.
108. **Si konkluzion**, në përfundim të analizës dhe evidencave ndërmarrja “Vodafon Albania” Sh.a. gjatë periudhës objekt hetimi zotëron pozitë dominuese në tregun e telefonisë celulare me pakicë sipas kritereve të përcaktuara në nenin 8 të Ligjit. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes objekt hetimi rezultoi se strategjia e ndjekur nga ky operator shkaktoi shqetësime për konkurrencën në tregun përkatës si dhe efekte negative për konkurrencën në periudha afatgjata ndaj konkurrentëve më të vegjël, nëpërmjet aplikimit të strategjisë diferencuese të çmimit të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit (on-net vs off-net). Diferencimi i çmimeve brenda me jashtë rrjetit mund të përdoret si një mekanizëm i mbylljes së tregut nga operatorët e mëdhenj për operatorët e vegjël të cilët mund të rezikojnë daljen nga tregu përkatës, dhe ky fakt përbën një shqetësim për mirë funksionimin e tregut në një periudhë afatgjatë.
109. Ndërmarrja “Vodafon Albania” SHA nuk ka abuzuar me pozitën e saj dominuese gjatë periudhës objekt hetimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe f), nenit 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA;
2. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare si ne vijim:
3. Të marë masat e ndërmjetme dhe të menjëhershme, përpara përfundimit të analizës së tregut të pakicës së telefonisë celulare, për të bërë të zbatueshme zgjidhjet e rregullimit të tregut për të parandaluar daljet nga tregu që do kishin pasoja afatgjatë mbi konkurrencën, dhe në veçanti:
 - a) Të modifikojë modelin BULRAIC duke ulur ndjeshëm koston e terminimit për operatorët e vegjël ndaj operatorve të mëdhenj në këtë treg, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun përkatës;
 - b) Të detyrojë zvogëlimin real të diferencës së tarifave off-net/on-net brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese.

Të realizojë analizën e tregut të pakicës në telefoninë celulare për të adresuar zgjidhjet për shqetësimet e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke ndërmarrë masa konkrete rregullatore për reduktimin e diferencimit të theksuar të tarifave për thirrjet brenda rrjetit me tarifat jashtë rrjetit të operatorit Vodafone.

4. Në rolin e rregullatorit të monitorojë zbatimin e angazhimit publik të Vodafone Albania për barazimin e tarifave brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt fix, AMC, Eagle dhe Plus) dhe në veçanti, reflektimin e zvogëlimt real të kësaj diference jo vetëm në tarifat nominale (off-net, on-net), por edhe në njësitë e përfshira në paketat opsionale të komunikimit kombëtar (ofertat dhe paketat javore, mujore e vjetore).
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e tregut objekt hetimi sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi të gjithë palëve të interesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr.304 , datë 27.01.2014

“Për

një ndryshim në Vendimin nr. 292, datë 16.09.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.01.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të Grupit të Punes dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);
- Ligji Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Pasi mori në shqyrtim raportin e Grupit të Punes dhe relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 292, datë 16.09.2013 ka hapur procedurën e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve, për periudhën Janar 2010 – Gusht 2013.
2. Gjate periudhes hetimore vihet re se ka ndryshim te struktures se tregut ne tetemujorin e pare te vitit 2013, me hyrjen ne tregun e importit dhe shitjes ne

magazine te lire doganore te ndermarrjes “Everest Oil”SHA, si dhe daljes nga tregu i importit dhe shitjes me shumice te ndermarrjes “Taci Oil International & Supply”

3. Gjithashtu duhet vleresuar edhe efekti i hyrjes ne fuqi te paketes se re fiskale ne date 1 Janar 2014 me Ligjin nr 180/2013 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr 61/2012” Per akcizat ne Republiken e Shqiperise”(i ndryshuar), ne te cilen eshte realizuar rritja e takses se qarkullimit per karburantet nga 7 leke ne 17 leke per liter.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se për vlerësimin e pasojave të ndryshimeve strukturore të ndodhura në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve si dhe reflektimi ne treg nga ndërmarrjet i efekteve të paketës së re fiskale të vitit 2014 , duhet zgjatur periudha hetimore, për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin nr. 292, datë 16.09.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës”, pika “II” dhe “III”, të ndryshohet si vijon:
2. Periudha e hetimit do të jetë nga 1 janar 2010 deri në 31 Janar 2014.
3. III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 15 prill 2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
nr. 305, datë 14.02.2014**

**“Për
ndryshime në vendimin e KK nr. 300, datë 06.12.2013 “Për hapjen e
procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të
mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për
mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.02. 2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm nr.16/1 datë 13/02/2014 dhe informacionit mbi monitorimin e realizuar në tregun e sigurimeve ;

Baza ligjore:Nenet 4, pika 1, 24, germa d, 41, pika 1, 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, këtu dhe me poshtë Ligji.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Relacionit Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e realizuar në tregun e sigurimeve” nr.16/1 datë 13/02/2014 dhe informacionin mbi monitorimin e realizuar në tregun e sigurimeve nr. 16 prot datë 12.02.2014.

VËREN SE :

1. Në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 297, datë 18.11.2013 është vendosur “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të

konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.

2. Me vendimin Vendimi nr. 300, date 06.12.2013 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 291, datë 18.11.2013 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta” është zgjatur periodha hetimore deri më datë 17.01.2014.
3. Sekretariati ka dorëzuar raportin e hetimit paraprak me relacionin shoqërues të Sekretares së Përgjithshme i cili është në fazën e diskutimeve brenda Komisionit të Konkurrencës.
4. Gjatë kësaj periudhe Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë me shkresën nr. 453 prot të datës 12/02/2014 ka kërkuar nga institucionet AMF, Autoriteti i Konkurrencës dhe Ministri i Financave një reagim të menjëhershëm dhe shpjegim me shkrim lidhur me zhvillimet e fundit në tregun e sigurimeve të detyrueshme.
5. Ndërkohë ka patur një shqetësim publik në media duke filluar nga shkrimi i datës 12.02.2014 ne portalin ne rrjet mapo.al te revistës Mapo“Fluturojnë’ tarifat e sigurimeve të makinave, nga dje 210 mijë lekë”. Pas marrjes së kësaj indicie ne lidhje me një rritje te primeve te policave te sigurimit te MTPL-se, në datë 12.02.2014 inspektorët e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar realizuan një monitorim në tregun e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
6. Nga monitorimi rezultoi se primet e aplikuara janë rritur në të njëjtën kohë nga të gjitha shoqëritë e sigurimit në të gjitha kategoritë e këtij lloji police sigurimi në një masë të përafërt për kategoritë përkatëse.
7. Duke marrë parasysh që në bazë të Ligjit nr. 10455, datë 21.7.2011 Për disa ndryshime në ligjin nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Nenin 10, pika 2 “shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, rritja dhe fiksimi i çmimeve nga të gjitha kompanitë e sigurimit 9 shoqëri në mënyrë të menjëhershme dhe në të njëjtin nivel mund të ketë ardhur si pasojë e një marrëveshje të ndaluar në formën e sjelljes së koordinuar e cila mund të përbëjë shkelje të nenit 4, pika 1, germa a të Ligjit Nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neneve 41, pika 1, 42, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" i ndryshuar,

V E N D O S I:

- I. Zgjatjen e periudhës hetimore të hetimit paraprak për tregun e sigurimeve të detyrueshme për përgjegjësitë ndaj palëve të treta deri më datë 28.02.2014.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave në zbatim të këtij vendimi dhe komunikimin e vendimit palëve nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr.306, datë, 19.02.2014

“Për

hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.02.2014, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Lati(Milo), Znj. Rezana Konomi, Znj. Servete Gruda, Z. Koço Broka, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i ankesës mbi prokurimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës .

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi disa shqetësime në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun Dibrës,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një shqetësim nëpërmjet të cilit pretendohet se në procedurat e prokurimit të realizuara në Qarkun e Dibrës, disa shoqëri të ruajtjes dhe sigurisë fizike kanë marrëveshje në oferta dhe bashkëpunojnë në procedurat e prokurimit në këtë qark. Këto ndërmarrje të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në Qarkun e

Dibrës, që prej vitit 2011 mund të kenë marrëveshje në oferta në prokurimet publike.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për procedurat e prokurimit në Qarkun Dibër ka shenja të ngjashme të bashkëpunimit midis shoqërive që operojnë në tregun përkatës, siç janë formularët e ofertës së këtyre shoqërive, janë lëshuar nga e njëjta shoqëri sigurimi, në të njëjtën datë dhe me numër serial të njëpasnjëshëm.
3. Gjithashtu nga shqyrtimi i ofertave të paraqitura rezulton se vlerat e ofertave fituese janë shumë afër fondit limit në rreth 99.9 % të tij.
4. Si konkluzion, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet që kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg; si dhe në Udhëzimin “Mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto shenja mund të tregojnë për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet marrëveshjeve në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun Dibër.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga Janar 2012 deri në 30 Janar 2014.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 19.05.2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr.308, datë 21.02.2014

“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës ne tregun e shërbimit të transportit ajror”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.02.2014 , shqyrtoi:

Objekt: Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d) dhe neni 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të grupit të punës për monitorimin e tregut të transportit ajror të pasagjerëve të paraqitur nga Sekretariati,

VËREN SE:

I. Rregullimi i tregut dhe analizë e përgjithshme

1. Tregu i transportit ajror të pasagjerëve është i përbërë nga dy shërbime bazë të cilat janë plotësues/ ndërvarur të njëri tjetrit: shërbimi i ofruar nga aeroporti ose shërbimet aeroportuale dhe shërbimet e ofruara nga kompanitë ajrore, të cilat realizojnë lëvizjen e udhëtarëve. Këto shërbime rregullohen nga entet rregullatore sipas specifikave dhe detyrave përkatëse.
2. Shërbimet aeroportuale ofrohen për shoqëritë ajrore vetëm nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës kështu që TIA është i vetmi operator në tregun e shërbimeve aeroportuale, pra ka pozitë dominuese në këtë treg, dhe kompanitë e fluturimeve ajrore nuk kanë mundësi tjetër zgjedhjeje për të përfituar këtë shërbim.

3. Kompanive “low cost” të njohura për ofrimin e shërbimeve më kosto të ulët nuk ju mundësohet ofrimi i shërbimit aeroportual nga nje aeroport dytësor apo me kosto të ulët, shërbim qëe synojnë kompanitë ajrore “low cost”.
4. Tarifat e aeroportit “Nene Tereza”, kanë ndryshuar për herë të fundit në vitin 2007, megjithëse sipas ligjit të koncensionit³⁰ tarifat duhet të ndryshojnë çdo tre vjet, pra ka kaluar afati i ndryshimit të tarifave që duhet të kryhej në vitin 2010.
5. Për tarifat që aplikon aeroporti nuk ka nje metodologji apo rregullore të aprovuar nga OSHA. Tregu i shërbimeve aeroportuale, është treg ku operon vetem nje operator, dhe si i tillë duhet që rregullatori të ndikojë në rregullimin e tarifave duke i orientuar ato drejt koston, me qëllim që të parandalohet abuzimi me pozitën dominuese në këtë treg³¹.
6. Sipas nenit 11/4 të Kodit të Transportit Ajror, Autoriteti i Aviacionit Civil mer të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e tarifave dhe praktikave diskriminuese, çmimeve abuzivisht të larta si rezultat i një pozite dominuese dhe çmimeve abuzivisht shumë të ulta.
7. Për vlerësimin e çmimeve/tarifave abuzivisht të larta si rezultat i një pozite dominuese dhe çmimeve abuzivisht shumë të ulta, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se është e domosdoshme një metodologji/rregullore e cila aktualisht mungon. AAC aprovon në mënyrë automatike tarifat e kompanive të njoftuara në AAC,por pa patur një analizë kosto apo metodologji për vlerësimin e këtyre tarifave.
8. Gjithashtu ekziston rreziku tarifimit të dyfishtë, pra që të njejtat shërbime mund të ngarkohen si nga kompanitë ajore ashtu dhe nga tarifat e aeroportit, të cilat reflektohen në biletat e pasagjerëve, pra vendosja e nje metodologjie dhe aprovimi i tarifave në bazë të kësaj metodologjie do ta eliminojë këtë rrezikune tarifimit të dyfishtë³².

I.1. Aktorët kryesore të tregut të shërbimit të transportit ajror të pasagjerëve janë:

30 ne piken 19 "Pagesat per Sherbimet e Aeroportit dhe Vleresimi i pavarur Ekonomik" nenpika 19. 2, germa (a), te Kontrates se Koncesionit thuhet "*Organi i Autorizuar Shtetëror dhe Shoqëria do te rishikojnë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit çdo tre vjet...*".

³¹ Bazuar ne manualin e ICAO paragrafi 2.25 "...Korniza per kontrollekonomikqe qeveritemundtevendosin per tembrojturperdoruesitngaabuzimetpotencialetemonopolit, nderkoheqesigurojnekostot e njekontrollitetillembahen ne minimumin e nevojshem, mundtemarrin forma tendryshme duke u varur, per shembull, nganese do teaplikohej per shoqeriteprvateapopublikedhengashkalla e fuqise se tregutteketyreshoqerive..."

³² GENERAL PRINCIPLES, Position Paper on Airport Charges, Association of European Airlines (AEA), June 2007

9. Kompanitë ajrore të fluturimit më kryesore janë Austria Airline 1 destinacion, Lufthansa(Munih), Alitalia 2 destinacione, Airone 2 destinacione dhe Turkish Airline 1 destinacion.
10. Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA), i cili është i vetmi aeroport në të cilin realizohen fluturimet e kompanive ajrore. Aeroporti “Nënë Tereza” operon si një kompani ajrore e dhënë me koncension, në bazë të një marrëveshje koncensionare për një periudhë 20 vjeçare. Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, duke filluar nga prilli 2005, është drejtuar nga kompania private Tirana International Airport SHPK. Aeroporti Ndërkombëtar Nene Tereza (TIA) është aeroporti i vetëm në Republikën e Shqipërisë me anë të cilit operojnë shoqëritë ajrore të fluturimit të licensuara për realizimin e transportit ajror të pasagjerëve.
11. Në Shqipëri ekzistojnë edhe disa aeroporte në faza të ndryshme të ndërtimit si Aeroporti i Kukësit, Aeroporti i Sarandës, por që nuk kanë ende infrastrukturën e nevojshme për të realizuar fluturime ndërkombëtare (apo qoftë edhe kombëtare). Arsyeja kryesore e mosfunksionimit/moslejimit apo e mosvënies në punë të këtyre aeroporeteve për të realizuar fluturime ndërkombëtare është kontrata koncensionare e aeroportit Nene Tereza (TIA) e cila i ka dhënë ekskluzivitetin e fluturimeve ndërkombëtare kompanisë koncensionare. Sipas Nenit 2.3, pika c, te marrëveshjes se koncesionit, Qeveria Shqiptare nuk mund te licencoje, autorizoje apo operoje asnjë aeroport tjetër ndërkombëtar tregtare (kargo dhe pasagjere).

I.2. Aktorët rregullatorë të tregut të transportit ajror të pasagjerëve janë:

12. **Autoriteti i Aviacionit Civil** ka për mision ofrim shërbimesh aviacioni efikase, të sigurta, dhe të parrezikshme. Krijimin e nje sistemi transporti ajror te pershtatshem me zhvillimet e reja dhe me kerkesat ekonomike te Shqiperise. Vizioni i tij është zhvillimi i një rrjeti aeroportesh që do të permbushë pjesën më të madhe të kërkesave të komunitetit të aviacionit në Shqipëri si edhe të publikut në përgjithësi; duke e arritur kete ne nje menyre e cila te jete efikase, te ofroje siguri, dhe te jete ekonomikisht e dobishme.³³
13. **Agjencia Nazionale e Trafikut Ajror** – ANTA- ka përmision të ofrojë Shërbimin Navigacional duke mundësuar fluturimin e avionëve në Hapësirën e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me standartet ndërkombëtare të parrezikshmerisë dhe cilësisë. ANTA, në përputhje me rekomandimet e ICAO-s dhe rregulloret e Komisionit Evropian, për funksionimin e ofruesve të shërbimit të navigimit ajror, është në procesin e implementimit të sistemit të integruar të menaxhimit.
14. **OSHA**-Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, janë organe shtetërore te autorizuar, në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe të kushteve të kontratës së koncesionit, të ngarkuara për zbatimin e kësaj kontrate, në emër dhe për llogari te Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

³³Referuarfaqessëebwww.aac.gov.al

II. Analiza e konkurrencës

Analiza e konkurrencës së tregut ajror të pasagjerëve fokusohet në kushtet e tregut përkatës.

15. Në kuptim të nenit 3, pika 7 të ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, treg përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, përsa u përketa karakteristikave të cmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njejta konkurruese, zonë e cila vechohet nga zonat e tjera kufizuese.
16. Në përcaktimin e tregut përkatës në rastin e M.4439 RYANAIR/AER LINGUS, Komisioni Europian ka përcaktuar ndër të tjera si shërbime zëvendësuese të ofruar nga dy aeroporte kur largësia mes tyre është deri në 100 km ose rreth 1 ore udhëtim me makinë. Ky përcaktim mund të merret në konsideratë nga Ministria e transporteve në rastet e përcaktimit të teritorit gjeografik, (tregut përkatës gjeografik) në dhënien ose rishikimin e të drejtave ekskluzive për një ose disa aeroporte.
17. Në analizën e tregut të transportit ajror të pasagjerë do të ndahen nëntregjet plotësues dhe të lidhura domosdoshmërisht me njëri tjetrin, nëntregu i shërbimit të fluturimit të transportit ajror të pasagjerëve (aviacioni civil) dhe ai i shërbimeve aeroportuale.
18. Aeroporti “Nënë Tereza” ofron shërbimin ground handling, parkimin e avionëve, shërbimin e ndricimit me kushtet përkatëse për veprimtarinë e avionëve, shërbimet për ulje dhe ngritje të avionëve etj.
19. Përsa i përket tarifave me anë të të cilave operon TIA për shërbimet që u ofron kompanive ajrore ato janë të përcaktuara në kontratën koncensionare. Në pikën 19 të kontratës koncensionare përcaktohen pagesat për shërbimet e aeroportit, vlerësimi periodik i tyre, rishikimi në periudha të ndërmjetme i pjesës së miratuar të kostos së operimit dhe rishikimi i pavarur në së mendohet se është e nevojshme. Tarifat për shërbimet e ofruara nga TIA, përgatiten nga shoqëria koncensionare dhe miratohen nga OSHA. Pra, në bazë të marrëveshjes koncensionare TIA është i vetmi aeroport që ofron shërbimin dhe infrastrukturën e nevojshme për shoqëritë ajrore të licensuara për ofrimin e shërbimit të transportit ajror të pasagjerëve me tarifat përkatëse.
20. Siç është përshkruar edhe më sipër TIA është i vetmi aeroport i licensuar që mundëson kompanitë ajrore të kryejnë ulje dhe ngritje për fluturime ndërkombëtare. Në bazë të ligjit për dhënien më koncension, nuk duhet të lejohet operimi i avionëve të shoqërive ajrore në ndonjë aeroport tjetër, gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes së koncensionit. Përveç rasteve të emergjencës apo për qëllime ushtarake. Pra, TIA mbetet i vetmi aeroport

kryesor kombëtar, që ofron shërbimet aeroportuale për kompanitë ajrore që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

21. Gjatë periudhës së monitorimit të Autoritetit të Konkurrencës nuk ishin publikuar në faqen e internetit të AAC kushtet dhe kriteret e licensimit të operatorëve në fushën e transportit ajror të pasagjerëve por kohët e fundit këto kritere janë të publikuara në faqen e internetit të AAC duke reflektuar rekomandimet paraprake të Autoritetit të Konkurrencës.

III. Konkluzionet

III.1. Lidhur me shërbimet aeroportuale

22. Përsa i përket tarifave për shërbimet e ofruara nga TIA për shoqëritë ajrore ato janë të përcaktuara në marrëveshjen koncensionare por me mundësi rishikimi në çdo tre vjet, por pa përcaktuar/aprovuar një metodologji. Tarifat e aeroportit ne baze te ligjit te koncensionit duhet te ndryshojnë në cdo tre vjet, nderkohe ka ndodhur nje ndryshim që ne vitin 2007, ndersa deri tani ende nuk ka ndryshime.
23. Referuar të dhënave të portalit zyrtar i TIA-s, kriteri për përcaktimin e tarifave sa i takon uljeve dhe ngritjeve të avionëve (Landing and take-off), përpunimit në tokë (base ground handling), parkimi për 24 orë dhe ai i ndriçimit është pesha e avionit. I njëjti kriter përdoret edhe nga aeroportet e tjerë të vendeve të rajonit. Por, nga krahasimi i tarifave për shërbimet respektive që ofrohen nga aeroportet e vendeve të rajonit rrezulton se tarifat për shërbimet e ofruara nga TIA janë më të larta. Në se e krahasojmë numrin e aeroporteve me vendet e rajonit rezulton se vetëm Shqipëria dhe Kosova kanë nga një aeroport. Ndërsa Bosnja&Hercegovina ka 3 aeroporte, Kroacia 8 aeroporte, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbi kanë 2 aeroporte.
24. Në këto kushtë të gjitha kompanitë që duan të operojnë në Republikën e Shqipërisë i ofrohen shërbimet aeroportuale vetëm nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) me tarifat e përcaktuara nga TIA. Nga te dhënat nuk rrezulton të ketë nje metodologji për përcaktimin e tarifave për shërbimet që TIA ofron për shoqëritë ajrore dhe të jetë e aprovuar nga OSHA ose autoritet e tjera rregullatore.
25. Në këndvështrimin e konkurrencës, - TIA ka pozicion monopol në ofrimin e shërbimeve aeroportuale. Ligji i koncensionit e pengon hyrjen në treg të një operatori tjetër i cili do të shërbejë si aeroport dytësor dhe të jetë si një mundësi zgjedhjeje për kompanitë ajrore që kërkojnë një shërbim ndryshe nga aeroporti kryesor kombëtar apo nga kompanitë të cilat konsiderohen "low cost". - **Tarifat e aeroportit TIA jane të më larta se të njejtat tarifa të krahasuara me vendet e rajonit** - Autoritetet rregullatore duhet të miratojnë një metodologji apo rregullore për

përcaktimin e tarifave, me qëllim që kompania e vetme që ofron këtë shërbim të ketë tarifa të orientuara drejt kostos.

III.2. Lidhur me metodologjinë e miratimit të tarifave

26. Për vlerësimin e çmimeve/tarifave abuzivisht të larta si rezultat i një pozite dominuese dhe çmimeve abuzivisht shumë të ulta Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se është e domosdoshme një metodologji/rregullore e cila aktualisht mungon. AAC aprovon në mënyrë automatike tarifat e kompanive të njoftuara në AAC por pa patur një analizë kosto apo metodologji për vlerësimin e këtyre tarifave.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d, dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” me propozim të Sekretariatit:

VENDOSI:

1) T’i rekomandojë OSHA;

a. Në zbatim të pikës 19. 2, germa (a), të Kontrates se Koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar në cilësinë e Organit të Autorizuar Shtetëror dhe në bashkëpunim me shoqërinë koncensionare të rishikojnë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit siç parashikohet çdo tre vjet.

b. Për shkak të pozicionit të kompanisë koncensionari si i vetmi ofrues i shërbimeve ndërkombëtare të transportit të pasagjerëve, OSHA të hartojë dhe aprovon një metodologji/rregullore për vendosjen e tarifave të aeroportit, si edhe tarifat të jenë të orientuara drejt kostos.

2) Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e vendimit për Organin Shtetëror të Autorizuar, Autoritetin e Aviacionit Civil dhe palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 309, datë 06.03.2014

“Mbi autorizimin

e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët në mënyrë të tërthortë në shoqërinë Beralb SH.A nëpërmjet transferimit të 50% të aksioneve të shoqërisë Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS, nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS tek shoqëritë Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co.LTD dhe CRM International (Beijing) Co.LTD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.03.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët në mënyrë të tërthortë në shoqërinë Beralb SH.A nëpërmjet transferimit të 50% të aksioneve të shoqërisë Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS, nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS tek shoqëritë Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co.LTD dhe CRM International (Beijing) Co.LTD

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2,10-12, dhe neni16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”,Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit në shoqërinë Beralb SH.A dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të “Marrëveshjes për shitjen e kapitalit” e lidhur me datë 9 Janar 2014, ndërmjet palëve (“Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co.LTD dhe CRM International (Bjing) Co.LTD” në cilësinë e blerësve dhe “Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS” në cilësinë e shitësit me objekt transferimin e 50% të aksioneve të “Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS” në cilësinë e shoqërisë Target), me pasojë përfitim të kontrollit të përbashkët indirekt të shoqërisë Beralb Sh.a nëpërmjet transferimit të 50% të aksioneve të shoqërisë Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS, nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS tek shoqëritë Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co.LTD dhe CRM International (Bjing) Co.LTD

Shoqëria shitëse Ekin Maden shet XXX aksione (me vlerë nominale XXX) që përfaqësojnë pjesën prej 50% të kapitalit e përkatësisht 48% të shoqërisë JCCL, dhe nga 1% Beijing Metal e CRM International. Pas realizimit këtij përqendrimi shoqëritë blerëse bëhen aksionere me të drejta të plota në shoqërinë turke Nesko Metal dhe për pasojë përftojnë kontrollin e përbashkët indirekt edhe në shoqërinë Beralb Sh.a.

Transaksioni i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen target (Beralb Sh.a) në formën e përfimit të kontrollit të përbashkët indirekt në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) dhe 12 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, përbën një përqendrim, që plotëson kriteret e xhiros dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 56 të Ligjit.

2. Palët në transaksion

- ❖ **Jiangxi Copper Corporation (JCCL)**, në cilësinë e **Blerësit**, është një shoqëri e cila funksionon në bazë të legjislacionit të Republikës së Kinës. Shoqëria është themeluar më 1979 e cila është shoqëria më e madhe prodhuese dhe përpunuese e bakrit në Kinë si dhe gjithashtu një shpërndarës i rëndësishëm për arin, argjendin, seleniumin, telurin, rhenium, si dhe për kimikatet sulfide.
- ❖ **Beijing Metal Challenge Global Trading Co., Ltd.**, në cilësinë e **Blerësit**, është një shoqëri e cila funksionon në bazë të legjislacionit të Republikës së Kinës. Shoqëria është themeluar në Pekin në 18 Janar 2005, me një kapital të regjistruar 30 milion CNY (Juan) është një shoqëri holding e pavarur.
- ❖ **CRM International (Beijing) Co. Ltd**, në cilësinë e **Blerësit** është një shoqëri kineze, e cila vepron në fushën e importitndërkombëtar të metaleve jo-ferrikë.
- ❖ **Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS (Ekin Maden)**, në cilësinë e **Shitësit** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit

turk. Shoqëria është një nga kompanitë lider në sektori e metaleve dhe mineraleve në Turqi.

- ❖ **Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS (Nesko Metal)**, në cilësinë e shoqërisë **Target**, e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit turk që prej 2008-tës. Qëllimi i shoqërisë është (i) prodhimi, tregtia me shumicë, importi, eksporti i çdo lloj minerali dhe metali, minerali dhe koncentratit mineralësh; (ii) pjesëmarrja në çdo lloj tenderi brenda dhe jashtë vendit, të bëjë ofertë dhe të përmbushë kontratat; (iii) të hyjë në ortakëri në shoqëritë e krijuara ose ato që do të krijohen lidhur me këto çështje duke mos ndërhyrë, dhe të blejë dhe shesë aksionet e këtyre shoqërive.
- ❖ **Beralb sh.a**, në cilësinë e shoqërisë **Target** është themeluar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr 25300, datë 26.02.2001, me aktivitet “ të zhvillojë, konstruktojë e modernizojë industrinë minerare në Shqipëri, të kryejë studime gjeologjike e minerare, të zhvillojë në përgjithësi aktivitetet importues e eksportues. Objekti i shoqërisë është aktiviteti në fushën minerare, ajo ka të drejtë të importojë lirisht dhe pa asnjë kufizim pajisje, makineri dhe materiale të tjera të cilat mund të nevojiten gjatë procesit të prodhimit, duke përfshirë eksplozivë dhe materiale të tjera për përdorimin e duhur të tyre. Shoqëria Beralb SH.A në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit të miratuar me Ligjin nr. 8761, date 02.04.2001, ka marrë në koncesion Minierat e Bakrit Munelle dhe Lakrosh, Kam si dhe fabrikën e pasurimit të bakrit Fushë-Arrëz³⁴.

3. Xhiro për vitin 2013

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXX lekë, ku:

- Jiangxi Copper Company Limited (JCCL): XXXX lekë
- Beijing Metal Challenge Global Trading Co, Ltd: XXXX lekë
- CRM International (Beijing) Co, Ltd: XXXX lekë
- Ekin Maden Ticaret ve Sanayi A.S XXXX lekë
- Nesko Metal Sanayi ve Ticaret A Serketi XXXX lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXX lekë

-Beralb sh.p.k. : XXXX lekë

Pra plotësohet kriteri i xhiros në tregun ndërkombëtar dhe në tregun e brendshëm sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit për të marrë autorizimin e Komisionit të Konkurrencës.

1. Tregu përkatës dhe zhvillimet kryesore në industrinë e bakrit

Tregu përkatës

Jiangxi Copper Company Limited (JCCL) është një prodhues dhe fabrikues i bakrit në Kinë, si dhe furnizues bazë për arin, argjendin, seleniumin, telleriumin, rheniumin si dhe kimikate sulfurore. Sektori ku JCCL ushtron aktivitetin është

³⁴Lejete shfrytëzimit janë të rinovueshme për një afat 25 vjeçar.

industria e bakrit në Kinë. JCCL nuk zhvillon ndonjë aktivitet në tregun shqiptar dhe as atë turk.

3.1 Tregu përkatës i produktit:

Bazuar në karakteristikat fizike të metaleve, përdorimin apo mënyrat e ndryshme të përpunimit apo rafinimit të tyre si dhe diferencat në çmime mund të thuhet se secili prej tyre përbën një treg të veçantë produkti.

Referuar rastit në fjalë, dhe duke u mbështetur në veprimtarinë e palëve në vendin tonë, treg përkatës produkti do konsiderohet: **nxjerrja/pasurimi i mineralit të bakrit dhe prodhimi i koncentratit të tijsi dhetregtimi (eksporti) i bakrit dhe nënprodukteve të tij.**

3.2 Tregu përkatës gjeografik:

Beralb sh.p.k.e kryen aktivitetin e nxjerrjes dhe përpunimit të bakrit (në formën e koncentratit) në miniera apo fabrika të cilat janë të shpërndara në territorin e Republikës së Shqipërisë, megjithëse produktin e prodhuar e eksporton. Beralb sh.a nuk ushtron aktivitet në tregun e prodhimit të produkteve finale të bakrit (si tela, monedha etj.) për arsye të investimeve të kërkuara dhe të rezervave të kufizuara. Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet Tregu i Brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

2. Analiza e konkurrencës dhe efektet e përqendrimit të realizuar në treg;

Në Shqipëri janë vlerësuar rreth 71 milion tonë rezerva gjeologjike për mineralin e bakrit sipas tipit të mineralizimeve dhe rajoneve. Beralb aktualisht ka në shfrytëzim objekte minerare në të cilat vlerësohet një sasi rezervash rreth XXX milion ton.

Prodhimi aktual në këtë industri është në nivelet e 30-35 % të prodhimit të realizuar para viteve 1990, pra në këtë sektor ka shumë mundësi për të rritur vlerat e prodhimit dhe të ardhurave prej tij.

Pas viteve 2000, shoqëria Beralb SHA, është e vetmja shoqëri që prodhon, kryen veprimtarinë e shfrytëzimit dhe eksporton bakër (në formën e koncentratit të tij) nga burimet e veta minerare duke zotëruar në këtë mënyrë pozitë dominuese në tregun përkatës sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit dhe prezumimit të dominancës për pjesë tregu mbi 50 %.

Ndërkohënga Shqipëria përveç ekstraktit të bakrit eksportohen edhe koncentrat pirit bakri, mbeturina bakri, skrap tunxhi, mbeturina tunxhi, skrap bakri, skrap bronxi, mbetje bakri, mbetje tel bakri, tub bakri, tel tunxhi, skrap tunxhi. Në totaline eksportit, bazuar te të dhënat e mundësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për eksportin e bakrit dhe nënprodukteve të tij, për vitin 2012 dhe vitin 2013, vihet re se shoqëria Beralb zë mbi X% të sasisë së bakrit dhe nënprodukteve të tij të eksportuara nga vendi jonë – përkatësisht X% në vitin 2012 dhe X% në vitin 2013³⁵.

35Gjatë përpunimit të të dhënave, shitja i bakrit dhe nënprodukteve të tij është konsideruar si një treg i vetëm duke qënë se transaksioni në fjalë nuk sjell asnjë ndryshim në tregun e brendshëm.

Pjesa e tregut dhe dominanca e shoqërisë Beralb sh.a do të mbeten të njëjta edhe pas transaksionit pasi asnjë nga shoqëritë që janë palë blerëse në këtë transaksion, nuk është prezente në Shqipëri. Si pasojë, transaksioni nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut pas përqendrimit.

Për më tepër, ky transaksion nuk sjell asnjë ndryshim jo vetëm në nivel horizontal, por edhe sa i takon marrëdhëniet në nivel vertikal. Kjo e fundit ndodh për dy arsye:

a) asnjë nga shoqëritë kineze, pjesë të transaksionit, nuk janë prezent në tregun e brendshëm sa i takon rafinimit/ prodhimit të produkteve finale të bakrit në vendin tonë;

b) industria e bakrit në Shqipëri është e përqendruar vetëm në nxjerrjen dhe pasurimin e mineralit të bakrit (kalimin në koncentrat).

Referuar palës njoftuese, me anë të këtij përqendrimi synohet të rritet siguria dhe garancia për fluksin e nevojshëm të investimeve të nevojshme për rritjen në sektorin minerar të bakrit. Vetë shoqëria Beralb sha, me qëllim mbajtjen në punë të investimit të saj më të rëndësishëm – fabrikës së pasurimit të bakrit në Fushë Arrëz, synon të aktivizojë edhe disa miniera të tjera ekzistuese, për të cilat është pajisur me leje minerare.

5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Transaksioni është një blerje e pjeshme e shoqërisë Nesko si rezultat i së cilës 48% e aksioneve do të shiten tek shoqëria kineze Jiangxi Copper Company Limited (JCCL), dhe 2% të aksioneve do të shitet CRM International (Beijing) Co. Ltd dhe Beijing Metal Challenge Global Trading Co. Ltd respektivisht nga 1% secilës. Aksionari ekzistues i Neskos, Ekin Maden Ticaret Sanayi A.S. do të mbetet aksioner me 50% tek Nesko dhe aksioner i Beralb sh.p.k. do të vazhdojë të jetë Nesko.

Meqenëse JCCL është një ndër prodhuesit lider të bakrit në botë, pjesëmarrja e tyre tek Nesko dhe indirekt te Beralb do të zgjerojë prodhimin e bakrit dhe koncentratit të tij në Shqipëri, çfarë do të ketë një impakt pozitiv të përgjithshëm. Transaksioni fut në industrinë e bakrit në Shqipëri një nga shoqëritë më të mëdha në tregun global në sektorin minerar, nëpërmjet të cilës priten të realizohen investime të reja në minierat ekzistuese dhe në zonat potenciale minerare.

Sa më sipër, ky transaksion, nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën dhe pjesët e tregut përkatës në kuptim të forcimit të pozitës dominuese dhe për këtë arsye duhet të autorizohet sipas parashikimeve të nenit 56 të Ligjit.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimintë realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët në mënyrë të tërthortë në shoqërinë Beralb Sh.a nëpërmjet transferimit të 50% të aksioneve të shoqërisë Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS, nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS tek shoqëritë Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co.LTD dhe CRM International (Beijing) Co.LTD
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
Nr. 310, datë 31.03.2014**

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të
detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAIMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.03.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Raporteve të hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit police sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, si dhe relacioneve respektive të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës .

VËREN SE :

I . PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, me anë të Vendimit nr. 297, datë 18.11.2013, ndryshuar me Vendimin nr. 300, datë

- 06.12.2013, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit police sigurimi për mjetet e transportit për pergjegjesite ndaj palëve të treta.
2. Në zbatim të këtij Vendimi, në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, inspektorët e Sekretariatit të AK kanë kryer inspektime dhe kanë kërkuar informacion nga ndërmarrjet, Byroja Shqiptare e Sigurimeve dhe shoqëritë e brokerimit që veprojnë në këtë treg, si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
 3. Gjatë procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve të detyrueshme evidentohen disa konstatime për mungesën e zgjedhjes konsumatore nga sistemi MSHM i administruar nga Star Broker të policës së sigurimit për mjetet motorrike, si dhe kompanitë e sigurimit rreth 94% të tregimit të policës në tregun e MTPL e tregtojnë nëpërmjet sistemit MSHM të administruar nga Star Broker.
 4. Ndërkohe pa u shqyrtuar raporti hetimit paraprak nga Komisioni i Konkurrencës, duke marrë shkas nga media e shkruar në lidhje me një rritje të primeve të policave të sigurimit të MTPL-se me date 11 Shkurt 2014, Inspektorët e AK në datë 12.02.2014 kanë realizuar një monitorim në tregun e sigurimeve në lidhje me primet e aplikuara për këto lloje policash sigurimi sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar(Ligji).
 5. Nga monitorimi rezultoi se me date 11 Shkurt 2014, primet e aplikuara janë rritur në mënyrë të menjëhershme dhe në të njëjtin nivel nga të gjitha shoqëritë e sigurimit për të gjitha kategoritë e këtij lloji police sigurimi.
 6. Duke marrë parasysh që në bazë të Ligjit nr 10 455, datë 21.07.2011, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 10, pika 2 “shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut”, caktimi i çmimeve nga të gjitha kompanitë e sigurimit (9 shoqëri) në mënyrë të menjëhershme dhe në të njëjtin nivel mund të përbëjë shkelje të nenit 4, pika 1, germa a të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.
 7. Bazuar në gjetjet e mësipërme, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 42 të Ligjit nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 305, datë 14.02.2014 vendosi për zgjatjen e periudhës hetimore të hetimit paraprak për tregun e sigurimeve të detyrueshme për përgjegjësitë ndaj palëve të treta deri më datë 28.02.2014.
 8. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 69, datë 14.02.2014, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar inspektime për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një

marrëveshje bashkëpunimit të mundshme midis konkurrentëve ose të një praktike të bashkërenduar mes kompanive.

II . TREGU PËRKATËS

1. Bazuar në Ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimin nr.76, datë 07.04.2008 të Komisionit të Konkurrencës “Për përcaktimin e tregut përkatës”, konkretisht përcaktohet se: “Tregu përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët, ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen, ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”. Tregu përkatës përfshin: (i) tregun përkatës të produktit dhe (ii) tregun përkatës gjeografik.

II.1 Tregu përkatës i produktit

1. Tregu përkatës i produktit përfshin sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta. Në ofrimin e shërbimit të detyrueshëm motorrik përfshihen këto produkte:
 - a. Ofrimi dhe shitja e policave të sigurimit të detyrueshëm (MTPL);
 - b. Ofrimi dhe shitja e Kartonit Jeshil
 - c. Ofrimi dhe shitja e Policës së Sigurimit Kufitar

II.2 Tregu përkatës gjeografik

1. Tregu gjeografik në këtë rast është Republika e Shqipërisë, pasi ky produkt tregtohet vetëm brenda territorit shqiptar.

III . VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE NË TREG

1. Sekretariati ka realizuar inspektime për gjetjen e evidencave të një marrëveshje bashkëpunimi të mundshëm midis konkurrentëve ose të një praktike të bashkërenduar mes kompanive, lidhur me dy pista kryesore të caktimit të primeve të shitjes, ndarja e tregut dhe/ose kufizimi i prodhimit apo tregëtimit. Gjatë inspektimeve dhe nëpërmjet kërkesave për informacion janë administruar materiale të nevojshme për hetimin për të bërë të mundur vlerësimin e kufizimeve të mundshme të konkurrencës në treg.
 - a. Nga inspektimet e befasishme pranë ndërmarrjeve të sigurimit, Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Star Broker Albania dhe Shoqatës së Siguruesve, janë administruar evidencat si vijon:
 - b. Vendimi nr. 12 datë 07.02.2014 “Mbi miratimin e Shoqërisë Anonime Star Broker Sha” i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtareve që përcakton të gjitha shitjet e policave të sigurimit të detyrueshëm TPL nga çdo shoqëri sigurimi do të kryhen përmes sistemit Star Broker;
 - c. Vendimi nr. 36 datë 21.11.2013 “Mbi arkëtimin e primeve të produktit police kufitare” sipas të cilit të gjitha shitjet nga çdo shoqëri sigurimi do të kryhen përmes sistemit Star Broker, si dhe do të arkëtohen në një llogari të vetme qëllimore bankare dhe të njoftohet BKT se kjo llogari bankare do të administrohet nga Star Broker;

- d. Vendimi nr. 34 datë 21.11.2013 “Mbi miratimin e Shoqërisë Anonime Star Broker Sha” me anë të të cilit është vendosur miratimi i Shoqërisë Anonime Star Broker sha për shitjen e policave karton jeshil;
 - e. Vendim i Asamblesë nr. 25 datë 26.06.2013 “Mbi prodhimin, administrimin, tregtimin e policës për sigurimin e detyrueshëm kufitar dhe kartonin jeshil” sipas të cilit primet e sigurimit të policës së sigurimit kufitar dhe kartonit jeshil të shoqërive të sigurimit derdhen në një llogari qëllimore nën administrimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, ose të një personi juridik të autorizuar prej saj;
2. Këto vendime mund të krijojnë kushte për një kufizim të konkurrencës referuar nenit 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
3. Nga analiza e evidencave ekonomike u konstatua se:
- a. Gjatë muajit Janar 2014, volumet e shitjeve të produktit MTPL nepermjet sistemit Star Broker, krahasuar me volumet e shitjeve të pasqyruara nga AMF, perbejne 96,9% te vlerës totale te primeve te shitjes se ketij produkti.
 - b. Të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e MTPL-së së brendshme, më datë 11 shkurt 2014 kanë aplikuar prime të shitjes pothuajse të njëjta, për të njëjtën klasë, për të gjitha kategoritë. Këto tarifa janë mbajtur të fiksuara (3 ditë) deri më datë 13 Shkurt 2014. Insig në datë 13 Shkurt 2014 reagon duke ulur tarifën, si dhe me date 14 reagojnë të gjitha ndërmarrjet e tjera duke aplikuar tarifa të uleta.
 - c. Nga inspektimi i sistemit MSHM është konstatuar se reflektimi në sistem i ndryshimit të tarifave për kategoritë MTPL është kryer në të njëjtën kohë pavarësisht nga momenti i kërkesave për ndryshim të ndërmarrjeve respektive. Në disa raste thjesht kërkohet të ndryshohen tarifën pa përcaktuar se kur; në disa raste të tjera kërkesa është paraqitur pranë Star Broker pasi tarifën janë ndryshuar në sistem; në disa raste tarifën janë ndryshuar me një apo dy dite vonësë referuar datës së kërkesës. Pavarësisht nga momenti i kërkesave për ndryshimin e tarifave, në sistemin MSHM, ato janë ndryshuar në të njëjtën ditë për të gjitha shoqëritë, me përjashtim të shoqërisë INSIG e cila në momentin e dytë të ndryshimeve ka ndryshuar tarifën që me date 13.02.2014 (pothuajse në fund të ditës së punës).
 - d. Duke marrë parasysh që në bazë të Ligjit nr. 10455, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, nenin 10, pika 2 “shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifën e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut.” Aplikimi i çmimeve të produktit police e brendshme të sigurimit motorrik MTPL nga të gjitha kompanitë e sigurimit në mënyrë të menjëhershme, dhe në të njëjtin nivel, mund të ketë ardhur si pasojë e një marrëveshje të ndaluar, e cila përbën shkelje të nenit 4, pika 1, të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

- e. Bazuar ne gjetjet dhe analizën e bërë, rezulton se sistemi MSHM i administruar nga Star Broker krijon mundësi për ndarje të tregut dhe caktim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve (primeve) të shitjes së produktit të policës së sigurimit për mjetet motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, pasi efekti i çdo veprimi në këtë treg me anë të këtij sistemi është i menjëhershëm dhe ka shtrirje në të gjithë tregun.
 - f. Star Broker duket qartë se nuk luan rolin e mirëfilltë të një brokeri ose një shoqërie të mirëfilltë brokerimi në sigurime, pasi luan rolin e ofruesit të shërbimit të administrimit të sistemit të tregtimit të policave TPL praktikisht për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe rolin e shpërndarësit të policave të prodhuara nga BSHS.
4. Ne vijim të shkresës nr. 68 datë 13.02.2014 drejtuar AMF “Mbi zhvillimet e fundit të tregut të sigurimit të detyrueshëm” AMF me shkresën nr 68/1, date 14.02.2014, bën me dije se: Lidhur me çmimet qe shoqëritë e sigurimit kane zbatuar se fundmi, bazuar ne ecurinë rezultatet e vitit 2013, ne përlllogaritjen e tarifave te primit te sigurimit të detyrueshëm motorrik, janë shtuar edhe dy faktorë të tjerë përcaktues, që janë data e prodhimit të automjeteve që sigurohen dhe kohëzgjatja e patentës së përdoruesve të këtyre automjeteve. Shtimi i këtyre dy faktorëve të riskut ka ndikuar në ndryshimet që kanë pësuar tarifat aktuale. Autoriteti i Konkurrencës gjykon se këto dy faktorë primesh të diferencuara duhet te sillnin ndryshime në tarifat që do të aplikoheshin për primin fundor.
 5. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është shprehur se do të ishte në interes të stabilitetit financiar të tregut të sigurimeve që Autoriteti i Konkurrencës të mbajë parasysh karakteristikat dhe brishtësinë e ekuilibrit të sistemit financiar të sigurimeve veçanërisht sigurimeve të detyrueshme.
 6. Ndërmarrjet gjatë realizimit të procedurës së hetimit paraprak janë shprehur nëpërmjet një shkrese të hartuar nga Shoqata e Siguruesve Shqipëtarë se: (a) Deri në funksionimin e plotë të sistemit Bonus Malus do të vendosin marrëdhënie tregtare të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi me çdo broker, bankë apo agjent sigurimesh për t'i ofruar të siguruarit shërbimin, për t'i garantuar sigurinë dhe standartin e policave të sigurimit dhe pagesën e dëmeve në rastet e ngjarjeve me pasojë shkaktimin e dëmit; dhe (b) Në një periudhë 12 mujore nga data e marrjes së angazhimeve dhe e fillimit të zbatimit të kontratës së shërbimit, shoqëritë angazhohen të bëjnë funksional sistemin e sigurimeve të detyrueshme motorrike në bazë të sistemit Bonus Malus dhe si deri më tani kanë vepruar, nuk do të bëhen pjesë e asnjë marrëveshjeje, apo praktike të heshtur që do të binte në kundërshtim me Ligjin e Konkurrencës dhe Ligjin “Për sigurimet e detyrueshme në sektorin e transportit”.
 7. Në kuptim të nenit 4, pika 1, germa (a), (b) dhe (c) e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), konstatohet që sjellja e ndërmarrjeve në treg mund të ketë ardhur si pasojë e ndonjë marrëveshjeje që mund të ketë pasur për objekt ose pasojë kufizimin,

kontrollimin e tregut (neni 4/1/b), ndarjen e tregut (neni 4/1/c), si dhe caktimin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve (primeve) të shitjes (neni 4/1/a) të produktit të policës së sigurimit për mjetet motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

8. Komisioni do të vlerësojë angazhimet individuale të ndërmarrjeve në këtë treg, sipas parashikimeve të nenit 45/1 të Ligjit (marrja e angazhimeve) dhe 62 pikat 2 dhe 3 (rivendosja e konkurrencës) dhe Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenet 5 dhe 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta mbi 9 (nëntë) ndërmarrjet vijuese, që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA, SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP, INTERALBANIAN VIG SHA, ALB - SIGURACION SHA, INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA, EUROSIG SHA, ANSIG SHA .
2. Ndërmarrjet në mënyrë individuale mund të ushtrojnë të drejtën për të bërë të njohur këndvështrimet e tyre jo më vonë se **20 ditë** nga marrja e këtij vendimi. Komunikimi me Autoritetin e Konkurrencës bëhet çdo ditë pune, në adresën e institucionit: Rruga “S. Frashëri”, Nr. 4, Kati IV, Tirane, Shqiperi, Tel: 04/2234504, Fax: 04/2234497, E-Mail: competition@caa.gov.al
3. Proçedura e hetimit të thelluar dhe hartimi i raportit do të përfundojë jo më vonë se 2 muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 311 , datë 17.04.2014

“Kërkesë për sigurimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enerprises S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.04.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: “Kërkesë për sigurimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enerprises S.A”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet 10-16, dhe neni 33”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të vlerësimit ligjor mbi njoftimin e përqendrimit në shoqërinë AMRA Oil Sh.a dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me anë të shkresës nr. 316 prot, datë 03.09.2013 është njoftuar përqendrimi me objekt shitblerjen e pjeshme të konsorciumit AMRA Oil Sh.a (e cila përbëhet nga aksionet e shoqërisë Anika Enerprises S.A) shoqërisë Armo Sh.a (indirekt) dhe shoqërisë Europetrol Sh.a (Europetrol) nga shoqëria Heaney Assets Corp.

Ky transaksion, i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në shoqëritë e sipërpërmendura në formën e përfutimit të kontrollit direkt dhe indirekt , përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

Për të vlerësuar nëse ky përqendrim duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës duhet të plotësohen kriteret e xhiros parashikuar në nenin 12 të Ligjit për ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim.

Pala njoftuese ka depozituar të dhënat mbi xhirot për ndërmarrjet pjesëmarrëse (Heaney Assets Corp, AMRA Oil Sh.a, Europetrol Sh.a), ndërkohë që megjithë kërkesat e përsëritura shkresat nr. 316/3 prot, date 30.09.2013, nr. 316/6 prot, date 25.10.2013 dhe nr. 316/8 prot, date 28.11.2013 të Autoritetit të Konkurrencës, ajo nuk ka arritur të vendosë në dispozicion të Autoritetit pasqyrat financiare të shoqërisë Anika Enterprises për vitin 2012.

Në këto kushte, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës e ka të pamundur të vlerësojë nëse plotësohen kriteret e xhiros për të filluar procedurën e kontrollit të këtij përqendrimi sipas kërkesave të nenit 12, 15.2 dhe 16 të Ligjit.

Konfirmimi i njoftimit të plotë sipas neneit 54 të Ligjit të sipërpërmendur dhe për pasojë edhe afati 2 mujori i procedurës së kontrollit të përqendrimit të njoftuar nuk mund të fillojë pa depozituar pasqyrat financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A.

Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) neni 73, pika 1, e klasifikon mosdepozitimin e të dhënave brenda afatit kohor si shkelje të lehtë, e cila sanksionohet me gjobë jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d), dhe nenit 33 pika 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar:

VENDOSI:

- a. T'i kërkojë palës njoftuese/shoqërisë AMRA OIL SHA sigurimin e pasqyrave financiare të shoqërisë Anika Enterprises për vitin 2012 brenda afatit ligjor 15 ditor nga marrja e këtij vendimi.
- b. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 312, datë 18.04.2014

**“Për disa rekomandime në lidhje me funksionimin etreguttë
shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.04.2014, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i “Raportit të monitorimit në tregun e shërbimit ekskluziv për kontrollin teknik të automjeteve dhe rekomandimet përkatëse” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja f), si dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit e Sekretaritit mbi monitorimin në tregun e shërbimit ekskluziv për kontrollin teknik të automjeteve dhe rekomandimet përkatëse dhe relacionin shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Ligji 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e në vijim Ligji) në nenin 2, pika 1 germa c, parashikon zbatimin e Ligjit për “ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet që ju janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta”. Neni 69 i Ligjit parashikon “detyrimet për organet qendrore dhe vendore që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt që ka të bëjë ndër të tjera me (a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin dhe

- (b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara”.
2. Ministria e Transportit në kohën kur ka nënshkruar marrëveshjen për dhënien e koncesionit “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë” nuk e ka zbatuar detyrimin e parashikuar në nenin 69, pika ,1 shkronja b të Ligjit për të kërkuar vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për dhënien e të drejtës ekskluzive të kontrollit teknik të automjeteve.
 3. Autoriteti i Konkurrencës nisur nga shqetësimi publik për krijimin e radhëve për kontrollin e automjeteve në fund të vitit 2013 dhe në fillim të vitit 2014, ka kryer vlerësimin *ex-post* të mënyrës së funksionimit të tregut të shërbimit të së drejtës ekskluzive për kontrollin teknik të automjeteve. Ky shërbim, sipas ligjit dhe kontratës koncensionare, i është dhënë e drejta e ushtrimit të kësaj veprimtarie vetëm një operatori në mënyrë ekskluzive, e cila përbën një kufizim sasior për hyrjen në këtë treg.
 4. Marrëveshja “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë” është nënshkruar në datë 03.09.2009, dhe ka për objekt “financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”. Palët në marrëveshje janë Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit (tani Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës) si dhe Konkensionari: SOCIETE GENERALE DE SURVEILLANCE S.A. Konkensiononi është dhënë për një periudhë prej 10 vitesh nga Data Efektive.
 5. Për realizimin e kontrollit teknik të detyrueshëm, objekti i të drejtës ekskluzive është kontrolli teknik i detyrueshëm i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Kontratën dhe Ligjin nr. 9663 date 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe të Vendimit i Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 03.10.2007, “Mbi përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi është përmirësimi i cilësisë së shërbimit ndaj shtetasve dhe subjekteve shtetërore e private, rritja e sigurisë së qarkullimit në rrugë, modernizimi i teknologjisë së shërbimit nëpërmjet vendosjes së standardeve teknologjike në nivelin e BE-së, si dhe lufta kundër korrupsionit. E drejta ekskluzive dhënë Kompanisë SGS për kontrollin teknik të automjeteve ka si qëllim rritjen e investimeve për qendrat e kontrollit teknik, shtimin e qendrave të reja, aplikimin e teknologjive të reja, rritjen e kapaciteteve njerëzore, si dhe shmangien e fenomeneve korruptive.
 6. Shqetësimi publik lidhet përgjithësisht me kufizimin sasior të pikave të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm vjetor sidomos për rrethet e mëdha, kryesisht Tiranë, që ka sjellë si pasojë radhë të gjata, shqetësime

që duhet të adresohen për zgjidhje nga ana e koncesionarit dhe të mbikëqyren nga Ministria e Transportit.

7. Shërbimi i kontrollit teknik të automjeteve, për sa i përket tarifave, është një treg i rregulluar nga Ministria e Transportit e cila ka përcaktuar këto tarifa sipas kategorive të shërbimit të publikuara në Marrëveshjen e Koncesionit; aneksi VI. Këto tarifa rezultojnë se janë më të larta se ato të aplikuara para nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
8. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe në terren është konstatuar që koncesionari i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij lidhur me investimet që duhet të kryejë.
9. Nga data 01 mars 2014 ka filluar të funksionojë sistemi on-line i pronotimit të shërbimit me dhënien e mundësisë së regjistrimit online të orarit për shërbimin, gjë e cila sipas verifikimit në terren e ka përmirësuar shërbimin duke ulur kohën e pritjes.
10. Kontrolli teknik i automjeteve në vende të ndryshme të botës, ofrohet sipas modeleve të ndryshme:
 - a. **Modeli i centralizuar:** referuar këtij modeli shërbimi i kontrollit teknik është i ndarë nga shërbimi i servisit.
 - b. **Modeli i decentralizuar:** referuar këtij modeli kontrolli teknik ofrohet nga disa operatorë të cilët kryejnë dhe shërbimin e servisit.
11. Legjislacioni i ri i Bashkimit Europian /direktiva e re për koncesionet e miratuar nga Këshilli në 11 Shkurt 2014, (32014L0023; **Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Europian dhe e këshillit e datës 26 Shkurt 2014 mbi dhënien e kontratave të koncesioneve; OJ L 94, 28/03/2014, p. 1–64**). Kjo direktive përcakton standardet për kontratat e koncesionit, për të siguruar një konkurrencë të drejtë dhe për të siguruar përdorimin më të mirë të fondeve publike.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70 pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës:
 - 1.1. Në periudha afatshkurtër të kërkojë nga koncesionari SOCIETE GENERALE DE SURVEILLANCE S.A të krijojë më shumë se një mundësi për zgjedhjen e konsumatorit për kryerjen e kontrollit të detyrueshëm teknik vjetor të automjeteve në qytetin e Tiranës.
 - 1.2. Në periudha afatgjatë të shikohet mundësia e ofrimit të kontrollit teknik të automjeteve nga disa operatorë.
 - 1.3. Të kërkojë shprehjen e mendimit të Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 69-70 të Ligjit, pasi të marrë studimin e tregut nga

koncesionari në lidhje me mënyrën e funksionimit të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm;

- 1.4. Të marrë parasysh direktivën e re të BE-së lidhur me rregullat e reja për koncesionet duke zbatuar parimin e transparencës dhe të përcaktojnë kriterin e “tenderit me avantazhin më të mirë ekonomik” përgjatë procedurave të prokurimit, ku autoritetet publike do t’i mëshojnë rëndësisë mbi cilësinë, pasojave mbi mjedisin, aspekteve sociale ose risive, si dhe duke pasur parasysh çmimin si dhe jetëgjatësinë-ciklin-koston e asaj çfarë prokurohet për tu dhënë si e drejtë ekskluzive ose e veçantë.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe njoftimin e vendimit Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturaes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr.313 , datë 30.04.2014

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të biznesit të markës ACE nga shoqëria Fater S.p.a me anë të blerjes së aseteve nga shoqëria The Procter & Gamble.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.04.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të biznesit të markës ACE nga shoqëria Fater S.p.a me anë të blerjes së aseteve nga shoqëria The Procter & Gamble.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit në biznesin ACE dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1.Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të “Marrëveshjes për Shitje Asetesh” e lidhur më datë 18 Shkurt 2014, ndërmjet palëve, “The Procter & Gamble” në cilësinë e shitësit, “Fater S.p.a” në cilësinë e blerësit, dhe shoqërisë italiane Tentimeti Angelini, në cilësinë e aksionerit shitës, me objekt transferimin e biznesit që

përbëhet nga asete të përdorura për prodhimin, paketimin, shpërndarjen, promovimin dhe shitjen e produkteve të kujdesit për rrobat, të përfshira në markën “Ace”, nga shoqëria The Procter & Gamble tek shoqëria Fater S.p.a.

Me anë të këtij përqendrimi, i cili do të realizohet me anë të blerjes nga ana e Fater S.p.a të biznesit ACE: (i) të aseteve të biznesit Ace, të cilat sipas nenit 1 të Marrëveshjes Shit-Blerje Asetesh, datë 18 Shkurt 2014; (ii) të drejtave e pronësisë intelektuale dhe industriale ku përfshihen të drejtat e Autorit, emrat Domain, Patenta, Marka Tregtare, Sekrete Tregtie dhe Teknologji, (sipas nenit 4.05); (iii) know how në lidhje me aktivitetin tregtar ; (iv) kontratave sipas nenit 4.12.

Në këtë mënyrë, pas realizimit të përqendrimit shoqëria Fater S.p.a do të shndërohet në qendrën e biznesit ACE për zonën EQLAQA (Europës Qëndrore dhe Europës Lindore, Azisë Qëndrore dhe Afrikës) ndërsa struktura e pronësisë në ACE do të ndryshojë në formën e hyrjes së një aksioneri të ri, Grupi Angelini.

Transaksioni i realizuar, i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në Biznesin Target në formën e hyrjes së një aksioneri të ri kontrollues, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1), shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 56 të Ligjit.

2. Palët në transaksion

Referuar Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, palë pjesëmarrëse në këtë transaksion janë:

✚ **Fater S.p.a**, në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit Italian me seli në adresën: Via Alessandro Volta 10, Cap 65129, Pescara, Itali. Shoqëria është një fond privat kapitalesh i administruar nga Bregal Capital L.P Ltd. Shoqëria është një shoqëri ndërkombëtare shumëdegëshe, aktivite kryesisht në prodhimin dhe shitjen e pelenave (të markës Pampers), produkteve të inkontinencës për të rritur dhe pecetave sanitare. Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në Pescara dhe gjithashtu ka fabrika në Itali dhe Portugali³⁶. Shoqëria është themeluar më 1958 nga familja Angelini dhe qysh në vitin 1992 ajo është bërë pjesë e Grupit Procter & Gamble dhe zotërohet në mënyrë të përbashkët nga Grupi Angelini (50%) dhe Grupi Procter & Gamble (50%) .

Fater S.p.a nuk ka filiale dhe nuk është prezente në tregun shqiptar.

✚ **The Procter & Gamble**, në cilësinë e **shitësit** është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Shteteve të

36 Burimi, Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimit, seksioni 2.

Bashkuara me seli në adresën: Plaza 1, Cincinnati, Ohio, SHBA. The Procter & Gamble është shoqëria mëmë e Grupit Procter & Gamble (P&G) i cili është një grup ndërkombëtar shoqërisht të përfshira në prodhimin e produkteve të përkujdesjes për shtëpinë dhe rrobat, produktet kozmetike, produkte të kujdesit personal, të përkujdesjes për shëndetin, për fëmijët dhe familjen. Procter & Gamble është e listuar në bursë. Zyrat qendrore të Grupit P&G për veprimtarinë në vendet e Europës, Azisë Qendrore dhe Afrikës janë në Gjenevë dhe po ashtu ka edhe zyra dhe fabrika në vende të ndryshme të Europës dhe Azisë Qendrore dhe Afrikës³⁷. Grupi P&G është i strukturuar në 4 shtylla (i) Njësitë e Biznesit Global; (ii) Organizata e Zhvillimit të Tregut; (iii) Shërbimet Globale të Biznesit; (iv) Korporata.

Grupi P&G nuk ka filiale në Shqipëri³⁸, por ai është prezent në tregun e brendshëm të larësve shtesë (ACE) nëpërmjet importuesit dhe distributorit të tij ekskluziv shoqërisë Marketing & Distribution.

✚ **ACE**, është **Biznesi Target** dhe përbëhet nga asetet e përdorura për prodhimin, paketimin, shpërndarjen, promovimin dhe shitjen produkteve për kujdesin ndaj rrobave në vende të ndryshme EQLAQA39. Në mënyrë të veçantë, biznesi target përbëhet nga produkte (duke përfshirë produktet zbardhuese) që përdoren si shtesë të lëndëve larëse (gjatë ose jashtë larjes) me qëllim që të arrihet një përfitim parësor për heqjen e njollave, pastrimin ose zbardhjen (të quajtur ndihmues për larje). Biznesi target aktualisht kontrollon nga grupi P&G me seli në Procter & Gamble Plaza 1, Cincinnati, Ohio, SH.B.A⁴⁰.

4. Xhiro për vitin 2013

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **XXXX** lek, ku:
- Fater S.p.A⁴¹XXX Euro⁴² = XXX lek

37 Ndërmjet të cilave dhe fabrika në Turqi dhe Marok, sipas Marrëveshjes për Shitblerje Asetesh datë 18 Shkurt 2014, të cilat janë pjesë e objektit të transaskionit dhe do të transferohen shoqërisë blerëse, Fater S.p.A

38 Grupi P&G ka ëënë prezent në Shqipëri me anë të degës së tij Procter & Gamble Albania e cila është themeluar në vitin 2006, por ajo është cregjistruar me likujdim në vitin më datë 10.06.2013. Burimi, ekstrakti historik i shoqërisë Procer & Gamble Albania.

39 Europës Qëndrore dhe Europës Lindore, Azisë Qëndrore dhe Afrikës.

40 Burimi, Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Perqendrimit

41 Burimi: Pasqyra financiare e Fater S.p.A 01.07.2012 – 30.06.2013.

- Grupi Angelini⁴³ XXXX euro = XXXX lek
- Procter & Gamble Company⁴⁴ XXX USD⁴⁵ = XXX lek

- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**⁴⁶ është XXX lek
 - Grupi Angelini XXX Euro⁴⁷ = XXXX lek
 - Grupi Procter & Gamble XXX Euro = XXXX lek
 - Biznesi target (Ace) XXX Euro = XXX lek

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

5. Tregu përkatës

Referuar Udhëzimit nr. 76, datë 07/04/2008 “PER PËRCAKTIMIN E TREGUT PËRKATËS”, “tregu përkatës” përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

5.1 Tregu përkatës i produktit:

Produktet e kujdesit të rrobave përdoren për larjen e rrobave/tekstileve të tjera, për heqjen e njollave dhe për zbutjen para përdorimit të tyre. Brenda gjithë gamës së sektorit të produkteve të kujdesit të rrobave mund të dallohen tre kategori produktesh kryesore: a) **detergjentët**, të cilët përdoren për larjen apo pastrimin e rrobave dhe tekstileve të ndryshme; b) **zbutësit e rrobave**, të cilët përdoren për aromatizimin dhe zbutjen e tyre dhe c) **produktet shitesë në larje, (larës shtesë** – përfshirë dhe heqësit e njollave) të cilët kanë si funksion përmirësimin e rezultatit të larjes para ose gjatë përdorimit të detergjentit.

Aktiviteti ekonomik i biznesit target lidhet me prodhimin dhe tregtimin e produkteve të markës Ace, produkte të kategorisë ‘larës shtesë/produkte ndihmës në larje’. Në vendin tonë, kryesisht kjo markë importohet, shpërndahet dhe shitet me shumicë me marrëveshje joeksluzive nga ndërmarrja Marketing & Distribution.

42 Kursi mesatar i këmbimit 1 Euro = 140.26 ALL. Burimi: Banka e Shqipërisë.

43 Burimi: Formulari I thjeshtuar I njoftimit të përqendrimit, fq 8.

44 Burimi: Pasqyra financiare e Procter& Gamble Company 01.01.2013 – 31.12.2013.

45 Kursi mesatar i këmbimit 1 USD = 105.67 ALL. Burimi: Banka e Shqipërisë.

46 Burimi: Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit, fq 8.

47 Xhiro e Grupit Angelini në tregun e brendshëm është realizuar në mënyrë ekskluzive nga shitjet e verës. Burimi: Pala njoftuese: Përgjigje për pyetjet e ngritura nga Autoriteti i Konkurrencës, dërguar tek competition@caa.gov.al, dt 11.04.2014

Në raste të ngjashme të trajtuara nga Komisioni European, këto produkte janë konsideruar si një treg i veçantë produkti⁴⁸. I njëjti qëndrim mbahet dhe nga palët sa i takon përcaktimit të tregut si tregu i produkteve ndihmëse për larje⁴⁹.

Në përkufizimin më të ngushtë, **treg përkatës produkti do të konsideronim tregun e larësve shtesë/ produkteve ndihmës në larje.**

Meqenëse analiza e konkurrencës nuk ndryshon pavarësisht çdo përcaktimi të mundshëm të tregut të produktit, përcaktimi i tregut të produktit në këtë rast mund të lihet dhe i hapur.

5.2 Tregu përkatës gjeografik:

Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet **Tregu i Brendshëm**, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

6. Vlerësimi i përqendrimit

Si rezultat i transaksionit, pjesa e tregut e mbajtur nga Procter & Gamble në tregun e larësve shtesë në vendin tonë do ti atribuohet ndërmarrjes Fater pas realizimit të përqendrimit, shoqëri kjo e përbashkët e grupit Procter & Gamble dhe Angelini me respektivisht 50% të kapitalit.

Produktet e prodhuara nga Fater i përkasin një tregu tjetër produkti, atij të prodhimit të pelenave, produkteve të inkontinencës për të rritur dhe pecetave higjienike/ sanitare, dhe si rrjedhim s'ka asnjë lloj mbivendosjeje horizontale sa i takon aktivitetit ekonomik të palëve në transaksion. Meqenëse Fater nuk ushtron aktivitet në Shqipëri⁵⁰, si dhe asnjë prej ndërmarrjeve të grupit Angelini nuk ka filial në vendin tonë⁵¹, pjesa e tregut e kombinuar e palëve në transaksion pas përqendrimit do të ngelet e njëjtë. Transaksioni nuk ndryshon nivelin e përqendrimit të tregut.

Sa më sipër, përqendrimi në fjalë nuk sjell shqetësime në lidhje me konkurrencën në tregun përkatës të produktit, qoftë dhe sa i takon përkufizimit më të ngushtë të tij.

Si konkluzion, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t'i kërkon Komisionit autorizimin e

48 Case No COMP/M.1632 -Reckitt + Colman /Benckiser, Commission Decision of 3 September 1999. Case No Comp/M.5658 – Unilever/Sara Lee.

49 Seksioni 6, Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit, fq 15.

50 Referuar pales njoftuese, Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit, Seksioni 1 fq 2.

51 Referuar Formularit të thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit, Seksioni 4.1.1 fq 9.

këtij përqëndrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të biznesit të markës ACE nga shoqëria Fater S.p.a me anë të blerjes së aseteve nga shoqëria The Procter & Gamble.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

nr.314, datë 08.05.2014

**“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit,
prodhimit, shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.04.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit, shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nenet 12 dhe 12/1 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit, prodhimit, shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit,
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. PROCEDURA

Ndodhur para një shqetësimi publik mbi rritjen e çmimit të duhanit dhe cigareve të paketuara në një masë më të madhe sesa akciza e rritur, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 302, datë 14.01.2014, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit

paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit” .

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, grupi i punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, date 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 20, datë 15.01.2014 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në treg.

II. NDËRMARRJET NËN HETIM

Bazuar në Vendimin nr. 302, datë 14.01.2014, vendosi “për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit” si informacionit të administruar gjatë inspektimeve, ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit janë:

- 1. AGNA Group**, me seli në Gjirokastrë Vrisera, importon 19 lloje të ndryshme paketash ndër të cilat peshën më të madhe e zënë paketat e mëposhtme: Karelia Slims (87%), George, Karelia Blue, American Legend etj. Shitjen me shumicë dhe shpërndarjen e paketave të saj kjo ndërmarrje e realizon nëpërmjet shoqërisë ALFA. Shoqëria ALFA ka selinë në Gjirokastrë Vrisera dhe zotërohet nga Z. Georgios Zoidis (19% të aksioneve) dhe tre aksionerët e tjerë që zotërojnë shoqërinë AGNA group.
- 2. British American Tobacco (BAT)**, me seli në Tiranë, Rruga e Kavajës, zotërohet 100% nga British American Tobacco International Holdings. BAT ushtron aktivitetin në Shqipëri prej 21 vitesh dhe tregton 26 paketa të ndryshme. Markat të cilat zënë peshën specifike në paketat e BAT janë Rothman Leggera (59%), Kent (25%), Lucky Strike etj. BAT operon në Shqipëri si importuese dhe shitjen me shumicë dhe shpërndarjen e paketave deri te shitësi me pakicë e realizon nëpërmjet Tabacco Holding Group (THG).
- 3. Japan Tobacco International Tirana**, me seli në Tiranë, Rruga “Milito Tutulani” zotërohet 100% nga Japan Tobacco International Holding ushtron aktivitetin në tregun shqiptar që nga janari i vitit 2011 duke hedhur të treg 35 lloje të ndryshme paketash. Paketa e cila zë peshën më të madhe është paketa Winston (89%) ndërsa paketat e tjera të importuara nga JTI janë Camel, Monte Carlo etj. JTI importon paketat e mësipërme dhe realizon shitjen me shumicë dhe distribucionin nëpërmjet Marketing & Distribution.

4. **Imperial Tobacco** është e vetmja kompani në tregun e duhanit e cila operon në Shqipëri me statusin e përfaqësisë. Kjo shoqëri ka selinë në Tiranë Rruga “Brigada e 8”. Të gjithë aktivitetin e saj e kryen shoqëria Marketing & Distribution.
5. **Marketing & Distribution**, me seli në Tiranë Kashar, importon, shet me shumicë dhe shpërndan paketat e Imperial Tobacco. Paketa e cila zë peshën më të madhe është paketa Imperial (48%) por kjo shoqëri tregton dhe paketa të tjera si Davidoff, West, LD Blue etj.
6. **Philip Morris** Albania, me seli në Tiranë, Rruga “Murat Toptani”, ka për objekt të veprimtarisë së saj blerjen, shitjen, eksport importin e produkteve të duhanit. Kjo shoqëri zotërohet 100% nga Philip Morris S.A. Philip Morris Albania importon 24 llojeve të ndryshme paketash, ku peshën specifike e zënë dy paketa Philip Morris (33%) dhe Malboro (44%), por kjo shoqëri tregton dhe LM ASOS, Merit etj. Shitjen me shumicë dhe shpërndarjen e paketave të shoqërisë Philip Morris e realizon shoqëria Inter Distribution Services.

III. STRUKTURA E TREGUT

Tregu përkatës, në bazë të nenit 3, pika 7, të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 76, datë 07. 04. 2008, “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:

- a. Tregu i produktit
- b. Tregu gjeografik

Tregu përkatës i produktit është: duhani dhe nënproduktet e tij, me dy nëntregje: nëntregu i prodhimit të duhanit dhe nëntregu i importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të cigareve. Duke qenë se duhani i prodhuar dhe i tregtuar i hapur nuk është konkurrent me cigaret e paketuara në analizën e sjelljes së ndërmarrjeve aktive në treg duke parë sjelljen ndaj ndryshimit të çmimit të paketave si pasojë e ndryshimit të akcizës, analiza e mëposhtme është përqëndruar kryesisht në cigaret e prodhuara nëpërmjet makinerive (paketat e cigareve)

Cigaret e prodhuara nëpërmjet makinerive kanë karakteristika të ndryshme përsa i përket paketimit, formës së tyre, elementëve të brendshëm si nikotina, aroma, niveli i katranit, shija etj. Duke qenë se në tregun e cigareve ka 140 lloje të ndryshme paketash, në analizë kemi marrë ato paketa të cilat zënë peshën më të madhe në importet dhe shitjet e një shoqërie.

III.1. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës dhe ofertës

Në tregun e cigareve kemi zëvendësueshmëri si nga ana e kërkesës ashtu edhe nga ana e ofertës. Përsa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës themi se duhanpirësit kanë mundësi zgjedhje duke qenë se ekzistojnë 140 lloje

të ndryshme paketash në treg. Pavarësisht faktit që çmimi i cigareve ndryshon shumë nga lloji në lloj, brenda të njejtës kategori çmimi, ka një shumëllojshmëri të madhe paketash p.sh në kategorinë Slims çmimi i të cilës varion nga 180-200 lek ka Karelia Slims, Kent Slims, Imperial, Rothman Leggera etj, produkte këto të ofruara nga shoqëri të ndryshme. ***Pra në tregun e cigareve ka zëvendësueshmëri nga ana e kërkesës.***

III.2. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës

Në tregun e cigareve janë 9 ndërmarrje importuese duhani dhe cigaresh. Referuar skemës së mësipërme të funksionimit të tregut, rezulton se disa prej ndërmarrjeve importuese operojnë në tregun e shitjes me shumicë dhe shpërndarjes së cigareve. Nga ana e ofertës themi se kemi zëvendësueshmëri duke qenë se ka disa ndërmarrje të cilat importojnë, tregtojnë me shumicë dhe shpërndajnë produktin.

Tregu gjeografik përfshin të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë sepse ky produkt tregtohet në të gjithë tregun e brendshëm.

Tregu përkatës është prodhimi, importi, shitja me shumicë dhe me pakicë e duhanit dhe nënprodukteve të tij në tregun e brendshëm.

IV. VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE

Gjatë vitit 2013, në vendin tonë është importuar rreth 1.2% më shumë fije cigaresh krahasuar me një vit më parë. Sasia totale e importuar në 2013 rezulton 3,512,365.6 mijë fije. Subjektet me volumin më të lartë të importeve edhe gjatë vitit 2013 ngelen sërish Philip Morris Albania me 1231767 mijë fije cigare (ose 35.07% të sasisë totale të importuar) dhe Agna me 1102724.2 mije fije ose 31.4% të importeve.

Në muajt shkurt, mars, maj, korrik dhe shtator sasia e cigareve të importuar gjatë vitit 2012 është më e lartë se ajo e importuar në 2013 (mbi 5000 mijë fije diferencë). Ndërkohë muajt prill, nëntor dhe dhjetor pasqyrojnë sasi më të larta importi për vitin 2013 krahasuar me vitin paraardhës. Muaji dhjetor paraqet dhe muajin me diferencën më të lartë (rreth 22000 mijë fije) sa i takon sasisë së cigareve të importuar nëse do krahasonim vitin 2012 me 2013.

Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës është bërë në baze të parashikimeve të nenin 4 (marrëveshjet e ndaluara) dhe 8 (pozita dominuese) dhe 9 (abuzimi me pozitën dominuese).

IV.1. Vlerësimi i pozitës dominuese

Në tregun përkatës, tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të cigareve, nuk ka pengesa për hyrjen në treg. Pra ndërmarrjet të cilat zotërojnë kapitalin e nevojshëm janë të lira të hyjnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve.

Themë se në treg ka konkurrencë potenciale sepse ka disa ndërmarrje që ofrojnë cigare në tregun e importit dhe shitjes me shumicë, si dhe ka disa distributor që realizojnë shpërndarjen deri te shitësit me pakicë. Gjithashtu

blerësit kanë fuqi kundërvepruese sepse në treg gjenden 140 lloje paketash të markave, cilësive dhe çmimeve të ndryshme. Lidhur me produktin e cigares themi se produkti cilësohet heterogjen sepse ka zëvendësueshmëri të lartë dhe sipas markës (në treg ka 140 marka paketash) dhe sipas karakteristikave të tjera të produktit sic janë shija, trashësia, niveli i nikotinës etj.

Në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe shitjes me pakicë të cigareve nuk ka asimetri informacioni. Si firmat ashtu dhe konsumatorët kanë informacion të plotë përsa i përket karakteristikave të produktit dhe ndryshimit të çmimit, duke qenë se firmat, bazuar në Udhëzimin 17 të Ministrisë së Financave, janë të detyruara të publikojnë 10 ditë përpara ndryshimin e çmimit.

Tre ndërmarrjet që kanë pjesën më të madhe të tregut zotërojnë pozitë dominancë kolektive duke e tejkaluar kriterin prej 70% të pjesës totale të tregut. Kjo ka sjellë që tregu të ketë indeks të lartë përqëndrimi. Prandaj është analizuar nëse këto ndërmarrje kanë sjellje të koordinuar si pasojë e dominancës kolektive.

Për sa më, sipër bazuar në pjesët e tregut të ndërmarrjeve në hetim, sjelljes së pavarur të ndërmarrjeve në treg, fuqisë kundërvepruese të blerësve, pengesave të hyrjes në tregun përkatës, themi se asnjë nga ndërmarrjet objekt hetim që ushtrojnë veprimtar në tregun përkatës, nuk përmbushin kriteret e nenit 8 duke mos zotëruar pozitë dominuese individuale në tregun përkatës dhe si pasojë nuk mund të ketë abuzuar me pozitën dominuese në treg.

IV.2. Ekzistenca ose jo e Marrëveshjeve të Ndaluar

Duke qenë se nuk u gjetën evidenca direkte të bashkëpunimit, si dhe nga analiza e tregut përkatës rezultoi një shkallë e lartë përqëndrimi, grupi i punës ka analizuar, nëse kjo fuqi tregu vjen si rezultat i koordinimit të sjelljeve të ndërmarrjeve në tregun përkatës nëpërmjet evidencave indirekte ekonomike dhe/ose të komunikimit.

Mënyra e funksionimit të këtij tregu është ndikuar nga zbatimi i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 17, i cili përcakton që furnizuesit kryesorë janë të detyruar të publikojnë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore nacionale dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketing çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.

Në këtë udhëzim parashikohet që çmimi i vendosur në faturën që i lëshohet nga shoqëria e tregtimit me shumicë shoqërisë së tregtimit me pakicë, është ai i shitjes me pakicë dhe mbi vlerën e tatueshme të çdo furnizimi aplikohet TVSH në shkallën tatimore 20%. Ajo deklarohet si TVSH e mbledhshme nga personi

që luan rolin e kryesorit dhe konsiderohet si TVSH e zbritshme për blerësin, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Komisioni i Konkurrencës ka dhënë rekomandimet Ministrisë së Financave me vendimin nr. 118 datë 29.05.2009 “Për disa rekomandime për aktet ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë të karburanteve”.

Në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës ka rekomanduar që në nenin 15 pika 2 të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, të shtohet fjalia: “Kontratat e furnizimit ndalohet të përmbajnë kushte që përcaktojnë çmimet e shitjes me pakicë, vendosjen e çmimeve minimum, si dhe vendosjen e kushteve të tjera të tregtimit që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mund të çojnë në përcaktimin e çmimit. Kopje të këtyre kontratave i vihen në dispozicion Autoritetit të Konkurrencës, sa herë që kërkohen nga ky institucion.” Gjithashtu, i është rekomanduar Ministrisë së Financave ndryshimi i pikës 9.4 të Udhëzimit 17 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, duke vendosur një afat kohor, i cili do të mundësojë realizimin e transparencës së çmimeve.

Vlerësim koherent i efekteve të këtij Udhëzimi në funksionimin e tregut objekt hetimi do të jetë pjesë e procedurës që është në proces në tregun e karburanteve, pasi ky Udhëzim vepron mbi të dyja tregjet.

Duke marrë në konsideratë këtë fakt janë analizuar datat e ndryshimit të çmimit të paketave të cilat zënë peshën më të madhe brenda një shoqërie që janë paketat: Winston, Imperial, Karelia Slims, Malboro, Philip Morris, Rothman Leggera dhe Kent.

Për sa më sipër, konstatojmë se secila ndërmarrje ka rritur çmimin e paketave në mënyrë individuale dhe në momente të ndryshme nga njëra tjetra, çka është vërtetuar dhe nga analiza që i është bërë faturave të shitjes të ardhura nga firmat.

Tregu i importit të duhanit ka strukturë oligopolistike pasi në treg operojnë 5 firma të mëdha. Bazuar në pjesët e tregut të ndërmarrjeve në hetim, sjelljes së pavarur të ndërmarrjeve në treg, fuqisë kundërvepruese të blerësve, pengesave të hyrjes në tregun përkatës, u konkludua se asnjë nga ndërmarrjet objekt hetimi që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës, nuk përmbushin kriteret e nenit 8 duke mos zotëruar pozitë dominuese individuale në tregun përkatës dhe si pasojë nuk mund të ketë abuzuar me pozitën dominuese në treg sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit.

Gjithashtu nga inspektimet e kryera në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë në ndërmarrjet nën hetim nuk u gjetën evidenca direkte ose indirekte për bashkëpunim të mundshëm të ndërmarrjeve përsa i përket ndryshimit të çmimit

dhe koordinimit të sjelljes së tyre në treg. Për sa më sipër, nuk konstatohen shkelje të nenit 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Pra si konkluzion, nga procedurat e hetimit paraprak nuk rezultuan shenja të kufizimit të konkurrencës referuar neneve 4 dhe 9 të Ligjit për të filluar procedurën e hetimit të thelluar sipas përcaktimeve të nenit 43 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

1. Mbyllet e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Në bazë të nenit 28 të Ligjit ngarkohet Sekretariati për monitorimin në vazhdimësi të tregut të importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi ndërmarrjeve nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
nr. 315, datë 13.05.2014**

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit
dhe shitjes me shumicë të karburanteve”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|------------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Rezana | KONOMI | Zv/kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 13.05.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi ne raportit të hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve.

Baza ligjore:Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 5, pika 3 i Rregullores “Për procedurat hetimore te Autoritetit të Konkurrencës”,si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Raportit tëhetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës si dhe relacionit e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE :

I . PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencësme anë të Vendimit nr. 292, datë 16.09.2013 ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit,

prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës.

2. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e në vijim Ligji) grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimete nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg.
3. Me vendimin nr. 304, datë 27.01.2014 “Për një ndryshim në vendimin nr.292, datë 16.09.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës”, vendosi zgjatjen e periudhës së hetimit deri në 31 janar 2014. Arsyet e zgjatjes së periudhës hetimore u argumentuan me ndryshimin e strukturës së tregut, daljen nga tregu i importit të një ndërmarrje dhe hyrja në fuqi e paketës së re fiskale më datë 1 janar 2014 me Ligjin nr 180/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilën është realizuar rritja e taksës së qarkullimit për karburantet nga 7 lek në 17 lek për litër.

II . TREGU PËRKATËS

1. Përcaktimi i tregut përkatës është realizuar në bazë të Udhëzimit nr.76 datë 07.06.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”.
2. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - c) Tregu përkatës i produktit
 - d) Tregu përkatës gjeografik

II.1 Tregu përkatës i produktit

1. Tregu përkatës i produktit i referohet tregut të importimit, prodhimit dhe shitjes me shumicë për nën-tregjet:
 - a. Eurodiezeli i standartit EN 590 të BE, me squfur < 0.05%. për mjete të transportit rrugor
 - Nën-tregu i prodhimit
 - Nën-tregu i importit dhe
 - Nën-tregu i shitjes me shumicë të naftës
 - b. Benzina e standardi S SH EN 228 e destinuar për automjete, "pa plumb" (Pb<=0,013g/l), me oktan më të madh ose të barabartë me 95 por më të vogël se 98
 - importi dhe shitja me shumicë e produktit benzinë;

Duke qenë se për produktin naftë dhe benzinë që përdoret në industrinë prodhuese, nxjerrëse, përpunuese, ndiqen politika të tjera tregtare në Republikën e Shqipërisë, ky produkt nuk është i zëvendësueshëm me produktin naftë dhe benzinë që tregtohet për automjetet në rrugë, për shkak të çmimit, i cili është i ndryshëm si pasojë e barrës fiskale.

Veçoria e rregullimit në tregun objekt hetimi është vendosja e çmimit të pakicës nga ndërmarrjet e tregtimit me shumicë. Për këtë arsye do të analizohet tregu i pakicës për të parë efektet e këtij rregullimi.

II.2.Tregu përkatës gjeografik

1. Ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë në tregun objekt hetimi e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm i Republikës së Shqipërisë. Edhe zona e lirë doganore, në bazë të Kodit Doganor (nenet 3 dhe 183) është pjesë e territorit të Republikës së Shqipërisë dhe si e tillë përfshin gjithë ndërmarrjet që kryejnë aktivitet në të. Karburantet në territorin shqiptar mund të blihen dhe shiten në zonën e lirë doganore ose pasi janë zhdoganuar.

III . STRUKTURA E TREGUT

1. Për vlerësimin e tregut të karburanteve dhe sjelljen e ndërmarrjeve pjesë e këtij tregu, analiza do të bëhet sipas nën-tregjeve të mëposhtme:
 - a) Tregu i prodhimit (shitjet nga rafineria)
 - b) Tregu i importit dhe:
 - c) Tregu i shitjes me shumicë.
2. Gjatë periudhës objekt hetimi Janar 2010 – Janar 2014 rafineria e vetme e naftës në vend ka **prodhuar** dhe hedhur në tregun vendës të karburanteve me destinacion automjetet në rrugë, produktin naftë, sipas standardeve të përcaktuara në ligj. Prodhimi i kësaj rafinerie, gjatë kësaj periudhe për këtë produkt dhe shitja në total në tregun vendës ka zënë nivele nga 4.1% viti 2013 (sasia më e ulët) deri në 17.5% (sasia më e lartë) viti 2011.
3. Tregu i karburanteve është i strukturuar në këtë mënyrë: importuesit e karburanteve, sjellin produktin në magazinat e lira doganore dhe një pjesë e shesin në regjimin e lirë doganor, ndërsa pjesën tjetër e zhdoganojnë vetë duke vazhduar zinxhirin e tregtimit të produktit në ndërmarrjet e integruara ose në ndërmarrje të tjera në tregun e shitjes me shumicë dhe ose pakicë deri tek konsumatori përfundimtar.
4. E vetmja ndërmarrje e cila rezulton se nuk ka një rrjet të vetin në hallkat e tjera të shitjes së karburanteve, pra në tregun e shitjes me shumicë drejt stacioneve të pakicës është ndërmarrja Everest Oil SHA, e cila e kryen aktivitetin e saj në tregun e blerjes dhe shitjes me shumicë në magazinën e lirë doganore në portin “Vlora 1”, Pylli i Sodës, Vlorë. Në total për vitin 2012 nëpërmjet magazinave doganore të Everest ka qarkulluar 23 % e tregut të naftës dhe 38 % e tregut të benzinës.
5. Të gjitha ndërmarrjet e tjera (përfshijto Everest Oil SHA) janë të integruara vertikalisht në këtë treg. Përqendrimi i tregut mbetet i lartë deri në nivelin e shitjes me pakicë. Ky përqendrim i lartë dhe karakteristikat e tregut si transparenca, homogjeniteti dhe kërkesa e qëndrueshme për

produktin bëjnë që elasticiteti i kërkesës ndaj çmimit të shitjes për karburantet të jetë i ulët.

IV . KARAKTERISTIKAT E TREGUT

IV.1. Tregu i prodhimit

1. Struktura e tregut të prodhimit vendës të naftës për tregun përkatës naftë për mjetet e transportit përbëhet vetëm nga një ndërmarrje e cila përpunon naftën dhe nënproduktet e saj, ARMO SHA.
2. Gjatë periudhës objekt hetimi Janar 2010 – Janar 2014 rafineria e vetme e naftës në vend ka prodhuar dhe hedhur në tregun vendës të karburanteve me destinacion automjetet në rrugë, produktin naftë, sipas standardeve të përcaktuara në ligj. Për pjesën dominuese të periudhës hetimore kjo shoqëri ka pasur aksionerë të përbashkët me shoqërinë e tregtimit me shumicë të karburanteve Taçi Oil dhe shoqërinë e integruar të saj Kuid sh.p.k në tregun e shitjes me pakicë.

15. IV.2. Tregu i Importit

1. Gjatë periudhës objekt hetimi evidentohet se ndërmarrjet Kastrati SHA dhe Kaspitol SHAtë cilat zotërohen nga të njëjtët aksionerë, si dhe Europetrol Durrës SHA, Taçi Oil SHA, Everest Oil SHA janë ndërmarrjet kryesore në tregun e importit, tregtimit, dhe të aktivitetit importues dhe tregtar në zonën e lirë doganore në Shqipëri.
2. Zonë e lirë doganore. Ndërmarrja Everest Oil SHA pothuajse të gjithë aktivitetin e saj tregtar e kryen në zonën e lirë doganore. Pra, kjo ndërmarrje i shet shoqërive aksionere shqiptare që realizojnë aktivitet në tregun e tregtimit me shumicë në Shqipëri.
3. Ndërmarrjet Kastrati SHA dhe Europetrol SHA realizojnë aktivitet tregtimi të karburanteve edhe në zonën e lirë doganore, por njëkohësisht pjesën më të madhe të karburanteve i zhdoganojnë duke vazhduar aktivitetin e tregtimit në hallkat e tjera të shitjes me shumicë dhe pakicë. Këto ndërmarrje janë të integruara vertikalisht në të gjithë nivelet e tregut.
4. Nga vlerësimi i pjesëve të tregut konstatohet se ndërmarrja Kastrati SHA është importuesi më i madh i produktit naftë për periudhën objekt hetimi. Pjesa e tregut të kësaj ndërmarrje është rritur në vitin 2013 duke arritur rreth 46,3% të tregut të produktit naftë dhe rreth 37% të tregut të produktit benzinë.
5. Për sa i përket produktit benzinë tre ndërmarrjet që zotërojnë pjesën dërrmuese të tregut janë Kastrati SHA, Europetrol SHA dhe Everest Oil SHA. Për të gjithë periudhën objekt hetimi pjesa e tregut që zotërojnë këto ndërmarrje ka qenë e qëndrueshme përjashtojë vitin 2012, vit në të cilin ndërmarrja Taçi Oil SHA ka zgjeruar aktivitetin e saj në këtë treg.
6. **Veprimet në zonën e lirë doganore.** Nga vlerësimi i pjesëve të tregut rezulton se një pjesë e ndërmarrjeve të cilat kanë pjesë të vogla tregu janë

blerës vetëm në zonën e lirë doganore. Në vitin 2013, ka pasur një ulje të mëtejshme të numrit të ndërmarrjeve të cilat kanë realizuar blerje të karburanteve në tregjet ndërkombëtare duke qenë vetëm katër, Kastrati SHA, Europetrol SHA, Taçi Oil SHA dhe ndërmarrja Everest Oil SHA.

7. Ndërmarrjet Kastrati SHA, Europetrol SHA dhe Taçi Oil SHA (vetëm për 3-mujorin e parë të vitit 2013) që disponojnë magazina të lira doganore në portin “Romano Port” SHA, pjesën më të madhe të produktit naftë dhe benzinë që blejnë në tregjet ndërkombëtare e zhdoganojnë vetë, ndërsa pjesa tjetër u shitet në zonën e lirë doganore ndërmarrjeve të tjera ku përmendim: Genklaudis SHA, Bolv Oil SHA, etj.
8. Blerja e produktit naftë dhe benzinë realizohet gjithashtu edhe në Portin Vlora 1, ku shitjet në zonën e lirë doganore në drejtim të tregut shqiptar i kryen vetëm ndërmarrja Everest Oil SHA. Nga analizimi i faturave të blerjes në zonën e lirë doganore, blerësit kryesorë nga ndërmarrja Everest Oil SHA janë ndërmarrjet Tea Construction SHA dhe AFT SHA.
9. **Shitësit me shumicë.** Strukturat e ngritura në tregun e karburanteve kanë evidentuar edhe një kategori ndërmarrjesh të cilat mund të kategorizohen si shitës me shumicë. Këto ndërmarrje pjesën dërrmuese të aktivitetit të tyre e realizojnë duke blerë dhe shitur karburante me shumicë, duke mos qenë vetë importues. Kështu, ndërmarrja Everest Oil SHA blen karburantet nga ndërmarrja ENI S.P.A dhe e shet këtë karburant ndërmarrjeve të tjera të shitjes me shumicë në zonën e lirë doganore (pra i gjithë transaksioni ndodh në zonë të lirë doganore). Ndërkohë edhe ndërmarrjet Genklaudis SHA dhe Bolv Oil SHA në pjesën dërrmuese të aktivitetit të tyre kanë blerë në zonën e lirë doganore dhe kanë shitur drejt ndërmarrjeve të tjera të pakicës, kryesisht drejt ndërmarrjeve të tyre të shitjes me pakicë, pasi këto ndërmarrje janë të integruar vertikalisht në treg.

V . KUFIZIMET E MUNDSHME TË KONKURRENCËS

V.1. DOMINANCA DHE ABUZIMI I MUNDSHËM ME POZITËN DOMINUESE

1. **Struktura e tregut** të karburanteve në Shqipëri është e formës **oligopolistike** ku një numër i vogël ndërmarrjesh rezultojnë që importojnë dhe tregtojnë karburant në territorin shqiptar. Gjithashtu, karburantet janë produkte homogjene me mundësi të pakta për inovacion nga ana e ndërmarrjeve në cilësinë e produktit apo shërbimit të ofruar klientëve në stacionet fundore.
2. **Pjesët e tregut** në import të ndërmarrjeve Kastrati SHA dhe Kaspetroli SHA (të dy ndërmarrjet kanë të njëjtët aksionerë) Europetrol Durrës SHA, Porto Romano Oil SHA dhe Bolv Oil SHA (të dy ndërmarrjet kanë të njëjtët aksionerë); Genklaudis SHA; Everest Oil SHA; Taçi Oil SHA dhe Armo SHA (ndërmarrjet kanë të njëjtët aksionerë gjatë periudhës hetimore); së bashku shkojnë nga 80% deri në 100% të tregut për periudhën objekt hetimit 2010, 2011, 2013, Janar 2014, përjashtojnë vitin

2012 ku në tregun e naftës kanë zënë rreth 67% dhe në atë të benzinës 75% për shkak të hyrjes së ndërmarrjes Taçi Oil në Import.

3. Bazuar në nenin 8 të Ligjit 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrjet Kastrati SHA dhe Kaspetro SH; Europetro Durrës SHA; Porto Romano Oil SHA dhe Bolv Oil SHA, Genklaudis SHA; Everest Oil SHA, Taçi Oil SHA dhe Armo SHA; **kanë pozitë dominuese të përbashkët** në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve.
4. Gjatë periudhës hetimore Janar 2010- Janar 2014 rezulton se ndërmarrjet të cilat dominojnë tregun me shumicë të karburanteve aplikojnë çmime të njëjta ose me diferencë shumë të vogël nga njëra-tjetra, duke ndjekur të njëjtën trajektore të ritmit të uljes dhe rritjes së çmimeve dhe duke ndjekur ngushtësisht njëra-tjetrën.
5. Gjithashtu, ndërmarrjet nuk reflektojnë çmimet e blerjes në bursa në rastin kur këto të fundit pësojnë rënie të ndjeshme duke i transferuar fitimet në llogaritë e tyre, kur në kushte konkurrenciale këto ulje çmimi duhet të transferoheshin në përfitime të konsumatorëve.
6. Strategjia për të mbajtur çmime të padrejta me pakicë dhe aplikimi i një sjellje të përbashkët nga ndërmarrjet dominuese në këtë treg, bazohet në faktin se këto ndërmarrje janë të vetmet që kanë pasur një akses periodik mbi burimet e furnizimit (importet) dhe integrimi i këtyre ndërmarrjeve deri në nivelin e shitjes me pakicë bën që kontrolli dhe ndëshkimi të jetë në kohë reale. Situata aktuale e konkurrencës në tregun e karburanteve konfirmon këtë vlerësim.
7. Analiza për zbatimin e çmimit të padrejta të shitjes përfshin krahasimin e çmimeve të tregtimit për periudhën hetimore, analiza e kostove dhe fitimeve të ndërmarrjeve, benchmark rajonal i çmimeve të naftës dhe benzinës si edhe marzhit bruto të fitimeve ku rezulton se Shqipëria ka nivelet më të larta, ndërmarrjet Kastrati SHA dhe Kaspetro SH; Europetro Durrës SHA; Porto Romano Oil SHA dhe Bolv Oil SHA; Genklaudis SHA; Everest Oil SHA, Taçi Oil SHA dhe Armo; përbëjnë shenja të kufizimit të mundshëm të konkurrencës që lidhen me elemente të abuzimit me pozitën dominuese të përbashkët sipas parashikimeve të nenit 9, pika 2, kryesisht gërma a e Ligjit, pasi janë vendosur çmime të padrejta të shitjes krahasuar me:
 - a- Koston sipas zinxhirit të vlerës ;
 - b- Nivelin rajonal të çmimeve .
8. Sa i përket nivelit (benchmarkut) rajonal të çmimit, sipas të dhënave të publikuara nga ana e Bankës Botërore rezulton se, për sa i përket çmimit, Shqipëria gjatë vitit 2012 ka një çmim mesatar të shitjes më të lartë se

Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Sllovenia dhe Bosnje&Hercegovina.

V.2. PRAKTIKAT E BASHKËRENDUARA

1. **Lidhjet mes aksionerëve** në shoqëritë kryesore aktive në tregun përkatës kanë lehtësuar komunikimin dhe strategjitë e sjelljes në treg. Sjellja ndaj çmimit e ndërmarrjeve Kastrati SHA dhe Kaspetroli SHA; Porto Romano Oil SHA dhe Bolv Oil SHA; Taçi Oil SHA dhe ARMO SHA, por edhe ndërmarrjet e tjera të mëdha Europetroli Durrës SHA, Genkludis SHA, Everest Oil SHA, ka konverguar në çmime thuajse të njëjta shitje në treg. Gjithashtu, një sjellje e tillë konfirmohet edhe gjatë uljeve të çmimit të blerjes së karburantit i cili në shumë raste nuk reflektohet në çmimin fundor të shitjes. Duke qenë se ndërmarrjet (përjashto Everest Oil SHA) janë të integruara vertikalisht në tregun e shitjes me pakicë, transparenca mbi çmimet është e lartë duke rritur mundësinë e një sjellje të përbashkët kundrejt çmimit.
2. Nga të dhënat e administruara nga Porti “Romano Port” SHA, si edhe nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, konstatohet se ndërmarrjet kanë **realizuar blerje të përbashkëta**. Këto blerje të përbashkëta realizohen në dy forma:
 - a. Rasti kur anija është porositur nga dy ndërmarrje;
 - b. Rasti kur anija sillet nga një ndërmarrje dhe malli shitet në territorin shqiptar (zonën e lirë doganore) disa ndërmarrjeve në magazina të ndryshme doganore. Këto transaksione, të cilat vlerësohen si blerje të përbashkëta janë indicie të një praktike të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve dhe grupit të ndërmarrjeve aktive në tregun e importimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve.
3. Më konkretisht, nga evidencat e administruara gjatë hetimit paraprak rezulton **sendërmarrjet realizojnë transaksione midis tyre të cilat mundësojnë sjellje të koordinuara ndaj çmimit në treg**. Shembuj të tillë mund të përmendim:
 - a. Në muajin Janar 2014, ndërmarrja Europetroli ka blerë në total në zonën e lirë doganore një sasi prej 13,808,658 litra naftë dhe benzinë nga të cilat 5,982,542 litra janë blerë nga ndërmarrja Kastrati SHA. Këto blerje zënë rreth 43% e blerjeve të ndërmarrjes Europetroli SHA në total. Gjatë gjithë vitit 2013 blerjet e ndërmarrjes Europetroli Durrës SHA nga ndërmarrja Kastrati SHA vetëm në zonën e lirë doganore, kanë qenë rreth 6-7% e blerjeve të karburantit në total.
 - b. Shitje në të gjitha nivelet kanë ndodhur edhe nga Europetroli në drejtim të Kastrati SHA në periudha të ndryshme. Transaksionet edhe në këtë drejtim konstatohen nga faturat e shitjeve dhe blerjeve të ndërmarrjeve. Edhe ndërmarrja Genkludis SHA, Bolv

- Oil SHA dhe Porto Romano Oil SHA kanë realizuar transaksione ndërmjet tyre në të gjitha nivelet e tregtimit.
- c. Transaksionet kryesisht kanë drejtimin nga ndërmarrja Kastrati SHA në drejtim të ndërmarrjeve të shitjes me shumicë, Europetrol Durrës SHA, Genklaudis SHA, Bolv Oil SHA, por edhe drejt ndërmarrjeve të shitjes me pakicë të integruara në tregun e shumicës si Skënderi G, Kastrati Shpk, Gega Center GKG shpk etj.
 - d. Ndërmarrjet Kastrati SHA dhe Kaspetro SHA; Europetrol Durrës SHA, Porto Romano Oil SHA dhe Bolv Oil SHA; Genklaudis SHA; Everest Oil SHA kanë ruajtur gjithashtu lidhje periodike midis tyre, pra nga faturat e shitjes dhe blerjes midis ndërmarrjeve të shumicës apo pakicës në të cilat janë të integruara vertikalisht, realizohen gjatë gjithë periudhës objekt hetimit transaksione shitje – blerje.
 - e. Të pesë ndërmarrjet Kastrati SHA dhe Kaspetro SHA; Europetrol Durrës SHA, Porto Romano Oil SHA dhe Bolv Oil SHA; Genklaudis SHA; Everest Oil SHA kanë ndërvarësi midis tyre pasi ato plotësojnë nevojat për produkt duke u kthyer në periudha të ndryshme në blerës me shumicë dhe në shitës me shumicë për njëra-tjetrën.
4. Struktura e ndërmarrjeve që mbajnë pozicion dominues në tregun e karburanteve, karakterizohet nga një integrim i lartë në të gjitha nivelet e tregtimit dhe shitjes nga një ndërmarrje tek tjetra. Kështu, psh kemi shitje të ndërmarrjeve në zonën e lirë doganore, shitje me shumicë jashtë zonës së lirë doganore dhe pakicë, duke rritur ndjeshëm transparencën e tregut dhe duke sjellë gjithashtu edhe informacion mbi sjelljen dhe çmimet e konkurrentëve. Ndërmarrjet Kastrati SHA, Kaspetro SHA, Europetrol Durrës SHA, Bolv Oil SHA, Porto Romano Oil SHA, Everest Oil SHA dhe Genklaudis SHA, Taçi Oil SHA dhe ARMO SHA zotërojnë strukturat e linjave të depozitimit, transportimit, stacionet e shitjes me pakicë etj, që favorizojnë sjelljen e tyre dominuese. Ndërlidhjet e shumta në hallkat e ndryshme të sistemit të importimit, shitjes dhe rishitjes, shpërndarjes, shkëmbimit të karburanteve (përdorimi si mjet shkëmbimi me anë të kontratave të furnizimit në zonën e lirë doganore) kanë bërë që sjellja e ndërmarrjeve të humbasë pavarësinë dhe ato të sillen si një e vetme.
5. Kufizimi i mundshëm i konkurrencës në zinxhirin e vlerës nga prodhimi/importi, shitja me shumicë dhe tregtimi me pakicë vjen edhe për shkak të fiksimit të çmimit fundor nga ana e ndërmarrjeve të shitjes me shumicë, gjithashtu edhe për stacionet e shitjes me pakicë të cilat nuk janë nën pronësinë e tyre, të ashtuquajturat ndryshe pikat e bardha. Me anë të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 17 datë 13. 05. 2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, çmimi fundor i karburantit mbetet i pandryshuar gjatë një furnizimi të shitjes me shumicë, duke rritur më tej transparencën e çmimit në treg dhe sjelljes së ndërmarrjeve, të cilat në këto kushte e kanë të thjeshtë të monitorojnë njëri – tjetrin. Efektet për sa i përket kufizimeve të mundshme në konkurrencë që vijnë si pasojë e këtij udhëzimi do të bëhen në përfundim të procedurave hetimore për të

gjithë nivelet e tregut përfshi edhe tregun e shitjes me pakicë të naftës dhe benzinës.

6. **Si konkluzion**, ndërmarrjet Kastrati SHA, Kastpetrol SHA, Europetrol Durrës SHA, Porto Romano Oil SHA, Bolv Oil SHA, Genklaudis SHA, Everest Oil SHA, Taçi Oil SHA dhe ArmoSHA, mund të kenë zbatuar sjellje anti-konkurrese, bazuar në nenin 4 të Ligjit 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) nëpërmjet caktimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të shitjes osenenit 9 të Ligjit nëpërmjet vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të shitjes për karburantet për mjetet rrugore, naftë dhe benzinë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24, (shkronja d) dhe 43, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 5, pika 3 i Rregullores “Për procedurat hetimore te Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg dhe konkretisht:
 - a. Kastrati SHA
 - b. Kaspetro SHA,
 - c. Europetrol Durrës SHA,
 - d. Porto Romano Oil SHA
 - e. Bolv Oil SHA
 - f. Genklaudis SHA
 - g. Everest Oil SHA
 - h. Taçi Oil SHA
 - i. ARMO SHA

për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2010 - 30 Prill 2014;
3. Procedurat hetimore do të përfundojnë jo më vonë se 3 muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.
5. Ndërmarrjet objekt hetimi mund të ushtrojnë të drejtën për të bërë të njohur këndvështrimin e tyre brenda 30 ditëve nga bërja me dije e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
nr. 316, datë 23.05.2014**

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit
ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.05.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të monitorimit në tregun e transportit ndërkombëtar detar në Republikën e Shqipërisë”.

Baza ligjore:Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 42, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të monitorimit në “Tregun e transportit ndërkombëtar detar në Republikën e Shqipërisë”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, si dhe të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

I . PROCEDURA E NDJEKUR

1. Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa a, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” ka nisur procedurën e monitorimit në tregun e shërbimit të transportit detar të automjeteve dhe udhëtarëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Gjithashtu, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka njoftuar Autoritetin e Konkurrencës se në adresë të saj në mënyrë të vazhdueshme kanë mbërritur ankesa nga persona apo kompani të ndryshme në lidhje me

konkurrencën dhe çmimet e larta të biletave të trageteve që operojnë në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë.

3. Bashkelidhurshkresës së mësipërme, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka dërguar dhe ankesën e 21 kompanive private nga Maqedonia që ushtrojnë veprimtari të transportit transit në Shqipëri. Sipas ankuesve “shërbimi i portit është rritur kurse shërbimi trageteve është zero”. Sipas tyre kompanitë e trageteve kanë 3 vjet që kanë bërë monopol dhe nuk ka konkurrencë.

II . BAZA LIGJORE

1. Referuar nenit 8 të Ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), transporti detar i njerëzve dhe i mallrave konsiderohet si veprimtari detare. Kodi detar i Republikës së Shqipërisë ka si objekt rregullimin e marrëdhënieve juridike, ekonomike dhe shoqërore në fushën e detarisë, duke vendosur rregulla mbi të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që ushtrojnë veprimtari detare dhe kanë përgjegjësi ligjore mbi hapësirën detare.
2. Në bazë të nenit 3 të Kodit detar, janë subjekte të së drejtës detare personat fizike ose juridike, publike ose private, vendas ose të huaj, të cilët realizojnë veprimtarinë në fushën e detarisë. Subjektet detare mund të jenë drejtues të veprimtarisë në fushën e detarisë, pronare të mjeteve ose të mjediseve detare dhe ushtrues të veprimtarive në fushën e detarisë, zotërues, jo pronare të mjeteve dhe të veprimtarive të fushës së detarisë, të punësuar ose përfitues nga kjo veprimtari.
3. Referuar VKM-së nr. 421, datë 15.5.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, (të ndryshuar) licencat për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve jepen nëpërmjet QKL-së, por pasi ka paraqitur një akt kontrolli dhe vlerësimi paraprak të dokumentacionit teknik të anijes kryer nga Drejtoria e Përgjithshme Detare si dhe listën me dokumentacionin e anijes.
4. Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, duke synuar rregullimin, disiplinimin, monitorimin dhe lehtësimin e veprimtarisë së ushtruar ose që kërkohet të ushtrohet nga personat juridikë në fushën e transportit detar, si edhe integrimin e plotë të tyre në tregun evropian të transportit detar, ka nxjerrë Udhëzimin nr. 10, datë 23.06.2008 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, i ndryshuar.
5. Referuar përkufizimeve të këtij Udhëzimi:
 - a. Operim në linjë të rregullt për transport ndërkombëtar për automjete dhe ose udhëtarë: është veprimtaria që ushtrohet për transport automjetesh dhe ose udhëtarëve me mjete lundruese të specializuara për kryerjen e një transporti të tillë, nga një port i hapur i Republikës së Shqipërisë për në një port të huaj.
 - b. *Agjent detar*: është çdo subjekt juridik, i cili ka fituar një status të tillë dhe vepron si përfaqësues i pronarit ose operatorit të një mjeti lundrues në një port në lidhje me marrëdhëniet që pronari i mjetit lundrues krijon me autoritetet shtetërore dhe ato të shërbimeve në port. Pronari i mjetit lundrues nuk mund të kryejë shërbimin e agjentit detar për anijet e tij.

6. Ndërmarrjet që kërkojnë të marrin leje për operim në linja të rregullta ndërkombëtare detare për transport automjetesh dhe/ose udhëtarësh, dorëzojnë pranë zyrës së licencave të transportit në MPPT kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, i cili është përcaktuar në nenin 5 të Udhëzimit.
7. Ndër dokumentet e tjera, subjektet e huaja që nuk janë të regjistruara në Shqipëri duhet të paraqesin kontratën midis pronarit të anijes me agjencinë detare në portin që prek, si dhe kontratë me portet që do të prekë anija së bashku me aneksin për ditët dhe oraret e prekjës.

III . TREGU PËRKATËS

1. Bazuar në Ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimin nr. 76, datë 07.04.2008 të Komisionit të Konkurrencës “Për përcaktimin e tregut përkatës”, bazuar në nenin 3 të Ligjit 9121, konkretisht përcaktohet se:
2. “Tregu përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët, ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen, ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.
3. Pra përkufizimi i tregut përkatës përfshin:
 - a) Tregun e produktit (mall/shërbim)
 - b) Zona gjeografike

III.1 Tregu i produktit/shërbimit

1. Treg përkatës produkti do të konsiderohet shërbimi i transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe udhëtarëve që realizohet nga Porti i Durrësit, Vlorës, Sarandës si dhe Porti i Shëngjinit.

III.2 Tregu përkatës gjeografik

1. Tregu përkatës gjeografik janë Portet e Republikës së Shqipërisë ku kryhet transport detar i mallrave dhe udhëtarëve.
2. Për sa mësipër, tregu përkatës i produktit është shërbimi i transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe udhëtarëve nga/drejt Republikës së Shqipërisë.

IV . MONITORIMI I TREGUT

1. Nga të dhënat e administruara në Portin Detar të Durrësit konstatohet se agjencitë Duni Shpk, Adria Ferries dhe Ionian Island Shpk realizojnë thuajse të gjitha shitjet e biletave nëpërmjet këtij porti. Çmimet e shitjes së biletave nga ana e këtyre agjencive për periudhën 2012-2014, sipas të dhënave të pjeshme që janë grumbulluar nga ana e grupit të punës, rezultojnë që janë më të larta se tavani i vendosur nga ana e Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës për të dy agjencitë dhe linjat e trageteve që realizohen nga ana e këtyre operatorëve, duke dhënë shenja për kufizime të mundshme të konkurrencës

2. Gjatë periudhës objekt i kësaj procedure monitorimi rezulton se në portin e Vlorës operon vetëm një traget për linjën Vlorë – Brindizi, i cili ka si agjent detar “Gerverni Travel”. Të dhënat e sjella pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ana e agjencisë “Gerverni Travel”, nuk janë në përputhje me kërkesën për informacion të dërguar nga ana e Sekretariatit dhe gjithashtu nuk lejojnë realizimin e procedurës së monitorimit konform Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Të dhënat për biletat e shitura janë në numër të pakët, nuk përfaqësojnë të gjitha kategoritë e shitjeve dhe si rrjedhim nuk ofrojnë mundësi për të bërë analizat e nevojshme.
3. Nga Porti i Sarandës realizohen udhëtime nga ana e agjencisë I.V.A shpk. Informacioni mbi tarifat e aplikuara nga ana e kësaj agjencie për periudhën 2012-2014, për linjën e transportit detar Sarandë-Korfuz-Sarandë për subjektet që ajo përfaqëson: MARINA MARITIME dhe subjektin FLYING DOLPHINS MARINE, i kërkuar nga ana e sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës nuk është depozituar nga ana e kësaj ndërmarrje. Nga ana e agjentit detar I.V.A nuk është kthyer asnjë informacion në lidhje me tarifat e aplikuara gjatë periudhës 2012 -2014 nga ana e trageteve që realizojnë linjën Sarandë-Korfuz-Sarandë.
4. Bazuar në karakteristikat e tregut përkatës dhe nësjelljen e operatorve të tregut të trajtuar mësipër si dhe ankesës së dërguar nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, sjellja e agjensive detare që operojnë në tregun e transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve, apo të përfaqësimit të pronarit të mjeteve lundruese, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës, në bazë të nenëve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 42, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2013 deri më 31.08.2014.
3. Procedura e hetimit paraprak dhe dorëzimi i raportit të hetimit të bëhet jo më vonë se data 30.09.2014.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
nr.317 , datë 23/05/2014**

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.05.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak mbi ekzistencën ose jo të shkeljes së konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës.

Baza ligjore:, Neni 24, shkronja d, dhe neni 26, Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe Ligji nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës, si dhe të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.

VËREN SE:

I. PROCEDURA

1. Duke marrë shkas nga disa shqetësime mbi kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (ketu e në vijim Ligji), me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 306, datë 19.02.2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë

fizike në qarkun e Dibrës”, vendosi të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën e hetimit nga Janari 2012 deri në Janar 2014.

2. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme mbi objektin e hetimit, bazuar në nenin 34 të Ligjit, grupi i punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga Autoritetet Kontraktore në procedurat e prokurimit të cilëve kanë marrë pjesë ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës.
3. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun përkatës.

II. BAZA LIGJORE

4. Bazuar në Vendimin nr. 306, datë 19.02.2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës”, si dhe referuar të dhënave të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, gjithashtu edhe informacionit të administruar gjatë procedurës hetimore, ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës janë:
 - **Shoqëria “Grand Security” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.31904, datë 08.07.2004, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT: K51705027S, me seli në: Lagja 1, banesë private 2 katëshe, Maqellarë, Dibër, me ortak 50% Z.Aqif Shehu dhe 50% Z.Napolon Dervishi.
 - **Shoqëria “Kevenjo” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.25003, datë 22.01.2001, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT K36308746I, me seli në: Lagjja e re, Peshkopi, Dibër me përfaqësues ligjor dhe ortak të vetëm Z. Veli Deda;
 - **Shoqëria “Res 03” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 30553, datë 17.02.2004, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT K26513468E, me seli në: Lagja Minatori, qyteti Bulqizë, Dibër me përfaqësues ligjor dhe ortak të vetëm: z. Mejtim Markeçi.
 - **Shoqëria “Snajper Security” Sh.p.k** regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.38937, datë 17.10.2007, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT K77217701L, me seli në: Lagja Seit Naideni, Dibër, me përfaqësues ligjor dhe ortak të vetëm z.Ahmet Cani.

III. STRUKTURA E TREGUT

Tregu përkatës, në bazë të nenit 3, pika 7, të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 76, datë 07. 04. 2008, "Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës" përcaktohet në dy dimensione:

- a. Tregu i produktit
- b. Tregu gjeografik

III.1. Tregu përkatës i produktit

5. Tregu i produktit përfshin: shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike i cili ofrohet nga shoqëritë e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike (SHRSF) dhe ka për mision: sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë; sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj; shoqërimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre.
6. Veprimtaria e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, përfshihet në kategorinë I.3 të shtojcës së Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". Specifikimet teknike që paraqesin Autoritetet Kontraktore në prokurime publike për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike mbeten përcaktuesit kryesorë për dimensionet e tregut përkatës. Çdo tender ka specifikimet e veta të shprehura nëpërmjet specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim. Këto kritere kushtëzojnë tregun përkatës të shërbimit që është objekt hetimi.
7. Duke u bazuar në kriterin e zëvendësueshmërisë, si kriteri kryesor në përcaktimin e tregut përkatës, produkte të zëvendësueshme që mund të marrin pjesë në prokurimet publike për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, janë të gjitha shërbimet e ruajtjes dhe sigurisë fizike të cilat plotësojnë specifikimet teknike që kërkohen në një prokurim publik të organizuar nga ana e një Autoriteti Kontraktor.
8. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, ***tregu përkatës produkti është tregu i prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.***

III.2. Tregu përkatës gjeografik

9. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, bazuar dhe në vendimin për hapjen e hetimit paraprak, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet "**Tregu i prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës**".

IV. VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE NË TREG

10. Në zbatim të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, gjatë datave 24- 26 Shkurt 2014 u kryen inspektime në qarkun e Dibrës në adresat e pasqyruara në ekstraktet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si seli të kryerjes së aktivitetit të ndërmarrjeve nën hetim, të cilat synonin që të provonin ekzistencën e evidencave direkte të bashkëpunimit midis firmave. Më konkretisht :

- U realizua inspektim në ambientet e ndërmarrjes “Grand Security” Sh.p.k me seli në: Lagja 1, banesë private 2 katëshe, Maqellarë, Dibër. Gjatë inspektimit u mbajt procesverbal i datës 24.02.2014 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”, si dhe procesverbal i datës 24.02.2014 “Mbi inspektimin në ndërmarrje”.
- Për sa i përket ndërmarrjeve “Kevenjo” Sh.p.k, “Res 03” Sh.p.k, dhe “Snajper Security” Sh.p.k në inspektimin e realizuar në datë 24.02.2014 në qarkun e Dibrës, Grupi i Inspektimit konstatoi se këto ndërmarrje nuk kishin zyra të ushtrimit të aktivitetit në adresat e paraqitura në ekstraktet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Kjo u vërtetua dhe nga deklaratimet e ankimesit, i cili në procesverbalin e datës 24.02.2014 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit” shprehet se: “ ndërmarrjet që operojnë në qarkun e Dibrës nuk kanë seli këtu, edhe pse janë të regjistruara në këtë qark”.
- Gjithsesi Grupi i Punës më datë 25.02. 2014 kontaktoi me përfaqësuesin e ndërmarrjes “Kevenjo”, ku u mbajt dhe procesverbali i datës 25.02.2014 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”.
- Më datë 25.02. 2014 u kontaktua me përfaqësuesin e ndërmarrjes “Res 03”, ku u mbajt dhe procesverbali i datës 25.02.2014 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”.
- Më datë 26.02. 2014 u kontaktua me përfaqësuesin e ndërmarrjes “Snajper Security”, ku u mbajt dhe procesverbali i datës 26.02.2014 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”.

11. Në përfundim të procedurave të mësipërme nuk u gjetën evidencave direkte që të provonin ekzistencën e bashkëpunimit ose marrëveshjeve të ndaluara midis ndërmarrjeve nën hetim.

12. Në mungesën e evidencave direkte mbi bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik midis ndërmarrjeve nën hetim, për te vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e prokurimit të shërbimit të

ruajtjes dhe sigurisë fizike u vlerësuan të dhënat e siguruar nga Autoritetet Kontraktore.

13. Gjatë procedurës së Hetimit Paraprak janë marrë në shqyrtim dokumentat e dorëzuara nga ndërmarrjet nën hetim në procedurat e prokurimit të realizuara nga autoritetet kontraktore: “Gjykata e Rrethit ” Mat, “Prokuroria e Rrethit ” Mat, “Drejtoria e Shendetit Publik” Bulqizë, “Drejtoria e Shendetit Publik” Bulqizë, “Bordi i Kullimit” Mat, “Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë” Dibër etj.
14. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në këto procedura prokurimi, nuk u konstatuan shenja të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave, gjatë paraqitjes së ofertave apo pas fitimit të tenderit bazuar në metodologjinë që aplikon OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike.
15. Gjithashtu vërehet se tregu i shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës është një treg shumë i vogël që karakterizohet nga një numër i vogël konkurrentësh, si dhe një numër i vogël autoritësh kontraktore të cilat kryejnë prokurimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike. Pavarësisht nga kjo rezultoi se në këto procedura prokurimi të realizuara vërehet një pjesëmarrje e të gjitha ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg e madje edhe e ndërmarrjeve nga zona të tjera.

Për sa më sipër, pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit të realizuara në ndërmarrjet nën hetim dhe vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga Autoritetet Kontraktore përkatëse, rezultoi se nuk janë gjetur evidencë direkte dhe/ose indirekte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve në procedurat e prokurimit publik në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës, duke mos pasur në këtë mënyrë shenja të një kufizimi të mundshëm të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

- I. Mbyllet procedura e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun Dibrës, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi ndërmarrjeve nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

nr. 318, datë 02.06. 2014

Për

“Vendosje gjobe ndaj shoqërisë ndaj ndërmarrjes Heaney Assets Corporation për mosdhënie të dhënash brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.06.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr 311, datë 17.04.2014,” Kërkese për sigurimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, neni 73, pika 1), shkronja a).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretaritetit Përgjithshëm mbi mosveprimin e shoqërisë Heaney Assets Corp. në lidhje me detyrimin që i lind nga Vendimi i Komisionit nr. 311, datë 17.04.2014 në lidhje me depozitimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A për vitin 2012”.

V Ë R E N S E:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me anë të shkresës nr. 316 prot, datë 03.09.2013, është njoftuar përqendrimi me objekt shitblerjen e pjeshme të konsorciumit AMRA Oil SHA (e cila përbëhet nga aksionet e shoqërisë Anika Enterprises S.A) shoqërisë Armo SHA (indirekt) dhe shoqërisë Europetrol SHA (Europetrol) nga shoqëria Heaney Assets Corp.

Ky transaksion, i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në shoqëritë e sipërpërmendura në formën e përfutimit të kontrollit direkt dhe indirekt , përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Për të vlerësuar nëse ky përqendrim duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës duhet të plotësohen kriteret e xhiros parashikuar në nenin 12 të Ligjit për ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim.

Pala njoftuese ka depozituar të dhënat mbi xhirot për ndërmarrjet pjesëmarrëse (Heaney Assets Corp, AMRA Oil SHA, Europetrol SHA), ndërkohë që megjithë kërkesat e përsëritura shkresat nr. 316/3 prot, datë 30.09.2013, nr. 316/6 prot, datë 25.10.2013 dhe nr. 316/8 prot, datë 28.11.2013 si dhe shtyrjen e afatit që me shkresë nr. 316/10, 29.01.2014, të Autoritetit të Konkurrencës, ajo nuk ka arritur të vendosë në dispozicion të Autoritetit pasqyrat financiare të shoqërisë Anika Enterprises për vitin 2012.

Komisioni ka marrë Vendim nr. 311, datë 17.04.2014 “Kërkesë për sigurimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A”, duke vënë afatin 15 ditor për depozitimin e tyre nga palesnjoftuese.

Shoqëria edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit nuk ka dërguar pranë Autoritetit të Konkurrencës të dhënat financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A.

Sjellja e shoqërisë Heaney Assets Corporation në lidhje me sigurimin e informacionit të plotë brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 311, datë 17.04.2014, cilësohet si shkelje e lehtë në bazë të nenit 73, pika 1, germa a), për rrjedhojë është e dënueshme me gjobë në masën jo më shumë se 1 % të xhiros totale të vitit financiar paraardhës.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); nenit 12, pika 1, nenit 73, pika 1, germa dh e Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar), dhe nenit 12 të Rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”.

VENDOSI:

- I. Të gjobisë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë ndërmarrjen Heaney Assets Corporation përfutuese e kontrollit të shoqërive AMRA Oil SHA, Armo SHA dhe shoqërisë Europetrol SHA, për mosdhënie të dhënash brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 311, datë 17.04.2014.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe procedurave të kontrollit të përqendrimit të njoftuar jo më vonë se data 25 korrik 2014, si dhe njoftimin e paleve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
nr.319, datë 13.06.2014**

“Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.06.2014, me pjesmarrjen e Znj. Lindita Milo, Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të monitorimit për kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifën e shërbimit të skanimit” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar),
neni 24, shkronja f), si dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të monitorimit për kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë

dhe rekomandimet përkatëse, si dhe relacionin shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) (këtu e në vijim Ligji) në nenin 2, pika 1 germa c, zbatohet edhe “për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet që ju janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta”. Neni 69 i Ligjit parashikon “detyrimet për organet qendrore dhe vendore që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt që ka të bëjë ndër të tjera me (a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin dhe (b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara”.
2. Ministria e Financave dhe Këshilli i Ministrave gjatë procedurës për dhënien e koncensionit sipas procedurës së ndjekur nuk ka respektuar detyrimin e nenit 2/1c dhe 69/1/b të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasi Ministria e Financave nuk ka zbatuar detyrimin për të marrë vlerësimin e Autoritetit për këtë akt që (germa b) ka vendosur të drejta ekskluzive për ndërmarrjen Rapiscan për produktin e skanimit të kontenierëve dhe automjeteve të tjera.
3. Autoriteti i Konkurrencës e ka nisur procedurën e vlerësimit ex-post të kontratës koncesionare në zbatim të nenit 2/1/c të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar) mbështetur në shqetësim publik të komunitetit të biznesit për shtimin e kostos me rreth 20 milionë euro në vit për skanimin e kontejnerëve në dogana dhe të rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013” ku një nga detyrat është zgjidhja e problematikës së shërbimeve koncesionare ndër të tjera edhe për shërbimin e skanimit të kontejnerëve.
4. Bazuar në Ligjin nr 123/2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si Autoritet Kontraktues, dhe shoqërisë Rrapiscan Security, Inc.”, si koncesionar, për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” , është dhënë me koncension skanimi i kontenierëve dhe automjeteve të tjera. Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje do të fillojë në datën efektive dhe do të mbarojë në përvjetorin e pesëmbëdhjetë (15) të certifikatës së Rapiscan. Kjo marrëveshje koncesioni është nënshkruar në datën 10 prill 2013, por ende nuk është vënë në zbatim.
5. Tarifa e shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera është në vlerën 39 euro (pa përfshirë TVSH-në). Shërbimi i skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera trajtohet si furnizim i tatuashëm me TVSH me shkallë tatimore 0 (zero). Rapiscan Scurity Inc do t’i paguajë Autoritetit një tarifë koncesionare që llogaritet si 2% e të ardhurave për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara.

6. Sipas shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 4404/3, datë 30.04.2014, arsyet e dhënies së këtij shërbimi për të siguruar dhe garantuar një mjet mbështetje të plotë për sistemin doganor dhe sistemin kufitar shqiptar nëpërmjet aplikimit të metodave bashkëkohore duke mundësuar: (i) zbulimin e evazionit të të ardhurave, duke përfshirë keq-deklarimin e tarifave; zbulimin e mallrave dhe produkteve kontrabande, (ii).zbulimin e mallrave dhe produkteve narkotike; zbulimin e produkteve të dëmshme radioaktive, lëvizjen e paligjshme të armeve dhe municioneve; në mënyrë të veçantë zbulimin e evazionit për mallrat e akcizës (duhani, alkooli; vajrat, etj); (iii) veprim të shpejtë dhe efikas në procedurat doganore dhe lehtësimi i biznesit; (iv). zbulimin e të gjitha mallrave të tjera që do të konsiderohen të paligjshme dhe si të tilla të ndaluara për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas kuadrit ligjor në fuqi. Autoriteti kontraktues ka synuar të përmirësojë shërbimin e skanimit nëpërmjet një subjekti privat i cili do të ketë aftësi të mira në projektim dhe planifikimit, ku duhet të merret parasysh projektimi inxhinierik, menaxhimi i projektit duke përfshirë sigurimin e të dhënave për të gjithë individët dhe institucionet e interesuar për transportin ndërkombëtar të mallrave.
7. Nga marrëveshja koncensionare rezulton se koncensionari nuk do ta ofrojë shërbimin në të gjitha pikat doganore pesë pika, tre fikse dhe dy të lëvizshme, ndërkohë që janë më shumë pika doganore dhe në këtë mënyrë mbulimi nuk është i plotë.
8. Shqipëria ka marrë angazhime konkrete lidhur me tregtinë me vendet anëtare të BE-së. Sipas nenit 33 të MSA-së, “që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen detyrime doganore të reja për importet ose eksportet, ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe nuk rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, si një arritje e rëndësishme në kuadër të integritimit në BE, parashikon krijimin e një zone të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe BE. Shqipëria, si palë në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, angazhohet në bazë të Titulli IV “Lëvizja e Lirë e Mallrave”duhet të respektojë dispozitat e kësaj marrëveshjeje.
9. Bazuar sidomos në nenin 33 “Pezullimi” të MSA-ësë parashikohet mosvendosja e tarifave të reja shtesë doganore qoftë për importet apo eksportet. Ndërkohë që sipas kontratës koncensionare, vendosen tarifa të reja shtesë, detyrime në kuota të përcaktuara (39 euro), të cilat do të paguhen për ofrimin e shërbimit të skanimit të kontenerëve dhe automjeteve.
10. Vetë ligji që miraton kontratën e koncesionit ka parashikuar një dispozitë, pika 4.3 sipas të cilës: “Në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ose në çdo kohë pas këtij anëtarësimi, Autoriteti (Ministria e Financave) do të ketë të drejtë të kërkojë rishikimin e kësaj Kontrate në mënyrë të tillë që të sigurojë përputhjen në mënyrë të plotë

me kriteret e detyrueshme për anëtarësim të Bashkimit Europian. Nëse, për sa më sipër, Autoriteti vendos të ndryshojë këtë Kontratë, Rapiscan do të ketë të drejtë, pa paragjykuar ndonjë të drejtë tjetër të ofruar nga ligji, të zgjidhë këtë Kontratë pa pësuar ndonjë penalitet ose pasojë ligjore përkundrejt Autoritetit.”

11. Nga ana e regjimit tregtar, Shqipëria ka një marrëveshje të plotë të tregtisë së lirë me Bashkimin Europian dhe për këtë arsye mendojmë se është momenti i përshtatshëm për ta trajtuar që në këtë fazë rishikimin e marrëveshjes pa pritur anëtarësimin e plotë në Bashkimin Europian.
12. Nga pikëpamja e efikasitetit ekonomike, pavarësisht justifikimit të Ministrisë së Financave në momentin e dhënies së koncensionit, vendosja e skanerëve në vetëm 5 pika nga të cilat tre fikse dhe dy të lëvizshme (në varësi të shtimit të fluksit të zhdoganimeve) nuk justifikon qëllimin për të cilin është dhënë koncensoni, shmangja e kontrabandës dhe evazionit fiskal.
13. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ka hyrë në fuqi në vitin 2009 ndërkohë që marrëveshja koncensionare është miratuar me ligj në vitin 2013, pra rreth 4 vite pas hyrjes në fuqi të MSA. Në këtë mënyrë marrëveshja koncensionare bie në kundërshtim me nenin 33 të MSA, një marrëveshje ndërkombëtare që prevalon mbi ligjet dhe aktet e tjera nënligjore sipas parashikimeve të nenit 116 të Kushtetutës.

1. Si konkluzion:

1. Kontrata e koncesionit bie në kundërshtim me nenin 33 të MSA-së, një marrëveshje ndërkombëtare që prevalon mbi ligjet dhe aktet e tjera nënligjore sipas parashikimeve të nenit 116 të Kushtetutës;
2. Procedura për dhënien e koncesionit nuk ka respektuar detyrimin e nenit 2/1c dhe 69/1/b të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar) pasi sipas pikës 1, nuk është zbatuar detyrimi ligjor për të marrë vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt-akt që vendos të drejta ekskluzive dhe/ose të drejta të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara.
3. Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 2/1/c të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar) ka bërë vlerësimin e kontratës koncensionare, nisur nga shqetësimi publik i komunitetit të biznesit për shtimin e kostos në lidhje me shërbimin për skanimin e kontenerierëve në dogana.
4. Procedura e dhënies së koncesionit ka qenë një propozim i pakërkuar dhe jo një procedurë e hapur tenderuese që do t'i vendoste të gjithë ofertuesit e mundshëm në pozita të njëjta konkurrence.
5. Vendosja e skanerëve në vetëm 5 pika nga të cilat tre fikse dhe dy të lëvizshme (në varësi të shtimit të fluksit të zhdoganimeve) nuk mbulon të gjitha pikat doganore për të justifikuar plotësisht qëllimin për të cilin është dhënë koncensoni;

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave, rishikimi i kontrates koncensionare për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”.
2. Institucionet publike duhet të respektojnë parashikimet e Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit e akteve që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.
3. Në procesin e rishikimit të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të mbahet parasysh direktiva e re e BE-së (32014L0023; Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Europian dhe e këshillit e datës 26 Shkurt 2014 mbi dhënien e kontratave të koncensioneve; OJ L 94, 28/03/2014, p. 1–64) që të ndahen qartë tregjet nga shërbimi publik dhe këto të fundit përgjithësisht t'i mbeten shtetit si detyrime pasi nëse kalojnë nga shteti te privati kanë kosto shtesë për biznesin dhe konsumatorin dhe eliminojnë mundësinë e zgjedhjes së biznesit apo konsumatorit pasi ofruesi është gjithmonë ekskluziv (i vetëm).
4. Instrumenti ligjor për rishikimin e kontratës koncensionare është procesi i rishikimit të Kodit Doganor dhe sipas nenit 18.2.1 të Ligjit 123/2013 për miratimin e marrëveshjes koncensionare.
5. Përmbajtja e kontratës rekomandohet si vijon: “Ministria e Financave duke marrë parasysh specifikat e shërbimit doganor për të luftuar kontrabandën dhe evazionin fiskal mund të kontraktojë koncensionarin vetëm për blerjen e pajisjeve dhe shërbimin ta kryejnë organet doganore” .
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe njoftimin e vendimit Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

nr.320, datë 24/06/2014

**“Për
shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe
“KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit të Komisionit të
Konkurrencës nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit
të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të
karburanteve”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.06.2014 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d, dhe neni 46 .

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve” dhe relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës për këtë kërkesë

VËREN SE:

1. Më datë 09.06.2014 pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një kërkesë nga ndërmarrjet “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA, me atë të së cilës këto ndërmarrje kërkojnë revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”.
2. Revokimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, mund të bëhet vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret e parashikuara në Nenin 46 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Sipas këtij Neni, Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
 - a. njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
 - b. palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - c. vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
3. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA dhe i argumenteve të dhëna nga këto ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi para kushteve të sipërcituara. Pra, në kuptim të Nenit 46 të Ligjit 9121, datë 28.09.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Nenit 24, germa (d) dhe Nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”, si të pabazuar në ligj dhe prova.
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

nr. 321, datë 01/07/2014

**“Për
shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “ Rapiscan Sustems ICN” për
revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë
13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit
për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të
kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës
së shërbimit të skanimit”**

Komisioni i Konkurrencës, me përberjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.07.2014, me pjesmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, dhe Z. Koço Broka, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 2, germa c, neni 24, germa d, dhe neni 46 .

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të

- Kërkesës së ndërmarrjes “Rapiscan Sustems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera

në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” si dhe Relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës për këtë kërkesë,

VËREN SE:

1. Më datë 25.06.2014, pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një kërkesë nga ndërmarrja “ Rapiscan Systems ICN” me atë të të cilës kjo ndërmarrje kërkon revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”
2. Autoriteti i Konkurrencës e ka nisur procedurën e vlerësimit ex-post të kontratës koncesionare në zbatim të nenit 2, pika 1, germa c) dhe nenit 69, pika 1 germa b) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).
3. Autoriteti i Konkurrencës ka detyrimin ligjor të vlerësojë shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës edhe në tregjet në të cilat janë dhënë të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose produkte të caktuara, duke dhënë edhe mendime dhe rekomandime në lidhje me këto të drejta. Ky vlerësim realizohet edhe për zbatimin e Politikës Kombëtare të Konkurrencës për liberalizimin e tregjeve, detyrim që rrjedh edhe nga proceset e integritimit në Bashkimin Europian.
4. Revokimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës mund të bëhet vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret e parashikuara në nenin 46 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Sipas këtij neni, Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
 - a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit kanë ndryshuar;
 - b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi para kushteve të sipërcituara. Pra, në kuptim të nenit 46 të Ligjit 9121, datë 28.09.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN” nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”, si të pabazuar në ligj dhe prova.
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 319, datë 13.06.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
nr. 322 , datë 03.07.2014**

**Për
miratimin e Rregullores
“Për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të
bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.07.2014, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar)

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 6, dhe 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Projekt-rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave” si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, duke përafuar Rregulloren e Këshillit nr. 246/2009 të datës 26 shkurt 2009, mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar ((32009R0246) /OJ L 79, 25.3.2009, p. 1–4) dhe Rregulloren e Komisionit nr. 906/2009 të datës 28 Shtator 2009, mbi zbatimin e nenit 6 të Ligjit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar. ((32009R0906)/ OJ L 256, 29.9.2009, p. 31–34);

VENDOSI:

Të miratojë Rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave” sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

**Rezana
KONOMI**

(_____)
Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R

Rregullore
“Për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave⁵²”

Kapitulli 1

Qëllimi dhe përkufizimi

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore do të zbatohet për marrëveshjet e konsorciumit, për sa kohë që ato ofrojnë shërbime të transportit ndërkombëtar detar të mallrave nga ose tek një nga portet e territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Bazuar në këtë rregullore dhe në përputhje me nenin 6 të ligjit parashikohet se neni 4 i ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), nuk do të zbatohet për disa kategori të marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve, vendime dhe praktika të bashkërenduara, që kanë si objekt promovimin ose krijimin/nisjen e një bashkëpunimi, në formën e një veprimtarie të përbashkët të shërbimeve të transportit detar, ndërmjet ndërmarrjeve të këtij transporti, me qëllim racionalizimin e operacioneve/veprimtarive të tyre nëpërmjet rregullimeve teknike, operacionale apo tregtare, duke përjashtuar fiksimin e çmimeve.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Konsorcium" nënkupton një marrëveshje ose grupim të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet dy ose më shumë transportuesve, që ushtrojnë aktivitet me anije, të cilët ofrojnë shërbime të transportit detar ndërkombëtar, ekskluzivisht për transportimin e kargove/ngarkesave. Objekti i këtyre marrëveshjeve është ushtrimi/ofrimi i përbashkët i shërbimeve të transportit detar, i përmirësuar në krahasim me shërbimin që do të ofronin individualisht;
2. "Transporti detar" nënkupton transportin rregullisht të produkteve, sipas një itinerari të caktuar ose itinerareve ndërmjet porteve dhe në përputhje me oraret dhe datat e lundrimit të publikuara paraprakisht dhe të disponueshme, edhe sipas rastësisë, tek çdo përdorues transporti përkundrejt pagesës;

52 (32009R0246) Rregullorja e Këshillit nr. 246/2009 e datës 26 shkurt 2009 mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar (OJ L 79, 25.3.2009, p. 1–4) / (32009R0906) Rregullorja e Komisionit nr. 906/2009 e datës 28 Shtator 2009 mbi zbatimin e nenit 6 të ligjit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar. (konsorcium) (OJ L 256, 29.9.2009, p. 31–34)

3. "Përdorues transporti" nënkupton çdo ndërmarrje (të tillë si transportues malli/dërgues malli, marrësi i ngarkesës ose ndërmjetës) i cili ka lidhur ose tenton të lidhë një marrëveshje kontraktuale, me një anëtar të konsorciumit, për transportimin e produkteve;
4. "Fillimi i shërbimit" nënkupton datën në të cilën anijet e para detare lundrojnë për këtë shërbim.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Marrëveshjet e konsorciumeve në transportin detar kërkojnë një nivel të lartë investimesh për shkak të blerjes apo marrjes me qira nga anëtarët e saj të pajisjeve të veçanta me qëllim krijimin e konsorciumit⁵³ dhe ngritjen e qendrave operacionale të përbashkëta.
2. Marrëveshjet e shërbimit të përbashkët ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar nëpërmjet rregullimeve teknike, operacionale dhe/ose tregtare (të përkufizuara si konsorciume) ndihmojnë për të siguruar mjetet e nevojshme për përmirësimin e produktivitetit të shërbimeve të transportit detar dhe të promovojnë progresin teknik dhe ekonomik.
3. Një pjesë e përfitimeve që rezultojnë nga eficientat duhet të kalohet tek përdoruesit e transportit. Përdoruesit e shërbimeve të transportit detar, mund të përfitojnë nga përmirësimi i produktivitetit dhe shërbimeve, nëpërmjet zvogëlimit të kostove/shpenzimeve që vijnë si rezultat i niveleve më të larta të përdorimit të kapaciteteve, dhe shërbimeve më cilësi më të mirë.
4. Me qëllim që të zbatohet neni 6 i ligjit, është e rëndësishme që një pjesë e përfitimeve të kalohen tek transportuesi i mallit dhe të mos kufizohet konkurrenca.
5. Përfitimi nga përjashtimi në bllok, përfshin ato marrëveshje të cilat plotësojnë kushtet e nenit 5 dhe 6 të ligjit. Megjithatë, konsorciumi i cili nuk përfiton nga kjo rregullore, jo domosdoshmërisht është objekt i nenit 4 të ligjit. Kur kryhet një vetëvlerësim i përputhshmërisë së marrëveshjes së lidhur midis ndërmarrjeve me nenet 4, 5 apo 6 të ligjit, palët të cilat janë pjesë e këtij konsorciumi, marrin në konsideratë kriteret e veçanta të tregut, ose situatat ku pjesa e tregut është tejkaluar si rezultat i prezencës në konsorcium të një transportuesi të vogël i cili nuk ka burime të rëndësishme dhe që rritja në pjesët totale të tregut të konsorciumit është shumë e parëndësishme (jodomethënëse).

⁵³ Për qëllime të kësaj rregulloreje, një marrëveshje konsorciumi konsiston në një marrëveshje apo grupim marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar, sipas të cilave palët ushtrojnë shërbimin e përbashkët. Forma ligjore e marrëveshjes nuk është shumë e rëndësishme në krahasim me atë çka paraqet marrëveshja në realitetin ekonomik duke qenë se palët ofrojnë një shërbim të përbashkët.

6. Konsorciumi (partneriteti) siç përshkruhet në këtë rregullore, në përgjithësi ndihmon në përmirësimin e produktivitetit dhe cilësisë së shërbimeve të transportit detar nëpërmjet racionalizimit që ato sjellin tek aktivitetet e ndërmarrjeve anëtare dhe nëpërmjet ekonomive të shkallës që ato lejojnë në përdorimin e anijeve dhe përdorimin e lehtësirave në port. Ato gjithashtu ndihmojnë në promovimin e progresit teknik dhe ekonomik duke lehtësuar dhe inkurajuar një përdorim më të madh/gjerë të kontenierëve dhe përdorim më eficient të kapaciteteve të anijeve. Një karakteristikë e rëndësishme e konsorciumeve është mundësia për ti përshtatur kapacitetet në përputhje me flukset e ofertës/furnizimeve dhe kërkesës. Kufizimi i pajustificuar i kapaciteteve dhe shitjeve dhe fiksimi i përbashkët i normave/tarifave të ngarkesave të mallit ose të shpërndarjes së tregjeve apo klientëve është e pamundur që të sjellin ndonjë efikasitet. Prandaj, përjashtimi i ofruar në këtë rregullore nuk do të zbatohet për marrëveshjet e konsorciumeve që përfshijnë aktivitete të tilla, pavarësisht fuqisë së tregut të palëve.

Kapituli II

Përjashtimet

Neni 4

Marrëveshjet që përjashtohen

Në përputhje me nenin 6 të ligjit dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore, neni 4 i ligjit nuk do të zbatohet për aktivitetet e mëposhtme të konsorciumit:

1. Ushtrimi/Ofrimi i përbashkët i shërbimeve të transportit detar, që përfshijnë një nga aktivitetet e mëposhtme:
 - a) Koordinimin dhe/ose fiksimin e përbashkët të kalendarit të lundrimit dhe përcaktimin e porteve të dërgimit;
 - b) Shkëmbimin, shitjen ose dhënien e të drejtave reciproke për hapësirën e anijeve;
 - c) Grumbullimin e anijeve dhe/ose instalimeve në porte;
 - d) Përdorimin e një ose më shumë zyrave të përbashkëta të veprimtarive;
 - e) Dispozitat mbi kontenierët, shasitë dhe pajisje të tjera dhe/ose dhënia me qera, marrja me qera ose kontratat e blerjes për pajisje të tilla;
2. Rregullimet lidhur me kapacitetet në përputhje me flukset në oferta dhe kërkesa;
3. Ushtrimi/Ofrimi i përbashkët ose përdorimi i terminaleve të porteve dhe shërbime që lidhen me to (të tilla si shërbime të marinarëve apo të punëtorëve të ngarkim shkarkimit);
4. Ndonjë aktivitet tjetër ndihmës të aktiviteteve që referohen sipas pikave 1, 2 dhe 3 të cilat janë të nevojshme për zbatimin e tyre të tilla si:

- a) Përdorimi i një sistemi të kompjuterizuar të shkëmbimit të informacionit;
- b) Detyrimi për anëtarët e konsorciumit, që të përdorin tregjet përkatëse ose tregjet e anijeve të konsorciumit dhe të shmangen nga hapësirat e anijeve që i përkasin palëve të treta;
- c) Detyrimi i anëtarëve të konsorciumit që të mos caktojnë apo të japin hapësira tek transportues /anije të tjera në tregun përkatës ose tregjet përkatëse me përjashtim të rasteve kur ka një miratim/pëlqim paraprak të anëtarëve të tjerë të konsorciumit.

Neni 5

Kufizimet e rënda

Përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, nuk do të zbatohet për konsorciumin i cili direkt ose indirekt, veçmas ose në kombinim me faktorë të tjerë ka për objekt:

- 1. Caktimin e çmimeve kur ofrohen shërbime të transportit detar tek palë të treta;
- 2. Kufizimin e kapaciteteve apo të shitjeve me përjashtim të kapaciteteve të referuara në nenin 4, pika 2;
- 3. Shpërndarjen e tregjeve ose të klientëve.

Kapitulli III

Kushtet për përjashtim

Neni 6

Kushtet lidhur me pjesën e tregut

- 1. Me qëllim që një konsorcium të përfitojë nga përjashtimi sipas kriterëve të nenit 4 të kësaj rregulloreje, pjesa e kombinuar e tregut të anëtarëve të konsorciumit në tregun përkatës në të cilën ushtron aktivitet konsorciumi, nuk duhet të tejkalojë 30 % të tregut, të llogaritur duke iu referuar volumit total të produkteve të transportuara në ngarkesë mallrash me tonë ose prej njësisish prej 6.1 metra⁵⁴.
- 2. Për përcaktimin e pjesës së tregut të një anëtari të konsorciumit, duhet të merren në konsideratë volumet totale të transportuara në tregun përkatës pavarësisht nëse këto volume janë transportuar :
 - a) brenda konsorciumit në fjalë;
 - b) brenda një konsorciumi tjetër, tek i cili anëtari është palë, ose;
 - c) jashtë konsorciumit të vetë anëtarit ose anijes së një pale të tretë.

⁵⁴ http://en.wikipedia.org/wiki/Twenty-foot_equivalent_unit: Ekuivalenti për njësinë TEU (The Twenty-Foot Equivalent unit (i njohur si TEU ose teu/ njësia prej 20 këmbë e gjatë) është një kapacitet ngarkese shpesh e përdorur për të përshkruar kapacitetin e kontenerëve të anijes.

3. Përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, do të vazhdojë të zbatohet nëse pjesët e tregut të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë tejkaluar përgjatë ndonjë periudhe kohore prej 2 vitesh kalendarike të njëpasnjëshme nga jo më shumë se sa 1/10.
4. Kur një nga kufizimet e përcaktuara nga paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni është tejkaluar, përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 6 muajsh që ndjek vitin kalendarik, në të cilin kjo periudhë është tejkaluar. Kjo periudhë do të zgjatet deri në 12 muaj, nëse ky tejkalim ka ardhur si pasojë e tërheqjes/daljes nga tregu të transportuesit, i cili nuk është më anëtar i konsorciumit.

Neni 7

Kushte të tjera

1. Me qëllim që të kualifikohet për përjashtim sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, konsorciumi duhet ti japë anëtarëve të drejtën që të tërhiqen/dalin pa asnjë penalitet financiar apo të një lloji tjetër. Kjo mund të jetë subjekt i një periudhe njoftimi, deri në 6 muaj. Konsorciumi, sidoqoftë mund të përcaktojë se një njoftim i tillë mund të bëhet vetëm pas një periudhe kohore maksimumi prej 24 muajsh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes ose nga fillimi/data e nisjes së shërbimit.
2. Në rastin e një konsorciumi të integruar, periudha maksimale e njoftimit mund të shtyhet deri në 12 muaj dhe konsorciumi mund të përcaktojë se një njoftim i tillë mund të bëhet vetëm pas një periudhe fillestare prej maksimumi prej 36 muajsh duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes ose nga data e nisjes/fillimit të shërbimit.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe dispozita të fundit

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

nr.323 , datë 08/07/2014

**“Për
vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes “Pelikan Security” Shpk në lidhje me
procedurat e prokurimit publik me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë
fizike”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.07.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimi i ankesës së ndërmarrjes “Pelikan Security” për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun e ruajtjes dhe sigurisë fizike.

Baza ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 29/1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Grupit të Punës lidhur me ankesën e ndërmarrjes “Pelikan Security” SHPK për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun e ruajtjes dhe sigurisë fizike:

VËREN SE :

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës me datë 22.04.2014, është depozituar një ankesë nga shoqëria “Pelikan Security” sh.p.k e cila ushtron aktivitet në shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike në të cilën ankimuesi shprehet për shqetsime të konkurrencës së pa ndershme në tregun e prokurimit publik të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

2. Ankuesi shprehet se shoqëria “Nazëri 2000” shpk ka kontratë qeraje të sallës operative se bashku me shoqërinë “Dea Security” shpk, duke marre pjese në procedurat e prokurimeve publike në kundërshtim me ligjin dhe duke konkurruar padrejtësisht. Gjithashtu, sipas ankimuesit këta operatorë nuk kanë zbatuar vendimin nr 240, datë 26.07.2012, të Komisionit të Konkurrencës, por e kanë thelluar më shumë konkurrencën e pandershme, konkretisht pika II e vendimit, duke shkelur haptazi nenin 4 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
3. Ankimuesi kërkon nga Autoriteti i Konkurrencës, “të ndërhyjë për stabilizimin e gjëndjes dhe marrjen e masave konform akteve ligjore, ndaj personave përgjegjës që me dashje nuk kanë marrë në konsideratë vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr 240, datë 26.07.2012 “Për ndalimin e marrëveshjeve në oferta në tregun e prokurimeve publike”, si marrëveshje e ndaluar.
4. Autoriteti i Konkurrencës, ne baze te nenit 29/1 te Ligjit nr. 9121 “Per mbrojtjen e konkurrences”, ka ndjekur procedurën e plotë të shqyrtimit te ankeses sipas parashikimeve te Ligjit duke depozituar nga ankimuesi Formularin Tip të Ankesës, protokolluar me nr. 195/1 prot,date 02.05.2014, në të cilin jane paraqitur disa Autoritete Kontraktore në të cilat pretendohej se kishte shenja te bashkepunimit midis dy ndermarrjeve në procedurat e prokurimit publik të shërbimit te ruajtjes dhe sigurise fizike.
5. Në vazhdim të vlerësimit të ankesës, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar informacion Autoriteteve Kontraktore të përmendura në ankesë në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ofertues në procedurat e prokurimit publik të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të realizuara gjatë periudhës 01 Janar – 30 Prill 2014.
6. Nga dokumentat e dërguara nga Autoritetet Kontraktore te mesiperme, grupi i punes shqyrtoi procedurat e prokurimit te realizuara nga autoritetet Kontraktore : Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetsor (DRSKSH),Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Instituti i Sigurimeve (INSIG), “Biblioteka Kombëtare”, “Dega e Doganës Rinas”, “Autoriteti Shëndetësor Rajonal”, “KQZ”, “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”, “Gjykata e Rrethit Gjyqësor” Tiranë, “Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit”, “Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit” dhe “Ministria e Financave”.
7. Shqyrtimi i dokumentave te paraqitura ne procedurat e prokurimit publik nga ndermarrjet pjesmarrese eshte bazuar ne udhezuesin “Mbi luftimin e marreveshjeve te ndaluara ne oferta ne prokurimet publike” pershtatur

sipas Metodologjise qe aplikon OECD per luften ndaj koordinimit te ofertave ne prokurimet publike (OECD-GUIDELINES FOR FIGHTING BID RIGGING IN PUBLIC PROCUREMENT).

8. Ne tenderin e realizuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve(Loti 1) kane marre pjese 17 ndermarrje ofertuese. Vlera e ofertes fituese qe ne kete rast eshte "Nazeri 2000" shpk, eshte 93% e fondit limit, ndersa oferta e ndermarrjes "Dea Security" eshte 77% e fondit limit.
9. Ne tenderin e realizuar nga Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Durres, kane marre pjese 8 ndermarrje ofertuese. Ne kete procedure prokurimi eshte shpallur fituese ndermarrja "Toni Security" me oferte 71% te fondit limit, ndersa oferta e ndermarrjes "Nazeri 2000" shpk eshte 83.5% e fondit limit dhe oferta e ndermarrjes "Dea Security" eshte 70% e fondit limit.
10. Ne tenderin e realizuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor(DRSKSH) kane marre pjese 15 ndermarrje ofertuese. Vlera e ofertes fituese ne kete rast eshte "Nazeri 2000" shpk eshte 81% e fondit limit, ndersa oferta e ndermarrjes "Dea Security" eshte 61% e fondit limit.
11. Në tenderin e realizuar nga KQZ kanë marrë pjesë 15 ndërmarrje ofertuese. Në këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese ndërmarrja "Arbana Sh.a" me ofertë 81.63 % të fondit limit, ndërsa oferta e ndërmarrjes Nazëri 2000 Sh.p.k është 99.80 % e fondit limit dhe oferta e ndërmarrjes Dea Security është 87.60 % e fondit limit.
12. Në tenderin e realizuar nga Instituti i Sigurimeve (INSIG) Sh.a kanë marrë pjesë 15 ndërmarrje ofertuese. Vlera e ofertës fituese që në këtë rast është Nazëri 2000 Sh.p.k është 95 % e fondit limit, ndërsa oferta e ndërmarrjes Dea Security është 75 % e fondit limit.
13. Në tenderin e realizuar nga Ministria e Financave kanë marrë pjesë 9 ndërmarrje ofertuese. Në këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese ndërmarrja "Mandi 2K" me ofertë 82,21% të fondit limit, ndërsa oferta e ndërmarrjes Nazëri 2000 Sh.p.k është 82,22 % e fondit limit, ndërsa oferta e ndërmarrjes Dea Security është 64,26% e fondit limit.
14. Në tenderin e realizuar nga Instituti i Biblioteka Kombëtare Sh.a kanë marrë pjesë 10 ndërmarrje ofertuese. Vlera e ofertës fituese që në këtë rast është Nazëri 2000 Sh.p.k është 93.24 % e fondit limit, ndërsa oferta e ndërmarrjes Dea Security është 89.68 % e fondit limit.

15. Nga vlerësimi i procedurave të mësipërme rezulton një pjesëmarrje e gjerë e ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg (mbi 8 ndërmarrje pjesëmarrëse në cdo procedurë tenderimi) dhe me oferta fituese të cilat variojnë nga 70 % - 90 % të fondit limit, si dhe duke mos u konstatuar skema të rotacionit të fituesve midis ndërmarrjeve, mbulimit të ofertave dhe nënkontraktimit konkludohet se nuk ka shenja për një marrëveshje në oferta në prokurimet publike të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike për ndërmarrjet ndaj të cilave është paraqitur ankesa.
16. Referuar ankesës si dhe dokumenteve të administruara gjatë vlerësimit të ankesës rezulton se kontrata e qerasë së sallës operative është po e njëjta, ku administratori i shoqërisë “Nazëri 2000” sallën e vet operative e ka lënë me qera shoqërisë Dea Security element ky që vërteton se midis ndërmarrjeve Dea Security dhe Nazëri 2000, mund të egzistojnë disa shenja komunikimi por të cilat nuk përbëjnë shenja të mjaftueshme për një marrëveshje në oferta midis tyre në procedurat e prokurimeve publike sipas parashikimeve të nenit 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
17. Gjithashtu referuar ekstrakteve të ndërmarrjeve “Nazëri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k të marra në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit rezulton se ndërmarrjet e mësipërme nuk kanë lidhje midis aksionerëve.
18. Nga vlerësimi sa më sipër, mund të themi se midis ndërmarrjeve “Dea Security” sh.p.k dhe “Nazëri 2000” sh.p.k, nuk ka indicie të mjaftueshme për shkelje të nenit 4 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, pasi:
- Nuk ka elementë të marrëveshjeve në oferta sipas metodologjisë së OECD-së për marrëveshjet në oferta si rotacioni, mbulimi i ofertave dhe nënkontraktimi pas prokurimit publik mes ndërmarrjeve;
 - Ofertat fituese variojnë nga 70 % - 90 % të fondit limit dhe vihet re pjesëmarrja e gjerë e ndërmarrjeve (mbi 8 ndërmarrje pjesëmarrëse në çdo procedurë tenderimi);

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së vlerësimit të ankesës së ndërmarrjes “Pelikan Security” sh.p.k. në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “Pelikan Security” Shpk.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

nr.324, datë 30.07.2014

“Për vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta dhe të pretendimeve të ndërmarrjeve objekt hetimi.

Baza ligjore: Neni 1, neni 4, neni 24, shkronja d, neni 45, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar

Ndërmarrjet nën hetim: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA, SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP, INTERALBANIAN VIG SHA, ALB - SIGURACION SHA, INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA, EUROSIG SHA, “ANSIG” SH.A.

Periudha e hetimit: Periudha objekt hetimi është përcaktuar me vendimet e Komisionit të Konkurrencës, 1 Nëntor 2013 deri 31 Mars 2014.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- “Raportit të hetimit të thelluar në tregun sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Pretendimet e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e sigurimeve të paraqitura në seancat dëgjimore të datave 22 dhe 23 korrik 2014 dhe/ose depozituar me shkrim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

VËREN SE:

I . PROCEDURA E NDJEKUR

1. Bazuar në disa sinjale të marra nga tregu i sigurimeve, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës me kërkesën e Komisionit të Konkurrencës në muajn nëntor 2013 ka monitoruar tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorrik për përgjegjësitë nga palët e treta.
2. Nga ky monitorim rezultoi se nga data 1 Nëntor 2013 të gjithë agjentët e shitjes i tregtonin këto polica nëpërmjet një sistemi që quhej MSHM dhe menaxhohej nga një subjekt që është i licencuar nga AMF si shoqëri brokerimi. Ky sistem në momentin e nisjes së veprimit të shitjes tek agjentët nuk të ofronte të gjitha kompanitë e licencuara për tregtimin e produktit përkatës, por një numër më të kufizuar, mesatarisht 4 ose 5 shoqëri.
3. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (këtu e në vijim Ligji), me anë të Vendimit nr. 297, datë 18.11.2013 të Komisionit të Konkurrencës dhe Vendimit nr. 300, datë 06.12.2013, vendosi të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës.
4. Procedurat e hetimit paraprak në tregun e sigurimeve përfunduan më 17 Janar 2014. Duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë e tregut dhe kërkesën e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), se do të ishte në interes të stabilitetit financiar të tregut të sigurimeve mbajtja parasysh e karakteristikave dhe brishtësisë të sistemit financiar të sigurimeve, veçanërisht sigurimeve të detyrueshme, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës propozoi mbajtjen nën monitorim të tregut të sigurimeve sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit.
5. Gjatë periudhës monitoruese, në median e shkruar të datës 12.02.2014, u shpreh shqetësimi publik për rritjen e tarifave të sigurimeve të makinave më datë 11 Shkurt 2014. Nga monitorimi i tregut rezultoi se primet e aplikuara ishin rritur ndjeshëm, në të njëjtën kohë nga të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe në një masë të përafërt për kategoritë përkatëse.

6. Për sa më sipër, në bazë të nenit 24, germa d) dhe nenit 42 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 305, datë 14.02.2014, vendosi për zgjatjen e periudhës hetimore të hetimit paraprak për tregun e sigurimeve të detyrueshme për përgjegjësitë ndaj palëve të treta deri më datë 28.02.2014.
7. Në përfundim të hetimit paraprak rezultoi se sjellja e ndërmarrjeve në kuptim të nenit 4, pika 1, germa (a), (b) e (c) të Ligjit mund të ketë patur si objekt ose pasojë kufizimin, kontrollimin e tregut (neni 4/1/b), ndarjen e tregut, neni 4/1/c), si dhe caktimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë, e çmimeve (primeve) të shitjes (neni 4/1/a) të produktit të policës së sigurimit për mjetet motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
8. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 310, datë 31.03.2014 vendosi, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta” ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA, SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP, INTERALBANIAN VIG SHA, ALB - SIGURACION SHA, INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA, EUROSIG SHA, “ANSIG” SH.A,.
9. Në zbatim të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” Komisioni i Konkurrencës u shpreh mbi të drejtën e palëve për të paraqitur këndvështrimet e tyre jo më vonë se 20 ditë nga marrja e këtij vendimi.
10. Pranë Autoritetit të Konkurrencës kanë depozituar këndvështrimet dhe angazhimet e tyre me shkrim ndërmarrjet: SIGAL SHA, ATLANTIK SHA dhe INSIG SHA, ndërkohë që sipas kërkesave u organizuan seancat dëgjimore me drejtuesit e shoqërive SIGAL SHA dhe ATLANTIK SHA.
11. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, realizoi njoftimin e ndërmarrjeve nën hetim në lidhje me Vendimin nr. 310, datë 31.03.2014 të Komisionit të Konkurrencës.
12. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë administruar informacione nga të gjitha shoqëritë e sigurimit nën hetim dhe agjentet e tyre, Star Broker dhe broker të tjerë të lincensuar, Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSSH) si dhe AMF në cilësinë e autoritetit rregullator të tregut.
13. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr.

69, datë 14.02.2014 “Autorizim Inspektorësh”, Grupet e Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kryen inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve nën hetim.

14. Pas administrimit të fakteve dhe provave dhe informacioneve të nevojshme për kyerjen e një hetimi të plotë mbi sjelljen e ndërmarrjeve në treg është hartuar raporti i hetimit të thelluar i cili i është dërguar ndërmarrjeve nën hetim me anë të shkresës së Autoritetit të Konkurrencës nr. 289, datë 20.06.2014.
15. Në bazë të nenit 39 të Ligjit, shoqëritë e sigurimit : Ansig, Interlbanian, Atlantik, Intersig, Sigal, Albsig, Eurosig, dhe Insig paraqitën pretendimet e tyre me shkrim, ndërsa shoqëritë Sigal, Albsig, Eurosig, dhe Insig u paraqitën edhe në seancat dëgjimore të datave 22 dhe 23 Korrik 2014.

II. TREGU PËRKATËS

16. Bazuar në Ligjin dhe Udhëzimin nr.76, datë 07.04.2008 të Komisionit të Konkurrencës “Për përcaktimin e tregut përkatës”, konkretisht përcaktohet se: “Tregu përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët, ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen, ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”. Tregu përkatës përfshin: (i) Tregun përkatës të produktit dhe (ii) tregun përkatës gjeografik

II.1. Tregu përkatës i produktit

17. Produkti i sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit (MTPL e brendshme) është një kontratë e lidhur midis Siguruesit (Shoqëritë e Sigurimit) dhe pronarit të mjetit motorik, i cili pranon kushtet e Siguruesit. Kushtet e sigurimit janë pjesë e pandashme e kontratës së sigurimit, të cilat miratohen nga AMF-ja. Ky produkt hyn në klasën e sigurimeve të detyrueshme dhe është unik në llojin e vet, pra nuk ka zëvendësues.
18. Në rastin e produktit MTPL, duke patur si karakteristikë kryesore sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta (pra jo vetë mbajtësin e policës së sigurimit), çmimi mbetet kriteri kryesor që përcakton zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës. Ky produkt përballet me një elasticitet të lartë kërkesë duke bërë që në raste të rritjes së çmimit nga një kompani ose të mbajtjes së çmimit të pandryshuar, kur kompanitë e tjera ndërmarrin ulje, kompania me çmim më të lartë të përballet me rënie të shitjeve.
19. Edhe nga ana e ofertës ekziston zëvendësueshmëria, të gjitha kompanitë e ofrojnë produktin MTPL e brendshme me karakteristikat, çmimin dhe cilësitë që e bëjnë atë plotësisht të zëvendësueshëm për klientët. Ndërkohë që nuk ka ndonjë kufizim ligjor për sa i përket futjes së

kompanive të reja në tregun e MTPL së brendshme në Shqipëri dhe në këto kushte duke konsideruar se një konkurrent potencial mund të hyjë në këtë treg, në një periudhë afatshkurtër kohore, mund të themi se ekziston edhe zëvendësueshmëria nga ana e ofertës. Gjatë vitit 2012 në këtë treg është futur një shoqëri e re.

20. Në tregun e produktit janë përfshirë policat e sigurimit brenda territorit të RSH, Kartoni Jeshil (çertifikata ndërkombëtare e sigurimit) dhe Sigurimi Kufitar (i cili mbulon përgjegjësinë e drejtuesit të mjetit motorik me targa të huaja për dëmet (materiale e jo materiale) që u shkaktohen palëve të treta gjatë qarkullimit rrugor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

II.2. Tregu përkatës gjeografik

21. Tregu gjeografik në këtë rast është Republika e Shqipërisë.

III. SJELLJA E NDËRMARRJEVE NË TREG

III.1. Vendimet e Asamblesë së Përgjithëshme të anëtarve të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve

22. Sekretariati ka realizuar inspektime për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një marrëveshje të bashkëpunimit të mundshëm midis konkurrentëve ose të një praktike të bashkërenduar, lidhur me caktimin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të primeve të shitjes, ndarjes së tregut, kufizimit ose kontrollit të tregut.

23. Gjatë inspektimit në Byronë Shqipëtare të Sigurimeve (BSHS) janë administruar disa vendime të Asamblesë së Përgjithëshme të BSHS-së e cila përbëhet nga përfaqësues të të gjitha shoqërive të sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë. Materialet e administruara gjatë inspektimit në ambientet e subjektit Byroja Shqiptare e Sigurimit janë:

- 1) Vendim i Asamblesë së Përgjithëshme të Antarëve nr. 12 datë 07.02.2014 "*Mbi miratimin e Shoqërisë Anonime Star Broker Sha*", sipas të cilit të gjitha shitjet (transaksionet bankare) për shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm TPL nga çdo shoqëri sigurimi do të kryhen përmes sistemit Star Broker, sipas marrëveshjeve të lidhura midis Brokerit dhe Shoqërive të sigurimit sipas këtij vendimi.
- 2) Vendim i Asamblesë së Përgjithëshme të Antarëve nr. 36 datë 21.11.2013 "*Mbi arkëtimin e primeve të produktit policë kufitare*" ku të gjitha shitjet (transaksionet bankare) për produktin policë kufitare, nga çdo shoqëri sigurimi do të kryhen përmes sistemit Star Broker si dhe do të arkëtohen në një llogari të vetme qëllimore bankare dhe të njoftohet BKT se kjo llogari bankare qëllimore do të administrohet nga Star Broker sipas këtij vendimi.

- 3) Vendim i Asamblesë Përgjithshme të Anëtareve nr. 34 datë 21.11.2013 “Mbi miratimin e Shoqërisë Anonime Star Broker Sha” për miratimin e Shoqërisë anonime Star Broker sha për shitjen e policave karton jeshil.
 - 4) Vendim i Asamblesë Përgjithshme të Anëtareve nr. 25 datë 26.06.2013 “Mbi prodhimin, administrimin tregtimin e policës për sigurimin e detyrueshëm Kufitare dhe Karton Jeshil”, sipas pikës 5 të vendimit: Primet e Sigurimit të policës të sigurimit kufitar karton jeshil të shoqërisë së sigurimit, derdhen në një llogari qëllimore nën administrimin e Byrosë shqiptare të sigurimeve ose të një personi juridik të autorizuar prej saj dhe në pikën 6 të vendimit ...në pikat e shitjes kufitare do të shitet polica e sigurimit kufitar dhe kartoni jeshil nëpërmjet agjentëve të secilës shoqëri sigurimi sipas grafikut të përdorur dhe më parë për këtë qëllim.
24. Referuar përmbatjes së këtyre vendimeve rezulton se këto dokumenta në cilësinë e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të anëtarëve të BSHS, që janë përfaqëuesit e nëntë shoqërive nën hetim nuk përmbajnë klauzola të shkruara të një marrëveshje të ndaluar në vetvete (*per se*) në kuptim të ndarjes së tregut apo fiksimit të çmimeve por kanë krijuar kushtet komunikimi midis ndërmarrjeve në treg duke krijuar mundësi për koordinimin e sjelljes për mbajtjen e një trendi për ndarjen e tregut dhe kufizimin e mundësive të zgjedhjes konsumatore.

III.2. Trendi i ndarjes së tregut përkatës

25. Tregtimi i MTPL-së mund të kryhet nëpërmjet shoqërive të brokerimit të cilat themelohen dhe funksionojnë sipas Ligjit nr. 9267 datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar. Shoqëria e brokerimit e licencuar ushtron veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime në emër dhe për llogari të të siguruarit. Shoqëria e brokerimit është përgjegjëse ndaj të siguruarve për humbjet e shkaktuara të siguruarit, si rezultat i neglizhencës ose i keqinformimit të tij. Shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit ose risigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
26. Për vlerësimin e ndarjes së tregut midis kompanive të sigurimit janë marrë në konsideratë të dhënat e administruara nga ndërmarrjet dhe të dhënat e administruara nga inspektimi në shoqërinë “Star Broker” duke u bazuar në faturat e shitjes së produktit MTPL. Vlerësimi është bërë duke krahasuar pjesët e tregut për çdo javë dhe muaj gjatë gjithë periudhës nën hetim, nga ku rezulton se shpërndarja e të ardhurave nga tregëtimi i produktit përkatës midis ndërmarrjeve objekt hetimi, gjatë periudhës

objekt hetimi, orientohet drejt një trendi të njëjtë të pjesës së tregut për produktin MTPL.

27. Sikurse paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme, rezulton se ndërmarrjet për periudhën e hetimit Nëntor 2013 – Mars 2014 duke përdorur sistemin MSHM të administruar nga Star Broker kanë ndarje të përafërt të pjesëve të tregut dhe sistemi ka raste që nuk ofron policat e sigurimit sipas shoqërive të sigurimit që kërkon i siguruari.

Tabelë 1 - Trendi mujor i pjesës së tregut për periudhën Nëntor 2013-31 Mars 2014 nga të dhënat e administruara nga ndërmarrjet

III.3 Përcaktimi i tarifave të sigurimit

28. Nga proçedurat hetimore rezulton që deri më datë 10 Shkurt 2014 primet e shitjes për produktin MTPL rezultojnë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelë 2- Tabela e primeve të aplikuara para rritjes së çmimeve deri date 10 Shkurt 2014 (në lekë)

(KONFIDENCIALE)

29. Nga evidencat e administruara gjatë hetimit në ndërmarrjet objekt hetimi dhe tek shoqëria “Star Broker”, rezulton se më datë 11 Shkurt 2014 u evidentua një rritje të ndjeshme të primeve të shitjes të produktit MTPL, si dhe nivele pothuajse të njëjta primesh të shitjes të aplikuara nga të gjitha ndërmarrjet sipas klasave (me diferenca 10 lekë mes shoqërive). Këto tarifa janë mbajtur të fiksuara deri më datë 13 Shkurt 2014 sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelë 3- Tarifat e aplikuara nga shoqëritë e sigurimeve për periudhën 11-14 Shkurt 2014

(KONFIDENCIALE)

30. Më datë 13 Shkurt 2014 reagon e para ndërmarrja “INSIG” sh.a., duke ulur tarifën dhe me date 14 Shkurt reagojnë të gjitha ndërmarrjet duke ulur tarifën kryesisht në klasat kryesore (autovetura: B1/1 dhe B1/2).

31. Kjo sjellje e ndërmarrjeve që operojnë në tregun përkatës, gjatë periudhës objekt hetimi bie në kundërshtim me parashikimet e ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” për konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, sepse përcaktimi i tarifave të sigurimit duhet të bëhet në mënyrë individuale dhe të pavarur mes ndërmarrjeve objekt hetimi.

IV. KËNDVËSHTRIMET DHE ANGAZHIMET E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

32. Gjatë proçedurës hetimore pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur në mënyrë verbale dhe me shkrim këndvështrimet, pretendimet si dhe angazhimet e ndërmarrjeve që operojnë në tregun përkatës objekt hetimi.

IV.1. Pretendimet e palëve objekt hetimi

33. Ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës gjatë proçedurës së hapjes së hetimit të thelluar si dhe në përfundim të tij kanë shprehur pretendimet e këndvështrimet e tyre në lidhje me gjetjet e raportit të hetimit si dhe mbi faktorët dhe rolin e AMF-së në mirë funksionimin e këtij tregu. Palët nuk kanë kontestuar asnjë nga faktet dhe provat e paraqitura në raportin e hetimit të thelluar në tregun e sigurimeve, me të cilin ishin bërë me dije në përfundim të këtij hetimi.

34. Këndvështrimet e shoqërive të sigurimit përmbledhen si mëposhtë:

a- Megjithëse tregu është i liberalizuar dhe shoqëritë e sigurimit aplikojnë prime rreziku të ndryshme, AMF vazhdon të miratojë prime në nivel tregu pa ndryshime mes shoqërive të sigurimit. Vendimi i fundit i AMF nr. 34, datë 25.3.2014, "Për miratimin e tabelave të primeve të rrezikut";

b- Pjesët e tregut kanë ndryshuar në mënyrë dinamike,

c- Tarifat e aplikuara janë të ndryshme mes shoqërive dhe

d- Marrëveshja me Star Broker nuk është e kundraligjshme pasi nuk cakton çmime dhe pjesë tregu por mundëson shitjen online dhe nëpërmjet bankave të policës së sigurimit të detyrueshëm motorrik.

35. Ndërmarrja INSIG Sh.A ka kontestuar vendimet e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe shprehet se do të njohë dhe zbatojë ato vendime të BSHS-së në atë masë që ato i përgjigjen kërkesave të Ligjit si edhe fushës së kompetencës që ligji i njeh BSHS-së. INSIG sh.a nuk i njeh shoqërisë së brokerimit Star Broker Sh.A asnjë lloj pozicioni ekskluziv apo preferencial në veprimtarinë e brokerimit të sigurimeve përfshirë sigurimet e detyrueshme motorrike, konfirmuar kjo me shkresat zyrtare me nr. Prot 677, datë 17.03.2014 drejtuar BSHS-së dhe Starbroker, me Nr. 815 Date 27.03.2014 drejtuar AMF-së dhe disa komunikime email nga adresa zyrtare te INSIG drejtuar AMF.

36. Në seancën dëgjimore të datës 23 korrik 2014 dhe në vijim me shkresën 289/7 prot, dt 24.7.2014, Insig Sh.A shprehet se në periudhën Maj-Korrik 2013 kompania Insig ka kaluar një moment të vështirë pasi me shkresën e AMF nr. 852/1 të datës 24.04.2013 janë caktuar tarifa minimale dhe maksimale duke bllokuar sistemin e shitjeve, në rast se tentohej të shitej jashtë këtyre tarifave.

IV.2. Angazhimet e palëve objekt hetimi

37. Bazuar në gjetjet dhe evidencat e paraqitura si në raportin e hetimit paraprak ashtu edhe atij të thelluar në tregun përkatës, shoqëritë e sigurimit (me përjashtim të "SIGMA" sh.a.) kanë shprehur angazhimet e tyre për të zbatuar rregullimet e propozuara raportin e hetimit të thelluar.

Në mënyrë të përmbledhur këto angazhime konsistojnë në:

a) Pagesa e dëmeve sipas shoqërive ku është siguruar mjeti motorrik, i cili parashikohet edhe në Ligjin 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

b) Zbatimi konkret i sistemit Bonus-Malus për përcaktimin e primeve individuale të shitjes për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorrik.

c) Trajtimi i drejtëpërdrejtë i dëmit nga shoqëria e sigurimit do ta zhvillonte konkurrencën mes shoqërive për produktet e tyre duke nxitur konkurrencën jo vetëm të tarifa e ofruar por edhe mbi pagesën e dëmeve për produktin e siguruar që është dhe qëllimi kryesor i çdo blerje të riskut nga shoqëria e sigurimit të i siguruari.

38. Nga ana e të gjitha ndërmarrjeve është konfirmuar se ka filluar testimi i sistemit të individualizuar të sigurimit të detyrueshëm Bonus Malus dhe ky testim do të përfundojë në 22 gusht 2014 për tu bërë funksional për tregun.

39. Edhe nga shkresa e AMF nr. 1494/1 prot të datës 17.7.2014 bëhet me dije se janë ndërmarrë të gjitha veprimet me shoqëritë e sigurimit, Drejtoritë e Transportit rrugor, Drejtoritë e Gjendjes Civile dhe janë kryer azhurnimet në qëndrën e sigurimit të detyrueshëm motorrik për zbatimin e këtij projekti. Testi për agjentët do të zhvillohet me datë 21.7.2014 dhe sistemi Bonus –Malus do të jetë i detyrueshëm për shoqëritë e sigurimit me datë 20.8.2014.

40. Shoqëritë e sigurit u shprehen mbi mundësinë e pagesës së dëmeve sipas shoqërive ku është siguruar mjeti motorrik, sipas nenit 11 pika 3 të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e

transportit" ku parashikohet që "siguruesit mund të lidhin marrëveshje ndërmjet tyre, sipas të cilave kërkesa për dëmshpërblim, që lidhet me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik ndaj një mjeti tjetër motorik, mund të trajtohet nga siguruesi i drejtpërdrejtë i pronarit të mjetit motorik të dëmtuar. Sipas pikës 4 të këtij neni, "siguruesi i drejtpërdrejtë ka të drejtën e rimbursimit nga siguruesi, përgjegjës i pagesave, që lidhen me dëmshpërblimin e kryer sipas kushteve limiteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet tyre".

41. Komisioni i Konkurrencës e ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme sjelljen në bllok të shoqërive të sigurimit me pasojë rritjen e çmimit dhe mungesën e zgjedhjes konsumatore për shoqërinë e sigurimit në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe është shprehur me vendimet nr. 50 dt. 21.3.2007/2007 dhe 246, datë 09.10.2012 lidhur me vendosjen e gjobave të rënda ndaj shoqërive të sigurimeve dhe dhënies së rekomandimeve për AMF-në (vendimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 28, dt 23.12.2005, nr. 49 dt 21.3.2007, nr. 247, datë 09.10.2012 "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)").

42. Nga vlerësimi i dinamikës së efekteve reale në treg të këtyre vendimeve konstatohet se Gjykatat përgjithësisht nuk kanë kuptuar drejt vendimmarjen e Autoritetit të Konkurrencës dhe rolin e tij në rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg.

43. Nga ana tjetër, AMF deri në përfundim të këtij hetimi nuk ka arritur të marrë masat rregullative efikase për të siguruar funksionimin e tregut sipas parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e sigurimeve të detyrueshme i cili mbetet ndër më të pazhvilluarit në rajon sa i përket pagesës së dëmeve dhe madhësisë së tregut. Që nga viti 2007 madhësia e tregut të sigurimit të detyrueshëm nuk ka ndryshuar pasi primet e sigurimit të detyrueshëm motorik ishin 3 miliardë e 865.3 milionë lekë dhe për vitin 2013 ishin 3 miliardë e 885.8 milionë lekë ndërkohë që tregu i sigurimeve në tërësi ka patur dinamikë rritje nga 5.25 miliardë lekë në 7.51 miliardë lekë nga pjesa e sigurimeve vullnetare.

44. Nga të dhënat e depozituara në Autoritetin e Konkurrencës rezulton se ndërmarrja me peshën specifike më të vogël të të ardhurave bruto (primeve të shkruara bruto-1/20 e tregut -përveç ndërmarrjes që ka hyrë e re) ka dukshëm nivelin më të lartë të fitimit.

45. **Si konkluzion**, në zbatim të qëllimit të ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" për përcaktimin e sjelljes së ndërmarrjeve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, Komisioni i Konkurrencës gjykon se sjellja e ndërmarrjeve në treg bie në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg duke rritur në masë të njëjtë dhe fiksuar për një periudhë tre ditore primet e shitjës së produktit MTPL, si dhe duke përdorur sistemin e shitjeve të përqëndruara nëpërmjet Star Broker për të ruajtur pjesët e tregut. Për të patur një efekt real në ndërhyrjen në këtë treg, bazuar në nenin 45/2 të ligjit, Komisioni i Konkurrencës shprehet **me kushte dhe detyrime, për të gjitha ndërmarrjet objekt hetimi, si instrument** për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 45, 74, 75 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Shoqëritë e sigurimit **duhet të përmbushin brenda 90 ditëve** nga marrja e këtij vendimi kushtet dhe detyrimet si vijon:
 - a) Vënien në funksionim të programit Bonus-Malus për sistemin e individualizuar të sigurimit të detyrueshëm bazuar në të dhënat e të siguruarit, mjetit, historikut të dëmeve të shkaktuara dhe vendndodhjes;
 - b) Ofrimi i shoqërisë së sigurimit sipas kërkesës së të siguruarit. Në sistemin e ofruar nga shoqëritë e brokerimit dhe agentët e shoqërive të sigurimit duhet të shfaqen në kohë reale logot e të gjitha shoqërive të sigurimit me te cilat agjenti ose brokeri kanë marrëveshje për tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorrik;
 - c) Të zbatojnë parashikimin ligjor për pagesën e dëmit nga siguroesi i drejtpëdrejtë;
 - d) Të lidhin marrëveshje me më shumë se 1 shoqëri brokerimi sipas kriterëve të parashikuara nga AMF-ja lidhur me sistemin online të sigurimeve të detyrueshme dhe sistemit bankar për pagesat sipas legjislacionit në fuqi;
 - e) Shtypja dhe tregtimi i policave të sigurimit me logon e secilës ndërmarrje;
4. Mospërmbushja e këtyre kushteve dhe detyrimeve sipas nenit 45/2 të Ligjit do të sjellë si pasojë vendosjen e masës së gjobës për shkelje të rënda **deri në 10 për qind të xhiros** sipas nenit 74, pika 1, gërma c e Ligjit.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr.325 , Datë, 30/07/2014

**“Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për
nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve
motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|------------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| • Rezana KONOMI | Zv/Kryetar |
| • Servete GRUDA | Anëtar |
| • Koço BROKA | Anëtar |
| • Iva ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit të Hetimit të Thelluar në tregun sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, qëndrimit zyrtar të AMF-së, pretendimet e palëve dhe kundërpretendimet e Grupit të Punës.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, nenet 69, 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- ✓ Raportit të hetimit të thelluar në tregun sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta dhe pretendimeve të palëve nën hetim
- ✓ Përgjigjes dhe komenteve të AMF-së për raportin të dërguara me shkresën nr. 1494/1 të datës 17.7.014 protokulluar pranë Autoritetit me shkresën 304/1 prot të datës 17.7.2014

VËREN SE:

I . PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 297, datë 18.11.2013 të Komisionit të Konkurrencës dhe Vendimit Nr. 300, datë 06.12.2013

vendosi të miratojë Hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik Ndaj Palëve të Treta, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës.

2. Komisioni i Konkurrencës, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 310, datë 31.03.2014 vendosi , “Për Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Sigurimit të Detyrueshëm të Mjeteve Motorike për Përgjegjësitë Ndaj Palëve të Treta”, ndaj 9 (nëntë) ndërmarrjet vijuese, që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA, SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP, INTERALBANIAN VIG SHA, ALB - SIGURACION SH, INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA, EUROSIG SHA, “ANSIG” Sh.a,.
3. Pas përfundimit të hetimit paraprak pranë Autoritetit të Konkurrencës kanë depozituar këndvështrimet dhe angazhimet e tyre me shkrim ndërmarrjet: SIGAL SHA, ATLANTIK SHA dhe INSIG SHA ndërkohë që në seancat dëgjimore u paraqitën vetëm drejtuesit e shoqërive Sigal SHA dhe Atlantik SHA.
4. Pas administrimit të fakteve dhe provave dhe informacioneve të nevojshme për kyerjen e një hetimit të plotë mbi sjelljen e ndërmarrjeve në treg është hartuar raporti i hetimit të thelluar i cili i është dërguar ndërmarrjeve nën hetim me anë të shkresës së Autoritetit të Konkurrencës nr. 289, datë 20.06.2014.
5. Në bazë të nenit 39 të Ligjit, shoqëritë e sigurimit : Ansig, Interalbanian, Atlantik, Intersig, Sigal, Albsig, Eurosig, dhe Insig paraqitën pretendimet e tyre me shkrim, ndërsa shoqëritë Sigal, Albsig, Eurosig, dhe Insig u paraqitën edhe në seancat dëgjimore të datave 22 dhe 23 Korrik 2014.
6. Raporti i është dërguar për mendim dhe për organizimin e një seancë konsultative me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF). AMF i ka shprehur qëndrimet e saj lidhur me raportin vetëm me shkresën 1494/1 prot të datës 17.7.2014.

II . RREGULLIMI I TREGUT

1. Tregu i Sigurimit të detyrueshëm motorik është i rregulluar në bazë të ligjit Nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin në sektorin e transportit” i ndryshuar, dhe enti rregullator përkatës është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).
2. Një nga sektorët e paktë që përfitojnë përjashtime në bllok për shkak të specifikave të tregut është sektori i Sigurimeve. Komisioni i Konkurrencës ka miratuar Rregulloren për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve, ku parashikon përjashtimin nga ndalimi të disa kategorive të

marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve të cilat kanë për objekt bashkëpunimin në lidhje me: vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve; vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta; mbulimi i zakonshëm për disa lloje të caktuara rreziqesh, shlyerja e dëmeve; rregullorja ka për synim të sigurojë një mbrojtje efektive të konkurrencës, ndërsa ofron përfitime për konsumatorët dhe siguri ligjore të përshtatshme për ndërmarrjet.

3. AMF në zbatim të nenit 10 të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, me vendimin nr. 44, datë 24.04.2013, “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti” miraton tabelën e primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.
4. Pas aplikimit të shoqërive të sigurimit gjatë periudhës mars 2014 AMF ka miratuar me vendimin nr.34 datë 25.03.2014 "Për miratimin e tabelave te primit te rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm te përgjegjësisë se pronarit te mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve te treta nga përdorimi i këtij mjeti", tarifat e primit të rrezikut. Nga ana tjetër, bazuar në ligjin nr. 10076 datë 12.02.2012 “Për sigurimin në sektorin e transportit”, i ndryshuar, shoqëritë përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm (primin e shitjes) sipas kushteve të tregut.
5. Primet e shitjes merren nga primi i rrezikut duke shtuar edhe shpenzimet dhe fitimin që kompania pret të realizojë nga produkti. Si shpenzime dhe fitim merren parasysh sa më poshtë (përqindja e këtyre shërbime caktohet nga vetë kompania e sigurimeve): Komisioni i agjentit, brokerit; fitimi i shoqërisë; shpenzimet administrative, pasi shtohen edhe shpenzimet e mësipërme primit të rrezikut, mbi këtë vlerë aplikohet TVSH (20%).
6. Në vijim të shkresës tonë nr. 68 datë 13.02.2014 drejtuar AMF “Mbi zhvillimet e fundit të tregut të sigurimit të detyrueshëm” AMF me shkresën nr. 68/1 date 14.02.2014 na bën me dije se “lidhur me çmimet që shoqëritë e sigurimit kanë zbatuar së fundmi, bazuar në ecurinë dhe rezultatet e vitit 2013, në përlllogaritjen e tarifave të primit të sigurimit të detyrueshëm motorik, janë shtuar edhe dy faktorë të tjerë përcaktues, që janë data e prodhimit të automjeteve që sigurohen dhe kohëzgjatja e

patentës së përdoruesve të këtyre automjeteve. Shtimi i këtyre dy faktorëve të riskut ka ndikuar në ndryshimet që kanë pësuar tarifatat aktuale”.

7. Autoriteti i Konkurrencës gjykon se këto dy faktorë prime të diferencuara duhet të sillnin ndryshime në tarifatat që do të aplikoheshin për klientin fundor. Nga inspektimet e kryera dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga ndërmarrjet rezulton se dy faktorët e përmendura nga AMF në shkresën nr. 68/1 date 14.02.2014 nuk janë aplikuar në përcaktimin e primeve të shitjes.
8. AMF, pas rritjes së primeve të shitjes së produktit MTPL, në datë 12.02.2014 ka publikuar në faqen e saj të internetit njoftimin “Mbi luhatjet e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik në tregun e sigurimeve në vend”, ku midis të tjerave paraqet:
 - a. Rregullimin Ligjor të produktit MTPL sipas ligjit Nr. 10455, datë 21.07.2011 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Në nenin 10 të këtij ligji parashikohet që, “... shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifatat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut ...” Pra, tarifatat e sigurimit të detyrueshëm janë të liberalizuara, duke i dhënë të drejtën shoqërive të sigurimit t’i përcaktojnë vetë ato, sipas kushteve të tregut...
 - b. Nga ana tjetër AMF thotë se nga përlllogaritjet e AMF, një çmim orientues në nivel tregu, nisur nga situata në treg, do të luhatej në nivelet prej të paktën 14.4 mijë lekë dhe 21 mijë lekë përkatësisht për kategoritë me B1/1 (kubikazhi nën 1,600 cc) dhe B1/2 (kubikazhi mbi 1,600 cc) për automjetet private, që shoqëritë e sigurimit të jenë në gjendje të ruajnë ekuilibrat ekonomikë. Këto nivele çmimesh bazohen në primin orientues për rrezikun dhe janë të mjaftueshme vetëm për mbulimin e pagesës së dëmeve dhe shpenzimeve operative. Nëse do të futej dhe marzhi i fitimit apo elementet fiskalë, si për shembull TVSH, është e qartë që çmimi minimal që do të duhej të paguante konsumatori do të ishte edhe më i lartë.
 - c. Sipas AMF, në nenin 99 të Ligjit Nr. 9267, date 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, i ndryshuar”, sanksionohen qartë elementet që duhet të përmbajë primi i sigurimit, të përmendura më sipër. Për AMF si autoritet mbikëqyrës e rregullator, situatë e rrezikshme do të konsiderohej nëse çmimi do të binte nën këtë nivel.

III . GJETJET E RAPORTIT PËR RREGULLIMIN E TREGUT

1. Tregu i sigurimeve paraqet specifika të veçanta për arsye të riskut që e shoqëron këtë shërbim (transferimi i rriskut nga njëra kompani te tjetra, brenda dhe/ose jashtë Shqipërisë) dhe menaxhimi i këtij rrisku kërkon bashkëpunim mes kompanive të sigurimit të cilat njohin probabilitetin e ndodhjes së ngjarjeve dhe duhet të ndihmojnë konsumatorët duke ju përgjigjur në kohë, në cilësi dhe sasinë e përcaktuar të përfitimit pavarësisht se policën e cilës kompani sigurimi mban konsumatori klienti.
2. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 247, Datë 09.10.2012 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”, ndër të tjera i ka rekomanduar AMF-së në pikën I.2 të vendimit: “Implementimin në një kohë sa më të afërt të sistemit bonus malus, i cili do të krijonte mundësi për një diversitet dhe aplikim të primeve të ndryshme për çdo policë sigurimi të detyrueshëm motorik, duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën midis kompanive që operojnë në këtë treg.” Deri në përfundimin e procedurave hetimore ky rekomandim i Autoritetit të Konkurrencës, për të vënë në zbatim sistemin Bonus Malus, nuk ishte zbatuar.
3. Për sa i përket karakteristikave dhe cilësive të tjera të produktit MTPL e brendshme, një përdorues mjete motorik, apo një tjetër individ që është përfshirë në një aksident ku është shkaktuar një dëm, është i lidhur me karakteristikat (kompaninë, cilësinë e shërbimit që ajo ofron, shpejtësinë dhe masën, mënyrën e vlerësimit të dëmit, etj.) e produktit të sigurimit të detyrueshëm për mjetin që është shkaktar i dëmit dhe jo për cilësitë/karakteristikat e MTPL-së brendshme që ai zotëron për mjetin që ai ka në pronësi apo përdorim. Pra, çmimi i policës së sigurimit mbetet faktori përcaktues për zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës në rastin e produktit MTPL, produkt i cili është i detyrueshëm për përdoruesit e mjeteve motorike.
4. Referuar nenit 11 të Ligjit Nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, pala e dëmtuar, bazuar në sigurimin, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te siguruuesi, përgjegjës i pronarit të mjetit, me të cilin është shkaktuar aksidenti. Gjithashtu, referuar pikave 3 dhe 4 të këtij neni, shoqëritë e sigurimit mund të lidhin marrëveshje ndërmjet tyre, sipas të cilave kërkesa për dëmshpërblim, që lidhet me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik ndaj një mjeti tjetër motorik, mund të trajtohet nga siguruuesi i drejtpërdrejtë i pronarit të mjetit motorik të dëmtuar. Siguruuesi i drejtpërdrejtë ka të drejtën e rimbursimit nga siguruuesi, përgjegjës i pagesave, që lidhen me dëmshpërblimin e kryer, sipas kushteve, limiteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet tyre.

5. Në rast se midis ndërmarrjeve do të lidhen marrëveshje ashtu si parashikon nenin 11 pika 3 dhe 4 e Ligjit Nr. 10 076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", atëherë çmimi i policës së sigurimit nuk do të mbetet i vetmi faktor përcaktues për zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës në rastin e produktit MTPL, por do të shtoheshin edhe faktorë të tjerë si cilësinë e shërbimit, shpejtësia dhe masa e dëmshpërblimit, mënyra e vlerësimit të dëmit, etj.
6. AMF ka miratuar çdo vit prime rreziku për sigurimin e detyrueshëm motorrik në nivel tregu pavarësisht propozimeve të herëpahershme të Autoritetit të Konkurrencës për të individualizuar primet e rrezikut sipas karakteristikave të shoqërive të sigurimit, raportit dëme-prime, etj.

IV. KËNDVSHTRIMET E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR RREGULLIMIN E TREGUT

1. Pas njohjes me raportin përfundimtar të hetimit të thelluar, bazuar në nenin 39 të Ligjit, në seancat dëgjimore të datave 22 dhe 23 korrik 2014 shoqëritë e sigurimit paraqitën pretendimet dhe angazhimet e tyre lidhur me raportin e hetimit të thelluar.
2. Në pretendimet e paraqitura me shkrim dhe gjatë seancave dëgjimore të gjitha shoqëritë e sigurimit kanë shprehur angazhimet e tyre për të zbatuar rregullimet e paraqitura në raportin e hetimit të thelluar.
3. Në përgjithësi shoqëritë e sigurimit shprehen mbi realizimin e pagesës së dëmeve sipas shoqërive ku është siguruar mjete motorrik.
4. Nga ana e të gjitha ndërmarrjeve është konfirmuar se ka filluar testimi i sistemit të individualizuar të sigurimit të detyrueshëm Bonus Malus dhe ky testim do të përfundojë në 22 gusht 2014 për tu kthyer në funksional për tregun.
5. Në seancën dëgjimore të datës 23 korrik 2014 dhe në vijim me shkresën 289/7 prot, dt 24.7.2014, INSIG Sh.A shprehet se në periudhën Maj-Korrik 2013 kompania Insig ka kaluar një moment të vështirë pasi me shkresën e AMF nr. 852/ 1 dt. 24.04.2013 janë caktuar tarifa minimale dhe maksimale duke bllokuar sistemin e shitjeve, në rast se tentohej të shitej jashtë këtyre tarifave.
6. Nga të dhënat e depozituara në Autoritetin e Konkurrencës rezulton se ndërmarrja me peshën specifike më të vogël të të ardhurave bruto (me prime të shkruara bruto-sa 1/20 e tregut) -përveç ndërmarrjes që ka hyrë e re) ka dukshëm nivelim më të lartë të fitimit.

V. QËNDRIMI I AMF-së PËR PROPOZIMET E AUTORITETIT PËR RREGULLIMIN E TREGUT

1. AMF me anë të shkresës nr. 1494/1 të datës 17.07.2014 pasi ka shqyrtuar raportin e depozituar nga Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 304 prot të datës 08.07.2014 dhe është shprehur si vijon:

I. Lidhur me rekomandimin për trajtimin e drejtëpdrejtë të dëmit nga shoqëria e sigurimit, AMF duke ju referuar dispozitave të ligjit 10076, date 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", kanë përcaktuar se: "siguruesit mund të lidhin marrëveshje ndërmjet tyre, sipas të cilave kërkesa për dëmshpërblim, që lidhet me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik ndaj një mjeti tjetër motorik, mund të trajtohet nga siguruesi i drejtëpdrejtë i pronarit të mjetit motorik të dëmtuar ", shprehet se trajtimi nga siguruesi i drejtëpdrejtë nuk është detyrues për shoqëritë e sigurimit por është opsional.

II. Lidhur me primin e njësuar për të gjithë tregun, AMF shprehet se në bazë të kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi, mbi bazën e të dhënave të shoqërive të sigurimit, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Ky prim do të jetë orientues për tregun e sigurimit lidhur me vlerësimin e primit të rrezikut që do të kryejnë vetë shoqëritë e sigurimit. Gjithashtu, vlerat e primeve të rrezikut të llogaritura nga Autoriteti vihen vetëm në funksion të vlerësimit të provigjonit teknik të primit të pafitur për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe sipas përcaktimeve në Rregullore, shoqëria e sigurimit përlllogarit nivelin e provigjonit teknik të primit të pafitur të sigurimit të detyrueshëm motorik, minimalisht me vlerat e primit të rrezikut të llogaritura nga Autoriteti.

Nga ana tjetër AMF shprehet se cilësimi se shoqëria e sigurimit i përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, është i mbështetur në pikën 2 të Nenit 10 të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar.

Në raportin vjetor për vitin 2013, fq. 18, AMF shprehet se "AMF e ka konsideruar të parakohshëm liberalizimin e sigurimit e detyrueshëm motorik dhe se liberalizimi do të kryhej me bashkëpunimin dhe asistencën e BB-së dhe pasi të ishte ngritur infrastruktura e duhur për këtë qëllim".

III. Lidhur me rekomandimin për vendosjen e sistemit Bonus - Malus, AMF njofton se janë përfunduar aktivitetet vendimmarrëse në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit dhe është vendosur ndarja e klasave për kategorizimin e riskut si dhe në zbatim të rekomandimeve të Bankës Botërore janë kryer lidhjet e sistemeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me qëllim marrjen e të dhënave të mjetit e të pronarit nga sistemi e në këtë mënyrë shmangien e abuzimeve gjatë hedhjes së të dhënave. Gjithashtu, janë kryer zhvillimet përkatëse në regjistrat elektronik të qendrës së sigurimit të detyrueshëm motorik dhe aktualisht po testohen e po kryen zhvillimet përkatëse të sistemeve nga shoqëritë e sigurimit. Ky sistem pritet të dalë në produksion në një fazë opsionale në datën 21/07/2014 me qëllim trajnimit e agjentëve e më pas në datë 20/08/2014 do të bëhet i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë e sigurimit.

VI. KONKLUZIONE

VI.1. Mbi sistemin e individualizuar të primit

1. Komisioni i Konkurrencës në mënyrë të vazhdueshme ka dhënë rekomandime për AMF-në (vendimet nr. 28 dt 23.12.2005, nr. 49 dt 21.3.2007, nr. 247, Datë 09.10.2012 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”) me qëllim rregullimin e tregut sipas parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Por deri në përfundimin e hetimit nuk është mundësuar funksionimi i sistemit Bonus-Malus
2. Nga ana e të gjitha ndërmarrjeve është konfirmuar se ka filluar testimi i sistemit të individualizuar të sigurimit të detyrueshëm Bonus Malus dhe ky testim do të përfundojë në 22 gusht 2014 për tu kthyer në funksional për tregun. Edhe nga shkresa e AMF nr. 1494/1 prot të datës 17.7.2014 bëhet me dije se janë ndërmarrë të gjitha veprimet me shoqëritë e sigurimit, Drejtoritë e Transportit rrugor, Drejtoritë e Gjendjes Civile dhe janë kryer azhornimet në qendrën e sigurimit të detyrueshëm motorik për zbatimin e këtij projekti. Testi për agjentët do të zhvillohet me datë 21.7.2014 dhe sistemi Bonus –Malus do të jetë i detyrueshëm për shoqëritë e sigurimit me datë 20.8.2014.

VI.2. Mbi pagesën e drejtëpëdrejtë të dëmeve

1. Në kushtet aktuale, parashikimi i pagesës së dëmit të drejtëpëdrejtë është një nga opsionet që përmban ligji por që të bëhet i zbatueshëm kërkon miratimin e akteve nënligjore (rregullore apo udhëzim nga AMF apo Byroja shqiptare e Sigurimit) si dhe marrëveshje mes gjitha shoqërive të sigurimit. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për sigurimet dhe risigurimet” AMF duhet të nxjerrë aktet nënligjore të cilat të mundësojnë zbatimin e kësaj pike detyruese të pagesës së drejtëpëdrejtë të dëmit nga shoqëria e sigurimit. Edhe shoqëritë e sigurimit janë shprehur se duhet mbajtur në konsideratë fakti se plotësimi i këtyre kushteve dhe detyrimeve nuk mund të përmbushen vetëm nga shoqëritë e sigurimit por kërkohet edhe plotësimi i akteve nënligjore nga veprimtaria e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
2. Në opinionin e saj dërguar me shkresë pranë Autoritetit të Konkurrencës AMF përsa i përket rekomandimit për trajtimin e dëmit nga siguruesi i drejtëpëdrejtë shprehet se dispozitat e ligjit 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", kanë përcaktuar se: "Siguruesit mund të lidhin marrëveshje ndërmjet tyre, sipas të cilave kërkesa për dëmshpërblim, që lidhet me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik ndaj një mjeti tjetër motorik, mund të trajtohet nga siguruesi i drejtëpëdrejtë pronarit të mjetit motorik të dëmtuar ". Sipas kësaj dispozite trajtimi nga siguruesi i

drejtpërdrejtë nuk është detyrues për shoqëritë e sigurimit por është opsional.

3. Sa më lart Autoriteti i Konkurrencës konkludon se për shkak të karakteristikave të produktit “policë sigurimi për mjetet motorrike”, si policë e detyrueshme, aktualisht konkurrenca zhvillohet vetëm në çmimin më të ulët gjë që i ka çuar shoqëritë e sigurimit disa herë në tarifa nën primet e rrezikut duke rrezikuar stabilitetin e sistemit financiar, evidentuar kjo edhe nga FMN dhe banka Botërore të cilat po asistojnë rregullimin e tregut të sigurimeve. Trajtimi i drejtëpdrejtë i dëmit nga shoqëria e sigurimit do ta zhvillonte konkurrencën mes shoqërive për produktet e tyre duke nxitur konkurrencën jo vetëm te tarifa e ofruar por edhe mbi bazën e gjendjes financiare të shoqërisë për pagesën e dëmeve për produktin e siguruar që është dhe qëllimi kryesor i çdo blerje të riskut nga shoqëria e sigurimit të i siguruari.

VI.3. Mbi unifikimin e primit të rrezikut në nivel tregu

1. Pavarësisht aplikimeve të individualizuara të shoqërive të sigurimit për primin e rrezikut gjatë periudhës mars 2014, AMF ka miratuar me vendimin nr. 34 datë 25.03.2014 "Për miratimin e tabelave te primit te rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm te përgjegjësisë se pronarit te mjetit motorik për demet qe u shkaktohen palëve te treta nga përdorimi i këtij mjete" tarifat e primit të rrezikut për të gjitha shoqëritë e sigurimit.
2. Gjithashtu në seancën dëgjimore të datës 23 korrik 2014 dhe në vijim me shkresën 289/7 prot, dt 24.7.2014, Insig Sh.A shprehet se në periudhën Maj-Korrik 2013 kompania Insig ka kaluar një moment te vështirë pasi me shkresën e AMF nr. 852/ 1 dt. 24.04.2013 janë caktuar tarifa minimale dhe maksimale duke bllokuar sistemin e shitjeve, ne rast se tentohej te shitej jashte këtyre tarifave.
3. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se shoqëri të ndryshme sigurimesh kanë nivel të ndryshëm të primit të rrezikut për produktet e tyre të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare marrjen e masave rregullatore për vendosjen e tregut të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta në kushtet e funksionimit eficient duke siguruar konkurrencën mes shoqërive të sigurimit nëpërmjet marrjes së masave si vijon:

- a. Të bëjë të zbatueshëm parashikimin ligjor për trajtimin e dëmit nga siguruesi i drejtëpërdrejtë sipas parashikimeve të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";
 - b. Të miratojë tabela të individualizuara të primit të riskut mbështetur në analizën e riskut sipas portofolit të shoqërive të sigurimit, karakteristikave të produkteve dhe strukturës së sigurimeve për çdo shoqëri sigurimi;
 - c. Të informojë Autoritetin e Konkurrencës në mënyrë periodike mbi vënien në funksionim të projektit Bonus-Malus deri në realizimin e plotë të projektit për individualizimin e primit të riskut sipas historikut të dëmeve të të siguruarit, moshës së drejtuesit të automjeteve, vendbanimi dhe fuqia motorike e automjetit etj.
 - d. Të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës në kuadër të projektit të asistencës me Bankën Botërore për rishikimin e kuadrit rregullator për produktet e sigurimit MTPL me theks të veçantë mbi teknikat e përlllogaritjes së provigjoneve të dëmeve nga produktet e sigurimit MTPL.
 - e. Të publikojë raportin dhe të dhënat financiare të shoqërive të sigurimit për të mundësuar konkurrencën e ndershme në tregun e sigurimeve mbështetur në Udhëzimin "Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatorë", me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikqyrës Financiare nr. 11, datë 08.02.2007, dhe të sigurojë që "Shoqëria e sigurimit publikon raportin vjetor i cili përfshin raportin vjetor financiar dhe të dhëna të tjera të përfshira në këtë Udhëzim. Ky raport publikohet, jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik".
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
Nr. 326, datë 08.09.2014**

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregëtimit të energjisë
elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.09.2014, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i vlerësimit të Sekretariatit lidhur me një ankesë për tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga OSSHEE”;

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të vlerësimit për një ankesë në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga OSSHEE”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE :

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një ankesë me lëndë “ankim mbi marrëveshjet/praktikat e ndaluara në tenderin e blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE SHA për periudhën Janar – Korrik 2014”, në lidhje me dyshime të besueshme mbi praktika të bashkërenduara/marrëveshje të ndaluara në tenderin e blerjes së energjisë elektrike nga ana e OSHEE SHA (ish-Cez Shpërndarje SHA) në dëm të konkurrencës së lirë dhe të vërtetë në treg”.

2. Ankimuesi në mënyrë të përmbledhur pretendon se “ofertat e paraqitura nga disa prej operatorëve janë të paarsyeshme dhe mbi çmimin e tregut dhe me diferenca të papërfillshme me njëri tjetrin, me 5 cent dhe ka koordinim për sasi të ofertuara dhe se skualifikimi i ofertave me çmime konkurruese ka sjellë humbje për OSHEE-në, buxhetin e shtetit dhe për konsumatorin përfundimtar”.
3. Tregu i energjisë elektrike rregullohet me anë të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA (ish-Cez Shpërndarje SH.A) në bazë të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, është i vetmi operator që ka të drejtën ekskluzive të shpërndarjes dhe furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike dhe detyrimin ligjor të sigurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve.
4. Segmenti i tregut të energjisë elektrike për blerjen e OSHEE-së për mbulimin e humbjeve sipas Modelit Të Tregut Të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave me nr.338, datë 18.3.2004, është i vetmi segment i liberalizuar dhe ku mund të zhvillohet konkurrenca, pasi OSSHEE ka të drejtë të prokurojë energjinë nga operatorët e licensuar.
5. Për të evidentuar kufizimet e mundshme të konkurrencës nga sjellja e pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga ana e OSHEE-së, që mund të sjellin pengimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve që marrin pjesë në procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.
- II. Periudha e hetimit do të jetë Janar - Shtator 2014.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se 3 muaj nga dalja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
Nr.327, datë 08/09/2014**

**“Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Autoritetit të Mbikëqyrjes
Financiare për revokimin e Vendimit nr. 325, datë 30.07.2014 të Komisionit
të Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.09.2014 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i ankimit administrativ të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014.

Baza ligjore: Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenet 135, 137, 139, 140 dhe 146;
Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, gërma d, dhe neni 46.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të ankimit administrativ të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014,

VËREN SE:

1. Bazuar në nenin 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet veprimtarisë së tij duhet të mbrojë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve si dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre.
2. Komisioni i Konkurrencës është shprehur disa herë në lidhje me efektet e sjelljes së shoqërive të sigurimit në treg, nëpërmjet vendimeve me gjobë

për shkelje të rendë të ligjit, të cilat nga rishikimi gjyqësor janë rrëzuar me argumentimin: "Rritja e primeve u bë në zbatim të urdhrave dhe politikave të vendosura nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (pika 26 e Vendimit nr.2180 datë 24.10.2013 të Gjykatës së Apelit, Tiranë).

3. Në zbatim të detyrave të përcaktuara nga Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet Rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e vitit 2013 dhe prioritetet e vitit 2014, Autoriteti i Konkurrencës ka detyrimin publik që së bashku me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) të forcojë bashkëpunimin për diversifikimin e primeve të sigurimit nëpërmjet sistemit Bonus Malus dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe afatgjata për zhvillimin e konkurrencës dhe stabilitetin e tregut të sigurimeve.
4. Pas përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 304 prot., datë 08.07.2014, përpara marrjes së vendimit përfundimtar ka kërkuar mendimin e AMF-së në lidhje me raportin e hetimit të thelluar dhe ka ftuar në një tryezë konsultative Bordin Drejtues të këtij institucioni, për të diskutuar mbi gjetjet e raportit dhe rekomandimet e propozuara për rregullimin e tregut. Në përgjigje të kësaj ftese, Bordi Drejtues i AMF-së u shpreh me shkrim në lidhje me opinionet me shkresën nr. 1494/1 prot., datë 17.07.2014 dhe nuk morri pjesë në tryezën e rrumbullakët, tryezë e cila synonte në diskutimin dhe sqarimin e çështjeve që shqetësonin konkurrencën në treg.
5. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 325, datë 30.07.2014, ka dhënë disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
6. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me anë të shkresës së saj nr. 1662/1 prot., datë 15.08.2014, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 338/1 prot., datë 15.05.2014, kërkon nga Komisioni i Konkurrencës: Ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014 "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta".
7. Më konkretisht në vijim janë pasqyruar rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, kundërshtimet e AMF lidhur me këto rekomandime dhe qëndrimet përfundimtare të Komisionit të Konkurrencës.

I- Rekomandimi i Parë

Lidhur me pikën 1.1 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014, AMF-ja shprehet se: Dispozitat e Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", kanë përcaktuar se: "Siguruesit mund të lidhin marrëveshje ndërmjet tyre, sipas të cilave kërkesa për dëmshpërblim, që lidhet me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik ndaj një mjeti tjetër motorik, mund të trajtohet nga siguruesi i drejtpërdrejtë i pronarit të mjetit motorik të dëmtuar".

Sipas kësaj dispozite trajtimi nga siguruesi i drejtpërdrejtë nuk është detyruar për shoqëritë e sigurimit, por është opsional.

Për këtë arsye AMF-ja shprehet se nuk mund të bëjë të zbatueshëm rekomandimin e Autoritetit të Konkurrencës, pasi është dhënë në kundërshtim me ligjin.

Meqenëse nga ana e shoqërive, sipas angazhimit të marrë, do të fillojë të zbatohet skema e trajtimit të dëmit nga ana e siguruesit të drejtpërdrejtë të pronarit të mjetit motorik të dëmtuar, atëherë AMF-ja, në zbatim të nenit 13 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, duhet të miratojë rregullat për trajtimin e dëmit sipas kësaj mënyre.

II- Rekomandimi i Dytë

Lidhur me pikën 1.2 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014, AMF-ja shprehet se: Në funksion të një tregu të liberalizuar, Autoriteti nuk mund të llogarisë dhe miratojë tabela të individualizuara sipas shoqërive të sigurimit lidhur me vlerësimin e primit të rrezikut. Autoriteti jep kontributin e tij, si institucion mbikëqyrës, në vlerësimin e parametrave në nivel tregu, sipas legjislacionit në fuqi, që ndikojnë drejtpërdrejtë në vlerësimin e primit të këtyre kontratave. Shoqëria e sigurimit i përcakton vetë tarifën e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, në bazë të pikës 2, të nenit 10 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Sa më sipër, nuk është përgjegjësi dhe detyrë e Autoritetit të miratojë tabela të individualizuara të primit të riskut për çdo shoqëri sigurimi dhe për këtë arsye kërkojmë ndryshimin e pikës 1.2 të vendimit, pasi bie në kundërshtim me nenin 9 të Rregullores nr. 110.

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se shoqëri të ndryshme sigurimesh kanë nivel të ndryshëm të primit të rrezikut për produktet e tyre të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike dhe për këtë arsye AMF duhet të marrë në konsideratë specifikat sipas shoqërive në miratimin e primeve të rrezikut.

III- Rekomandimi i Tretë

Lidhur me pikën 1.3 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014, AMF-ja shprehet se: Ka qenë gjithmonë transparente me publikun dhe tregun, për të gjitha projektet që ka pasur në zbatim. E shohim të panevojshëm rekomandimin për informimin periodik të Autoritetit të Konkurrencës, pasi vënia në zbatim e këtij projekti është detyrë dhe përgjegjësi e AMF-së dhe tregut të sigurimeve. Për ecurinë e projekteve dhe caktimin e objektivave AMF-ja raporton në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Për këtë arsye kërkojmë ndryshimin e pikës 1.3 të vendimit".

Nga ana tjetër AMF në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës dhe rregullator të tregut duhet të marrë të gjitha masat me karakter rregullativ dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera publike si Drejtoritë e Shërbimit të Transportit Rrugor dhe zyrat e gjendjes civile për të mundësuar aksesin në të dhënat dhe funksionimin e këtij tregu në bazë të programit Bonus-Malus.

IV- Rekomandimi i Katërt

Lidhur me pikën 1.4 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014, AMF-ja shprehet se: Përsa i përket pikës 1.4 të vendimit rekomandimi është i paqartë se ku konsiston bashkëpunimi, pasi teknikat e përlllogaritjes së provigjoneve teknike, përcaktohen nga aktuarët në përputhje

me legjislacionin në fuqi dhe standardet e fushës aktuariale. Ndërkohë që projekti me Bankën Botërore ka përfunduar në Prill 2013. Për këtë arsye kërkohet ndryshimin pikës 1.4 të vendimit.

Në fakt AMF në një njoftim zyrtar të datës 14 korrik 2014 të publikuar në faqen zyrtare shprehet se “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare fillon zbatimin e projektit të asistencës për tregun e sigurimeve”(botuar më 14/07/2014) dhe në mënyrë të detajuar informon se “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet First Initiative (Financial Sector Reform and Strengthening Initiative) filloi zbatimin e projektit të asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve”.

Megjithëse AMF është konfuzë për projektin e asistencës së Bankës së Botërore për tregun e sigurimeve nëse ka përfunduar në prill të vitit 2013 apo ka filluar në korrik 2014, Autoriteti i Konkurrencës shpreh vullnetin e plotë për bashkëpunim në zbatim të nenit 70 të Ligjit për rregullimin e tregut duke përcaktuar detyrimin për të zbatuar dispozitat e këtij Ligji gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

V- Rekomandimi i Pestë

Lidhur me pikën 1.5 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014, AMF-ja shprehet se: Në drejtim të publikimeve dhe transparencës, AMF-ja ka marrë nota maksimale dhe nga vlerësimi i fundit nga FMN dhe BB, në kuadër të FSAP 2013-2014. Si referencë është raporti dhe notat teknike të lëshuara nga ky mekanizëm. Gjithashtu kjo ka qenë një nga fushat ku AMF është e përputhur plotësisht me parimet e IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve), përsëri e nxjerre në pah nga FSAP. Për më tepër AMF në sajë të një projekti madhor financiar nga BERZH dhe një pune disavjeçare, tashmë disponon një nga platformat më moderne të raportimit dhe përpunimit të informacionit mbikëqyrës, ku një pjesë e mirë e raporteve të publikuara janë të automatizuara. Përveç kësaj, faqja zyrtare e AMF-së është shpallur e dyta në rajon nga një vlerësim i pavarur i kryer nga PFS (Partnerët për Stabilitet Financiar) në vitin 2012. Për sa më sipër ky rekomandim nuk qëndron dhe kërkohet të ndryshohet.

Në pretendimin e mësipërm të AMF-së nuk paraqitet asnjë e dhënë në lidhje me Rekomandimin konkret të Autoritetit të Konkurrencës për të publikuar raportin dhe të dhënat financiare të shoqërive të sigurimit. Autoriteti i Konkurrencës e konsideron transparencën e pasqyrave financiare të këtyre shoqërive si një instrument të rëndësishëm për të mundësuar konkurrencën e ndershme në tregun e sigurimeve. Ky rekomandim është mbështetur në Udhëzimin “Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatorë”, miratuar me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 11, datë 08.02.2007, në të cilin thuhet që: “Shoqëria e sigurimit publikon raportin vjetor, i cili përfshin raportin vjetor financiar dhe të dhëna të tjera të përfshira në këtë udhëzim. Ky raport publikohet jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik”.

8. Në përfundim të Ankimit Administrativ, AMF-ja, në zbatim të nenit 146, gërma (b) të Kodit të Procedurave Administrative, kërkon: Ndryshimin e aktit administrativ Vendimit nr. 325 datë 30.07.2014 të Komisionit të Konkurrencës.
9. Referuar nenit 146, gërma (b) të Kodit të Procedurave Administrative, organi administrativ që shqyrton ankimin vendos: Shfuqizimin/revokimin e aktit administrativ dhe pranimin e ankimit;
10. Referuar nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, revokimi vendimit mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 kriteret e përcaktuara në këtë nen:
 - njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
 - palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
11. Nga vlerësimi i kërkesës së AMF-së lidhur me këto rekomandime, në kuptim të nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.09.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e AMF-së nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d, nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenet 135, 137, 139, 140 dhe 146 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e Ankimit Administrativ të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014;
2. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 325, datë 30.07.2014 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 328, datë 11.09.2014

Mbi

“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Alpha Bank S.A, të aseteve të zotëruara nga CitiBank Internacional PLC që i përkasin aktivitetit të shërbimeve bankare për individë në Greqi dhe të ndërmarrjes Diners Club of Greece Finance Company S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2014, shqyrtoi çështjen me :

- Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Alpha Bank S.A, të aseteve të zotëruara nga CitiBank Internacional PLC që i përkasin aktivitetit të shërbimeve bankare për individë në Greqi dhe të ndërmarrjes Diners Club of Greece Finance Company S.A.
- Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, dhe neni 15, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Alpha Bank S.A - CitiBank Internacional PLC - Diners Club of Greece Finance Company S.A dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1 . Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes për shitjen dhe transferimin e biznesit të Citibank për konsumatorin dhe aksioneve të Diners Co.” të datës 13 Qershor 2014, e lidhur midis palëve Alpha Bank S.A, Citibank International PLC dhe Cititbank Overseas Investment Corporation, me objekt përfitim të kontrollit, nga Aplha Bank S.A, të aseteve të zotëruara nga CitiBank Internacional PLC që i përkasin aktivitetit të shërbimeve bankare për individë të grupit ndërkombëtar të Citi në Greqi dhe të ndërmarrjes Diners Club of Greece Finance Company S.A nëpërmjet përfimit të masës prej 100% të kapitalit aksionar në këtë të fundit.

Transaksioni i cili realizohet në formën e përfimit të kontrollit të pjesshëm mbi një ndërmarrje (biznesi i Citibank) dhe të kontrollit ekskluziv në shoqërinë Diners Co dhe sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit është përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- ❖ **Alpha Bank**, është një shoqëri e themeluar në 1879 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek me seli në adresën: 40 Stadiou Str, Athinë, Greqi. Ajo është një nga bankat më të mëdha të Greqisë me më shumë se 900 degë. Grupi Alpha Bank është gjithashtu aktiv edhe në tregun ndërkombëtar të bankave me prezencë në Qipro, Rumani, Bullgari, Serbi, Ukrainë, Shqipëri, Maqedoni dhe Mbretëri e Bashkuar.

Alpha Bank është prezente dhe për pasojë realizon xhiro në Shqipëri me anë të degës së saj **Alpha Bank – Albania** e cila ka filluar aktivitetin që prej vitit 1998.

- ❖ **Citibank Internacional PLC (Greqi)** aktiviteti tregat i Citibank në cilësinë e **target-it**, përfshin (i) veprimtaritë e lidhura me kartat e pagesës, kartat e kreditit dhe të debitit, përse i përket lëshimit të kartave dhe administrimin e veprimtarive në терминаlet virtuale POS për kryerjen e transaksioneve virtuale; (ii) *retail banking* dhe shërbime bankare për Sipërmarrje të Vogla dhe të Mesme, shërbime bankare për individë (retail banking) përfshijnë administrimin e pasurisë personale, këshillim për persona fizik me vlerë neto të lartë (“adminisitrimi i pasurisë”), letër garanci dhe shërbime për kasaforta sigurie, adminisitrimi i pasurisë përfshin shërbimet e shpërndarjes së fondeve të përbashkëta; (iii) ndërmjetësim të sigurimit.
- ❖ **Diners Club of Greece Finance Company S.A**, në cilësinë e ndërmarrjes **target** , është një insitucion financiar grek i liçencuar dhe rregulluar nga

Banka e Greqisë. Ajo kryen aktivitetin tregtar të origjinimit, reklamimit dhe ofrimit të shërbimit dhe koleksionimin dhe aktivitetet e rekuperimit të kartave të kreditit dhe pagesës të konsumatorëve të të njëjtës markë në zbatim të Ligjeve të Zbatueshme. Diners është aktive në tregun grek për leshimin e kartave dhe administrimin e veprimeve në терминаlet virtuale POS për kryerjen e transaksioneve virtuale, pasi ofron shërbimet përkatëse për kartat që mbajnë marken ndërkombëtare Diners dhe është e liçencuar për të përdorur markën ndërkombëtare të Diners nga Diners Club International Ltd.

3.Xhiro për vitin 2013

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar**⁵⁵ është XXXX **Lekë**:
 - **Alpha Bank S. A.** : XXX €⁵⁶ = XXX Lekë
 - **Citi Bank International PLC** : XXX £⁵⁷ = XXX Lekë
 - **Diners Club of Greece Finance Company SA**:
XXX € = XXX Lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**⁵⁸: është XXX **Lekë**:
 - **Alpha Bank Albania SH.A.** : XXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit.

4.ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë

- I). tregu i produktit, dhe
- II). tregu gjeografik.
 - **Tregu përkatës i produktit**: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet ofrimi i shërbimeve bankare për individë (retail banking) dhe korporata (corporate banking)⁵⁹.

55 Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013, 1euro=140.26 lek dhe 1£=165.19

56 Burimi: Raporti vjetor 2013 i Alpha Bank

57 Burimi: Raporti vjetor 2013 i Citibank International PLC

58 Burimi: Bilanci i Audituar i Alpha Bank Albania

59 Referuar rasteve të ngjashme të Komisionit Europian si ; COMP/M.2567, COMP/M.4844, etj.

Në rastin konkret treg përkatës të produktit do të konsiderojmë **shërbime bankare për individë** (depozita dhe shërbime për llogaritë (llogari kursimi, llogari rrjedhëse etj), kreditim (kredi personale, kredi konsumi, overdraft , kredi për binzese etj), bono thesari etj).

Veprimtaritë bankare për korporatat dhe veprimtaritë e transportit të Citibank International PLC janë jashtë qëllimit të transaksionit, pra nuk do të konsiderohen treg përkatës i produktit.

5 . Tregu gjeografik:

Për analizimin e këtij rasti *treg gjeografik* do të konsiderohet tregu kombëtar pra **Tregu i brendshëm**.

5.1 . Struktura e tregut (Tregu bankar ne Shqipëri)

Sektori bankar vazhdon të luajë rolin kryesor në ndërmjetësimin financiar në Shqipëri, me një strukturë që ka mbetur e pandryshuar në vitet e fundit, e përbërë nga 16 banka me kapital të gjithin privat, dhe me mbizotërim të bankave të huaja me qendra në vendet e Bashkimit Europian.

Edhe shërbimet e ofruara për mundësimin e bankingut nëpërmjet internetit kanë ardhur duke u rritur që prej futjes së tyre të parë në treg në vitin 2005. Aktualisht, 12 nga 16 bankat në vend ofrojnë *internet banking*, ndërkohë që 6 prej tyre kanë ndërmarrë ose po ndërmarrin iniciativa për futjen e *mobile banking* si dhe shërbime të tjera si *MultiCash* dhe *SMS banking*.

5.2. Konkurrentët në tregun kombëtar

Referuar të dhënave të Shoqatës Shqiptare të Bankave , banka e cila rezulton të ketë mbulimin më të gjërë nëpërmjet degëve dhe agjensive të saj është Raiffeisen Bank me 102 degë dhe agjensi, e ndjekur nga Banka Kombëtare Tregtare me 84 degë dhe agjensi dhe Tirana Bank me 53 degë dhe agjensi.

5.3.Pozicioni në treg pas përqendrimit

Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi, Citibank International PLC dhe Diners Club of Greece Finance Company SA nuk janë prezente në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonje formë tjetër aktiviteti).

Transaksioni nuk përfshin Alpha Bank Albania SH.A., e cila aktualisht zotërohet dhe do të mbetet në zotërimin direkt dhe 100% të Alpha Bank S.A.

Transaksioni i propozuar do të rezultojë në sinergji të dobishme për Alpha Bank S.A, duke e lejuar atë të përballojë mjedisin e ri në industrinë bankare si rrjedhojë e krizes financiare.

Alpha Bank S.A do të fitojë akses në praktikat më të mira të zbatuara nga një bankë ndërkombëtare duke e lejuar atë të bëhet konkurrese në nivel europian.

Alpha Bank S.A do të fitojë akses në klientë të shtresave të pasura apo shtresave të pasura në zhvillim, likuiditete më të larta, teknika të avancuara për sigurimin e shërbimeve dhe të shitjeve individuale me vlerë neto të lartë, si dhe akses në sistemet e avancuara të administrimit të riskut dhe në një bazë

njohurish më të gjerë të mbështetur nga personeli ekspert dhe me eksperiencë i Citibank International PLC.

6 . Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

1. Transaksioni i njoftuar përbën një ndryshim kontrolli në mënyrë të qëndrueshme që rezulton prej blerjes nga Alpha Bank S.A te: 1.aksioneve të aktivitetit tregtar target të CITI, dhe 2. të gjitha aksionet e lëshuara nga Diners Club of Greece Finance Company SA.
2. Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi, Citibank International PLC dhe Diners Club International L.t.d. nuk janë prezente në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonje formë tjetër aktiviteti).
3. Pas realizimit të përqendrimit nuk do të ndodhë asnjë ndryshim në strukturën e aksionerëve të Alpha Bank Albania SH.A.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t'i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës":

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Alpha Bank S.A, të aseteve të zotëruara nga CitiBank Internacional PLC që i përkasin aktivitetit të shërbimeve bankare për individë në Greqi dhe të ndërmarrjes Diners Club of Greece Finance Company S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr.329 , Datë 29.09.2014

“Për

një ndryshim në Vendimin nr. 316, datë 23.05.2014 ”Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|------------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Rezana | KONOMI | Zv/Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 29.09.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);
- Ligji nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Pasi mori në shqyrtim Relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me “Mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”,

VËREN SE:

1. Autoriteti i Konkurrencës, me Vendimin nr. 316, datë 23.05.2014 ”Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve” ka vendosur hapjen e procedurave të hetimit paraprak në këtë treg, për periudhën kohore nga 01.01.2013 deri më 31.08.2014

2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti Grupin e Punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
3. Për realizimin e kësaj procedure nga Grupi i Punës është kërkuar informacion nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në këtë treg me anë të shkresës nr. 277 prot., datë 13.06.2014, si dhe nga ana e agjencive detare, të cilat janë përfaqësuese të tyre me autoritetet shtetërore në Shqipëri me anë të shkresës nr. 278 prot, datë 13.06.2014.
4. Informacioni i kërkuar me anë të shkresave të mësipërme nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në tregun përkatës, si dhe nga ana e agjencive detare nuk është dërguar fare ose nuk ka qenë i plotë.
5. Për këtë arsye, nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, me anë të shkresave nr. 277/1 port., datë 19.08.2014, ju është kërkuar përsëri ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg dhe agjencive detare, që të dërgojnë të gjithë informacionin e kërkuar pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda datës 08.09.2014.
6. Në përgjigje të shkresës së mësipërme, nga ana e ndërmarrjeve Duni Port Agency sh.p.k me anë të shkresës nr. 277/2 prot., datë 08.09.2014, Adria Ferries sh.p.k me anë të shkresës nr. 277/3 prot., datë 08.09.2014 dhe Ionian Island sh.p.k me anë të shkresës nr. 277/4 prot., datë 08.09.2014, për shkak të periudhës së ngarkuar të punës dhe fluksit të udhëtarëve, është kërkuar shtyrja e afatit të dorëzimit të të dhënave të kërkuara deri në 30 Shtator 2014.
7. Komisioni i Konkurrencës çmon se sigurimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar, për të parë më mirë sjelljen e ndërmarrjeve në treg dhe për të siguruar një vendimmarrje objektive, është i domosdoshëm.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si dhe Ligjit nr. 8485, datë 11.11.1999 "Kodi i procedurave administrative",

VENDOSI:

1. Në Vendimin nr. 316, datë 23.05.2014 "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve", pika "III", të ndryshohet si vijon:
 - a. Procedurat e hetimit paraprak dhe dorëzimi i raportit duhet të bëhen jo më vonë se data 14 Nëntor 2014."
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 330, datë 03.10.2014

Mbi

“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë nga shoqëria Ferrero International S.A të shoqërive të Oltan Group”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 3.10.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë nga shoqëria Ferrero International S.A të shoqërive të Oltan Group.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Ferrero International S.A me grupin e shoqërive Oltan (Oltan Gıda Maddeleri İhracat İthalat ve Ticaret Anonim Şirketi, Oltan Fındık İşletmeleri Sanayi Ve Ticaret Anonim Şirketi, Oltan Fındık Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi/ Oltan Boyer SAS/ Oltan Grout Limited).

V Ë R E N S E:

I . Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të implementimit të tre “Marrëveshjeve për blerjen e kuotave” të nënshkruara ndërmjet palëve Ferrero International S.A në cilësinë e Blerësit dhe Z. Orhan Veli Oltan në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërive të Grupit Oltan kontrolli i të cilave do t'i kalojë shoqërisë Ferrero International S.A.

Transaksioni, i cili realizohet në formën e përfutimit të kontrollit të plotë eskuziv mbi një grupim ndërmarrjesh (Grupi Oltan), sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit është përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

II . Palët në transaksion

❖ **Ferrero International S.A**, në cilësinë e **Blerësit** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Luxenbourg-ut , me seli në adresën: Rued e treves 2631, Findel, Luxenbourg. Ajo është shoqëria holding e Ferrero Group. Grupi Ferrero është prodhues ushqimor aktiv në të gjithë botën në përpunimin prodhimin dhe shitjen e produkteve të paketuara dhe të tjerë produkte të ëmbla si psh. çokolatë pakeluar, karamela, merenda dhe produkte të buta të ëmbla. Grupi Ferrero është gjithashtu aktiv në blerjen dhe tregtimin e lajthive dhe frutave të thata të ngrënshme dhe në vëçanti të lajthive, në të gjithë botën.

Ferrero, është blerësi më i madh i lajthive në botë, përdor lajthitë si një përbërës në prodhimin dhe shitjen e çokolatave të paketuara, duke përfshirë produktet si Kinder Bueno, Kinder Surprise, Rocher dhe Mon Cheri, dhe në prodhimin e shitjen e produkteve të buta të ëmbla si Nutella. Ferrero International S.A është prezent në Shqipëri me shitjen e produkteve të tij nëpërmjet distributorëve Inter Trade & Distribution Sh.p.k dhe Kosmonte Foods Tirana Sh.p.k.

❖ **Oltan Group**, në cilësinë e **targetit**, është një grup shoqëri aktive në blerjen, përpunimin dhe tregtimin e lajthive të ngrënshme në të gjithë botën.

Oltan Group nuk ka prezencë në Shqipëri.

III . Xhiro për vitin 2013

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun ndërkombëtar për vitin 2013 është XXX miliard Lek:

- Xhiro e Ferrero International S.A⁶⁰ = XXX Euro⁶¹ = XXX Lek ≈ XXX miliard Lek.
- Xhiro e Oltan = XXX Euro⁶² = XXX Lek ≈ XXX miliard Lek.

Ndërkohë, **xhiro totale e palëve pjesëmarrëse** në përqendrim **në tregun e brendshëm**, për vitin 2013 është rreth XXX miliard Lek:

Në Shqipëri, grupi Ferrero është prezent me produktet e tij nëpërmjet distributorëve Inter Trade & Distribution Sh.p.k dhe Kosmonte Foods Tirana Sh.p.k.

Për vitin 2013, xhiro e Ferrero në Shqipëri është XXXLek.

Kosmonte Foods Tirana sh.p.k = XXX Lek

Inter Trade & Distribution sh.p.k = XXX Lek

IV . ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu Përkatës:

A. Tregu përkatës i produktit:

Oltan Trabzon ushtron aktivitet në tregtinë e lajthive dhe është eksportuesi dhe përpunuesi më i madh i lajthive në Turqi.

Oltan Ordu ushtron aktivitet në tregtimin e lajthive. Aktiviteti i saj i vetëm është të blejë lajthi nga prodhuesit dhe tregtarët e krahinës Ordu, Turqi; ti thyejë ato dhe më pas ti shesë drejtpërdrejt tek Oltan Trabzon.

Oltan Düzce ushtron aktivitet në tregtimin e lajthive në krahinën e Düzce në Turqi. Aktiviteti i saj konsiston tek blerja, thyerja dhe shitja në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Oltan Trabzon.

Oltan Boyer ka si aktivitet ekonomik blerjen e lajthive nga Oltan Trabzon dhe i shet ato në Europë dhe vende të tjera. Të njëjtin aktivitet ekonomik kryen dhe Oltan Grout.

Asnjë prej ndërmarrjeve të sipërpërmendura nuk ka aktivitet apo shitje në vendin tonë.

Ferrero është prodhues produktesh ushqimore, i cili ushtron aktivitet në prodhimin dhe tregtimin e ëmbëlsirave dhe produkteve të tjera të ëmbla si snacks, ëmbëlsirave prej çokollate, kremrave të ëmbël lehtësisht të përhapshëm (kremi të çokollatës) etj. Ferrero gjithashtu është përfshirë dhe në blerjen dhe tregtimin e arrorëve të ngrënëshëm – kryesisht lajthive – të cilët i përdor për prodhimin e disa prej produkteve të tij prej çokollate, snacks-ave, apo produkteve me bazë qumështi.

60 Burimi: <http://www.ferrero.com/the-group/business/a-groëing-turnover>

61 Kursi mesatar për vitin 2013 – 1 Euro = 140.26 lek Burimi: Banka e Shqipërisë.

62 Burimi:Tabela 1, Seksioni 3.3, Formulari i thjeshtuar i njoftimit te përqendrimit. Referuar pasqyrave financiare: Oltan Grout Ltd = xxx £; Oltan Findik San. ve TIC. LTD.STI =xxx TL; Oltan Boyer = xxx Euro; Oltan Trabzon xxx TL; Oltan Ordu = xxx TL.

Në vendin tonë, produktet e Ferreros janë të pranishëm nëpërmjet distributorëve vendas të Ferrero d.o.o⁶³, **Inter Trade & Distribution** shpk dhe **Kosmonte Foods Tirana** shpk. Ferrero d.o.o shet produktet tek distributorët dhe kamionët dërgohen drejtpërdrejt nga impiantet e prodhimit në Itali, Gjermani, Poloni në magazinat e distributorëve. Ferrero nuk ushtron veprimtari të tjera në Shqipëri, as në prokurimin e lëndës së parë dhe as nuk zotëron impiante përpunimi apo prodhimi. Manaxhimi apo investimet në lidhje me marketingun administrohen nga sektori i tregtisë dhe i marketingut në Kroaci.

Referuar veprimtarisë ekonomike të shoqërive pjesë e këtij transaksioni, tregjet, të cilat janë marrë parasysh në analizën e këtij përqendrimi janë: prokurimi dhe shitja e lajthive, tregu i produkteve të ëmbla me përmbajtje cokollate (ëmbëlsirave të cokollatës) dhe tregu i kremrave të ëmbël lehtësisht të përhapshëm/ cokokremi.

Përcaktimi i tregut përkatës së produktit në këtë rast mund të lihet dhe i hapur duke patur parasysh se asnjë prej shoqërive turke, mbi të cilat Ferrero International S.A do të përftojë kontrollin, nuk është prezente dhe nuk ushtrojnë aktivitet ekonomik në vendin tonë. Si pasojë transaksioni nuk sjell asnjë shqetësim për konkurrencën.

B. Tregu përkatës gjeografik:

Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, treg përkatës gjeografik është konsideruar Republika e Shqipërisë.

Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Sa i takon tregut të brendshëm, asnjë prej palëve në transaksion nuk është i pranishëm në **tregun e brendshëm të prokurimit apo shitjes së lajthive**. Oltan nuk është prezent në tregun shqiptar as në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu as Ferrero apo distributorët e tij në vendin tone - Inter Trade & Distribution dhe Kosmonte Foods Albania nuk importojnë apo shesin lajthi. Si rrjedhojë, ky transaksion nuk ka asnjë efekt sa i takon tregut të brendshëm të prokurimit /shitjes së lajthive duke mos sjellë mbivendosje horizontale të veprimtarisë së palëve apo shkaktuar tregje të prekura.

Si konkluzion, realizimi i këtij transaksioni nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në tregun e produktit sa i takon strukturës së tij, pozicionimit të shoqërive të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në të - pjesëve të tregut dhe fuqisë së tyre ekonomike në tregun e brendshëm. Si pasojë, ky transaksion nuk shfaq asnjë shqetësim për konkurrencën.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës

63 Shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë.

dominuuese dhe për këto arsye propozojmë t'i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqëndrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës":

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë nga shoqëria Ferrero International S.A të shoqërive të Oltan Group.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 331, datë 07.10.2014

Mbi

“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë CEZ SH.A nga shoqëria CEZ A.S. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|------------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| • Rezana KONOMI | Zv/Kryetar |
| • Servete GRUDA | Anëtar |
| • Koço BROKA | Anëtar |
| • Iva ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 07.10.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë CEZ SH.A nga shoqëria CEZ A.S. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të përqendrimit,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe Përqendrimi

Transaksioni i transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë CEZ SH.A (OSHEE SH.A) nga shoqëria CEZ A.S. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) realizohet nëpërmjet “Marrëveshjes për blerje aksionesh”, midis CEZ A.S (Shitësi) dhe Ministria Shqiptare e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë (Blerësi).

Objekti i kontratës është tërësia e aksioneve të zotëruara nga shoqëria CEZ A.S, që përbëjnë pjesën prej 76% të aksioneve të CEZ SH.A (OSHEE SH.A).

MZHETS përfiton me anë të kësaj kontrate 76% të aksioneve të shoqërisë OSHEE SH.A duke u bërë kështu zotëruesi i vetëm i 100% të aksioneve të kësaj shoqërie dhe duke e rikthyer atë në një shoqëri me kapital tërësisht shtetëror.

Ky transferim i aksioneve ishte i nevojshëm për shkak se zgjidhja me mirëkuptim, nga ku edhe nënshkrimi i marrëveshjes më datë 23 Qershor 2014, ka qenë një kërkesë e institucioneve ndërkombëtare financiare, me qëllim lëvrimin e fondeve të nevojshme për rimëkëmbjen e sektorit.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b dhe 10/2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, është përfitim i kontrollit të vetëm, për këtë arsye i nënshtrohet procesit të kontrollit të përqendrimeve..

II. Procedura e ndjekur

Autoriteti Konkurrencës është njohur për përqendrimin me objekt përfitim të kontrollit të vetëm dhe ekskluziv të shoqërisë OSHEE SH.A nëpërmjet transferimit të pjesës prej 76% të aksioneve të kapitalit aksionar nga CEZ A.S tek MZHETS, me anë të shkresës nr. 378 prot, më datë 15 Shtator 2014, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë.

Autoriteti i Konkurrencës, menjëherë i është përgjigjur Ministrisë me shkresën nr. 378/1 prot., datë 15 Shtator 2014, ku i ka kërkuar të plotësojë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit për Përqendrimet e Ndërmarrjeve.

Gjithashtu Sekretariati i ka kërkuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, bilancet e konsoliduara të shoqërive OSHEE SH.A , Shared Services Albania SH.A dhe CEZ Trade Albania Sh.p.k. për vitet 2011-2013, me shkresë nr. 378/2 prot., datë 24. 09.2014. Kjo kërkesë i është bërë edhe OSHEE SH.A me shkresë nr. 423 prot., datë 01.10.2014.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka depozituar me anë të shkresës nr. 378/3 prot., datë 03.10.2014, Fomularin e Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit dhe dokumentacionin përkatës.

Së fundmi, OSHEE ka depozituar pasqyrat financiare të audituara për vitin 2013 për shoqërinë CEZ SH.A , me anë të postës elektronike, ndërsa Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka sjellë dokumentacionin e kërkuar me shkresë nr. 378/4 prot., datë 06.10.2014. Të njëjtin dokumentacion ka sjellë edhe QKR me anë të shkresës nr. 378/5 prot., datë 06.10.2014.

Autoriteti i Konkurrencës, më datë 15 Shtator 2014, në faqen zyrtare ka publikuar njoftimin për shprehjen e interesit të palëve të treta. Nga palët e treta nuk ka patur asnjë koment mbi procedurën e kontrollit të përqendrimit MZHETS - CEZ A.S deri në momentin e dorëzimit të këtij raporti.

III. Palët në transaksion

a. Ministria Shqiptare e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), në cilësinë e palës **blerëse**, e cila vepron si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë, në këtë Marrëveshje do të jetë edhe zotëruese e 100% të aksioneve të shoqërisë OSHEE SH.A .

b. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE SH.A), në cilësinë e shoqërisë **target**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me numër regjistri K72410014H, me seli në adresën “Njësia Bashkiake nr. 5, Rr. Andon Zako Cajupi ”, pallati Conad , kati 3, Tiranë.

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj sipas kuadrit rregullator të ERE-s. Në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 4, datë 21 Janar 2013 “Për heqjen e liçencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A ” është vendosur: 1). Vënia në administrim të përkohshëm të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A sipas nenit 18, pika 4, gërma c), e Ligjit 9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar dhe 2). Gjatë periudhës së përkohshme të administrimit pezullohen të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e organeve të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A , si dhe të aksionerëve të saj ne funksion të detyrimeve të liçencës.

c. Shoqëria CEZ A.S, në cilësinë e **shitësit**, është një shoqëri aksionere, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit çek, me seli në Pragë 4, Duhova 2/1444, 14053, Çeki, e regjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Pragë, me numër dosje 1581 “CEZ A.S”. Objekti i shoqërisë është (i) prodhimi i energjisë; (ii) shpërndarja e energjisë; (iii) tregtimi i energjisë (iv) instalimi i instrumenteve matës, etj. Në Shqipëri shoqëria zotëronte, përveç shoqërisë CEZ SH.A , edhe shoqëritë Shared Services Albania SH.A dhe CEZ Trade Albania Sh.p.k.

IV. Xhiro e ndërmarrjeve

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar**⁶⁴ është XXX Lekë:
 - **CEZ Group** : XXXCZK⁶⁵ = XXX Lekë

- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**⁶⁶: është XXX Lekë:
 - **CEZ Shpërndarje (OSHEE)** : XXX Lekë
 - **CEZ Trade Albania sh.p.k.** : XXX Lekë
 - **Shared Services Albania SH.A .** : XXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin 12, pika 1 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndyshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

V. Tregu përkatës

Në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për përqendrimet dhe sipas veprimtarisë që kryejnë palët pjesëmarrëse në këtë transaksion, **tregu përkatës produkti** do të konsiderojmë:

- ❖ **shpërndarjen e energjisë elektrike nëpërmjet sistemit të shpërndarjes dhe;**
- ❖ **furnizimin/shitjen e energjisë elektrike tek konsumatori përfundimtar.**

Tregu përkatës gjeografik: Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm/territori** i Republikës së Shqipërisë.

Sistemi i shpërndarjes është i ndarë në 10 qendra rajonale shërbimi, të cilat shërbejnë për tensione me voltazh të ulët dhe të mesëm dhe 5 zona me tension me voltazh të lartë. Shumica e zonave janë të ndara në katër dhe pesë agjensi. Numri i agjensive shkon deri në 39.

Megjithëse palët pjesëmarrëse në përqëndrim ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel tregu të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, veçojmë që në tregun e brendshëm, vetëm OSSH është e pranishme, pra nuk kemi të bëjmë me tregje të prekura.

64 Burimi: www.xe.com 1CZK=5.09 lekë

65 Burimi: Raporti vjetor 2013 i CEZ Group, fq 64

66 Burimi: Pasqyrat Financiare të Audituar të CEZ Shpërndarje Sh.a., CEZ Trade Albania dhe Shared Service Albania viti 2013, fq 8

(i) Tregu i shpërndarjes së energjisë elektrike

"Shpërndarje" është transporti i energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke pasur parasysh shpërndarjen të konsumatori i fundit. "Shoqëri shpërndarjeje" është person i licencuar për të kryer shpërndarjen e energjisë elektrike në një zonë të caktuar. Në rastin tonë është OSHEE. OSHEE-ja zotëron, mirëmban, zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes në të gjithë Shqipërinë. Ajo është përgjegjëse për blerjen e energjisë elektrike për të mbuluar të gjitha humbjet në sistemin e shpërndarjes. Tarifat, termat dhe kushtet e shërbimeve të shpërndarjes, që sigurohen nga OSHEE-ja rregullohen nga ERE. OSHEE-ja është përgjegjëse për reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike në sistemin e shpërndarjes, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

Ajo kryen transportin e energjisë elektrike në rrjete shpërndarje të tensionit të mesëm dhe të ulët 35kv, 20kv, 10kv, 6kv dhe 0.4kv për lëvizim të klientët duke u bazuar në kërkesat e përdoruesve të lidhur me Sistemin e Shpërndarjes , si dhe në Planifikimin e Sistemit të Transmetimit të realizuar nga OST. OSHEE, Furnizuesi Publik me Pakicë dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit bashkëpunojnë për të plotësuar detyrimet e tyre lidhur me planifikimin e rrjeteve përkatëse dhe bazuar në vendime të marra së bashku, përballojnë së bashku kostot e studimeve të kërkuara për veprimet planifikuese.

(ii) Tregu i furnizimit / shitjes së energjisë elektrike tek konsumatori përfundimtar

OSHEE / Furnizuesi publik me pakicë furnizon / shet, mat dhe lexon matësat e konsumit të energjisë dhe i faturon konsumin e energjisë elektrike të klientët tariforë me tarifa të rregulluara sipas Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, miratuar nga ERE.

VI. Analiza e konkurrencës

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka ekskluzivitet menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike të tensioneve 35, 20, 10, 6 dhe 0,4 kV, si dhe menaxhimin e nën-stacioneve me tension 110 kV dhe më të ulët. OSHEE SH.A gjithashtu ka dhe ekskluzivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë në tregun e energjisë elektrike për konsumatorët tariforë.

Përqëndrimi i njoftuar shprehet në formën e rikthimit të një monopoli publik nga një shoqëri private, e cila zotëronte kontrollin e operatorit të sistemit të shpërndarjes pasi kishte 76 % të aksioneve.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 111, datë 15.05.2009 "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 76% të aksioneve të OSSH SH.A nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës tek shoqëria CEZ A.S" ka autorizuar transferimin e 76% të aksioneve të kompanisë që zotëronte pozicion monopol në tregun e furnizimit dhe të shitjes me pakicë së energjisë elektrike tek konsumatori përfundimtar. .

Në këtë vendim, Komisioni I Konkurrencës u shpreh për rolin e Entit Rregullator të Energjisë lidhur me dy aspekte si mbrojtja e konsumatorit dhe rregullimi i tregut. Komisioni i Konkurrencës ka rekomanduar rregullimin dhe monitorimin si instrumenta për zhvillimin e një tregu eficient të energjisë elektrike dhe mbrojtjen e konsumatorit nga fuqia e tregut që zotëronte ky monopol.

Në vitet e para pas privatizimit, 2010 dhe 2011, OSSH, si rezultat i uljes së nivelit të humbjeve teknike dhe jo teknike, pati një përmirësim të situatës dhe performancës financiare. Por, që nga viti 2012 e në vijim, treguesit financiarë u përkeqësuan ndjeshëm dhe humbjet arritën në 37 miliardë e 917 milionë lekë (rreth 370 milionë dollarë) ndërkohë që treguesi i humbjeve arriti në 46 %. Kjo performancë financiare ndikoi ndjeshëm në uljen e aftësisë paguese të kompanisë CEZ SH.A , për të blerë energji elektrike

Në kushtet e përkeqësimit të performancës së kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike, më 21 Janar 2013, ERE mori vendimin për heqjen e liçensës kompanisë CEZ Shpërndarje në aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizuesit publik me pakicë. Kompania CEZ Shpërndarje u vendos në administrim të përkohshëm, status ky në të cilën kompania vazhdon të qëndrojë edhe sot.

Problematika financiare e operatorit të sistemit të shpërndarjes ka patur efekt në gjithë tregun e energjisë dhe ekonominë në tërësi, për shkak të rolit të energjisë në industri, tregti dhe shërbime dhe në mirëqënien konsumatore.

Ndërmarrja target e këtij transaksioni objekt shqyrtimi, ka një efekt të rëndësishëm në treg, i cili lidhet me fuqinë e tregut që ndërmarrja zotëron, si dhe me llojin e të mirës së ofruar, që është një produkt jetik për ekonominë e vendit dhe konsumatorin shqiptar.

Në këto kushte, përcaktimi i saktë i marrëdhënieve financiare të kësaj kompanie, pritet të ketë efekte si në sjelljen e saj, ashtu dhe në mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë sektor.

Për sa më sipër, monitorimi i rregullimit dhe i sjelljes së ndërmarrjes në treg, nga Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim të ngushtë me ERE-, me synimin rritjen e efijences së këtij tregu është i domosdoshëm.

Nga pikpamja e strukturës së tregut ky përqëndrim nuk e ndryshon pozicionin monopol të ndërmarrjes në treg sipas parashikimeve të nenit 56 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” në nenin 3, pika 1, përcakton të njëjtin trajtim për ndërmarrjet për çdo person fizik ose juridik, privat ose publik.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, nenit 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë CEZ SH.A nga shoqëria CEZ A.S. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

nr.332 , datë 09.10.2014

Për miratimin e udhëzimit

“Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominues”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.10.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e Udhëzimit “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese”

Baza ligjore: Neni 8,9 dhe 24, shkronja d), dh) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Projekt Udhëzimit ‘Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese’;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

V Ë R E N S E:

1. Sekretari i Përgjithshëm ka paraqitur për miratim në Komision Projekt Udhëzimin “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese” në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).
2. Udhëzimi “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese” është i përshtatur me legjislacionin europian në fushën e konkurrencës dhe në mënyrë specifike nenin 82 të Traktatit të BE-së për sjelljet

abuzive nga ndërmarrjet me pozitë dominuese
(52009XC0224(01);(2009/C45/02)(OJ C 45,24.02.2009,p.7-20).

3. Ky udhëzim do t'i shërbejë Autoritetit të Konkurrencës dhe palëve të interesuara për një interpretim sa më të gjerë të nenit 8 (pozita dominuese) të Ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar, dhe nenit 9 (abuzimi me pozitën dominuese).

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës

V E N D O S I:

1. Të miratojë Udhëzimin 'Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese' sipas tekstit të bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA (_____)	Koço BROKA (_____)	Iva ZAJMI (_____)	Rezana KONOMI (_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R

Udhëzim

“Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të Ligjit 9121 datë 23.07.2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’”⁶⁷

I. Qëllimi i udhëzimit

Qëllimi i këtij udhëzimi është pasqyrimi i parimeve të përgjithshme mbi të cilat Autoriteti i Konkurrencës (këtu e më poshtë Autoriteti) mbështetet për vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese të një ose disa ndërmarrjeve në treg.

II. Fuqia e tregut

- 1) Në zbatim të ligjit, Autoriteti kryen vlerësimin e pozitës dominuese të një ndërmarrje dhe fuqisë së tregut që ajo zotëron. Sipas ligjit zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë, qëllimi i të cilës duhet marrë në konsideratë rast pas rasti.
- 2) Pozita dominuese është përcaktuar në ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) si një pozicion i fuqisë ekonomike që zotëron një ndërmarrje, e cila bën të mundur pengimin e konkurrencës efektive në tregun përkatës, duke i dhënë asaj fuqinë që të silllet në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët e saj dhe konsumatorët përfundimtar. Nocioni i pavarësisë është i lidhur me shkallën e kufizimeve të konkurrencës të shfaqura nga ndërmarrja në fjalë. Pozita dominuese bën që kufizimet konkurruese të mos jenë mjaftueshmërisht efektive dhe prandaj ndërmarrja në fjalë gëzon fuqi të konsiderueshme tregu gjatë një periudhe kohe. Kjo do të thotë që vendimet e ndërmarrjes nuk ndikohen nga veprimet dhe kundërveprimet e konkurrentëve, klientëve dhe konsumatorëve përfundimtar. Në përgjithësi pozita dominuese rrjedh nga kombinimi i disa faktorëve të cilët nëse analizohen veç e veç nuk janë domosdoshmërisht përcaktues për një pozicion të tillë.
- 3) Konsiderohet si ndërmarrje me pozitë dominuese një ndërmarrje, e cila ka mundësi të përfitojë nga rritja e çmimeve mbi nivelin konkurrues.. Me “rritje çmimesh” kuptohet fuqia për të mbajtur çmimet mbi nivelin konkurrues. Kjo përdoret si një strategji në të cilën treguesit e konkurrencës – të tillë si çmimet, produktet, rritë, shumëllojshmëria ose cilësia e mallrave dhe shërbimeve – mund të ndikojnë në përfitimin e ndërmarrjes me pozitë dominuese dhe dëmin e konsumatorëve.
- 4) Për vlerësimin e pozitës dominuese merren në konsideratë struktura e tregut, dhe në veçanti faktorët e mëposhtëm:

⁶⁷52009XC0224(01); Udhëzim mbi prioritetet zbatuese të Komisionit në zbatimin e nenit 82 të Traktatit të BE-së për sjelljet abuzive nga ndërmarrjet dominuese (2009/C 45/02) (OJ C 45, 24.2.2009, p. 7–20)

- kufizimet e vendosura nga furnizuesit ekzistues dhe pozita në treg e konkurrentëve aktual (pozita në treg e ndërmarrjeve me pozitë dominuese dhe konkurrentëve të saj)
- kufizimet e vendosura nga kërcënimet e zgjerimit në të ardhmen, të konkurrentëve aktual ose hyrja e mundshme e konkurrentëve potencial (zgjerimi dhe hyrja);
- kufizimet e vendosura për klientët e ndërmarrjes (kundërveprimi i fuqisë blerëse).

III . Pozicioni në treg i ndërmarrjeve me pozitë dominuese dhe konkurrentëve

- 1) Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm për Autoritetin, në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues.
- 2) Autoriteti në përgjithësi i konsideron pjesët e vogla të tregut si një tregues i mirë për mungesën e fuqisë së rëndësishme të tregut. Eksperienca e vendeve të Komitetit Evropian tregon se pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës e ndërmarrjes është më e vogël se 40%. Sidoqoftë, ka shumë raste specifike poshtë këtij pragu ku konkurrentët nuk janë në një pozicion të tillë që të kufizojnë sjelljen e një ndërmarrjeje me pozitë dominuese, për shembull kur ata përballen me kufizime të rëndësishme kapacitetesh. Të tilla raste duhet të vlerësohen nga ana e Autoritetit.
- 3) Eksperienca tregon se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha në të cilën ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozitë dominuese dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit. Por si rregull i përgjithshëm, Autoriteti nuk del me një konkluzion përfundimtar pa analizuar të gjithë faktorët e rëndësishëm, të cilët mund të kufizojnë sjelljen e një ndërmarrjeje.

IV . Zgjerimi ose hyrja

- 1) Konkurrenca është një proces dinamik dhe një vlerësim i kufizimeve të konkurrencës së një ndërmarrjeje nuk mund të bazohet vetëm në situatën aktuale të tregut. Ndikimi i mundshëm i zgjerimit të konkurrentëve aktual ose hyrja e konkurrentëve potencial, përfshirë këtu edhe riskun e zgjerimit dhe hyrjes së konkurrentëve të rinj, është gjithashtu i mundshëm. Një ndërmarrje mund të kufizohet nga rritja e çmimeve në qoftë se zgjerimi dhe hyrja është e mundshme. Zgjerimin ose hyrja e mundshme të një konkurrenti në treg, duhet të jetë mjaftueshmërisht fitim-prurëse për konkurrentin ose hyrësin në mënyrë që Autoriteti të marrë në konsideratë, faktorë të tillë si barrierat e zgjerimit ose hyrjes, reagimet e mundshme të ndërmarrjes që pretendon

të jetë me pozitë dominuese dhe konkurrentëve të tjerë, si dhe riskun dhe kostot e falimentimit.

2) Barrierat e zgjerimit ose hyrjes mund të marrin forma të ndryshme. Ato mund të jenë barriera të ligjshme, si tarifat dhe kuotat, ose mund të marrim formën e avantazheve të zotëruara nga ndërmarrja me pozitë dominuese të tilla si: ekonomitë e shkallës dhe qëllimi, pasja e aksesit të privilegjuar në inputet kryesore ose burimet natyrore, teknologji të rëndësishme, ose rrjete ekzistuese të shpërndarjes dhe të shitjes. Barrierat mund të përfshijnë kosto dhe pengesa të tjera, p.sh kostot me të cilat përballen klientët kur ndërrojnë ofertues. Sjellja e ndërmarrjeve me pozitë dominuese mund të krijojë barriera në hyrje në rastet kur:

- janë bërë investime të rëndësishme me të cilat hyrësit dhe konkurrentët duhet të përshtaten;
- ndërmarrja me pozitë dominuese ka kontrata afatgjata me klientët me efekte përjashtuese.

Pjesët e mëdha të tregut shërbejnë si tregues për ekzistencën e barrierave të hyrjes dhe zgjerimit.

V . Fuqia kundërvepruese e blerësit

1) Kufizimet e konkurrencës mund të ushtrohen jo vetëm nga konkurrentet potencial apo aktual por edhe nga klientët. Madje një ndërmarrje me pjesë të madhe tregu nuk mund të veprojë e pavarur nga klientët që zotërojnë fuqi të mjaftueshme për marrëveshjet. Një fuqi e tillë kundërvepruese,blerëse mund të vijë si rezultat:

- i numrit të klientëve ose rëndësisë së tyre tregtare për ndërmarrjen me pozitë dominuese;
- i aftësisë së tyre për të kaluar drejt furnizuesve të tjerë konkurrent për promovimin e hyrjeve të reja ose të integruara vertikalisht, duke paraqitur risk me një sjellje të tillë.

Në qoftë se fuqia kundërvepruese është e mjaftueshme, ajo mund të ndalojë ose të anulojë çdo përpjekje të ndërmarrjes me pozitë dominuese, për të përfituar nga rritja e çmimeve. Sidoqoftë fuqia blerëse mund të mos konsiderohet një kufizim efektiv në raste kur një segment i veçantë ose i kufizuar klientësh është i mbrojtur nga fuqia e tregut të ndërmarrjes me pozitë dominuese.

VI . Përjashtimi që i sjell dëm konsumatorit (përjashtimet anti-konkurruese)

1. Qëllimi i forcimit të aktivitetit të Autoritetit në lidhje me sjelljen përjashtuese është të sigurojë që ndërmarrja me pozitë dominuese të mos dëmtojë konkurrencën efektive duke përjashtuar rivalet e tyre në mënyrë anti konkurruese dhe kështu duke pasur një ndikim të kundërt në mirëqenien konsumatore, gjë që mund të realizohet nëpërmjet rritjes së çmimeve, kufizimeve të cilësisë dhe kufizimeve të zgjedhjes konsumatore. Me "përjashtim anti-konkurruese" do të kuptojmë një situatë kur hyrja efektive e konkurrentëve aktuale ose potencial të

ofertuesve ose tregjeve është penguar ose eliminuar si rezultat i sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese, nëpërmjet të cilës kjo ndërmarrje është në një pozicion përfitues nga rritja e çmimeve në dëm të konsumatorëve. Identifikimi i konsumatorëve të dëmtuar mund të mbështetet në cilësinë dhe kur është e mundur dhe e përshtatshme dhe në evidenca sasiore.

2. Autoriteti, bazuar në nenin 9, ndërhyr kur mbi bazën e evidencave të forta dhe bindëse, sjellja e supozuar abuzuese është e pritshme të çojë në përjashtime anti-konkurruese. Autoriteti merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:
 - i. Pozicioni i ndërmarrjes me pozitë dominuese. Në përgjithësi, sa më e fortë të jetë pozita dominuese aq më e madhe është mundësia që sjellja që mbron këtë pozicion të çojë në përjashtime anti-konkurrues
 - ii. Kushtet e tregut përkatës. Këtu përfshihen kushtet e hyrjes dhe zgjerimit, si ekzistenca e ekonomisë së shkallës dhe/ose qëllimit dhe efektet e rrjetit. Ekonomi e shkallës do të thotë që konkurrentët kanë më pak mundësi të hyjnë ose të qëndrojnë në treg, në se ndërmarrja me pozitë dominuese përjashton pjesë domethënëse të tregut përkatës. Në mënyrë të ngjashme kjo sjellje lejon që ndërmarrjet me pozitë dominuese të “piketojnë” një treg të karakterizuar nga efektet e rrjetit në favor të tij ose për më tepër të “ruajë” pozicionin e saj në këtë treg. Gjithashtu, n.q.s barrierat e hyrjes në tregun e rrjedhën e sipërme dhe/ose në tregun e rrjedhës së poshtme janë domethënëse atëherë kjo mund të jetë e kushtueshme për konkurrentët që të kapërcejnë përjashtimet e mundshme nëpërmjet integritimit vertikal.
 - iii. Pozicioni i konkurrentëve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese. Kjo përfshin rëndësinë që kanë konkurrentët për mbajtjen e konkurrencës efektive. Një rival specifik mund të luajë një rol të rëndësishëm konkurrues edhe kur ka një pjesë të vogël tregu krahasuar me konkurrentët e tjerë; p.sh mund të jetë konkurrenti më i afërt i një ndërmarrjeje me pozitë dominuese, të jetë konkurrent novator ose të ketë reputacionin e konkurrentit që bën ulje çmimi sistematike.
 - iv. Pozicioni i klientëve ose inputi i ofertuesit. Ndërmarrja me pozitë dominuese mund të zbatohet praktika të veçanta vetëm për klientët ose furnitorët e zgjedhur, të cilët mund të jenë të një rëndësie të veçantë për hyrjen ose zgjerimin e konkurrentëve, gjë e cila rrit mundësinë e përjashtimeve anti-konkurruese. Ata për shembull mund të jenë një nga ofertuesit që i përgjigjet ofertës së furnitorit alternativ dhe mund të përfaqësojnë mënyra të veçanta të shpërndarjes së produktit që mund të jenë të përshtatshme për hyrësit e rinj. Ata mund të jenë pozicionuar në zona gjeografike të përshtatura mirë me hyrjet e reja ose mund të influencojnë sjelljen e klientëve të tjerë. Për ofertuesit e inputit, me të cilët ndërmarrja me pozitë dominuese ka përfunduar një marrëveshje ekskluzive oferte, mund të jetë një nga rastet më të mundshme që i përgjigjet

kërkesave të klientëve (të cilët mund të jenë konkurrentë të ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun e rrjedhës së poshtme dhe/ose mund të prodhojnë një kategori të produktit – ose të prodhojnë në një zonë të caktuar gjeografike – veçanërisht e përshtatshëm për hyrësit e rinj). Autoriteti vlerëson çdo strategji të zgjedhur të klientëve ose ofertuesve të inputit, e cila ndihmon në sjelljen e ndërmarrjes me pozitë dominuese.

- v. Evidencat e mundshme të përjashtimit aktual. Nëse sjellja ka vazhduar për një periudhë kohe, performanca e ndërmarrjes me pozitë dominuese dhe konkurrentëve të saj në treg, mund të sigurojë evidenca direkt rreth përjashtimeve anti-konkurrese. Për arsye të veçanta të sjelljes të supozuar abuzive, pjesa e tregut e ndërmarrjes me pozitë dominuese mund të rritet ose të ulet. Për arsye të ngjashme konkurrentët aktual mund të kenë qenë të kufizuar ose të përjashtuar, ose konkurrentët potencial mund të jenë përpjekur të hyjnë në treg dhe kanë dështuar.
- vi. Të dhëna direkte për një strategji përjashtuese. Kjo përfshin dokumentet e brendshëm të cilët përmbajnë të dhëna direkte të strategjisë për të përjashtuar konsumatorët, të tillë si një plan i detajuar për të përjashtuar një rival, të parandalojnë hyrjet, ose të dhëna për rreziqet konkrete të veprimeve përjashtuese. Të tilla të dhëna direkte mund të jenë të dobishme për të interpretuar sjelljen dominuese të ndërmarrjes.
- vii. Në një rast konkret hetimi, Autoriteti, si rregull kryen analizat e faktorëve të mësipërm së bashku me faktorë më specifik që përshkruhen më poshtë në pikat që lidhen me sjelljen përjashtuese dhe faktorë të tjerë të cilët konsiderohen të përshtatshëm. Ky vlerësim do të bëhet nga krahasimi i situatës aktuale ose të ardhshme në tregun përkatës.

3. Ka rrethana ku mund të mos jetë e nevojshme për Autoritetin, të ndërmarrë një vlerësim të detajuar përpara se të arrijë në përfundimin që sjellja në këtë rast është në dëm të konsumatorit. Në rast se sjellja rrit pengesat për konkurrencën dhe nuk krijon efikasitet, atëherë mund të themi se janë shfaqur efekte anti-konkurrese. P.sh nëse ndërmarrja me pozitë dominuese pengon klientët e saj të provojnë produktet e konkurrentëve; siguron shtysa financiare për klientët, me kusht që ata të mos provojnë produkte të konkurrentëve; ose paguan një shpërndarës ose klient që të pengojë futjen në treg të produkteve të rivalëve të saj.

VII . Sjellja përjashtuese bazuar në çmim

1. Përkufizimet në vijim zbatohen në sjelljen përjashtuese të bazuar në çmim. Çmimi i vendosur në kushte konkurrenciale është zakonisht i dobishëm për konsumatorin. Për të parandaluar përjashtimet anti-konkurrese, Autoriteti do të ndërhyjë normalisht vetëm kur sjellja është ose ka aftësitë që të pengojë konkurrencën nga konkurrentët që janë konsideruar po aq eficient sa një ndërmarrje me pozitë dominuese.

2. Megjithatë, Autoriteti vlerëson që në rrethana të caktuara, një konkurrent më pak eficient mund të sjell një kufizim i cili duhet të merret në konsideratë në rastet kur një sjellje e veçantë e bazuar në çmim, çon në një përjashtim anti-konkures. Autoriteti merr në konsideratë faktin se në mungesë të një praktike abuzive, ky konkurrent mund të përfitojë nga avantazhet që rrjedhin nga kërkesa të tilla si rrjeti, të cilat rrisin eficientësinë.
3. Për të përcaktuar nëse një konkurrent hipotetik(i cili është po aq eficient sa edhe ndërmarrja me pozitë dominuese) mundet të përjashtohet nga sjellja në fjalë, Autoriteti shqyrton të dhënat ekonomike lidhur me koston dhe çmimet e shitjes dhe në veçanti nëse ndërmarrja me pozitë dominuese është e nxitur të vendos kosto më të ulët se çmimi. Kjo kërkon të dhëna të sakta dhe të plota. Kur këto të dhëna janë të disponueshme, Autoriteti përdorë informacionin për koston e ndërmarrjes me pozitë dominuese. Nëse informacioni i besueshëm për këto kosto nuk është i disponueshëm, Autoriteti mund të vendosë të përdorë të dhënat e kostove të konkurrentëve ose të dhëna të tjera të krahasueshme.
4. Kostot më të mira që Autoriteti mund të përdorë janë kostot mesatare të shmangshme (AAC-pjesë e kostove të cilat mund të shmangen kur reduktohet prodhimi) dhe kosto marxhinale afatgjatë (LRAIC)⁶⁸. Dështimi për të mbuluar AAC bën që ndërmarrja me pozitë dominuese, të sakrifikojë fitimet në një periudhë afatshkurtër dhe në këto kushte asnjë konkurrent eficient nuk do të mund t'iu shërbente klientëve të caktuar pa pasur humbje. LRAIC përdoret më shpesh se AAC sepse ndryshe nga kjo e fundit (që përfshin vetëm koston fikse nëse analizohet periudha nën hetim), ajo përfshin koston fikse specifike të produktit, marrë para periudhës në të cilën marrëveshja e supozuar abuzive ka ndodhur. Dështimi për të mbuluar LRAIC bën që ndërmarrja me pozitë dominuese të mos rikuperojë të gjitha koston fikse në prodhimin e produkteve dhe shërbimeve dhe kjo tregon se një konkurrent eficient mund të përjashtohet nga tregu.⁶⁹
5. Nëse të dhënat sugjerojnë qartësisht se një konkurrent eficient, mund të konkurrojë në mënyrë efektive me ndërmarrjen me pozitë dominuese

68 Kostoja mesatare e shmangshme, është mesatarja e kostove që mundet të shmangen nëse kompania nuk do të prodhojë një sasi të dallueshme (extra) outputit, sasi e cila supozohet si subjekt i sjelljes abuzive. Në shumë raste, AAC dhe koston mesatare të ndryshueshme (AVC) mund të jenë e njëjta gjë, dhe në këtë rast janë vetëm koston e ndryshueshme ato që mund të shmangen. Kostoja mesatare marxhinale afatgjatë është mesatarja e të gjitha kostove variabël dhe fikse që një kompanie i duhen për të prodhuar një produkt të caktuar. LRAIC dhe kostoja mesatare totale (ATC) janë zëvendësues të mirë për njëri tjetrin dhe janë të njëjta për ndërmarrjet që prodhojnë vetëm një produkt. Në se ndërmarrjet e produkteve të shumëfishitë kanë ekonomi qëllimi, LRAIC mund të jetë poshtë ATC për çdo produkt individual kështu që koston e zakonshme nuk llogariten në LRAIC. Në rastin e produkteve të shumëfishita çdo kosto që mundet të shmangen për të mos prodhuar një produkt të veçantë ose një linjë, nuk konsiderohen si kosto të zakonshme. Në situatat kur kostoja e përbashkët është domethënëse, ato mund të grumbullohen në një llogari kur vlerësohen si mundësi për të përjashtuar konkurrentët eficientë.

69 Në mënyrë që të aplikohet këto kosto të krahasueshme është gjithashtu e nevojshme të shihen të ardhurat dhe koston e kompanisë dominuese dhe konkurrentëve në një kontekst më të gjerë. Mundet që të mos jetë e mjaftueshme vetëm për të vlerësuar çmimin ose të ardhurat në një kohë që ato mbulojnë koston, por mund të jetë e nevojshme për të parë të ardhurat shtesë në një rast e sjelljes së një kompanie dominuese duke sjellë efekte negative në të ardhurat e tregjeve të tjerë apo produkteve të tjerë. Në mënyrë të ngjashme, në rastin e tregjeve me dy anë mund të jetë e nevojshme që të shihen në të njëjtën kohë si të ardhurat dhe koston e të dy anëve të tregut

çmim-udhëheqëse, Autoriteti në parim arrin në konkluzionin se ndërmarrja çmim-udhëheqëse nuk ka një ndikim të kundërt në konkurrencën efektive (të përjashtojë konkurrentët eficientë) dhe mbi konsumatorët. Në një situatë të tillë Autoriteti mund të mos ndërhyjë.

Nëse, në të kundërt, të dhënat sugjerojnë se çmimi i vendosur, nga ndërmarrja me pozitë dominuese, ka mundësinë që të përjashtojë konkurrentët eficientë, atëherë Autoriteti mund ta përfshijë këtë në një vlerësim të përgjithshëm për përjashtim anti-konkurrues (shih seksion B më sipër), duke marrë parasysh edhe evidencat sasiore dhe/ose cilësore.

VIII . Domosdoshmëria e objektivitetit dhe e eficientës

1. Në zbatim të nenit 9, Autoriteti gjithashtu analizon pretendimet kundrejt një ndërmarrjeje me pozitë dominuese sjellja e të cilës është e justifikuar. Një ndërmarrjeje me pozitë dominuese mundet të tregojë se sjellja e saj është objektivisht e nevojshme ose të tregojë se nga sjellja e saj vijnë efekte të rëndësishme, të cilat tejkalojnë çdo efekt anti-konkurrues mbi konsumatorët. Në këtë kontekst, Autoriteti vlerëson nëse sjellja në fjalë është e domosdoshme dhe në përputhje me qëllimin e ndërmarrjes me pozitë dominuese.
2. Çështja nëse sjellja është objektivisht e nevojshme dhe propocionale, mund të përcaktohet në bazë të faktorëve të jashtëm. Sjellja përjashtuese për shembull, mund të konsiderohet objektivisht e nevojshme për arsyet e mirëfunksionimit dhe sigurisë lidhur me natyrën e produktit në fjalë. Megjithatë, nëse një sjellje e tillë është e nevojshme, duhet të merret parasysh që është detyrë e autoriteteve publike për të vendosur dhe forcuar standardet e sigurisë dhe shëndetit publik. Nuk është detyrë e ndërmarrjes me pozitë dominuese që të ndërmarrë hapa për të përjashtuar produktet, qofshin këta të drejtë ose të gabuar, të rrezikshëm ose inferior në krahasim me produktin e saj.
3. Një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të justifikojë një sjellje e cila çon në përjashtimin e konkurrentëve mbi bazën e eficientëve, duke garantuar se nuk do të shkaktohet dëm mbi konsumatorin. Në këtë kontekst, ndërmarrja me pozitë dominuese në përgjithësi pritet që të tregojë, me probabilitet të lartë dhe bazuar në evidenca të verifikueshme, që kushtet kumulative përmbushen.

IX . Eficientat ekzistojnë ose mund të realizohen si rezultat i sjelljes. Kjo mundet, për shembull, të përfshijë përmirësimet teknike në cilësinë e produkteve, ose reduktim në koston e prodhimit ose të shpërndarjes.

Sjellja është e domosdoshme për realizimin e këtyre eficientëve.

- i. Eficientat duhet që të tejkalojnë çdo efekt të mundshëm negativ në konkurrencë dhe në mirëqenien e konsumatorëve në tregjet e dëmtuara.
- ii. Sjellja nuk eliminon konkurrencën efektive nga mënjanimi i të gjithë ose shumicës së burimeve ekzistuese të konkurrentëve aktualë ose potenciale.
- iii. Rivaliteti ndërmjet firmave është një drejtues thelbësor për eficientën ekonomike, përfshi eficientat dinamike në formën e novacionit/risive. Në këtë mungesë ndërmarrja me pozitë dominuese nuk ka shtysa që të

- vazhdojë të krijojë në të ardhmen përfitime në efikasitet. Kur nuk ka më konkurrencë dhe pritshmëri për hyrje të reja, mbrojtja e rivalitetit dhe procesi i konkurrencës është më i madh se mundësitë e përfitimeve nga novacionet.
- iv. Në këndvështrimin e Autoritetit, sjellja përjashtuese e cila mban, krijon dhe fuqizon një pozicion në treg duke sjellë si pasojë një monopol, normalisht nuk mund të justifikohet pavarësisht se mund të krijohen përfitime në efikasitet.
4. Është e rëndësishme për një ndërmarrje me pozitë dominuese të sigurojë të gjitha faktet e nevojshme për të treguar që sjellja e saj është objektivist e justifikuar. Autoriteti duhet të bëjë një vlerësim përfundimtar nëse sjellja e analizuar nuk është e nevojshme dhe nuk mund të sjellë dëm për konsumatorin nëse është e bazuar në efektet anti-konkurrese të shfaqura ndaj çdo efikasiteti të avancuar dhe domethënëse.

X . Format specifike të abuzimit

A. Marrëveshjet ekskluzive

Një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të përpiqet të përjashtojë konkurrentët duke i penguar ata nga shitja duke përdorur detyrimet e blerjeve ekskluzive ose skontot, që mund të cilësohen si marrëveshje ekskluzive⁷⁰. Ky seksion nxjerr në pah argumentet që mund të përdoren për një ndërhyrje të shpejtë nga ana e Autoritetit, kur ekziston një marrëveshje ekskluzive nga një ndërmarrjeje me pozitë dominuese.

1. Blerjet Ekskluzive

- i. Një detyrim për një blerje ekskluzive i kërkon klientit në një treg të veçantë që të blejë vetëm nga ndërmarrja me pozitë dominuese.
- ii. Blerja ekskluzive mund të kërkojë që ndërmarrja me pozitë dominuese të kompensojë blerësit tërësisht ose pjesërisht, për humbjet në konkurrencë si rezultat i ekskluzivitetit. Është në interesin personal të klientit që të hyjë në një detyrim të blerjes ekskluzive me ndërmarrjen dominuese, në rastet kur janë dhënë disa kompensime. Por mund të jetë e gabuar të arrihet në përfundime në mënyrë automatike se të gjitha detyrimet ekskluzive të marra së bashku janë të dobishme për klientët, përfshi këtu edhe ato që aktualisht nuk blihen nga ndërmarrja me pozitë dominuese dhe konsumatori përfundimtar. Autoriteti do të fokusohet në ato çështje ku duket qartë se konsumatorët nuk kanë përfitime. Kjo veçanërisht në rastin kur ka shumë blerës dhe detyrimet për blerje ekskluzive të

⁷⁰ Nocioni i marrëveshjeve ekskluzive gjithashtu përfshin detyrimeve e ofertës ose shtysat me të njëjtin efekt, ku ndërmarrja me pozitë dominuese mundohet që të përjashtojë konkurrentët nga blerjet që ata kanë me ofertuesit. Autoriteti gjykon që përjashtimi i inputeve është në parim i bazuar në rezultatet e përjashtimit anti-konkurrese nëse detyrimi i ofertës ekskluzive ose shtysa lidhin shumicën e ofertuesve eficientë dhe konsumatorëve që konkurrojnë me ndërmarrjen me pozitë dominuese që nuk mund të gjejnë burimeve alternative eficientë në ofertën e inputeve.

ndërmarrjes me pozitë dominuese, të marra bashkë, kanë efekt në parandalimin e hyrjes ose zgjerimit të ndërmarrjeve konkurrense.

- iii. Në vijim të faktorëve të përmendur në pikën 10, faktorët në vazhdim kanë një rëndësi të veçantë nëse Autoriteti do të ndërhyjë ndaj marrëveshjeve të blerjeve ekskluzive.
- iv. Kapaciteti për detyrimet e blerjeve ekskluzive, si rezultat i përjashtimit anti-konkurrues shfaqet veçanërisht atëherë kur, në mungesë të detyrimeve, një kufizim i rëndësishëm i konkurrencës është ushtruar nga konkurrentët të cilët ose nuk janë të pranishëm në treg kur përmbushen detyrimet ose nuk janë në gjendje për të konkurruar për të gjithë ofertën e klientëve. Konkurrentët mbase nuk janë në gjendje të konkurrojnë për të gjithë kërkesën individuale të klientit sepse ndërmarrja dominuese është një partner tregtar i pashmangshëm, të paktën për një pjesë të kërkesës në treg (për shembull sepse marka e tij preferohet nga shumica e konsumatorëve përfundimtar ose sepse kufizimet e kapacitetit për ofertuesit e tjerë janë të tilla që një pjesë e kërkesës mund të sigurohet vetëm nga ofertuesi me pozitë dominuese). Nëse konkurrentët mund të konkurrojnë në terma të njëjtë për kërkesën totale të çdo klienti, detyrimet për blerjet ekskluzive janë përgjithësisht të pamundura për të dëmtuar konkurrencën efektive, pavarësisht se ndryshimi i ofertuesve nga klientët është i vështirë për shkak të kohëzgjatjes së detyrimeve të blerjeve ekskluzive.
- v. Në përgjithësi, sa më e gjatë të jetë kohëzgjatja e detyrimit, aq më i madh është efekti i përjashtimit. Megjithatë, nëse ndërmarrja me pozitë dominuese është një partner tregtar i pashmangshëm për të gjithë ose pjesën dërrmuese të klientëve, edhe një detyrim për blerje ekskluzive për një kohë të shkurtër, mund të çojë në një përjashtim anti-konkurrues.

2. Uljet/Skontot e kushtëzuara

- i. Uljet e kushtëzuara janë ulje që i jepen klientëve për ti shpërblyer ata për forma të veçanta të sjelljes blerëse. Kusht i përgjithshëm për ulje, është ai kur klienti e përfiton këtë nëse blerjet gjatë një periudhe të caktuar kohe tejkalojnë një prag të caktuar xhiroje. Ulja garantohet ose mbi të gjithë blerjen (ulje retroaktive) ose vetëm në atë pjesë të blerjes që është mbi kufirin e caktuar (ulje rritëse). Uljet e kushtëzuara janë një praktikë e zakonshme. Ndërmarrjet mund të ofrojnë ulje të tilla në mënyrë që të tërheqin më shumë kërkesë, dhe disa prej tyre mund të stimulojnë kërkesën dhe përfitimet për konsumatorët. Megjithatë, ulje të tilla kur ofrohen nga një ndërmarrje me pozitë dominuese mundet të kenë efekte përjashtimore aktuale ose potenciale të ngjashme me detyrimet e blerjeve ekskluzive. Uljet e kushtëzuara mund të kenë efekte të tilla pa qenë nevoja që një ndërmarrje dominuese të sakrifikojë .
- ii. Përveç faktorëve të paraqitur në paragrafin 10, faktorët në vijim kanë një rëndësi të veçantë për Autoritetin për përcaktimin nëse një sistem i dhënë i uljeve të kushtëzuara është përgjegjës për një përjashtim anti-konkurrues dhe si pasojë shqyrtohet nga Autoritetit.

- iii. Mundësia për një përjashtim anti-konkurrues është më e madhe nëse konkurrentët nuk janë në gjendje që të konkurrojnë në terma të njëjtë të kërkesës për çdo klientë individual. Një ulje e kushtëzuar e dhënë nga një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të përdoret si pjesë e kërkesës për çdo klient (d.m.th sasi që gjithsesi mund të blihet nga klienti nga ndërmarrja me pozitë dominuese) dhe si mekanizëm për të ulur çmimin që do të paguhet për pjesën e “diskutuar” të kërkesës (d.m.th sasi që çdo klient mund të preferojë dhe që mundet të gjejë zëvendësues).
- iv. Uljet retroaktive (zbritëse) mund të sjellin përjashtime të konsiderueshme në treg, duke e bërë atë më pak tërheqëse për klientët për të këmbyer sasi të vogla të kërkesës me një ofertues alternativ. Efekti potencial përjashtues i uljeve zbritëse (retroaktive) është më i fortë në njësinë e fundit të blerjes para se pragu i xhiros të kalohet. Megjithatë ajo që merret në konsideratë nga Autoriteti për vlerësimin e efektit të uljes nuk është vetëm efekti në konkurrencë për të siguruar njësinë e fundit, por edhe efekti përjashtues i sistemit të uljeve (aktual dhe potencial) ndaj konkurrentëve të ofertuesit me pozitë dominuese. Sa më e lartë të jetë ulja si përqindje totale ndaj çmimit dhe sa më i lartë pragu, sa më i madh të jetë ulja nën këtë prag atëherë më i fortë do të jetë përjashtimi i mundshëm për konkurrentët aktualë dhe potencialë.
- v. Kur sistemi i uljeve pengon zgjerimin ose hyrjet e konkurrentëve eficient, atëherë bëhet i vështirë ofrimi për konsumatorët përfundimtar. Në këtë kontekst, Autoriteti mund të vlerësojë se çfarë çmimi mund të ofrojë konkurrenti rival në mënyrë që të kompensojë klientin për humbjen nga uljet e kushtëzuara, nëse ky i fundit mund të ndryshojë një pjesë të kërkesës së tij larg ndërmarrjes me pozitë dominuese. Autoriteti do të marrë në konsideratë edhe nivelin e gabimit që mund të shkaktohet nga disa paqartësi që mund të shfaqen nga kjo analizë.
- vi. Niveli mbi të cilin llogaritet çmimi efektiv, në raste të veçanta, varet nga faktet specifike për çdo rast dhe nëse ulja është rritëse ose rënëse. Për uljet rritëse (incremental), niveli është ai i blerjeve rritëse (incremental) që është marrë në konsideratë. Për uljet zbritëse (retroaktive), përgjithësisht mund të jetë e përshtatshme për të vlerësuar se sa shumë kërkesat e një blerje konsumatore mundet që të këmbehen me një konkurrent. Nëse është e mundshme që klientët të kenë mundësi që të ndërrojnë në një kohë të shkurtër sasi të mëdha të kërkesës të një konkurrenti potencial, gama e sasive mund të bëhet relativisht e madhe. Nëse është e mundur që klientët të ndërrojnë vetëm sasi të vogla shtesë, atëherë gama përkatëse mund të zvogëlohet. Për konkurrentët ekzistues, kapaciteti i tyre për të zgjeruar shitjet tek klientët dhe luhatjet e këtyre shitjeve në kohë, mund të ndikojnë në gamën e produkteve. Për konkurrentët potencial duhet të bëhet vlerësimi i të gjitha barrierave me të cilat një hyrës i ri mund të përballet. Mund të merret në analizë modeli i mëparshëm i hyrësve të rinj⁷¹ të tregjeve të njëjtë ose të ngjashme.

71 Niveli mund të vlerësohet mbi bazën e të dhënave të cilat mund të kenë shkallë të ndryshme variacioni. Autoriteti mund ta marrë këtë në konsideratë për të orientuar një konkluzion për sa i përket mundësisë së ndërmarrjes me pozitë dominuese që të përjashtojë konkurrentët eficientë. Gjithashtu mund të jetë e nevojshme që të llogaritet sa më të mëdha janë kërkesat e konsumatorëve mbi mesataren që hyrësi do të

- vii. Për atë kohë sa çmimi efektiv është mbi LRAIC-në e ndërmarrjes me pozitë dominuese, kjo do të lejonte që konkurrentët të konkurronin me fitim, pavarësisht uljeve. Në rrethana të tilla uljet nuk janë në gjendje të përjashtojë konkurrentët në mënyrë anti-konkurrese.
- viii. Kur një çmim efektiv është nën AAC, si rregull i përgjithshëm nëpërmjet skemës së uljeve mund të përjashtohet edhe një konkurrent eficient. Nëse çmimet efektive janë midis AAC dhe LRAIC, Autoriteti mund të hetojë nëse faktorët e tjerë të çojnë në konkluzionin se hyrja apo zgjerimi edhe i një konkurenti eficient mund të ndikohet. Në këtë kontekst, Autoriteti mund të hetojë nëse dhe në çfarë shkalle rivalët kanë në dispozicion një kundër-strategji reale dhe efektive, për shembull nëse kapaciteti i tyre mund të përdoret për një pjesë “të pakontestueshme” të kërkesës së blerësve, si mekanizëm për të ulur çmimin për gamën e produkteve. Nëse konkurrentët nuk kanë në dispozicion disa kundër-strategji, Autoriteti do të marrë në konsideratë se skema e uljeve është në gjendje për të përjashtuar konkurrentët eficientë.
- ix. Siç është përcaktuar në paragrafin 16, kjo analizë mund të përfshihet në vlerësimin e përgjithshëm, duke marrë në konsideratë evidenca sasiore dhe cilësore. Është e rëndësishme të merret në konsideratë nëse sistemi i uljeve është zbatuar me një xhiro të individualizuar ose të standartizuar. Një xhiro e individualizuar, e bazuar në përqindjen e kërkesave totale të klientit ose në një volum individual të caktuar, i lejon ofertuesit me pozitë dominuese të përcaktojë xhiron në një nivel të tillë që të krijojë vështirësi për klientët që të ndërrojnë ofertuesit, duke krijuar kështu një besnikëri maksimale. Një xhiro standarde (kur xhironja është e njëjtë për të gjithë grupin e klientëve) mund të jetë shumë e lartë për disa klientë të vegjël dhe/ose shumë e vogël për klientët e mëdhenj për të pasur një efekt besnikërie në rritje. Atëherë mund të vendoset që një xhiro standarde të përafrohet me kërkesat e një grupi të konsiderueshëm klientësh. Autoriteti mund të marrë në konsideratë që një sistem i standardizuar uljesh mund të prodhojë efekte anti-konkurrese.

3. Eficencat

Nëse kushtet e përmendura në kreun ‘Mbi nevojat objektive dhe eficientat’ janë përmbushur, Autoriteti merr në konsideratë ankesat e ndërmarrjeve me pozitë dominuese kur sistemi i uljeve arrin kosto ose avantazhe të tjera të cilat kalohen te klientët. Skemat e uljeve rritëse, në përgjithësi janë në gjendje të japin rishitësve një shtysë për të prodhuar dhe rishitur një volum më të lartë se skemat e uljeve zbritëse. Në të njëjtat kushte, Autoriteti mund të marrë në konsideratë ato të dhëna që tregojnë që një marrëveshje ekskluzive sjell avantazhe për klientë të veçantë, nëse këto marrëveshje janë të nevojshme për

zinte si një minimum në mënyrë që nëse çmimi efektiv të jetë të paktën atë i lartë sa LRAIC e një ndërmarrje me pozitë dominuese. Në disa raste madhësia e kësaj pjesë, kur krahasohet me pjesën aktuale të tregut të konkurrentëve dhe pjesëve e tyre të tregut për kërkesat e konsumatorëve, mund të japin qartë nëse skema e skontove është e aftë për të pasur një efekt përjashtimor anti-konkurrese.

ndërmarrjen me pozitë dominuese, që të krijojë marrëdhënie specifike investimesh për të qenë e aftë që ti ofrojë këtyre klientëve.

B. Shitje të lidhura/ të kushtëzuara dhe shitje të grupuara/të bashkëngjitura

- 1) Një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të përpiqet të përjashtojë konkurrentët e saj nëpërmjet shitjeve të lidhura dhe shitjeve të grupuara. Ky seksion ka për qëllim të nxjerrë në pah rrethana të cilat mund të nxisin një ndërhyrje nga Autoriteti kur vlerësohen shitjet e lidhura dhe shitjet e grupuara të ndërmarrjeve dominuese.
- 2) “Shitja e lidhur”, zakonisht i referohet situatave, kur klientëve që blejnë një produkt (produktin e lidhur) iu është kërkuar gjithashtu të blejnë një produkt tjetër nga ndërmarrja me pozitë dominuese. Shitja e lidhur mund të vendoset në baza teknike ose kontraktuale. Shitja e grupuar zakonisht i referohet mënyrës me anë të të cilës produktet janë ofruar dhe mënyrës se si është vendosur çmimi nga ndërmarrja me pozitë dominuese. Në rastin e shitjeve të lidhura, produktet shiten bashkë dhe në sasi të fiksuara. Në rastin e shitjeve të grupuara të përziera (që shpesh trajtohen si ulje të produkteve) produktet mund të sigurohen veç e veç, por shuma e çmimeve kur ato shiten veç e veç është më e lartë se shuma e çmimit në rastin kur produktet shiten si të lidhura (bundle).
- 3) Shitjet e lidhura dhe shitjet e grupuara janë praktika që kanë për qëllim ti sigurojnë klientëve produktet më të mira ose të ofrojnë mënyra më efektive kostoje. Një ndërmarrje, e cila zotëron pozitë dominuese në tregun e një produkti të lidhur ose të grupuar, (referuar si treg i lidhur) mund të dëmtojë konsumatorët nëpërmjet praktikave të shitjeve të lidhura ose të grupuara, duke përjashtuar nga tregu produkte të tjera që janë pjesë e kësaj praktike të lidhur ose të grupuar.
- 4) Autoriteti normalisht do të veprojë në bazë të nenit 9 të ligjit kur një ndërmarrje ka pozitë dominuese në një treg të lidhur dhe kur kushtet e mëposhtme plotësohen: (i) kur produktet e lidhura janë produkte të dallueshëm dhe (ii) praktika e shitjeve të lidhura mund të sjellin përjashtime anti-konkurruese.

1. Produktet e veçantë/të dallueshëm

Nëse produktet do të konsiderohen nga Autoriteti si të veçantë/të dallueshëm kjo do të varet nga kërkesa konsumatore. Dy produkte janë të veçantë/të dallueshëm nëse në mungesë të produktit të lidhur ose të grupuar, një numër i caktuar klientësh do të blejnë ose do të ketë blerë produktet e lidhur pa blerë produktin plotësues (tied) nga i njëjti ofertues, duke lenë mënjanë prodhimin e të dy produkteve dhe për produktin që ‘lidhet’ dhe për ‘lidhësin’ e produktit. Evidenca që tregon se dy produkte janë të veçantë/të dallueshëm mund të jetë evidencë direkte:

- i. në rastet kur klientët blejnë produktet e lidhur dhe lidhësit e tyre nga burime të ndryshme furnizimi;

- ii. mund të jetë evidencë indirekte kur kemi në treg ndërmarrje të specializuara për prodhimin ose shitjen e produkteve lidhës pa produktin e lidhur;
- iii. apo evidenca që tregojnë që ndërmarrjet me fuqi të vogël tregu, veçanërisht në tregjet konkurruese, tentojnë të mos lidhin ose grupojnë të tilla produkte.

2. Përrjashtimet anti-konkurruese në tregun lidhës ose të lidhur

- 1) Shitjet e lidhura/të kushtëzuara dhe shitjet e grupuara/të bashkëngjitura mund të sjellin efekte anti-konkurruese në tregun e lidhur, ose në tregun lidhës ose në të dy tregjet në të njëjtën kohë. Megjithatë, edhe kur qëllimi i shitjeve të lidhura/ të kushtëzuara dhe shitjeve të grupuara është të mbrojë pozicionin e ndërmarrjeve me pozitë dominuese në tregun lidhës, kjo indirekt çon në përrjashtim të tregut të lidhur. Pavarësisht faktorëve të përrmendur në paragrafin 10, faktorët e mëposhtëm kanë rëndësi të veçantë për identifikimin e rasteve të mundshme të përrjashtimeve anti-konkurruese.
- 2) Risku i përrjashtimeve anti-konkurruese pritet të jetë më i madh kur ndërmarrja me pozitë dominuese bën që strategjia e vet e lidhjes (tying and bundling) të zgjasë, për shembull nëpërrmjet lidhjes teknike e cila është e kushtueshme për t'u ndërruar. Lidhja teknike redukton mundësinë për rishitje të komponentëve individual.
- 3) Në rastin e shitjeve të kushtëzuara, ndërmarrja mund të ketë një pozicion dominuese për më shumë se një produkt të kushtëzuar. Sa më i madh të jetë numri i produkteve të tillë, aq më i madh është përrjashtimi i mundshëm anti-konkurruese. Kjo është veçanërisht e vërtetë në se kushtëzimi (bundle) është i vështirë që të përrsëritet nga një konkurrent i vetëm ose nga disa konkurrentë së bashku.
- 4) Shitjet e lidhura sjellin më pak konkurrencë për klientët e interesuar në blerjen e produktit të lidhur, por jo për produktin lidhës. Nëse nuk ka numër të mjaftueshëm klientësh të cilët do të blejnë vetëm produktin e lidhur për të mbështetur konkurrentët e ndërmarrjeve me pozitë dominuese në tregun e lidhur, shitja e lidhur mund ti bëjë këta klientë të përballen me çmime më të larta.
- 5) Nëse lidhësi dhe produkti i lidhur mund të jetë përrdorur në porcione të ndryshme si inpute në procesin e prodhimit, klientët mund të reagojnë për rritjen e çmimit të produktit lidhës duke rritur kërkesën e tyre për produktin e lidhur ndërrkohë që zvogëlojnë kërkesën e tyre për produktin lidhës. Nga lidhja e dy produkteve, ndërmarrja me pozitë dominuese mund të kërkojë të shmangë këtë zëvendësim dhe si rezultat të rrisë çmimet.
- 6) Në se çmimet e ndërmarrjeve me pozitë dominuese që zbatohen në tregun e lidhur janë çmime të rregulluara, shitja e lidhur mund të lejojë ndërmarrjen me pozitë dominuese të rrisë çmimet në tregun e lidhur, me qëllim kompensimin për humbjen e të ardhurave që mund të shkaktohet nga rregullimi i tregut lidhës.

- 7) Në se produkti lidhës është produkt i rëndësishëm plotësues për klientët e produktit të lidhur, një reduktim i furnitorëve alternativ të produktit të lidhur dhe një reduktim i disponueshmërisë së këtij produkti mund të bëjë më të vështirë hyrjen në tregun e lidhur.

3. Skontot e shumëfishta të produktit

- 1) Skontot mund të jenë anti-konkurrese në tregun e lidhur ose lidhës, nëse ato janë aq të mëdha sa që konkurrentët efiçent që ofrojnë vetëm disa komponentë, nuk mund të konkurrojnë ndaj kësaj ulje të kushtëzuar.
- 2) Në teori, situata ideale është kur efekti skontos vlerësohet duke shqyrtuar në se e ardhura marxhinale mbulon koston marxhinale për çdo produkt të kushtëzuar nga ndërmarrja me pozitë dominuese. Megjithatë, në praktikë vlerësimi i të ardhurës marxhinale është kompleks. Prandaj Autoriteti në shumë situata do të përdorë çmimin (marxhinal) si një tregues të mirë. Në se çmimi marxhinal që konsumatorët paguajnë për çdo produkt të kushtëzuar të ndërmarrjes me pozitë dominuese është mbi LRAIC e ndërmarrjes me pozitë dominuese, Autoriteti nuk do të ndërhyjë derisa një konkurrent po aq efiçent vetëm me një produkt, të jetë i aftë të konkurrojë me fitim kundrejt vendosjes së këtij kushtëzimi. Veprimet detyruese mund të jenë të justifikuara në se çmimi rritës (marxhinal) është nën LRAIC, sepse në të tilla raste edhe një konkurrent po aq efiçent mund të ndalohet nga zgjerimi ose hyrja.
- 3) Nëse të dhënat tregojnë se konkurrentët e ndërmarrjes me pozitë dominuese shesin produkte të njëjta të kushtëzuara, ose mund të kenë kohë pa ndryshuar koston shtesë, Autoriteti e vlerëson këtë si një produkt të kushtëzuar që konkurren kundrejt një produkti tjetër të kushtëzuar. Në rastin konkret, pyetja nuk është nëse të ardhurat marxhinale mbulojnë koston marxhinale për çdo produkt të kushtëzuar, por nëse çmimi i një produkti të kushtëzuar është grabitqar.

4. Efiçencat

Nëse kushtet e përmendura në seksionin III D përmbushen, Autoriteti shikon pretendimet e ndërmarrjeve me pozitë dominuese nëse praktikët e tyre të lidhura dhe të kushtëzuara mund të sjellin kursime në prodhim ose shpërndarje dhe përfitime për konsumatorin. Autoriteti, mund të marrë në konsideratë faktin nëse praktika të tilla reduktojnë kostot e transaksionit për klientët, të cilët në të kundërt do të ishin të detyruar të blinin komponentë në mënyrë të ndarë dhe i krijojnë ofruesit kursime të rëndësishme në kostot e paketimit dhe shpërndarjes. Gjithashtu, mund të analizohet nëse kombinimi i dy produkteve të pavarur në një produkt të ri të vetëm, mund të rrisë mundësinë për të sjellë një produkt të tillë në treg për përfitimin e konsumatorëve. Autoriteti mund të marrë në konsideratë faktin nëse praktikët e lidhura dhe të kushtëzuara i lejojnë ofruesit të kalojnë në efiçencat që vijnë nga prodhimi ose nga blerja e sasive të mëdha të produkteve të lidhura.

C. Predation (Situata grabitqare)

Autoriteti ndërhyt kur ka të dhëna që tregojnë se një ndërmarrje me pozitë dominuese kryen një sjellje grabitqare, dhe me paramendim shkakton humbje dhe jo fitime si më parë, në periudhën afat shkurtër (në vazhdim mund të përdoret me termin sakrificë), me qëllim që të përjashtojë një ose disa konkurrentë potencialë me synimin për të forcuar ose për të mbajtur fuqinë e tregut duke i shkakuar dëm konsumatorit⁷².

1. Sakrifica

- 1) Autoriteti konsideron si sakrificë të detyruar, sjelljen e një ndërmarrje me pozitë dominuese e cila duke vendosur një çmim të ulët për të gjithë ose për një pjesë të veçantë të outputit të saj për një periudhë të caktuar kohe, ose duke zgjeruar outputin e saj për një periudhë të caktuar kohe, shkakton ose është duke shkakuar humbje të cilat mund të shmangeshin. Autoriteti merr një AAC si një pikë nisëse për të vlerësuar nëse një firmë dominuese pëson humbje të shmangshme. Nëse një firmë dominuese, vendos çmime nën AAC për të gjithë ose një pjesë të outputit të saj, duke mos mbuluar kostot që mund të ishin shmangur duke mos prodhuar atë output: ajo po pëson një humbje që mund të shmangej. Çmimi nën AAC, në shumicën e rasteve mund të konsiderohet nga Autoriteti si një tregues i qartë i sakrificës⁷³.
- 2) Por koncepti i sakrificës përfshin jo vetëm çmime nën AAC. Për të treguar një strategji grabitqare, Autoriteti heton nëse sjellja grabitqare, në periudhën afat shkurtër, çon në të ardhura neto më të ulta sesa do të priteshin nga një sjellje e arsyeshme alternative p.sh nëse një ndërmarrje me pozitë dominuese, pëson një humbje që mund të shmangej. Në disa raste do të ishte e mundur t'i referoheshin të dhënave direkte që konsistojnë në dokumente nga një ndërmarrje me pozitë dominuese që tregon qartësisht një strategji grabitqare si p.sh një plan i detajuar për të sakrifikuar, me qëllim që të përjashtojë një rival, të pengojë hyrjen ose të përvetësojë një emergjencë tregu ose të dhëna të sfidave/kërcënimeve të veprimeve grabitqare.

2. Përjashtime anti-konkurrese

- 1) Nëse të dhëna të besueshme janë të disponueshme, Autoriteti zbaton analizat e konkurrentit më eficient, për të përcaktuar nëse një sjellje mund

72 Autoriteti vlerëson edhe praktikën grabitqare të kryera nga ndërmarrjet me pozitë dominuese edhe në tregjet sekondare ku ato nuk e zotërojnë një pozitë të tillë. Ka më shumë mundësi që të vërtetohet një abuzim në ato sektorë ku veprimtaria mbrohet nga një monopol ligjor. Ndërsa ndërmarrjet me pozitë dominuese nuk e kanë të nevojshme që të përdorin çmime grabitqare për të mbrojtur pozitën e tyre në tregun e mbrojtur si monopol ligjor, mund të përdori fitimet e përfuara në tregun monopol për të zëvendësuar aktivitetet e tyre në një treg tjetër duke kërcënuar kështu me eliminim të konkurrencës efektive.

73 Në shumë raste AVC dhe AAC janë të barabarta dhe shpesh herë kostot variabël mund të shmangen. Megjithatë në rrethanat kur AVC dhe AAC ndryshojnë, AAC reflekton më mirë sakrificën e mundshme p.sh nëse ndërmarrja me pozitë dominuese duhet të zgjerojë kapacitet me qëllim që të jetë në gjendje të përdor çmime grabitqare atëherë kostot fikse të kapaciteteve ekstra do të merren në konsideratë kur shqyrtohen humbjen e ndërmarrjes me pozitë dominuese. Këto kosto do të reflektohen te AAC dhe jo te AVC.

të dëmtojë ose jo konsumatorët. Normalisht çmimet që janë nën LRAIC mund të përjashtojnë konkurrentët eficientë nga tregu.

- 2) Autoriteti zakonisht heton nëse sjellja e dyshuar redukton mundësinë e rivalëve për të konkurruar. Për shembull, nëse një ndërmarrje me pozitë dominuese është e informuar rreth kostove ose kushteve të tjera të tregut, ose ka mundësi të fshehtë të dhëna për fitimet në një treg të dhënë, mund të influencojë në pritjet që mund të kenë hyrësit potencial dhe kështu mund të frenojë hyrjen e tyre. Nëse sjellja dhe efektet e saj të mundshme ndjehen në tregje të shumëfishtë dhe/ose në periudha të suksesshme për hyrje të mundshme, ndërmarrja me pozitë dominuese duket sikur po kërkon reputacion për një sjellje grabitqare. Nëse konkurenti i caktuar, varet nga financime të jashtme, skonto të rëndësishme të çmimit ose sjellje të tjera grabitqare nga një ndërmarrje me pozitë dominuese, mund të ndikojë në performancën e konkurrentit kështu që aksesimi i tij për financime të mëtejshme mund të jetë i papërcaktuar.
- 3) Për Autoritetin nuk është i rëndësishëm fakti që tregon se konkurrentët kanë ekzistuar në treg, për të vërtetuar se ka pasur përjashtime antikonkurruese. Nuk mund të përjashtohet që ndërmarrja me pozitë dominuese, mund të preferojë të parandalojë konkurrentin nga konkurrimi i fortë dhe ta bëjë atë që të ndjekë çmimet e ndërmarrjes me pozitë dominuese, në vend që ta përjashtojë atë krejtësisht nga tregu. Rregulla të tilla, shmangin riskun e pandarë në eliminimin e konkurrentëve, në veçanti riskun që asetet e konkurrentëve shiten me një çmim më të ulët dhe qëndrojnë në treg, duke krijuar një hyrës të ri me kosto të ulta.
- 4) Konsumatorët mund të dëmtohen nëse ndërmarrja me pozitë dominuese mendon që fuqia e saj në treg pas sjelljes grabitqare mund të jetë më e madhe se në rastet kur ndërmarrja nuk përfshihet e para në një sjellje të tillë p.sh ndërmarrja mund të përfitojë nga sakrificat.
- 5) Kjo nuk do të thotë që Autoriteti do të ndërhyjë nëse ndërmarrja me pozitë dominuese do të rrisë çmimet mbi nivelin e çmimeve që ka qenë në treg para sjelljes grabitqare. Është e mundshme që sjellja të pengojë ose të ngadalësojë një rënie të çmimit, e cila në rast të kundërt mund të kishte ndodhur. Identifikimi i dëmit të konsumatorit nuk është një llogaritje mekanike e fitimeve dhe humbjeve dhe prova e fitimit të përgjithshëm nuk kërkohet. Dëmi i konsumatorit tregohet nga vlerësimi i efekteve përjashtuese të sjelljes, e kombinuar me elementë të faktorëve të tjerë si p.sh barrierat e hyrjes. Në këtë kontekst, Autoriteti do të konsiderojë mundësitë e ri-hyrjes në treg.
- 6) Mund të jetë më e lehtë për një ndërmarrje me pozitë dominuese të përdorë çmime grabitqare nëse në mënyrë specifike ajo targeton klientë me çmime të ulta, meqë kjo do të kufizojë humbjet e shkaktuara nga ndërmarrja me pozitë dominuese.
- 7) Është më pak e mundshme që ndërmarrja të vendosë çmime grabitqare nëse sjellja që ka të bëjë më një çmim të ulët, zbatohet për një periudhë të gjatë kohe.

3. Eficencat

Në përgjithësi konsiderohet si e vështirë që sjellja grabitqare të krijojë efica. Megjithatë, për të provuar që kushtet e përmendura në Seksionin III D janë përmbushur, Autoriteti merr në konsideratë pretendimet nga ndërmarrja me pozitë dominuese që ulja e çmimit i krijon mundësi asaj të arrijë ekonomitë e shkallës ose efica të lidhura me zgjerimin e tregut.

D. Refuzimi për të ofruar dhe ngjeshja e çmimit (margin squeeze⁷⁴)

- 1) Autoriteti mban qëndrimin se çdo ndërmarrje pavarësisht nga fakti nëse ka pozitë dominuese ose jo, duhet të ketë të drejtën për të zgjedhur partnerët tregtar dhe të vendosë në mënyrë të lirë për pronën e saj. Prandaj Autoriteti duhet të kryej një vlerësim të kujdesshëm kur zbatohet neni 9 i Ligjit në rastet kur vendosen detyrime për të ofruar për ndërmarrjen me pozitë dominuese. Prania e një detyrimi të tillë, edhe për një pagesë të drejtë, nxit ndërmarrjet të investojnë dhe të rrisin novacionet/shpikjet. Njoftimi se ata mund të kenë një detyrim për të ofruar përkundrejt dëshirës së tyre, do t'i bënte ndërmarrjet me pozitë dominuese ose ndërmarrjet që parashikojnë që mund të përftojnë pozitë dominuese, të mos investonin ose të investonin më pak në aktivitetin në fjalë. Gjithashtu, konkurrentët mund të joshen për të përfituar në kurriz të tjetrit për investimet e bëra nga një ndërmarrje me pozitë dominuese në vend që të investonin vetë. Në periudhë afatgjatë asnjë nga këto pasoja nuk do të ishte në interes të konsumatorëve.
- 2) Problemet tipike të konkurrencës shfaqen kur ndërmarrjet me pozitë dominuese konkurrojnë në tregun e 'rrjedhës së poshtme' me blerësin të cilit i refuzohet të ofrojë. Termi 'treg i rrjedhës së poshtme' i referohet tregut për të cilin inputi i refuzuar është i nevojshëm për të prodhuar një produkt ose për të siguruar një shërbim.
- 3) Lloje të tjera të refuzimit të paligjshëm për të ofruar, në të cilat oferta është kusht për blerësin për të pranuar kufizimet në këtë sjellje, nuk janë trajtuar në këtë seksion. Në mënyrë të ngjashme, refuzimet për të ofruar që kërkojnë të kufizojnë blerësin nga përfshirja në tregti paralele ose nga ulja e çmimit të rishitjesh, janë trajtuar në këtë seksion. Koncepti i refuzimit për të ofruar përfshin një rang të gjerë praktikash, të tilla si refuzimi për ti ofruar produkte klientëve të rinj ose ekzistuesve, licencimi i të drejtave të pronësisë intelektuale duke përfshirë kur është e nevojshme edhe sigurimin e informacionit ose sigurimin e aksesit në një rrjet.

⁷⁴ Margin squeeze ka të bëjë me ofrimin e një produkti/shërbimi nga ndërmarrja me pozitë dominuese me çmime të ndryshme. Më konkretisht është rasti kur ndërmarrja me pozitë dominuese i shet ofruesve me shumicë, produktin e saj, me çmim më të lartë se sa e shet këtë produkt te konsumatori përfundimtar.

- 4) Autoriteti nuk e konsideron si të nevojshëm që produkti i refuzuar të jetë tregtuar tashmë: është e mjaftueshme që ka kërkesë nga blerësit potencial dhe që një treg potencial për një input mund të identifikohet.
- 5) Si përfundim, në vend të refuzimit, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të vendosë një çmim për produktin në tregun e rrjedhës së sipërme, i cili krahasuar me çmimin që vendoset në tregun e rrjedhës së poshtme, nuk lejon as një konkurrent eficient të tregtojë me fitim në tregun e rrjedhës së poshtme (e quajtur 'margin squeeze'). Në rastet 'margin squeeze' kostoja në të cilin Autoriteti do të mbështetet për përcaktimin e kostove të një konkurenti eficient janë LRAIC e një sektori në rrjedhën e poshtme të një ndërmarrje të integruar me pozitë dominuese.
- 6) Autoriteti i konsideron këto praktika nëse rrethanat e mëposhtme janë të pranishme:
 - i. Refuzimi lidhet me një produkt ose shërbim që është objektivisht i nevojshëm për të konkurruar efektivisht në tregun e rrjedhës së poshtme,
 - ii. Refuzimi mund të çojë në eliminimin e konkurrencës efektive në tregun e rrjedhës së poshtme
 - iii. Refuzimi mund të shkaktojë dëm për konsumatorin.
- 7) Në disa raste të veçanta, mund të jetë e qartë që vendosja e detyrimeve për të ofruar, nuk sjell efekte negative të zotëruesit dhe/ose shtysat e agjentëve për të investuar dhe rinovuar tregun e rrjedhës së sipërme, qofshin ato ex ante ose ex post. Autoriteti konsideron që ky është rasti kur rregullimet, në përputhje me Ligjin e Konkurrencës, vendosin detyrime për ndërmarrjen me pozitë dominuese që ajo të ofrojë. Ky mund të jetë rasti kur pozicioni i ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun e rrjedhës së sipërme është zhvilluar nën mbrojtjen e të drejtave speciale ose ekskluzive ose është financuar nga burime të shtetit. Në këto raste specifike, nuk ka arsye që Autoriteti të devijojë nga zbatimi i standardeve të përgjithshme dhe mund të tregojë kufizimet e mundshme anti-konkurrese, pa konsideruar nëse janë të pranishme 3 rrethanat e përmendura në paragrafin 68.

1. Nevojat objektive të inputit

- 1) Për të analizuar refuzimin për të ofruar, Autoriteti merr në konsideratë nëse oferta e inputit të refuzuar nevojitet objektivisht për agjentët, për të qenë të aftë të konkurrojnë efektivisht në treg. Kjo nuk do të thotë që, pa inputin e përjashtuar, asnjë konkurrentë nuk mund të hyjë ose mbijetojë në tregun e rrjedhës së poshtme. Një input është i domosdoshëm kur nuk ka zëvendësues potencial ose aktual në të cilin konkurrentët në tregun e rrjedhës së poshtme mund të mbështeten te kundërshtari - të paktën në një periudhë afatgjatë (pasoja negative të refuzimit). Autoriteti, vlerëson nëse konkurrentët dyfishojnë efektivisht inputin e prodhuar nga një ndërmarrje me pozitë dominuese. Nocioni i dyfishimit do të thotë krijimi i burimeve alternative të ofertës eficiente që është e aftë të lejojë

konkurrentët të shfaqin një kufizim konkurrencial në tregun e rrjedhës së poshtme të një ndërmarrje me pozitë dominuese.

- 2) Kriteri i paraqitur në paragrafin 68 zbatohet në të dy rastet e përçarjes së ofertës së mëparshme dhe refuzimit për të ofruar produkte, të cilat ndërmarrja me pozitë dominuese nuk i ka ofruar më parë për të tjerët (refuzim de novo për të ofruar). Sidoqoftë është më e mundshme që përfundimi i marrëveshjes të ofertës ekzistuese të jetë më abuziv se një refuzim de novo për të ofruar. P.sh nëse ndërmarrja me pozitë dominuese, më parë i ka ofruar ndërmarrjes kërkuese dhe më vonë ka krijuar marrëdhënie të veçantë për investimet me qëllim që të përdorë më pas inputin e refuzuar, Autoriteti mund ta konsiderojë inputin në fjalë si të domosdoshëm. Fakti që ofrimi i inputit kryesor është në favor të zotëruesit të tij të mëparshëm, është një tregues që ofrimi i inputit nuk përbën risk që zotëruesi mund të marrë kompensim të pamjaftueshëm për investimin fillestar.

2. Eliminimi i konkurrencës efektive

Nëse kërkesat e shfaqura në paragrafin 70 dhe 71 përbushen, Autoriteti konsideron që refuzimi për të ofruar nga ndërmarrja me pozitë dominuese në përgjithësi eliminon, menjëherë ose me kalimin e kohës, konkurrencën efektive në tregun e rrjedhës së poshtme. Mundësia që konkurrenca efektive të eliminohet, zakonisht është më e madhe kur: pjesa e tregut të ndërmarrjes me pozitë dominuese është më e madhe në tregun e rrjedhës së poshtme; (sa më pak kufizime kapacitetesh të ketë ndërmarrja me pozitë dominuese që është e afërt me konkurrentët në tregun e rrjedhës së poshtme; sa më e afërt të jetë zëvendësueshmëria midis outputit të ndërmarrjes me pozitë dominuese dhe atij të konkurrentëve në tregun e rrjedhës së poshtme; sa më i madh të jetë numri i konkurrentëve që preken në tregun e rrjedhës së poshtme aq më tepër është e mundshme që kërkesa e konkurrentëve të përjashtuar të shërbejë për ti cuar ata në avantazh të ndërmarrjes me pozitë dominuese.)

3. Dëmi i konsumatorit

- 1) Për të analizuar ndikimin e refuzimit për të ofruar, në mirëqenien e konsumatorit, Autoriteti analizon pasojat negative të refuzimit për të ofruar në tregun përkatës për konsumatorin.
- 2) Autoriteti vlerëson se dëmi i konsumatorit mund të shfaqet kur konkurrentët që ndërmarrja me pozitë dominuese kufizon, janë rezultat i refuzimit për të sjellë në treg produkte të reja dhe/ose kur inovacionet/shpikjet e vazhdueshme mund të kufizohen. Ky mund të jetë rasti kur ndërmarrja e cila kërkon të ofrojë, nuk tenton të kufizojë veten për të dyfishuar të mirat dhe shërbimet e ofruara tashmë në tregun e rrjedhës së poshtme nga ndërmarrja me pozitë dominuese, por tenton të prodhojë të mira dhe shërbime të reja dhe të përmirësuara për të cilat ekziston një kërkesë konsumatore potenciale ose mund të kontribuojë në zhvillimin teknologjik.
- 3) Autoriteti, gjithashtu vlerëson se refuzimi për të ofruar mund të sjellë dëm të konsumatorit, kur çmimi në tregun e rrjedhës së sipërme është i

rregulluar, kur çmimi në rrjedhën e poshtme nuk është i rregulluar dhe kur ndërmarrja me pozitë dominuese përjashton konkurrentët në tregun e rrjedhës së poshtme duke refuzuar të ofrojë. Është e mundur, që ndërmarrja të nxjerrë më shumë fitime në tregun e parregulluar të rrjedhës së poshtme sesa do të nxirrte normalisht.

4. Eficencat

- 1) Autoriteti do të marrë në konsideratë pretendimet e ndërmarrjes me pozitë dominuese, që një refuzim për të ofruar është i nevojshëm për t'i lejuar ndërmarrjes me pozitë dominuese të realizojë një kthim të përshtatshëm nga investimet e kërkuara për të zhvilluar inputet e biznesit, të tilla si gjenerimi i shtysave për të vazhduar për të investuar në të ardhmen, duke marrë përsipër riskun e dështimit të projekteve. Autoriteti gjithashtu do të marrë në konsideratë edhe pretendimet e ndërmarrjes me pozitë dominuese, që inovacionet e saj do të ndikohen negativisht nga detyrimi për të ofruar, ose nga ndryshimet strukturore në kushtet e tregut, që vendosja e detyrimeve të tilla do të sjellë, duke përfshirë edhe zhvillimin e inovacioneve të vazhdueshme nga konkurrentët.
- 2) Sidoqoftë, kur merren në konsideratë pretendime të tilla, Autoriteti duhet të sigurohet që kushtet e paraqitura në seksionin III D përmbushen të gjitha. Në veçanti, ndërmarrja me pozitë dominuese ka për detyrë të tregojë ndikimin negativ që një detyrim për të ofruar mund të ketë në nivelin e inovacioneve të saj dhe nëse një ndërmarrje me pozitë dominuese ka ofertuar më parë inputin në fjalë. Kjo mund të jetë relevante për vlerësimin e çdo pretendimi që refuzimi për të ofruar është i justifikuar nga efica.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
nr.333 , datë 21.10.2014**

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me
objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore
(segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.10.2014,,me pjësemarrjen e Znj. Lindita Milo, Znj. Rezana Konomi, Znj. Servete Gruda dhe Z. Koço Broka, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e vlerësimit juridik të informacionit mbi rastin e dyshuar për marrëveshje në oferta në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe vlerësimit ligjor të Grupit të Punës mbi

rastin e dyshuar për marrëveshje në oferta në tregun e prokurimit publik me objekt

“Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore”.

VËREN SE:

Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të një informacioni të administruar në rrugë administrative mbi mundësinë e një marrëveshje në oferta në procedurat e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit)”, në bashkëpunim me

Agjencinë e Prokurimit Publik ka administruar informacionin e kërkuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ofertues në procedurën e prokurimit publik të realizuar në vitin 2013, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, vërehet se:

- Vlera e ofertave fituese në të tre lotet e procedurës së prokurimit është mbi 99% të fondit limit.
- Operatorë ofertues janë vetëm tre ndërmarrje.
- Fituese të loteve janë sejcila prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse, duke krijuar një skemë rotacioni për shoqërinë që do shpallej fituese.

Nga vlerësimi ligjor i rastit sipas nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” rezulton se ofertat në rotacion mes tre konkurrentëve dhe afërsia e vlerës së ofertës fituese në raport me fondin limit janë shenja të kufizimit të konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit në oferta në prokurimet publike.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës;
2. Periudha e hetimit do të jetë Janar-Dhjetor 2013.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se dy muaj nga dalja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
nr. 334, datë 31.10.2014**

**“Për
disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të
energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv. Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.10.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i “Raport monitorimi i tregut të importit të energjisë elektrike nga CEZ SHA për mbulimin e humbjeve”.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 70, pika 2.
Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të: Raportit monitorimi i tregut të importit të energjisë elektrike nga CEZ SHA për mbulimin e humbjeve” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës lidhur me këtë raport.

VËREN SE:

1. Tregu i energjisë elektrike është një treg i rregulluar me anë të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar. Sipas përcaktimeve të ligjit të mësipërm “Shpërndarja” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë (nënstacionet 110 kV), të mesëm dhe të ulët, deri te klienti i fundit, por që nuk përfshin furnizimin dhe “Operator i Sistemit të Shpërndarjes” është personi përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të

shpërndarjes. Gjithashtu, "Furnizim" është shitja dhe blerja për rishitje të klientët e energjisë elektrike. "Furnizuesi publik me pakicë" është person i licencuar për të furnizuar klientët tarifore, të cilët furnizohet nga furnizuesi publik me çmime dhe tarifa të rregulluara.

2. Shoqëria CEZ Shpërndarje është krijuar dhe ka fituar personalitet juridik me Vendimin Nr.38587, datë 19.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe është pajisur me certifikatën e Regjistrimit të Personit të Tatuashëm me NIPT-i K72410014H. Me Vendim të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, Shoqëria është licencuar për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë.
3. Në bazë të Marrëveshjes për Shitjen e Aksioneve, datë 11.03.2009, miratuar me Ligjin Nr. 10116, datë 23.04.2009 "Për miratimin e Kontratës së Shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ A.S-se", 76 % e aksioneve të Shoqërisë u privatizuan duke kaluar nën pronësinë e Shoqërisë Çeke CEZ a.s, ndërkohë që 24 % të aksioneve janë nën pronësinë e Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a, ushtron dy aktivitete, atë të furnizimit me pakicë dhe aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, aktivitete këto për të cilat ka qenë e licencuar nga ERE. Në këtë kuptim, Shoqëria dispononte Licencën për Furnizimin me Pakicë të Energjisë Elektrike dhe Licencën për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike.
4. Me Vendimin Nr. 5, date 21.01.2013 "Mbi vendosjen në Administrim të Përkohshëm të Shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a", ERE vendosi kalimin e CEZ Shpërndarje në Administrim të Përkohshëm dhe përcaktoi një Administrator të përzgjedhur konform kushteve të përcaktuara në Rregulloren e miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2013 "Për miratimin e Rregullores "Mbi procedurat e emërimit të Administratorit dhe kompetencat e tij", e cila ka dalë në zbatim të nenit 18 të Ligjit.
5. Me Vendimin Nr. 63, datë 17.07.2014, Bordi i Komisionerëve të ERE vendosi miratimin e ndryshimit të emrit tregtar të shoqërisë "Cez Shpërndarje" SHA në "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" SHA. Me anë të Ligjit Nr. 114/2014, datë 31.07.2014, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë është miratuar marrëveshja për zgjidhjen me mirëkuptim, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, A.S
6. Tregu i importit të energjisë elektrike funksionon në zbatim të VKM nr 338, date 19.03.2008 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike" dhe në pikën 4.5 të Deklaratës Rregullatore të miratuar nga ERE me Vendimin Nr. 12, datë 03.03.2009, OSSH-ja do të blejë energji elektrike për të mbuluar humbjet në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë rregullore, të cilat do të jenë në fuqi deri përfundimin e afatit të Deklaratës Rregullatore.
7. Lidhur me procedurat e tenderimit të OSSH-së, ERE me anë të Vendimin nr. 42, datë 25.05.2009, ka miratuar "Rregullat dhe Procedurat Standarde të

Prokurimit të Energjisë Elektrike nga OSSH sh.a (Kompania)". Në bazë të kësaj rregulloreje CEZ shpërndarje ka kryer importin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve për periudhën deri në muajin shkurt 2014.

8. Me VKM nr. 897, datë 12.12.2012 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 338, datë 19.03.2008, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike" të ndryshuar, është vendosur të ndryshojë paragrafi 4.4 "...me çmime tregu ose me furnizuesit publik me shumicë të rregulluar dhe kontratë të miratuar nga ERE-ja..." zëvendësohet "... zëvendësohen "... apo furnizuesi publik me shumicë dhe/ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, me çmime të vendosura në kontratën e shitblerjes dhe të rënë dakort ndërmjet palëve". Pra, PPE dhe FPSH dhe/ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, mund të lidhin kontrata shitblerje të negociuara dhe të rëna dakort ndërmjet palëve.
9. Gjatë periudhës gusht 2013 dhe 2014, pranë Autoritetit të konkurrencës, ka ardhur në mënyrë të vazhdueshme një ankesë nga shoqëria GEN-I, e cila operon në tregun e importit të energjisë elektrike. Pas shqyrtimit të ankesës, dhe raportit përkatës Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 308/15 të datës 03.12.2013 i rekomandoi ERE-s, "... të hartojë një rregullore të veçantë mujore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbështetur në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të konkurentëve..." dhe "qartësimin e procedurës së negociimit midis Cez shpërndarje dhe ofertuesve pas shpalljes së ofertave fillestare për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve". Ky rekomandim i Komisionit të Konkurrencës, është marrë në konsideratë nga ERE.
10. ERE me anë të vendimit Nr. 9, datë 06.02.2014, pika 2 përcakton se "...CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm, për nevoja të mbulimit të plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike mbi baza mujore për sasinë e energjisë elektrike që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor. Për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes mbi baza mujore, Administratori zbaton Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me Nr. 30, datë 23.03.2011, "Për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të Blerjes së Energjisë Elektrike nga KESH sh.a".
11. Pavarësisht vendimit të mësipërm, kjo rregullore nuk i zgjidh problemet e këtij segmenti tregu për më tepër nuk e vendos në kushte konkurrence këtë treg.
12. Por, kompania GEN – I, me shkresën nr.308/17, datë 31.03.2014 paraqiti përsëri një ankesë pranë Autoritetit të Konkurrencës sipas të cilës ERE nuk ka marrë asnjë veprim me qëllim adresimin në mënyrë të plotë dhe profesionale të rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës pasi miratimi i aplikimit të rregullave të prokurimit mujor për Cez Shpërndarje SH.A si të KESH Sh.A tregon mungesën e interesit apo dëshirës nga ana e ERE për të adresuar profesionalisht rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës pasi këto rregulla jo vetëm që janë miratuar në vitin 2011 dhe nuk i përgjigjen zhvillimeve të kohës janë miratuar në një kontekst tjetër dhe për një operator

tjetër si Kesh Sh.A me aktivitet, veçori dhe karakteristika të ndryshme nga ato të Cez Shpërndarje sh.A.

13. Cez Sh.a e ka kundërshtuar zbatimin e kësaj rregulloreje pasi sipas Cez shpërndarje vihet re një situatë në të cilën ky segment tregu nuk mund të veproje në kushte konkurrencë, pasi rregullorja kufizon/përjashton pjesëmarrësit në tender, sic janë prodhuesit e vegjël dhe të pavarur të energjisë elektrike. Pra rregullorja përjashton prodhuesit e vegjël dhe të pavarur të energjisë, për shkak se ata kanë kontrata shitje me çmim të rregulluar me FPSH. Kështu janë përjashtuar nga pjesëmarrja në tender e disa HEC-eve të privatizuara sic janë HEC-et Bistrica 1 dhe 2, Ulëz Shkopet.
14. Do të ishte në favor dhe interes të tregut dhe konkurrencës që në këtë segment tregu, këta lojtarë tregu të futeshin në procesin e tenderimit/konkurrimit, pasi do të ekzistonte mundësia e konkurimit me kosto më të ulëta për shkak të shmangies së kostove të interkonjeksionit. Në këto kushte do të çlirohej sado pak KESH sh.a/FPSH nga detyrimet për të paguar apo likuiduar këtë kategori prodhuesit të cilët prodhojnë dhe shesin energji me çmime të rregulluara.
15. Duke ditur se përcaktimi i tarifës së shpërndarjes është i lidhur me vlerësimin e komponentëve të tillë si niveli i humbjeve, të pranuar në tarifë si kosto e arsyeshme, sasia e energjisë së lëvruar në rrjetin e shpërndarjes, investimet e kryera, çmimi dhe sasia e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të cilat janë të lidhur me treguesit e performancës së kompanisë së shpërndarjes dhe që janë të fiksuara në Deklaratën Regullatore, mendojmë se pasojat e aplikimit të këtyre rregulloreve në blerjen e energjisë elektrike të importuar do të kenë ndikim negativ të drejtpërdrejtë në tarifën e reja që kompanitë do të propozojnë për miratim në fund të vitit 2014, për periudhën në vazhdim.
16. Nga Raporti rezulton se ERE nuk ka marrë në konsideratë rekomandimet e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr 159, datë 19.11.2010, për ndarjen funksionale dhe financiare reale të "Furnizuesit Publik me Shumicë" nga KESH-Gen dhe ndarjen financiare reale të "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" dhe Furnizuesi Publik me Pakicë, duke mos krijuar hapësirën e nevojshme për transaksione konkurruese dhe rritjen e konkurrencës në këto segment të tregut.
17. Po kështu në ligjin 138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme" të miratuar më datë 2/05/2013, nuk janë marrë në konsideratë propozimet e Autoriteti të Konkurrencës. Neni 15 i këtij ligji garanton tregun e shitjes midis ndërmarrjes/ve gjeneruese dhe Furnizuesit Publik për një periudhë 15 vjeçare si dhe përcakton se tarifa e shitjes së energjisë do të jetë e miratuar nga ERE. Pra sipas këtij ligji, operatorët që do të prodhojnë energji të rinovueshme nuk do të konkurrojnë në treg të lirë po nëpërmjet kontrave 15 vjeçare do të shesin energjinë e prodhuar, me çmim të garantuar në një blerës që është KESH sha (FPSH)
18. Të dhënat e pasqyruara në Raport mbi sasinë e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, të siguruar nga ERE, kanë ndryshime të

konsiderueshme, nga ato të prezantuara nga INSTAT. Po kështu të dhënat mbi sasinë e humbjeve në rrjet dhe në shpërndarje dhe për rrjedhojë dhe sasia e energjisë të përdorur nga konsumatorët, të prezantuara nga INSTAT, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, gjatë vitit të kaluar dhe të axhustuara në vitin në vazhdim kanë ndryshime shumë të mëdha me vlerë prej miliarda lekë. Kjo mund të jetë një pasojë tjetër e mosdarrjes reale financiare të Furnizuesit Publik me Pakicë, nga OSSH, dhe të Furnizuesit me Shumicë nga KESH-sha, me pasojë burim abuzimi dhe shpërdorimi

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

I. Me qëllim mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike, për rritjen e konkurrencës në tregun përkatës së blerjes së energjisë elektrik, t'i rekomandojë Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, si vijon:

1. Në kushtet e ndryshuara, të rishikojnë procedurat e blerjes së energjisë elektrike mujore dhe vjetore për OSHEE sipas parimeve:

- a) Nxitjen e pjesëmarrjes në procedurat e blerjes së energjisë,
- b) Nxitja e konkurrencës ndërmjet blerësve;
- c) Sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e blerjes së energjisë;
- d) Sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e blerjes së energjisë elektrike dhe kosto sa me të ulëta për këto lloj transaksionesh.

2. Për periudhën afatshkurtër (meqënëse tenderat janë në periodicitet mujor) deri në miratimin e një rregullorje të re për blerjen e energjisë elektrike nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, të rishikohet vendimi 30, datë 23.3.2001 i ERE “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH sh.a....”:

-Duke ndryshuar nenin 13, pika 4, në mënyrë që pranimi, vleresimi dhe negociimi i ofertave të kryhet në prani të ofertuesve duke rritur në këtë mënyrë besueshmërinë e procesit dhe konkurrencën ndërmjet ofruesve.

- Duke ndryshuar neni 7 i rregullores i cili aktualisht përjashton nga procedurat e tenderimit prodhuesit vendas të licensuar, duke hapur tregun dhe lejuar të gjithë aktoret e tregut të marrin pjesë në procedurat e tenderit duke e bërë në këtë mënyrë me konkurrencës procesin.

3. Në draftimin e rregullave për blerjen e energjisë për operatorin e shpërndarjes të mbahen parasysh edhe parashikimet e vendimit nr. 30, datë 23.3.2011 “Për rregullat dhe procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga KESH Sh.A” në mënyrë të veçantë: të nenit 9/2 (Publikimi ftesës), nenit 11(kriteret e vlerësimit të ofertave sipas çmimit/njësi më të ulët, nenit 19 (publikimi në faqen zyrtare të internetit i procedurës së blerjes).

Gjithashtu mënyra e përcaktimit të oferëts fituese të përshtatet sipas rregullores së Ministrisë së Financave nr. 31, datë 27.12.2013 “Për emetimin e obligacioneve”, neni 13, pika 6, **“kërkesat konkurruese pranohen si fituese duke filluar nga ato që kanë çmimin më të ulët deri në plotësimin e sasisë së energjisë së kërkuar”**.

4. Duke marrë në konsideratë faktin që aktualisht në Shqipëri të gjitha procedurat e prokurimit publik janë në formë elektronike dhe realizohen nëpërmjet platformave përkatëse elektronike, kjo procedurë të parashikohet edhe në rregullat e blerjes së energjisë elektrike.

5. Për rritjen e transparencës dhe uljen e mundësive të abuzimeve, të bëhet publikimi mujor dhe vjetor i sasise dhe çmimit mesatar të energjisë elektrike të importuar, nga Enti Rregullator (ERE).

II. ERE dhe Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, në zbatim të neneve 69 dhe 70 të Ligjit duhet të sjellin për mendim pranë Komisionit të Konkurrencës, para miratimit, të gjitha aktet ligjore dhe nenligjore të funksionimit të tregut të energjisë, pasi kjo do të ndihmonte tregun e energjisë të zhvillohej dhe të bëhej më konkurrues.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës, ERE-s, ankimuesit dhe subjekteve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

nr. 335, datë 31.10.2014

Mbi

“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë nga shoqëria TransAtlantic Petroleum Ltd të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.10.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë nga shoqëria TransAtlantic Petroleum Ltd të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”), neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit TransAtlantic Petroleum Ltd / Stream Oil & Gas Ltd,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të “Kontratë Marrëveshjes” e lidhur më datë 2 Shtator 2014, ndërmjet palëve TransAtlantic Petroleum Ltd në cilësinë e blerësit dhe Stream Oil & Gas Ltd në cilësinë e shitësit me objekt transferimin e 100% të aksioneve të zakonshëm të Stream dhe për rrjedhojë të tre zonave të naftës dhe një zonë gazi dhe një liçencë kërkim-zbulimi në Shqipëri.

Transaksioni i cili realizohet në formën e përfutimit të kontrollit të plotë dhe të vetëm eskuziv mbi një ndërmarrje (Stream Oil & Gas Ltd dega Shqipëri) dhe sjell një ndryshim afatgjatë në ciësinë e kontrollit në këtë të fundit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit është përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- ❖ **TransAtlantic Petroleum Ltd (TransAtlantic)**, në cilësinë e **Blerësit**, është një shoqëri ndërkombëtare e cila funksionon në bazë të legjislacionit të British Columbia me seli në adresën: 885 East Georgia Street, kati 19, Vancouver, British Columbia. Shoqëria është themeluar më 1985 dhe është e angazhuar në blerjen, kërkimin, zbulimin, zhvillimin e gazit natyror dhe të naftës. Shoqëria nuk është prezente në Shqipëri.
- ❖ **Stream Oil & Gas Ltd (Stream)**, në cilësinë e **Shitësit**, është një shoqëri e cila funksionon në bazë të legjislacionit të Republikës së Kanadasë. E angazhuar në kërkimin, zbulimin, zhvillimin dhe prodhimin e gazit dhe naftës në tre zona nafte dhe një zonë gazi në Shqipëri. Stream zotëron 100% të kapitalit .

3. Xhiro për vitin 2013

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar**⁷⁵ është xxxx **Lekë**:
 - **TransAtlantic Petroleum Ltd** : xxxx \$⁷⁶ = xxxx Lekë
 - **Stream Oil & Gas Ltd** : xxxx \$⁷⁷ = xxxx Lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**⁷⁸: është xxxx **Lekë**:
 - **Stream Oil & Gas Ltd dega Shqipëri** : xxxx Lekë

⁷⁵ Burimi: Banka e Shqipërisë Kursi mesatar për vitin 2013, 1\$ = 105.67 lekë

⁷⁶ Burimi: Raporti Vjetor 2013 TransAtlantic, fq 44

⁷⁷ Burimi: Raporti Vjetor 2013 Stream Oil & Gas, fq 25

⁷⁸ Burimi: Pasqyrat Financiare të Audituarra viti 2013 të Stream Oil & Gas dega Shqipëri

Sa më lart, palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin12, pika 1 të Ligjit.

4. Tregu përkatës

4.1. Tregu përkatës i produktit:

Sipas rregullores mbi tregun perkates, treg përkatës produkti do të konsiderojmë: kërkimin, zbulimin dhe prodhimin e gazit natyror dhe i naftës.

4.2. Tregu përkatës gjeografik:

Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

5. Vlerësimi i konkurrencës

Aktualisht për kërkimin e naftës dhe gazit në Shqipëri, janë të lidhura disa Marrëveshje Hidrokarbure, në bazë të të cilave zhvillojnë aktivitetin e tyre një sërë kompanish.

Për vitin 2013 prodhimi i përgjithshëm i naftës në Shqipëri është 1.1 milionë ton. Kjo sasi përbën një vlerë prej 450 – 500 milion USD⁷⁹. Të ardhurat e realizuara për vitin 2013 nga Stream Oil&Gas - dega Shqipëri janë afërsisht në shifrën e xx milion USD. Sa më sipër Stream Oil&Gas – dega Shqipëri dhe respektivisht Stream Oil & Gas LTD zënë një pjese tregu prej xx% - xx%.

Nga pikpamja ekonomike, palët besojnë se kjo blerje përbën një transaksion të dobishëm në kuptimin strategjik dhe ekonomik pasi TransAtlantic është financiarisht më e fuqishme se Stream dhe ka eksperiencë më të madhe në zhvillimin e zonave të prodhimit të naftës në krahasim me Stream.

Nga pikpamja e investimeve në tregun shqiptar TransAtlantic dhe Stream besojnë se transaksioni në fjalë do të sjell më shumë investime në Shqipëri dhe gjithashtu ekspertiza e TransAtlantic do të rezultojë në një veprimtari më eficiente në Shqipëri.

Si konkluzion përqëndrimi TransAtlantic vs Stream Oil në formën e ndryshimit të qëndrueshëm nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të Stream rezulton në kontrollin e Stream dhe për pasojë Stream Albania e cila do të kthehet në një shoqëri degë e zotëruar plotësisht prej TransAtlantic.

Meqënëse pala përfituese e kontrollit, TransAtlantic nuk është prezente në tregun shqiptar dhe përqëndrimi i njoftuar shfaqet si zëvendësim pronësie, atëherë për pasojë përqëndrimi i njoftuar nuk do të ketë asnjë efekt në ndryshimin e strukturës së tregut

⁷⁹ Burimi: Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqëndrimit.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye duhet të autorizohet në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë e përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të plotë nga shoqëria TransAtlantic Petroleum Ltd të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd.
2. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
Nr.336, datë 11.11.2014**

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë
celulare ndaj shoqërisë Vodafone SH.A”**

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Sevrete Gruda, Znj. Iva Zajmi dhe Z. Eduard Ypi, në mbledhjen e tij të datës 11.11.2014, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i vlerësimit të ankesës së shoqërisë “Plus Communication” ndaj shoqërisë “Vodafone SH.A” për abuzim me pozitën dominuese në tregun e pakicës

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 29/1 dhe neni 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Vlerësimit nga Sekretariati i ankesës së ndërmarrjes “Plus Communication” ndaj ndërmarrjes “Vodafone SH.A” dhe relacionit shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN SE :

1. Shoqëria “Plus Communication SHA (PLUS) me anë të shkresës së saj nr. 950 prot., datë 13.10.2014, ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe për dijeni Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), një ankim kundër ndërmarrjes Vodafone Albania për abuzim në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri.

2. Në tregun përkatës të telefonisë celulare të pakicës ndërmarrja Vodafone Albania SHA zotëron pozitën dominuese sipas përcaktimeve të vendimit nr.303 të Komisionit të Konkurrencës për periudhën 2011-2012. Edhe për vitin 2013, sipas të dhënave të AKEP në dokumentin e “Analizës së tregut të telefonisë celulare”, struktura dhe pjesët e tregut për vitin 2013 nuk kanë ndryshime domethënëse. Për këto arsye Autoriteti ka vendosur ta zgjasë periudhën hetimore përtej kërkesës së ankimesit duke përfshirë edhe 6 mujorin e parë të vitit 2014.
3. Autoriteti i Konkurrencës ka konstatuar shqetësime në tregun e telefonisë së lëvizëshme dhe ka adresuar rekomandime AKEP-it, si dhe ka vlerësuar ankesën sipas parashikimeve të neneve 29/1, 8, 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) lidhur me kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës në tregun përkatës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, pika d, neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj shoqërisë Vodafone SH.A për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
2. Periudha e hetimit do të jetë 1 Janar 2013-30 Qershor 2014.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se tre muaj nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Eduard YPI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

nr.337, datë 11.11.2014

“Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11/11/2014, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të vleresimit të kontratës së koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja f), si dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Raportit të vleresimit të kontratës së koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, si dhe relacionin shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në shqetësimet e komunitetit të biznesit të bëra prezent në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet mediave, realizoi procesin e vlerësimit të marrëveshjes koncesionare për ofrimin e shërbimit publik të pullave fiskale.
2. Marrëveshja e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe shoqërisë SICPA Holding SA është nënshkruar në 30 nëntor 2012. Shoqëria koncesionare SICPA HOLDING SA është një shoqëri anonime e regjistruar sipas kuadrit ligjor të Zvicrës.
3. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 922, datë 02.09.2009 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të prodhimit e të kontrollit të pullave fiskale dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë", i identifikuar si investim dhe shërbim me interes publik nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, si Autoritet Kontraktues u përcaktua Ministria e Financave.
4. Si rezultat i ushtrimit të këtij aktiviteti ekonomik, koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktor një vlerë që përfaqëson vetëm 2% të të ardhurave të tij vjetore të realizuara nga shitjet e pullave fiskale dhe pullave të kontrollit të bamave.
5. Nga krahasimi i çmimeve të pullave fiskale para dhe pas dhënies së koncesionit rezulton se për cigaret dhe alkoolin çmimet e pullave janë rritur rreth 4 herë duke përbërë kosto të shtuar për biznesin.
6. Çmimi i shitjes së pullave fiskale para marrëveshjes koncesionare ka qënë: Pullat fiskale të cigareve 0.49992 leke / copa me tvsh dhe pullat fiskale të pijeve 1.20 (nje.dy) leke / copa me tvsh. Pas dhënies së koncesionit çmimi i pullës fiskale ka ndryshuar si vijon: për duhanin 2.7 lekë, 4.4 lekë për alkoolin, 3 lekë për birrën dhe 2.9 lekë për ilaçet.
7. Nga vlerësimi i marrëveshjes koncesionare rezulton se:
 - a) Para lidhjes së marrëveshjes së koncesionit nuk janë respektuar dispozitat e Ligjit 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" i ndryshuar, dhe konkretisht nuk është respektuar neni 69 i Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" sipas të cilit duhet të ishte marrë vlerësimi i Autoritetit.
 - b) Autoriteti i Konkurrencës ka detyrimin ligjor për vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta të dhëna në territorin e Republikës së Shqipërisë referuar nenit 2 pika c e Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, si dhe detyrimeve në kuadër të respektimit të marrëveshjes së Stabilizim Associmit (AK është lider dhe koordinatori i kapitullit 8 dhe ka detyrimin për të raportuar mbi të drejtat e veçanta dhe ekskluzive në territorin e Shqipërisë).
 - c) Vendimi i Këshillit të Ministrave për caktimin e Ministrisë së Financave si Autoritet Kontraktor dhe dhënien e bonusit prej 5% për shoqërinë ICPA Security Solution SA, ka shkelur parimet e konkurrencës së lirë

duke e vendosur në kushte të pabarabarta shoqërinë tjetër konkurruese.

8. Nga ana e Komisionit të Konkurrencës është kërkuar vlerësimi i Ministrisë së Financave mbi arsyetimin dhe justifikimin ekonomik të koncensionit në kuptimin që dhënia e një të drejte ekskluzive për një operator privat që është pasuar me rritjen e kostos së biznesit për pullat fiskale nëse ka patur apo jo efekt në qëllimin për të cilin është dhënë koncensionin, rritjen e të ardhurave fiskale dhe luftën ndaj evazionit dhe kontrabandës së produkteve të akcizës.
9. Ministria e Financave në shkresën nr 372/2, datë 06.10.2014, shprehet se nuk ka një vlerësim ekonomik për koncensionin e dhënë as në fazën paraprake(ex-ante) dhe as në fazën aktuale(ex-post).
10. Gjithashtu i është kërkuar koncensionarit informacion i detajuar mbi koston, investimet dhe informacionin perkates qe lidhej me procesin e marrjes se koncesionit. Koncesionari me anë të shkresës 372/3, datë 8.10.2014, ka dërguar kontratën koncensionare dhe pasqyrat financiare, por jo argumenta dhe analizën shoqeruese mbi justifikimin ekonomik të marrëveshjes koncensionare.
11. Zbatimi i koncensionit për prodhimin e pullave fiskale per barnat nuk është realizuar deri më sot. Vendosja e nje tarife 2.3 leke/cope me e larte e pulles fiskale për çdo medikament do të ishte një kosto e lartë për produktet farmaceutike, të cilat kanë ndjeshmeri shume te larte tek konsumatori.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,
 - 1.1. Të kryejnë vlerësimin ekonomik dhe teknik mbi zbatueshmërinë e kushteve të kontratës koncensionare dhe analizën e justifikimit ekonomik të koncensionit, i cili është pasuar me rritjen e kostos së biznesit për pullat fiskale. Në këtë vlerësim të identifikohet permbushja e qëllimit për të cilin është dhënë koncensionin, si rritjen e të ardhurave fiskale dhe luftën ndaj evazionit dhe

kontrabandës së produkteve të akcizës.

- 1.2. Rishikimin e kontratës koncionare, për pjesën e pullave fiskale për barnat pasi konstatohet se nuk ka filluar prodhimi i tyre, si dhe sjell kosto të lartë për produktet farmaceutike të cilat kanë një ndjeshmëri shumë të lartë.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Eduard YPI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

nr. 338, datë
11.11.2014

**“Mbi përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes-Tip mes shoqërisë
“Digitalb” SH.A dhe operatorëve televizivë”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar
Eduart	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.11.2014 shqyrtoi çështjen
me:

Objekt: Raporti (i rishikuar) i “Përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjes
midis Digitalb-Operator Televiziv”, pas parashtrimeve të Digitalb
në seancë dëgjimore të datës 24.10.2014.

Baza ligjore: Nenet 5, 24, *shkronja d*, neni 49 dhe neni 50 (*pika 1*), të
Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e
konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të rishikuar të “Përjashtimit
nga ndalimi i marrëveshjes midis Digitalb - Operator Televiziv”, parashtrimeve të
Digitalb në seancë dëgjimore të datës 24.10.2014 dhe relacionit shoqërues të
Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

Në datën 14.07.2014 Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 5 dhe 48 e në vijim të Ligjit, ka marrë njoftimin nga ndërmarrja Digitalb SH.A për kërkesën për përjashtim nga ndalimi të marrëveshjes “DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV” me objekt mbartja e kanaleve TV ne platformën numerike Digitalb.

Me marrjen e informacionit të plotë është publikuar një njoftim paraprak për shtyp në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës për shprehjen e interesit nga palët e treta. Gjatë periudhës 30 ditore të publikimit nuk ka patur asnjë reagim nga palë të treta në adresat e publikuara të Autoritetit të Konkurrencës.

II. Palët në marrëveshje

Digitalb SH.A – është një shoqëri aksionere, e cila ka si objekt të aktivitetit të saj prodhimin, transmetimin dhe shitjen në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video. Digitalb është regjistruar si operator platforme numerike kombëtare satelitore. Shoqëria “Digitalb” ka filluar transmetimet prej korrikut 2004.

Operatorët Televizivë – janë operatorët televizivë të cilët sipas Digitalb kanë shprehur gatishmërinë e përfshirjes në këtë marrëveshje si më poshtë: Shop Tv, Klan Tv, Top Channel, Ora News, News 24, ABC News, A1 Report, UTV News, Supersonic, STV Folk, Kanali i Folklorit, Scan TV, Channel One, Albanian Screen.

III. Përshkrimi i marrëveshjes

Objekt i marrëveshjes (Kontratës Tip) së paraqitur nga Digitalb SH.A është mbartja e kanaleve TV në platformën numerike Digitalb të: TOP CHANEL, SHOP TV, KLAN TV, ORA NEWS, NEWS-24, ABC NEWS, A1 REPORT, UTV NEWS, SUPERSONIC, STV FOLK, KANALI FOLKLORIT, SCAN TV, CHANEL ONE, ALBANIAN SCREEN.

Qëllimi i marrëveshjes, është përfshirja në platformën satelitore të kanaleve televizive të 14 operatorëve televizivë, i cili konsiston në ritransmetimin e sinjalit të kanalit në valë satelitore në kohë reale (live) dhe pa asnjë ndërhyrje në kanal in origjinal.

IV. Tregu përkatës

IV.1. Tregu përkatës i produktit

Referuar marrëveshjes, Digitalb ofron shërbimin e përfshirjes në platformën satelitore të kanalit televiziv, ku shërbimi konsiston në ritransmetimin e sinjalit të kanalit në valë satelitore. Ritransmetimi i njëkohshëm në kuptim të shërbimit është transmetimi i kanalit televiziv në kohë reale (live) dhe pa asnjë ndërhyrje në transmetimin origjinal. Si konkluzion, treg përkatës produkti do të konsiderohen transmetimet me pagesë të përmbajtjes televizive.

IV.2. Tregu përkatës gjeografik

Meqenëse shërbimi përkatës ofrohet në të gjithë territorin atëherë si treg gjeografik, do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

V. Analiza e Konkurrencës

Ky treg rregullohet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, me anë të Ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Transmetimet televizive në Shqipëri janë në një masë të madhe të liberalizuara dhe realizohen në forma të ndryshme, qoftë transmetime të hapura analoge toksore apo satelitore, qoftë numerike toksore apo satelitore, kabllore.

Operatorët televizivë që kryejnë transmetime të përmbajtjes televizive janë gjerësisht të përhapur. Transmetime të përmbajtjes televizive kryhen edhe në internet, apo nëpërmjet IPTV, ku operatorët e shpërndarjes së internetit në Shqipëri janë të shumtë.

Si rrjedhim, shkalla e zëvendësueshmërisë së kërkesës është e lartë dhe konsumatori mund të përfitojë përmbajtje televizive në mënyra nga më të ndryshmet dhe pavarësisht nga transmetimi ose jo i këtyre kanaleve në platformat e televizionit me pagesë.

Në platformën tokësore, nga 53 kanale që transmetohen aktualisht, vetëm 7 kanale janë ato që kanë lidhje me DGA, ndërkohë që në platformën satelitore nga 78 kanale të saj vetëm 14 janë pjesë e marrëveshjes individuale të kërkuar për përjashtim.

V.1.1 Përfitimet e marreveshjes

a) Marrëveshja vertikale kontribuon për përmirësimin e shpërndarjes;

Teknologjia e ofruar nga DGA në transmetimin për publikun e gjere është në nivelin më të lartë dhe transmetimi në high definition në disa lloj formatesh që operatorë të tjerë nuk mund të ofrojnë, si dhe zgjerohet zona e mbulimit duke përfshirë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) Marrëveshja vertikale i lejon konsumatorit të ketë një pjesëmarrje të drejtë në këto përfitime;

Konsumatorët final përfitojnë nga marrëveshja qoftë në mënyrë sasiore, duke qenë se u rritet oferta, pra u shtohen kanalet televizive që mund të përfitojnë ndërmjet transmetimeve satelitore e numerike tokësorë të Digitalb, qoftë cilësia e ofertës, duke qenë se transmetimet dhe përmbajtja televizive që do të përfitojnë do të jenë më cilësore, duke qenë se vetë operatorët televizivë kane përfitime financiare nga marrëveshja, te cilat ndikojnë në prodhimin e ofrimin e një programacioni më cilësor.

c) Marrëveshja vertikale nuk i vendos ndërmarrjeve nënshkruese kufizime vertikale, të cilat nuk janë të nevojshme për arritjen e këtyre përfitimeve.

Bashkëpunimi i vendosur me anë të marrëveshjes sjell disa benefite për operatorin televiziv palë të marrëveshjes. Gjithashtu, me anë të zbatimit të Marrëveshjes operatori televiziv i përgjigjet në mënyrë më cilësore rritjes se presionit konkurrues nga operatorët e tjerë televiziv dhe një tregu të ndryshueshëm, i cili në vetvete sjell rritje të progresit teknologjik dhe rrit dinamikën e tregut qoftë për operatorin televiziv palë në marrëveshje dhe për operatorët e tjerë televizivë operues në treg.

d) Nuk kufizon në mënyrë të ndjeshme konkurrencën në lidhje me produktet, shërbimet objekt i marrëveshjes

Kufizimi i vendosur për ekskluzivitetin është i nevojshëm për arritjen e marrëveshjes dhe nuk egzistojnë më pak kufizime për të arritur përfitime të ngjashme. Ky kriter ka lidhje nëse operatori objekt i marrëveshjes ka pozitë dominuese. DGA solli argumente të tjera nga ato të paraqitura në formularin e njoftimit mbi pjesën e tregut të DGA pasi përfshin Pay TV dhe pjesa e tregut rreth 37% nuk rezulton që DGA të jetë në pozitë dominuese.

Gjithashtu aksesit i konsumatorëve(shikuesve) në kanalet televizive objekt të marrëveshjes është i mundur në pjesën më të madhe të vendit pavarësisht aksesit të shikuesve në platformën e Digitalb Albania.

Transmetimi nëpërmjet kësaj platforme e ka zgjeruar tregun gjeografik për kanalet kombëtare (Klan dhe Top Channel) për zonat ku nuk mbulojnë me valë si dhe ka rritur gjeografikisht në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar edhe për

kanalet lokale(p.sh. News 24, Ora News, Scan Tv) të cilët janë të licensuar vetëm për rajone të caktuara (nivel qarku).

e) Kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë deri për një periudhë të kufizuar, deri në fund të vitit 2015

Lidhur me këtë pikë situata në tregun e transmetimeve televizive me pagesë (Pay Tv) dhe medias vizuale në tërësi do të ndryshojë përpara kësaj date kur Shqipëria në bazë të ligjit “Për dixhitalizimin” do të duhet të kalojë nga transmetimet analoge në transmetime të plota dixhitale deri në qershor të vitit 2015. Ky evoluim teknologjik pritet të ketë efekte edhe në mënyrën e funksionimit të tregjeve të transmetimeve me pagesë dhe do të ridimensionojë mënyrën e funksionimit dhe konkurrencën në treg mes televizionit publik dhe platformave të transmetimit dixhital.

V.1.2 Kufizimet

- 1) Operatori i cili do të përfshihet në marrëveshje është i detyruar që të mos ofrojë për transmetim kanalën ndaj asnjë platforme/operator tjetër satelitor, tokësor, dixhital, kabllor, apo çdo formë tjetër transmetimi, me apo pa pagesë brenda Territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç platformës Digitalb.
- 2) Operatori TIP nuk mund të transmetojë në faqen e saj të internetit në kohë reale, apo në transmetim direkt si dhe nuk mund të jete pjesëmarrës, apo negociues në tendera që transmetojnë evente sportive Pay TV.
- 3) Digitalb përfiton të drejtën ekskluzive të transmetimit dhe distribucionit televiziv të kanalit në të gjitha format e njohura të transmetimit (satelitor, tokësor, kabllor, internet, Pay Tv, Free Tv, PPV, IPTV, mobile etj) Digitalb me anë të kësaj kontrate është zotëuesi i vetëm i të drejtave për distribucionin e kanalit për ritransmetimin e njëkohshëm apo të vonuar në çdo mënyrë transmetimi etj.

VI. Konkluzionet

Nga vlerësimi i marrëveshjes së paraqitur për përjashtim, pas një analize të hollësishme të përfitimeve dhe kufizimeve të marrëveshjes, konkludohet se marrëveshja ka si objekt dhe pasojë disa kufizime të konkurrencës, por nga krahasimi i përfitimeve me kufizimet e marrëveshjes, arrihet në konkluzionin se sipas parashikimeve të nenit 5 të Ligjit dhe udhëzimit për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale marrëveshja plotëson kushtet për përjashtim nga ndalimi si vijon:

- 1) Aksesin e abonentëve të kanalet kombëtare dhe lokale është i mundur, pavarësisht transmetimeve të Digitalb dhe kjo e fundit ka rritur mbulimin gjeografik nëpërmjet ritransmetimit për kanalet kombëtare dhe lokale;
- 2) Marrëveshja vertikale kontribuon për përmirësimin e shpërndarjes, duke qënë se i ofron publikut një mundësi shtesë (edhe në zonat e pambuluara

- me sinjal analog të televizioneve të licensuara);
- 3) Marrëveshja vertikale i lejon konsumatorit të ketë një pjesëmarrje të drejtë në këto përfitime;
 - 4) Marrëveshja vertikale nuk i vendos ndërmarrjeve nënshkruese kufizime vertikale, të cilat nuk janë të nevojshme për arritjen e këtyre përfitimeve;
 - 5) Nuk kufizon në mënyrë të ndjeshme konkurrencën në lidhje me produktet shërbimet objekt i marrëveshjes;
 - 6) Kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë deri për një periudhë të kufizuar, deri në fund të vitit 2015, qe perkon me fundin dhe vetshfuqizimin e kontratave mes paleve lidhur mbi bazen e marreveshjes se perjashtuar.
 - 7) Lidhur me kriterin e ekskluzivitetit, për të cilin disa nga palët sollën përgjigje se është kryer mbi bazën e përfitimeve të dyanshme dhe me vullnet të plotë dhe se ka argumente (si p.sh. mbrojtja e të drejtës së autorit dhe rritja e cilësisë së transmetimit) për kufizimin e vendosur për ekskluzivitetin është i nevojshëm për arritjen e marrëveshjes dhe nuk egzistojnë më pak kufizime për të arritur përfitime të ngjashme;

Sa më sipër bazuar edhe në nenin 5 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni Konkurrencës çmon se marrëveshja-tip ndërmjet “Digitalb dhe Operatorëve televizivë” duhet të përjashtohet nga ndalimi, pasi kontribuon në përmirësimin e shpërndarjes, nxitjen e progresit teknologjik, si dhe se një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në përkrahje të interesave të klientëve dhe konsumatorëve.

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve, përkatësisht: 24, (shkronja d); 5; 50; të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar),

V E N D O S I:

- I. Të përjashtojë nga ndalimi marrëveshjen-tip ndërmjet “Digitalb me Operatorët televizivë” deri më date 31.12.2015.
- II. Çdo ndryshim ose amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët, por edhe rilidhje e saj pas afatit të saj të shfuqizimit më 31.12.2015, do duhet t'i rinjoftohet për përjashtim Autoritetit të Konkurrencës.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për dërgimin e vendimit palëve të interesuara pasi të bëhen pagesat e parashikuara në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Eduard

(_____)

Anëtar

YPI

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
nr. 339, datë 24.11.2014**

“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 324, datë 30.07.2014, të Komisionit të Konkurrencës mbi kushtet dhe detyrimet ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.11.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të monitorimit mbi zbatimin e Vendimit nr. 324, datë 30.07.2014 të Komisionit të Konkurrencës

Baza ligjore: Nenet 4, pika 1, 24, 45, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, këtu dhe me poshtë Ligji.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e monitorimit mbi zbatimin e Vendimit nr. 324, datë 30.07.2014 të Komisionit të Konkurrencës nr. 194 prot., datë 19.11.2014;
- Informacioneve të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, përkatësisht: Sigal Uniqa Group Austria Sh.A, Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A, Atlantik ShA, Intersig Vienna Sh.A, Albsig Sh.A, Insig Sh.A, Eurosig Sh.A dhe Ansig Sh.a.

VËREN SE :

1. Me anë të Vendimit nr. 310, datë 31.03.2014, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve

të treta”, ndaj 9 (nëntë) ndërmarrjeve vijuese, që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg: Sigal Uniq Group Austria Sh.A, Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group Sh.A, Atlantik ShA, Intersig Vienna Sh.A, Albsig Sh.A, Insig Sh.A, Eurosig Sh.A dhe Ansig Sh.a.

2. Në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar dhe pas dëgjimit të palëve dhe të angazhimeve të marra nga ato, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 324, datë 30.07.2014, vendosi kushte dhe detyrimeve ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
3. Në zbatim të këtij Vendimi, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës është nxjerrë Urdhri nr. 68, datë 30.10.2014, për të kryer monitorimin e zbatimit nga ana e shoqërive të sigurimeve të kushteve dhe detyrimeve të vendosura me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 324, datë 30.07.2014 si vijon:
 - A. Vënien në funksionim të programit Bonus-Malus për sistemin e individualizuar të sigurimit të detyrueshëm bazuar në të dhënat e të siguruarit, mjetit, historikut të dëmeve të shkaktuara dhe vendndodhjes;
 - B. Ofrimi i shoqërisë së sigurimit sipas kërkesës së të siguruarit. Në sistemin e ofruar nga shoqëritë e brokerimit dhe agjentët e shoqërive të sigurimit duhet të shfaqen në kohë reale logot e të gjitha shoqërive të sigurimit me te cilat agjenti ose brokeri ka marrëveshje për tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorik;
 - C. Të zbatojnë parashikimin ligjor për pagesën e dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë;
 - D. Të lidhin marrëveshje me më shumë se 1 shoqëri brokerimi sipas kriterëve të parashikuara nga AMF-ja lidhur me sistemin online të sigurimeve të detyrueshme dhe sistemit bankar për pagesat sipas legjislacionit në fuqi;
 - E. Shtypja dhe tregtimi i policave të sigurimit me logon e secilës ndërmarrje;
4. Në zbatim të Urdhrit të mësipërm, nga ana e Grupit të Punës janë kryer inspektime pranë agjentëve të të gjitha ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve për të parë mënyrën e zbatimit të kushteve dhe detyrimeve nga ana e ndërmarrjeve.
5. Gjithashtu nga ana e të gjitha ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve është dërguar informacion në lidhje me zbatimin e kushteve dhe detyrimeve të vendosura me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 324, datë 30.07.2014.

A. Zbatimi angazhimit për vënien në funksionim të programit Bonus-Malus

6. Në lidhje me sistemin Bonus-Malus, nga monitorimi rezultoi se në sistemin e shitjes janë kryer ndryshime kryesisht në plotësimin e të dhënave të klientit ku tani me vendosjen e targës së automjetit të dhënat e tjera plotësohen automatikisht nga sistemi. Por për të njëjtën kategori sigurimi, nuk ka ndryshim primi nga klienti në klient për të njëjtën shoqëri sigurimi gjë që tregon se në sistem nuk është implementuar plotësisht sistemi bonus-malus që mundëson individualizim të primeve sipas historikut të dëmeve,

kohëzgjatjes së patentës, moshës së të siguarit dhe elementëve të tjerë që individualizojnë primin e rrezikut.

7. Sipas shoqërive të sigurimeve sistemi Bonus Malus është i aktivizuar pasi shitja kryhet nëpërmjet përpunimit të të dhënave që gjeneron sistemi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Policisë. Sipas shoqërive, tashmë primi i sigurimit përcaktohet mbi disa parametra risku, të cilët lejojnë vlerësimin e primit të sigurimit të detyrueshëm motorik bazuar edhe në historikun e të siguarit. Shoqëritë shprehen se kanë kryer me sukses në muajin gusht 2014 testin e funksionimit të sistemit me të dhëna hipotetike. Por ky sistem mbetet ende në fazë eksperimentale, pasi kërkohet përfshirja e të dhënave për dëmet dhe këtu nevojitet edhe roli i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
8. Nga ana e AMF me anë të shkresës nr. 1662/1 prot., datë 15.08.2014 bëhet e ditur se po punohet për projektimin dhe vënien në zbatim të këtij sistemi, por që ende nuk është vënë në funksionim pasi kërkon më shumë kohë.
9. Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë detyrim të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në pikën (1.a) të VKK nr. 324, datë 30.07.2014, rezulton se sistemi Bonus-Malus nuk është vënë në funksionim, por ndërmarrjet kanë bërë përpjekjet që nevojiten nga ana e tyre për vënien në funksionim të sistemit Bonus-Malus, por nuk është zbatuar plotësisht brenda afatit të vendosur në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës, pasi, sipas tyre, mungojnë të dhënat në lidhje me dëmet të cilat mundësohen nga AMF-ja.

B. Ofrimi i shoqërisë së sigurimit sipas kërkesës së të siguarit

10. Gjatë procesit të monitorimit pranë agjentëve dhe pikave të shitjes së shoqërive është vërejtur mënyra e shfaqjes së ofertave (logot) nga shoqëritë e sigurimit në sistemin e shitjes. Nga monitorimi konstatojmë se ndërmarrja Insig Sh.A përdor sistemin e saj të shitjes dhe si zgjedhje shfaqet vetëm ajo ndërmarrje. Të gjitha ndërmarrjet e tjera përdorin sistemin e shitjes MSHM. Në agjentët e ndërmarrjeve Sigal dhe Albsig u vërejt se shfaqej vetëm një ndërmarrje, respektivisht Sigal dhe Albsig. Në agjentët e ndërmarrjeve të tjera shfaqen logot e të gjitha ndërmarrjeve, përveç INSIG, dhe agjenti mund të zgjedhë sipas kërkesës së klientit shoqërinë e sigurimit që dëshiron të lidhë kontratën.
11. Referuar rezultateve të mësipërme të monitorimit në lidhje me këtë detyrim të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në pikën (1.b) të Vendimit nr. 324, datë 30.07.2014, rezulton se ky detyrim i vendosur nga Komisioni i Konkurrencës është zbatuar nga ana e ndërmarrjeve.

C. Zbatimi i angazhimit për pagesën e dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë;

12. Në lidhje me këtë angazhim, nga pothuajse të gjitha ndërmarrjet është informuar se për zbatimin e përcaktimeve ligjore për pagesën e dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë janë draftuar marrëveshjet përkatëse, të cilat disa ndërmarrje i kanë vënë në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës.

13. Për të mundësuar trajtimin e dëmeve nga siguruesi i drejtpërdrejtë, nga ana e shoqërive konstatohet një vakum në rregullore, udhëzime dhe akte rregullative të unifikuara në drejtim të vlerësimit të dëmeve motorike, mungesa e të cilave krijon kushte për shumë subjektivizëm dhe vështirëson bashkëveprimin.
14. Por hartimi i këtyre rregulloreve, nuk mund të kryhet individualisht nga kompani të veçanta, por në mënyrë të përqendruar nga institucioni përgjegjës rregullator AMF, e cila duhet t'i përgjigjej vullnetit të shoqërive të sigurimit me hartimin e akteve nënligjore sipas përcaktimeve në ligj, të cilat të jenë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha ndërmarrjet.
15. Në rregulloret që duhet të hartohen nga AMF, pavarësisht marrëveshjeve të lidhura mes shoqërive të sigurimit, duhet të përcaktohet saktë bashkëveprimi midis kompanive, detyrimi për pagesat e dëmeve si dhe rimbursimi i tyre nga kompanitë përgjegjëse të dëmit, ndaj kompanive të drejtpërdrejta që kanë paguar demin, për të shmangur zgjidhjen e konflikteve midis kompanive në rrugë gjyqësore dhe që marrëveshjet midis kompanive të kenë baze ligjore.
16. Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë detyrim të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në pikën (1.c) të Vendimit nr. 324, datë 30.07.2014, rezulton se nga ana e ndërmarrjeve është shprehur vullnet për vënien në funksion të pagesës së dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë, duke draftuar dhe kontrata midis tyre, por nevojitet miratimi i akteve nënligjore nga ana e AMF-së, ashtu si ka rekomanduar dhe Komisioni i Konkurrencës në Vendimin nr. 325, datë 30.07.2014.

D. Zbatimi i detyrimit për lidhjen e marrëveshjeve me më shumë se një broker

17. Nga ana e shoqërive të sigurimit, në shkresat e tyre të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, lidhur me marrëveshjet me më shumë se një shoqëri brokerimi janë paraqitur të gjithë brokerat me të cilët ata kanë marrëveshje brokerimi, të cilat jepen në tabelën e mëposhtme:

NR	Shoqëritë e Sigurimeve	Brokerat me të cilat janë lidhur
1	Sigal	Ifis Broker, First Broker, Star Broker, wVP sh.a. brokera të tjere
2	Eurosig	Star Broker, A-eja Insurance Broker, 3B Broker, All-Sig, Ifis Broker
3	SigmaInteralbanian (SIVIG)	Star Broker, Ifis Broker, First Broker, All-Sig Broker, A-eja Insurance Broker, WVP sh.a etj gjithashtu me shoqëri agjentesh si UDSA që ka mbi 150 agjent.
4	Atlantik	First Broker, IFIS Broker, Star Broker, brokera të tjere
5	Intersig	Mai Broker, Star Broker, Ifis Broker dhe brokera të tjerë që po standartizojnë shitjen on-line.
6	Albsig	DEVON sh.a, Star Broker, Ifis Broker

7	Insig	Star Broker, IFIS Broker, 3B Broker
8	Ansig	First Broker, Star Broker, brokera te tjere

18. Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se nga ana e Shoqërive të sigurimit nuk ka marrëveshje vetëm me një broker por me disa prej tyre dhe në lidhje me këtë detyrim të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në pikën (1.d) të Vendimit nr. 324, datë 30.07.2014, rezulton se ky detyrim i vendosur nga Komisioni i Konkurrencës është zbatuar nga ana e ndërmarrjeve.

F. Shtypja dhe tregtimi i policave të sigurimit me logon e secilës ndërmarrje

19. Lidhur me këtë detyrim të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës, janë monitoruar Policat e Sigurimit që shtypeshin dhe tregtoheshin nga agjentët e shoqërive të sigurimit. Nga monitorimi vërehet se Policat e Sigurimit shtypen dhe tregtohen me logon e secilës shoqëri sigurimi, e cila shfaqet në momentin e printimit të policës, me përjashtim të ndërmarrjes Insig dhe Albsig, policat e të cilave kishin paraprakisht të vendosur vulën e këtyre ndërmarrjeve. Policat e Sigurimit të paplotësuar, të gjendura pranë Agjentëve të Shoqërive të sigurimit, kishin paraprakisht të vendosur vulën e Star Broker, me përjashtim të ndërmarrjes Insig.

20. Secila prej ndërmarrjeve, pothuajse në terma të njëjta është shprehur se shtypja dhe tregtimi i policave të sigurimit bëhet me logon e shoqërisë përkatëse dhe vetëm më pas pranohet dhe nënshkruhet nga i siguruari, i cili ka të drejtën e zgjedhjes (të pranimit apo refuzimit).

21. Sistemi i shitjes online të kontratave të sigurimit të detyrueshëm mundëson përzgjedhjen, printimin (shtypjen) me logo të veçantë të shoqërisë të sigurimit sipas kërkesës së të siguruarit, duke siguruar që ato kanë bere ndërhyrjet e duhura për mundësinë e zgjedhjes konsumatore sipas kërkesës se te siguruarit për shoqërinë.

22. Në lidhje me këtë pikë, ndërmarrja Insig shprehet se shtypja dhe tregtimi i policave të sigurimit behet me logon e saj. Insig ka bashkëngjitur përgjigjen e AMF-së me shkresën Nr. 2196/1, datë 28.10.2014, ku citohet: Shitja e kontratave të sigurimit të detyrueshëm bëhet në përputhje me nenin 38 të ligjit Nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" të ndryshuar, të Rregullores për Regjistrimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, si dhe Rregullores për regjistrin elektronik të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm, miratuar me vendimin e Bordit Nr. 3, datë 03.10.2001, i ndryshuar. Kontratat e sigurimit, të cilat shiten nëpërmjet regjistrin online të sigurimit të detyrueshëm motorik, printohen dhe tregtohen me logon e secilës shoqëri sigurimi që konfirmon dhe njëherë që kontratat e sigurimit printohet dhe tregtohen me logon e secilës kompani".

23. Referuar rezultateve të mësipërme të monitorimit, në lidhje me këtë detyrim të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në pikën (1.e) të Vendimit Nr. 324, datë 30.07.2014, rezulton se ky detyrim i vendosur nga Komisioni i Konkurrencës është zbatuar nga ana e ndërmarrjeve.

24. Si përfundim, referuar sa më sipër, arrijmë në përfundimin se ndërmarrjet kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 324, datë 30.07.2014, lidhur me ofrimin e **shoqërisë së sigurimit sipas kërkesës së të siguruarit, zbatimin e detyrimit për lidhjen e marrëveshjeve me më shumë se një broker dhe shtypjen dhe tregtimin e policave të sigurimit me logon e secilës ndërmarrje**, ndërsa lidhur me detyrim e vendosur në pikën (1.a), për sistemin Bonus Malus, dhe detyrimin e vendosur në pikën (1.c), për pagesën e dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë, **nevojitet ndërhyrja e AMF dhe miratimi i akteve nënligjore nga ana e AMF-së, ashtu si ka rekomanduar dhe Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 325, datë 30.07.2014.**

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, pika d dhe nenit 45, pika (1) dhe (2), të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", (i ndryshuar),

V E N D O S I:

- I. Mbyllet e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta ndaj ndërmarrjeve: Sigal Uniqa Group Austria Sh.A, Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A, Atlantik ShA, Intersig Vienna Sh.A, Albsig Sh.A, Insig Sh.A, Eurosig Sh.A dhe Ansig Sh.a.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Eduard YPI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 340 , datë 27.11.2014

Mbi

“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur CMA CGM Albania Sh.p.k nga ndërmarrjet CMA CGM Agencies Worldwide dhe Pelikan Sh.p.k ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|---------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |
| • | Eduard | YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 27.11.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur CMA CGM Albania Sh.p.k nga ndërmarrjet CMA CGM Agencies Worldwide dhe Pelikan Sh.p.k.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”), neni 24, shkronja d, nenet 10-12, 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”,Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit” dhe “Udhëzimi mbi kontrollin e përqendrimit të ndërmarrjeve” .

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit CMA CGM Albania Sh.p.k / CMA CGM Agencies Worldwide / Pelikan Sh.p.k,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të “Marrëveshjes së Ortakëve” e lidhur më datë 25 Qershor 2014, ndërmjet palëve CMA CGM Agencies Worldwide dhe Pelikan Sh.p.k në cilësinë e ndërmarrjeve mëmë, me objekt krijimin e ndërmarrjes së re të pavarur CMA CGM Albania Sh.p.k.

Ndërmarrja e përbashkët CMA CGM Albania Sh.p.k, është krijuar në bazë dhe në zbatim të “Marrëveshjes së Ortakëve”, në të cilën shoqëritë Pelikan Sh.p.k dhe CMA CGM Agencies Worldwide kanë rënë dakord që të investojnë pjesë të kapitalit të tyre themeltar për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët CMA CGM Albania Sh.p.k, përkatësisht:

- Pelikan Sh.p.k është zotërues i 40% të kuotave të kapitalit themeltar;
- AMC AGM Agencies Worldwide, është zotërues i 60% të kuotave të kapitalit themeltar.

Ndërmarrja e përbashkët CMA CGM Albania Sh.p.k nuk do të funksionojë si një ndërmarrje për të bashkërenduar veprimtarinë e mëmave të saj, por si një ndërmarrje e përbashkët në përputhje të plotë me nenin 10.3 të Ligjit dhe për pasojë përbën një përqendrim në kuptim të tij.

2. Palët në transaksion

- 2.1. **Pelikan Sh.p.k**, në cilësinë e ndërmarrjes **mëmë**, është një shoqëri e cila funksionon në bazë të legjislacionit të Shqipërisë me seli në adresën: Rr. Egnatia, kulla “Fly”, Durrës. Shoqëria ushtron veprimtarinë në aktivitetin e Agjencisë Doganore, Agjenci Detare, Agjenci spedicionere në transportin detar, tokësor, automobilistik, transport mallrash dhe udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit si dhe çdo aktivitet tjetër i cili nuk bie ndesh me ligjin dhe është në dobi të shoqërisë.
- 2.2. **CMA CGM Agencies Worldwide**, në cilësinë e ndërmarrjes **mëmë**, është një shoqëri e cila funksionon në bazë të legjislacionit të Francës me seli në adresën: 4 Quai d’Arenc, 13002, Marseille, Francë. Objekti i shoqërisë është : (i) zotërimi i kompanive holding me qëllim për të përfaqësuar kompanitë e transportit detar dhe të mbajë komision prej tyre; (ii) të ndërmarrë përfaqësinë e të gjitha shoqërive të transportit detar dhe aktivitete të tjera transporti në treg; (iii) të blejë dhe të menaxhojë stoqet dhe aksionet në shoqëri; (iv) pajis , vë në veprim, ndërton , shet , blen dhe jep me qira të gjitha llojet e anijeve dhe realizon aktivitet të transportit të pasagjerëve; (v) krijon linja transporti detar dhe operon në të gjitha aktivitetet dhe trafiqet e transportit detar; (vi) ofron çdo lloj shërbimi tjetër në sektorin e operacioneve detare. CMA CGM është gjithashtu aktive në transportin e ngarkesave të

kontenierizuara nga deti përmes linjave të rregullta që veprojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe deri tani e ka ushtruar këtë aktivitet nëpërmjet shoqërisë Pelikan Sh.p.k.

- 2.3. **CMA CGM Albania Sh.p.k.**, në cilësinë e ndërmarrjes së re të pavarur, e cila do të ushtrorë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin e saj dhe me legjislacionin shqiptar. Objekti i saj do të jetë aktiviteti e import eksportit në fushën e transportit detar me kontejnerë.

3. Xhiro për vitin 2013

3.1. Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar**⁸⁰ është **XXX Lekë**:

- o **CMA CGM S.A.** : XXX \$⁸¹ = XXX Lekë

3.2. Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është **XXX Lekë**:

- o **CMA CGM S.A.** ⁸²: XXX \$ = XXX Lekë
- o **Pelikan sh.p.k.** ⁸³ : XXX Lekë

Sa më lart, palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin12, pika 1 të Ligjit.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

4.1. Tregu Përkatës:

C. Tregu përkatës i produktit:

Në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për përqendrimet dhe sipas veprimtarisë që kryejnë palët pjesëmarrëse në këtë transaksion, treg përkatës produkti do të konsiderojmë: Transporti detar i kontenierëve (import/eksport).

Tregu përkatës gjeografik: Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm / territori i Republikës së Shqipërisë.

80 Burimi: Banka e Shqipërisë Kursi mesatar për vitin 2013 1\$ = 105.67 lekë

81 Burimi: Raporti Vjetor 2013 CMA CGM Group, fq 3

82 Burimi: Formulari I Thjeshtuar I Njoftimit të Përqendrimit, Xhiro e realizuar nga CMA CGM s.a. në Shqipëri për vitin 2013, nëpërmjet degës së saj CMA CGM Agencies Worldwide

83 Burimi: Pasqyrat Financiare të Audituar viti 2013 Pelikan sh.p.k.

4.2. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

CMA CGM Albania sh.p.k. në mënyrë të pavarur nga aktiviteti i shoqërive mëma, duke mos cenuar dhe interferuar në asnjë rast veprimtarinë e tyre apo pozitën e tyre në treg, do të veprojë në cilësinë e agjentit të shoqërisë CMA CGM, duke pritur dhe trajtuar kontenierët e kësaj linje që mbërrijnë dhe nisen nga Shqipëria (import/eksport).

Shoqëria Pelikan sh.p.k. nga ana e saj, me krijimin e ndërmarrjes së përbashkët (JV) CMA CGM Albana sh.p.k., do të heqë dorë nga aktiviteti të cilin e kryente deri tani si agjent i shoqërisë CMA CGM dhe do të vazhdojë punën e saj në aktivitetet e tjera të transportit dhe logjistikës sipas Statutit dhe Akt Themelimit të saj.

Krijimi i shoqërisë CMA CGM Albani sh.p.k. nuk do të sjellë asnjë efekt në strukturën e tregut dhe konkurrencën në tregun vendas.

Me krijimin e kësaj shoqërie të re JV, palët besojnë se do të ketë rritje të përfitimeve në dobi të konsumatorëve në aspektin e rritjes së cilësisë së shërbimeve si edhe rritje të kapaciteteve transportuese.

CMA CGM S.A. do të vazhdojë aktivitetin e saj në transportin e ngarkesave të kontenierizuara (import/eksport) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me ndryshimin e vetëm se kontenierët e shoqërisë CMA CGM S.A që mbërrijnë dhe nisen nga Shqipëria që deri me tani janë trajtuar nga shoqëria Pelikan sh.p.k., me krimin e shoqërisë CMA CGM Albania sh.p.k. do të trajtohen prej saj.

Si konkluzion, ky përqendrim, pra krijimi i shoqërisë (JV) CMA CGM Albania sh.p.k. nuk do të sjellë ndryshime në strukturën e tregut dhe konkurrencën në tregun vendas.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye duhet të autorizohet në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur CMA CGM Albania Sh.p.k nga ndërmarrjet CMA CGM Agencies Worldwide dhe Pelikan Sh.p.k.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Eduart YPI

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr _____prot
27.11.2014

Tiranë, më

**V E N D I M
nr. 341 , datë 27.11.2014**

“Për vendosjen e një gjobe të lehtë ndaj shoqërisë “Pelikan” Sh.p.k për njoftimin jashtë afatit të përqëndrimit të realizuar me CMA CGMA Agencies Worldwide për krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|---------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |
| • | Eduard | YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 27.11.2014 shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Shqyrtimin e relacionit mbi përqëndrimin e realizuar mes ndërmarrjeve “Pelikan” Sh.p.k dhe CMA CGMA Agencies Worldwide për krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k.

Baza ligjore:

Nenet 10, 12, 24, *shkronja d*, neni 71 të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe rregullorja e Komisionit të Konkurrencës “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të :

-Raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi përqëndrimin të realizuar mes ndërmarrjeve Pelikan Sh.p.k dhe CMA CGMA Agencies Worldwide për krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k.

VËREN SE :

1. Autoriteti i Konkurrencës, në datën 3 Tetor 2014, me shkresën nr. 425 prot, nga përfaqësuesi i shoqërive Pelikan Sh.p.k dhe CMA CGMA Agencies Worldwide, ka marrë njoftimin për përqendrimin me objekt krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k.
2. Transaksioni që realizon krijimin e një ndërmarrje të re të pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k nga ndërmarrjet mëma Pelikan Sh.p.k dhe CMA CGM Agencies Worldwide, në kuptim të nenit 10/3 dhe 12 të Ligjit është përqendrim, që duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës.
3. Në këtë kuadër, ky transaksion i është nënshtruar procedurës së kontrollit të përqendrimeve, të parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të Ligjit dhe në “Rregulloren për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.
4. Përqendrimi i realizuar është njoftuar jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar në nenin 12 të Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës dhe në kuptim të nenit 73, pika 1, shkronja dh e Ligjit cilësohet si shkelje e lehtë. Në bazë të tij është e dënueshme më gjorbë në masën deri në 1 % të xhiros totale të vitit financiar paraardhës.
5. Megjithëse njoftimi është bërë jashtë afatit, sjellja e palës njoftuese ka qenë bashkëpunuese për të përmbushur detyrimet ligjore si për njoftimin ashtu edhe për dhënien e informacionit në lidhje me këtë procedurë të kontrollit të përqendrimit.
6. Nga verifikimi në QKR rezulton se shoqëria e re ende nuk është regjistruar në pritje të marrjes së autorizimit të Komisionit sipas nenit 14/1/a të ligjit dhe për këtë arsye konkludojmë se nuk ka patur efekte në treg.

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); nenit 12, pika 2, nenit 53, pika 1, gërma a, nenit 73, pika 1, gërma dh e Ligjit nr 9121“Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar) dhe nenit 12 të rregullores “Për gjordat dhe lehtësimin prej tyre”

V E N D O S I:

1. Të gjobisë me gjobë të lehtë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë shoqërinë “Pelikan” Sh.p.k si njoftuese e përqendrimit në krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k. të realizuar mes shoqërive “Pelikan” Sh.p.k dhe CMA CGMA Agencies Worldwide.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Eduard YPI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M
nr. 342, datë 27.11.2014**

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes
me shumicë të cigareve të fabrikuara”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|---------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |
| • | Eduard | YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 27.11.2014, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimit të raportit të grupit të punës mbi monitorimin e tregut të importit dhe tregut të shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d), 26 dhe 42, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës mbi monitorimin e tregut të importit dhe tregut të shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara dhe relacionit perkates te Sekretarit të Përgjithshëm;

VËREN SE :

- I. Nisur nga shqetesimet e percjella nga mediat e shkruara dhe vizive mbi rritjen e çmimit të cigareve në kushtet e pandryshuara fiskale, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e në vijim Ligji), ka monitoruar dhe analizuar kushtet e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.
- II. Tregu përkatës i produktit u përcaktua **tregu i cigareve të fabrikuara dhe analiza e konkurrencës është fokusuar në përcaktimin e strukturës së tregut**

të importit e shitjes me shumicë të cigareve dhe sjelljen ndaj çmimit sipas ndërmarrjeve importuese.

- III. Në përfundim të përpunimit të të dhënave të administruara nga ndërmarrjet, monitorimet në terren, evidentimit dhe vlerësimin e shqetësimeve të tregut gjatë mesit të muajit tetor, u arrit në përfundimin se tregu i importit të cigareve të fabrikuar paraqet karakteristikat e një tregu me përqendrim të lartë, ku dy ndërmarrjet kryesore kanë pjesë të konsiderueshme tregu duke zotëruar 77% të tregut e ndjekur. Nga struktura e tregut sipas markave u konstatua se në treg ofrohen një numër i madh markash ku dy marka kryesore zënë 49% të tregut.
- IV. Nga vlerësimi i problematikave të shfaqura në treg në lidhje me rritje e çmimit, kufizimin e ofertës si dhe shitje të kushtëzuara u vu re se tregu i shitjes së cigareve gjatë muajit tetor 2014 ka qenë nën ndikimin e ndryshimeve ligjore që pritet të prekin këtë treg, duke rritur në mënyre fiktive kërkesën konsumatore.
- V. Nga vlerësimi i deklaratave për çmimin e shitjes së cigareve të paketuara të depozituara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, vihen re ndërmarrje që kanë rritur thujtë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën masë 30 lekë, çmimet e shitjes me pakicë për pjesën më të madhe të markave, përpara hyrjes në fuqi të akcizës të parashikuar në datën 1 janar 2015.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24 (shkronja d), nenit 26 dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë cigareve të fabrikuar.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga muaji 1 janar 2014 – 31 dhjetor 2014;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)

Anëtar

Eduard

YPI

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

nr. 343, datë 04.12.2014

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të Landeslease Sh.a nga Union Bank Sh.a ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|---------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |
| • | Eduard | YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 04.12.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të Landeslease Sh.a nga Union Bank Sh.a.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”), neni 24, shkronja d, nenet 10-12, 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit” dhe “Udhëzimi mbi kontrollin e përqendrimit të ndërmarrjeve” .

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Union Bank Sh.a / Landeslease Sh.a ,

V Ë R E N S E:

I . Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të “Kontratave së shitblerjes së aksioneve të Landeslease Sh.a” lidhur më datë 25 Shtator 2014, ndërmjet aksionarëve të Landeslease Sh.a dhe Union Bank Sh.a, me objekt transferimin e 100% të

aksioneve të Landeslease Sh.a tek ndërmarrja Union Bank Sh.a. Marrëveshjet janë nënshkruar në të njëjtën datë dhe do të hyjnë në fuqi në ditën e mbylljes pasi të jenë plotësuar kushtet e përmbylljes sipas nenit 4.1 të kontratës së shitblerjes së aksioneve, ndër të cilat është dhe autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Transaksioni i transferimit të xxx% të aksioneve nga Landeslease tek Union Bank realizohet ndërmjet dy kontratave të veçanta me të njëjtin objekt 'transferimi i aksioneve të Landeslease'. Nëpërmjet kontratës së parë aksioneri maxhoritar Emerging Europe Leasing and Finance (EELF) B.V do të transferojë të gjithë zotërimin e tij prej 71% të kapitalit aksionar në Landeslease Sh.a tek Union Bank Sh.a dhe me anë të kontratës së dytë aksionerët e minorancës do të transferojnë zotërimet e tyre prej xx, xx% dhe xx% tek ndërmarrja Union Bank.

Ky transaksion është në përputhje të plotë me nenin 10.1.b) të Ligjit dhe për pasojë përbën një përqendrim në kuptim të tij.

II . Palët në transaksion

✚ **Union Bank Sh.a**, në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri e cila është themeluar dhe funksionon në bazë të legjislacionit të Shqipërisë me seli në adresën: Blv. Zogu Parë, Tiranë. Shoqëria ushtron veprimtarinë si më poshtë: (i) të pranojë dhe të grumbullojë depozita bankare, të japë kredi; (ii) të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve; (iii) instrumente të tregut të parave, letra me vlerë të borxhit, kontrata të së ardhmes dhe kontrata të së ardhmes dhe kontrata me kusht; (iv) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve; (v) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave; (vi) të ndërmjetësojë për transaksione monetare; (vii) të ushtrojë qira financiare.

Union Bank është regjistruar si institucion financiar/bankë tregtare më 28 Dhjetor 2005 dhe funksionon në përputhje të plotë me Liçencën dhe me Ligjin nr. 9662, datë 18 Dhjetor 2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" si dhe me të gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

✚ **Landeslease Sh.a**, në cilësinë e ndërmarrjes **target**, është një shoqëri e cila funksionon në bazë të legjislacionit të Shqipërisë, me seli në adresën: Rruga Themistokli Germezi, Ndertesa Sefbi, nr.10, Tiranë. Objekti⁸⁴ i shoqërisë është veprimtaria e qerese financiare në përputhje me ligjin për qiranë financiare.

III . Xhiro për vitin 2013

➤ Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar**⁸⁵

- Emerging Europe Leasing Finance : xxx Euro = xxxx Lekë:

84 Burimi, Ekstrakti Historik I shoqërisë.

85 Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013, 1 euro=140.26 lek

➤ Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është xxxx Lekë:

- Union Bank Sh.a : xxxx Lekë
- Unioni Financiar Tiranë : xxxx lekë
- Landeslease Sh.a : xxxx

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndyshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

IV . Analiza e konkurrencës

IV .1. Përcaktimi i tregut përkatës

- **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës në analizën e përqendrimit të ndodhur është konsideruar ‘**qiraja financiare/ leasing**’.
- **Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm**, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

IV .2. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Tregu i qirasë financiare është një treg shumë i përqendruar. Ai nuk paraqet pengesa domethënëse në hyrje për subjektet e reja të cilat duan të ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në të.

Ky transaksion nuk sjell asnjë ndryshim sa i takon pjesës së tregut që do të zërë Landeslease pas realizimit të transaksionit, pasi Union Bank nuk është prezente në këtë treg.

Si pasojë niveli i përqendrimit të tregut, struktura e tregut dhe fuqia e Landeslease në treg pas transaksionit ngelet e pandryshuar pas realizimit të transaksionit.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye duhet të autorizohet në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të Landeslease Sh.a nga Union Bank Sh.a.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Eduard YPI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R